



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 30 MARS 2023, TIRANË

**PROCESVERBAL**

**SEANCËN E DREJTON**  
**KRYETARJA E KUVENDIT**  
**LINDITA NIKOLLA**

*(Seanca filloi në orën 10:00)*

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 23.3.2023 *(neni 44, pika 2 e Rregullores)*

2. Njoftime *(neni 44, pika 3 e Rregullores)*

3. Interpelancë me Ministren e Financave dhe Ekonomisë, zonjën Delina Ibrahimaj, kërkuar nga deputetja, zonja Jorida Tabaku *(neni 80 i Kushtetutës dhe neni 96 i Rregullores së Kuvendit)*

4. Raporti i veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit (ERRU) për vitin 2022 *(neni 103, pika 2 e Rregullores së Kuvendit dhe neni 31 i ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës)*

Paraqitja e raportit nga kryetari i Komisionit Rregullator, zoti Ndrim Shani - jo më shumë se 20 minuta.

Shprehet për projektrezolutën Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Pyetje

Zhvillimi i debatit *(Nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë)*

5. Projektligji “Për tatimin mbi të ardhurat” *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, neni 155 të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin Europian.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

6. Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar (në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 21/1 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit)

7. Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar (në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 21/1 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit)

8. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’).

**Lindita Nikolla** – Mirëdita!

Hapim seancën plenare.

Në bazë të nenit 30 të Rregullores, ju bëj të njohur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

(Pasi lexon rendin e ditës)

Fillojmë me miratimin e procesverbalit të seancës plenare të datës 23 mars 2023.

Po, zonja Tabaku.

**Jorida Tabaku** – Zonja Kryetare, kisha diçka për procedurë sa i takon rendit të ditës.

Sot në rendin e ditës është projektligji “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili është depozituar në Kuvendin e Shqipërisë në fillim të këtij viti. Komisioni i Integritimit e diskutoi ligjin me prioritet, duke gjykuar se duhej të kalonte menjëherë në seancë si rezultat i efekteve financiare që kishte ky ligj, megjithëse, në mënyrë të gabuar, se duhej të kalonte me buxhetin. Po kush po pyet sot për zbatimin e ligjit dhe zbatimin e Rregullores së Kuvendit!

Komisioni i Integritimit, pasi e shqyrtoi dhe e miratoi në lidhje me përputhshmërinë me legjislacionin e Bashkimit European, pati diskutime të gjera në Komisionin e Ekonomisë dhe, sipas tabelës që unë kam, pati ndryshime thelbësore në përkufizimin e termave,

njëkohësisht edhe në përmbajtjen e ligjit. Nga analiza që ka bërë stafi i Komisionit të Integritimit, ky ligj duhej të kalonte edhe një herë në Komisionin e Integritimit për çështjet e përputhshmërisë. Konceptet e ligjit, termi “korporatë”, si dhe terma të tjerë që janë të përkrahur në këtë ligj, duhet ende të rishikohen sa i përket përputhshmërisë, sepse ka ndryshuar më shumë se 1/3-a e ligjit. Komisioni i Integritimit nuk është informuar që ky ligj do të kalonte në seancë, prandaj duhej patjetër që të ndiqej kjo procedurë parlamentare. Unë e kam ngritur këtë shqetësim edhe me shërbimet e Kuvendit, nuk e di nëse ju jeni njoftuar ose jo, kështu që unë kërktoj që për këtë ligj të ndiqet procedura e duhur parlamentare dhe të diskutohet në Komisionin e Ligjeve dhe në Komisionin e Integritimit për termat që kanë ndryshuar dhe për të parë përputhshmërinë me legjislacionin e Bashkimit European.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Zoti Shalsi.

**Eduard Shalsi** – Dy korrigjime që në krye të herës.

Së pari, ligji nuk ka ardhur këtë vit, por është depozituar në Kuvend në nëntor të vitit të kaluar. Kjo ishte për saktësim.

Së dyti, po bëhet praktikë, në fakt, gjë që mua po më bezdis edhe në Komisionin e Ekonomisë, që pas 3-4 muaj diskutimesh tejet intensive me grupet e interesit, ekspertët e fushës, sipërmarrës ose jo, në takime me të cilët ju nuk keni qenë të pranishëm, në minutën e fundit dilni me disa propozime. Vazhdimisht shërbimet e Kuvendit, këshilltarët e komisionit dhe vetë komisioni ka azhurnuar në lidhje me të gjitha ndryshimet për të cilat ka pasur debat dhe sot kemi një draft final. Nëse shërbimet e Komisionit të Integritimit, të cilat kanë qenë shumë të azhurnuara, në dijeninë time, kanë pasur shqetësime të tilla, atëherë po ju jap praktikën e Komisionit të Ekonomisë, kur nuk është komisioni përgjegjës. Këshilltarët e Komisionit të Ekonomisë ndjekin diskutimin e ligjit në komisionin përgjegjës dhe nëse konstatojnë shqetësime, i sjellin në vëmendjen e kryesisë së komisionit, dhe më tej është kryesia që komunikon me komisionin përgjegjës.

Pra, edhe aspekti procedural i komunikimit është i tillë që nuk pret ditën kur ligji do të diskutohet në Kuvend, apo siç ndodhi me 2-3

kolegë në mbledhjen e komisionit që, pas 3 muajsh, ditën e fundit shfaqën të bënin disa objeksione. Kjo është e drejta e tyre, por procesi nuk është serioz. Po ju them se debatet konstruktive me të gjithë aktorët kanë qenë tejet intensive dhe e kam çmuar dhe e çmoj, madje kam dashur që edhe ju të bëheshit pjesë, sepse është një ligj që ndikon në perspektivën e ardhshme, në filozofi dhe ndryshon edhe qasjen e sistemit tatimor, i cili ndryshohet pas shumë vitesh. Pra, është bërë një punë voluminoze, kjo për shkak të seriozitetit, kështu që duhet që edhe qasja të jetë serioze.

Unë mendoj që nuk kemi se çfarë të ezaurojmë, përveçse të themi që është bërë një punë voluminoze dhe intensive debatesh. Nuk kemi rënë dakord për gjithçka, më duhet ta them edhe këtë, madje edhe unë vetë kam disa pikëpyetje që do t'i shohim kur të aplikohet ligji, por ama gjatë 3-4 muajve kemi qenë në diskutime dhe kontakte intensive me të gjithë ata që kanë dashur të thonë një fjalë për ligjin.

Faleminderit!

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)*

**Lindita Nikolla** – Nuk do të vazhdojmë ta kthejmë në debat, kështu që diskutimi mbyllet këtu.

Vijojmë me rendin e ditës. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 23 mars 2023.

A ka vërejtje për procesverbalin? Nuk ka. Miratohet.

Vijojmë me njoftimet.

Ju njoftoj se në Kuvend gjatë kësaj jave janë depozituar 5 akte nga Këshilli i Ministrave dhe 2 raporte vjetore. Titujt e çështjeve të depozituara i gjeni në sistemin këtu në sallë, ndërsa materialet në sistemin *e-parlament* dhe në faqen e Kuvendit në internet.

Në bazë të kërkesës së deputetëve Agron Gjekmarkaj dhe Ervin Saliçani, ata do të bëhen pjesë e grupit të miqësisë Shqipëri-Australi.

Ju njoftoj se një grup deputetësh, në bazë të nenit 103, pika 8 e Rregullores, kanë paraqitur kërkesën për diskutime për pikën e katërt të rendit të ditës të seancës së sotme, datë 30.3.2023: raporti i veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit për vitin 2022. Konferenca e Kryetarëve, në zbatim të nenit 103, pika 8 e Rregullores së Kuvendit, vendosi që koha e debatit për çështjen e mësipërme, sipas edhe përvojës parlamentare, të

jetë 1 orë e 30 minuta. Në bazë të nenit 48, pika 3, koha 1 orë e 30 minuta do të ndahet në mënyrë përpjesëtimore ndërmjet grupeve, si më poshtë vijon: Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, 45 minuta; Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, 20 minuta; Grupi Parlamentar Aleanca për Ndryshim, 5 minuta; Grupi Parlamentar Demokraci për Integritim, 5 minuta; deputetët jashtë grupeve parlamentare në total 14 minuta, Partia e Lirisë, 5 minuta dhe Partia Socialdemokrate, 5 minuta.

Vijojmë me rendin e ditës. Interpelancë...

Po, zoti Spaho.

**Edmond Spaho** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Duke marrë shkas nga njoftimi juaj, doja të dija se pse për pothuajse 2 vjet rresht nuk jam i përfshirë në asnjë delegacion parlamentar dhe asnjë grup miqësie? Apo disa janë dhe disa jo?

**Lindita Nikolla** – I kemi shpallur delegacionet e përhershme.

**Edmond Spaho** – Nuk jam në asnjë delegacion të përhershëm dhe në asnjë grup miqësie.

**Lindita Nikolla** – Delegacionet janë bërë në bazë të grupeve parlamentare, megjithatë ju mund bëni kërkesën tuaj për grupet e miqësisë dhe...

**Edmond Spaho** – Unë i kam bërë kërkesat.

**Lindita Nikolla** - ...ne patjetër do t'i shikojmë dhe do t'i respektojmë sa u takon grupeve të miqësisë.

Faleminderit!

Interpelancë me ministren e Financave dhe Ekonomisë, zonjën Delina Ibrahimaj, kërkuar nga deputetja Jorida Tabaku. Interpelanca kërkohet bazuar në nenin 80 të Kushtetutës dhe të nenit 96 të Rregullores së Kuvendit dhe ka si objekt, dhënien e informacioneve mbi fondet për procesin e rindërtimit.

Fillojmë duke përcaktuar minutazhin e përcaktuar në nenin 96, pika 5 e Rregullores.

Zonja Tabaku, keni të drejtën për të parashtruar interpelancën deri në 7 minuta.

**Jorida Tabaku** – Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Në fakt, unë e kam kërkuar këtë interpelancë pak muaj më parë, duke u bazuar edhe në të dhënat e raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por edhe menjëherë pas diskutimit të buxhetit dhe vetëm sot kemi mundësi ta diskutojmë.

Në vitin 2019, një tërmet tragjik goditi Shqipërinë, ku 81 shqiptarë humbën tragjikisht jetën, ndërsa mbi 3000 të tjerë u plagosën.

Së pari, duke qenë se sot është edhe Dita e Mjekut, unë dua të tregoj respektin, por njëkohësisht të shpreh edhe falënderimet maksimale për të gjithë mjekët dhe infermierët që morën pjesë në shpëtimin e jetës së shqiptarëve, kjo edhe gjatë periudhës së pandemisë.

Qeveria shqiptare me pompozitet të madh në fillim të vitit 2020 mori pjesë në një konferencë donatorësh organizuar nga Bashkimi Europian, dhe jo vetëm, për të përfituar një shumë prej pothuajse 1,15 miliardë eurosh, na u tha në atë kohë, nga të cilat 295 milionë euro në formën e granteve dhe 853 milionë euro në formën e kredive të buta.

Ndërkohë, u vendos si afat përfundimtar për procesin e rindërtimit viti 2021. Sigurisht, atëherë ish-zëvendëskryeministri në një interpelancë me kolegun Xhaferraj deklaroi se procesi ka përfunduar.

Pas fatkeqësisë, qeveria shqiptare ngriti Ministrinë e famshme të Rindërtimit për të mbarëvajtur procesin e rindërtimit, por, ndërkohë që ne po flasim as Ministria e Rindërtimit dhe as Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk kanë një bilanc dhe as të dhëna konkrete se sa u ka kushtuar ky proces shqiptarëve.

Në fakt, sot shqiptarët, pak muaj para zgjedhjeve, po kalojnë pikërisht atë që kaluan pak muaj para zgjedhjeve të 2 vjetëve më parë: mëshirën e qeverisë. Qeveritarët janë ringritur, janë rilindur dhe janë kujtuar se ka ndodhur një tërmet këtu e 4 vjet të shkuara, duke e përdorur përsëri, ashtu siç u shprehën edhe përfaqësuesit e OSBE-ODIHR-it, çështjen e fatkeqësisë, të jetëve të humbura dhe procesin e rindërtimit për propagandën e tyre të ditës, për biznesin e ditës, por njëkohësisht edhe për reklamën e ditës.

Ndërkohë që jemi duke folur nuk kemi asnjë informacion se sa është fondi që është shpenzuar, sikundër na mungojnë të dhënat totale për kostot e këtij procesi. Sa është fatura e rindërtimit në total? Sa është vlera totale e fondeve të vendosura me vendime të Këshillit të Ministrave?

Në 3 vjet e gjysmë ne nuk kemi arritur të kuptojmë realisht sa është kjo vlerë, sepse ish-ministri i Financave dhe i Rindërtimit, i cili ka qenë edhe përgjegjës, ka thënë se ky ka qenë një proces dinamik, i cili ka nisur me 5 milionë euro

dhe ka përfunduar me 800 milionë euro, që ndryshon, siç i kanë ndryshuar shifrat këtij ish-ministri edhe për shumë gjëra të tjera.

Në vitin e katërt pas fatkeqësisë, në mars të vitit 2023, qeveria ka miratuar buxhetin dhe, sipas shifrave të konsoliduara, kanë thënë se janë harxhuar 75 miliardë lekë, ndërkohë që në vitin 2020 ishin shpenzuar 16,6 miliardë lekë; në vitin 2021 janë 29,5 miliardë dhe në vitin 2022, 28,9 miliardë lekë e kështu me radhë, ndërsa këtë vit kanë vendosur në buxhet 5 miliardë lekë.

Jua thashë këto shifra për transparencë, por edhe për të kuptuar se ndërkohë që jemi duke folur qeveria shqiptare ka hapur tenderë, të cilët shkojnë në një vlerë reale prej pothuajse 1,1 miliardë eurosh, i ka tenderuar të gjitha këto, ndërkohë që ka miratuar shpenzime buxhetore 400 milionë euro më pak se kjo vlerë, 400 milionë euro, të cilat nuk janë në buxhetin e shtetit, por janë tenderuar në mënyrë korruptive dhe abuzive.

Së dyti, në buxhetin e qeverisë thuhet se pothuajse 11% e këtyre fondeve do të vijnë nga Konferenca e Donatorëve. Sa është lista e të gjitha marrëveshjeve që ka nënshkruar qeveria shqiptare? Si janë detajet e këtyre marrëveshjeve? A janë ato publike dhe të aksesueshme? A ka marrë Shqipëria eurobond me norma interesi 3,75% për fondet e rindërtimit, ndërkohë që ka pasur kredi të buta me 1% dhe 2% dhe nuk i ka shfrytëzuar? Kush mban përgjegjësi për koston e shkaktuar në buxhetin e shtetit, por edhe për këtë kosto shtesë, sigurisht përveç atyre abuzive që përmenda pak më parë?

Qeveria shqiptare thotë se ka nënshkruar 277 milionë euro nga grantet, por ndërkohë nuk ka asnjë detajim për këto, e njëjta gjë edhe për kreditë e buta. A janë raportuar dhe ekzekutuar këto grante? Si është procesi i transparencës në lidhje me përdorimin dhe ekzekutimin e këtyre fondeve? A kanë lidhje këto donacione me detyrimet e prapambetura, që ka krijuar qeveria shqiptare si pasojë e keqmenaxhimit të këtyre fondeve?

Ligji për buxhetin e shtetit na tregon që viti 2023 do të jetë viti i fundit për paketën e rindërtimit. Sigurisht, kjo është një dëshirë për të gjithë shqiptarët, sepse unë jam e sigurt që sa herë të ketë zgjedhje, kjo do të kalojë në pikën e parë të rendit të ditës.

Ndërkohë, sot që po flasim, vazhdojnë dhe hapen tenderë edhe për banesat individuale, për

procesin e rindërtimit, por edhe për objekte të tjera. Falë Zotit, njëkohësisht edhe për të mirën e shqiptarëve, një pjesë e madhe e fondeve të donatorëve u koordinuan vetë nga Bashkimi Europian me fondin *EU4Culture*, *EU4School* dhe u zbatuan nga vetë ata me kosto shumë të ulëta, pothuajse 800 mijë euro një shkollë, ndërkohë që ekuivalentja e tenderuar nga qeveria shqiptare ka qenë pothuajse 4,2 milionë euro. E njëjta gjë edhe për fondet, të cilat vinin për sektorin e kulturës. Pse ndodh kjo mospërputhje e madhe kostosh? Sepse qeveria shqiptare tenderon 4-5 herë më shtrenjtë se fondet që koordinohen dhe menaxhohen nga donatorët. Pse qeveria shqiptare përdor çdo krizë në funksion të zgjedhjeve?

Ndërkohë që jemi duke folur, sot banorët e “5 Majit”, të Oxhakut dhe të Kombinatit, pasi kanë jetuar 3 vjet në banesat e tyre, u është thënë dilni nga shtëpia, sepse banesat tuaja kanë qenë të pasigurta dhe se pallatet do të shemben për interesa klienteliste. Nuk u kujtua askush pas tërmetit, as 1 apo 2 vjet pas tërmetit, por u kujtuan sot për ta përdorur këtë proces, siç e kanë përdorur në krye të herës, edhe një herë për të bërë biznes me jetën, me fatkeqësitë dhe me fondet e shqiptarëve.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zonja Ibrahimaj, duke pasur mundësi për të dhënë shpjegime.

Koha që keni në dispozicion është deri në 20 minuta.

**Delina Ibrahimaj** - E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Kjo është pamja e Thumanës në agim të 26 nëntorit. Është një pamje, e cila nuk do të shqitet nga mendja e të gjithë shqiptarëve, pasi tronditi jo vetëm gjithë Shqipërinë, por gjithë botën. Në ato ditë të tmerrshme ne patëm dhe treguan një solidaritet të madh si popull, një solidaritet, i cili nuk u ndie vetëm brenda kufijve të Shqipërisë, por edhe jashtë saj. Të gjitha frazat që u parashtruan, pompoziteti apo propaganda elektorale janë fraza që nuk i përkasin këtij procesi. Të gjithë shqiptarët e kanë parë se si qeveria, biznesi dhe të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë u ngritën në këmbë dhe u bashkuan me solidaritet maksimal, me qëllim që t’u gjendeshim pranë të gjithë personave e të dëmtuarve të asaj rrethane tragjike.

Biznesi u ngrit në këmbë duke hapur dyert. Të gjitha hotelet e zonës së Tiranës, Durrësit, Lezhës, por edhe të Pogradecit, Korçës e të Vlorës treguan solidaritet maksimal duke hapur portat e tyre dhe duke mirëpritur të gjithë të dëmtuarit nga tërmeti.

Nuk jam këtu të flas për solidaritetin e qeverisë dhe se çfarë bëri qeveria, pasi qeveria, sigurisht, e ka për detyrë që t’i gjendet pranë çdo shqiptari në çdo moment. Kjo ishte ajo që ne bëjmë. Nga ana tjetër, të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë na ndihmuan jo vetëm në Konferencën e Donatorëve, por që në ditët e para në operacionet e kërkim-shpëtimit, në dhënien e granteve, si qeveri apo si individë të veçantë, që përfaqësonin shtetet dhe që e ndienin atë që po i ndodhte Shqipërisë.

Të nderuar deputetë,

Kjo është Thumana sot, Thumana e rilindur! Thumana, e cila nisi rrugën e transformimit të pakthyesëm vetëm 8 muaj pas ngjarjes tragjike. Sot Thumana është kthyer në një model zhvillimi të qëndrueshëm urban dhe social. Sot mund të thuhet me plot gojën se shumë lagje të vendit tonë do të donin të ishin si Thumana dhe të kishin këtë nivel infrastrukturor. Ndaj ne, ju dhe të gjithë shqiptarët, nuk duhet të harrojmë se çfarë lamë pas, se si e gjetëm forcën për t’u ringritur mbi ato rrënoja dhe se si po punojmë çdo ditë për t’i bërë zonat që u prekën nga tërmeti, por edhe të gjithë Shqipërinë, më të zhvilluar për qytetarët sot, por edhe për brezat që do të vijnë.

Unë nuk e di se ku e gjejmë forcën për të thënë se tërmeti përdoret vetëm në momente fushatash apo për qëllime elektorale. Unë nuk e di se si mund të harrohet që fill pas tërmetit ne u prekëm nga pandemia dhe fill pas kapërcimit të pandemisë ne, si e gjithë bota, u prekëm nga kriza e çmimeve të energjisë dhe e konsumit, të shkaktuara nga lufta. Këto nuk janë ngjarje, të cilat mund të merren në mënyrë të veçuar. Ekonomia e vendit dhe masat që merr qeveria për të përballuar të gjitha ato që ndodhin, nuk mund të merren si të veçanta dhe të shkëputura.

Ju në parashtrimin tuaj thatë se i gjithë procesi i rindërtimit duhet të përfundonte brenda vitit 2021. Po, vërtet duhet të përfundonte brenda vitit 2021, por a mund ta parashikonim në dhjetor të vitit 2019 se në vitin 2020, pra në pranverë të vitit 2020, e gjithë bota do të mbyllej, të gjitha punimet do të ndërpriteshin, e gjithë tregtia do të ndërpritej dhe që e gjithë bota do të shkonte në

recesion? Jo, këtë nuk mund ta parashikonim dot. E megjithatë, sot që flasim ne kemi një proces rindërtimi, i cili po vazhdon me ritme të shpejta, ndonëse ka pasur dy kriza të njëpasnjëshme pas situatës tragjike që na u desh të përballonim.

Megjithatë, kjo është një arsye pse unë dua ta falënderoj deputeten Tabaku, që e kërkoi këtë interpelancë, me të cilën na jep një mundësi që ne të bëjmë një parashtrim të të gjithë atyre që kanë ndodhur këta 3 vjetët e fundit, pra se si ne arritëm të transformonim lagje të tëra, se si arritëm t'u jepnin një strehë qindra e qindra familjeve, por edhe shpresën për një të ardhme më të mirë. Ne, gjatë këtyre viteve të fundit, kemi treguar se kontrata që ne kemi me qytetarët është gjëja më vyer, është angazhimi ynë më i madh, është ajo që na motivon drejt reformave. Ne nuk qeverisim vetëm për ata që na kanë votuar, por qeverisim për të gjithë shqiptarët.

Tërmeti masiv i vitit 2019 ndikoi fort në pronën e mbi 200 mijë qytetarëve shqiptarë, ndikoi në aspektin social dhe ekonomik të vendit dhe këto ndikime ishin mjaft negative. Për fatin tonë të keq, ne humbëm jetë njerëzish, por pati edhe shumë lëndime dhe dëmtime. Vendi humbi kapital fizik. Një ndër vlerësimet që u bë sapo përfundoi tërmeti ishte që tërmeti kishte shkaktuar një dëm total prej 1 miliard eurosh ose 120 miliardë lekësh. Sa për t'ju vënë në kontekst, 120 miliardë lekë janë 40% e investimeve totale të vendit tonë apo 2 vjet investime me mbështetje buxhetore me financim të brendshëm.

984 milionë euro u llogaritën dëmet për strehimin, prodhimin, arsimin, infrastrukturën, mbrojtjen civile dhe shëndetësinë. Nga këto, 696 milionë u llogaritën si dëme dhe humbje vetëm në strehim, 11 490 njësi banimi u kategorizuan si të shkatërruara plotësisht ose të dëmtuara dhe që duhet të rindërtoheshin, 83 745 njësi të tjera banimi u dëmtuan pjesërisht ose lehtë me nevoja për riparim.

Në kushtet e emergjencës dhe menjëherë pas ngjarjes qeveria shqiptare u angazhua tërësisht përmes mekanizmit të fondit rezervë të buxhetit të shtetit, duke ndërmarrë një sërë masash të menjëhershme në seri kohore të ndryshme. Një fond prej 200 milionë lekësh u akordua me qëllim rikonstruksionin dhe rindërtimin e shtëpive të dëmtuara në qarqet Tiranë, Durrës dhe Lezhë; një fond prej 270 milionë lekësh u akordua me qëllim sigurimin e akomodimit të përkohshëm në hotele

për të dëmtuarit në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë.

Dua të ndalem pak këtu, pasi si në asnjë vend tjetër të botës, në një kohë rekord, të dëmtuarve nga tërmeti iu dha mundësia të akomodoheshin nëpër hotele dhe jo të qëndronin në çadra për muaj e vite. Ata që vendosën të qëndronin nëpër çadra, sepse donin të qëndronin pranë pronës së tyre, e patëm zgjedhje të lirë dhe jo të detyruar.

Një fond prej 70 milionë lekësh u akordua për përballimin e shpenzimeve, për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve. Për realizimin e të gjitha programeve të procesit të rindërtimit, në ligjin për buxhetin për periudhën 2019-2023, u sanksionua krijimi i fondit të rindërtimit, burimet e financimit të të cilit ishin mjetet financiare dhe/ose kontributet në natyrë të dhëna nga buxheti i shtetit dhe donatorët. Janë 101,9 miliardë lekë fonde të akorduara nga buxheti i shtetit për transferta tek individët dhe projektet e investimit publik, nga të cilat 73 miliardë lekë është realizimi faktik për periudhën 2019-2022 dhe 5 miliardë lekë është plani për vitin 2023; 8,8 miliardë lekë janë fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirave të strehimit të përkohshëm të familjeve të dëmtuara, nga të cilat 500 milionë lekë janë në plan për vitin 2023; 2,5 miliardë lekë janë grante të huaja apo hyrje në *cash*, të cilat janë përdorur për këtë proces.

Pra, nga pikpamja financiare, sa i takon planifikimit dhe disbursimit të fondit të rindërtimit, janë 117,6 miliardë lekë fonde me vlerë të plotë, të miratuara me VKM për kompensime, projekte dhe investime. Janë 75,5 miliardë lekë, të cilat aktualisht janë realizuar. Pra, niveli faktik i realizimit është 75,5 miliardë për periudhën 2020-2022. 42 miliardë lekë është nevoja për financim shtesë, e cila mbetet pas vitit 2023.

Duhet theksuar se një kosto të konsiderueshme financiare, të mbuluar tërësisht nga buxheti i shtetit, ka sjellë edhe politika e subvencionimit të qirasë për strehimin e familjeve të dëmtuara. Në vitin 2020, numri i familjeve përfituese nga politika e strehimit, pra e subvencionimit të qirasë, ishte rreth 14 100, ndërsa sot janë 8 400 familje që marrin bonusin e qirasë me një vlerë mesatare prej 20 mijë lekësh në muaj.

Përgjatë periudhës 2020-2022 janë 8,4 miliardë lekë, të cilat janë financuar për këtë qëllim dhe për vitin 2023 janë planifikuar 500 milionë lekë. Vazhdimi i këtij programi do të varet në mënyrë thelbësore nga ritmet e përfundimit të pjesës më të madhe të projekteve të nisura.

Nëse do të ndaleshim tek alokimet sipas viteve, për programin e rindërtimit janë përdorur: 540 milionë lekë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit në vitin 2019; 16,7 miliardë lekë në vitin 2020; 29,7 miliardë lekë në vitin 2021 dhe 29,1 miliardë lekë në vitin 2022. Ndërsa, siç thashë edhe më parë, për vitin 2023 janë planifikuar 5 miliardë lekë. Ky fond do të përdoret i tëri për të financuar projektet në vazhdim dhe ata që kanë një ecuri më të mirë. Ajo që mund të them, dhe që është shumë e rëndësishme, është se aktualisht ne nuk kemi asnjë faturë të papaguar për projektin, nuk kemi detyrime të prapambetura të krijuara nga procesi i rindërtimit.

Më lejoni të qartësoj se fondet e rindërtimit janë kaluar me ligj të veçantë dhe rrjedhimisht, procesi i buxhetimit të projekteve, që lidhet me to, ka qenë i ndryshëm nga procesi i buxhetimit të të gjithë projekteve të tjera të investimit që parashikon ligji për menaxhimin buxhetor. Projektet e investimit nuk kanë qenë pjesë e projektbuxhetit afatmesëm.

A ishte e mundur që në vitet 2019 dhe 2020 ne të kishim një parashikim të saktë për fondet dhe projektet që do të nisnin, kur vlerësimet ende nuk ishin përfunduar dhe ishin në proces? Arsyeja pse ne krijuam këtë fleksibilitet në procedurat buxhetore ishte nevoja dhe urgjenca që kishim për të filluar proceset e investimeve. Ne nuk mund të parashikonim sa do të ishte kostoja totale e çdo godine apo e çdo projekti.

U tha këtu dhe u përsërit se fondet e rindërtimit janë tenderuar. Sigurisht që janë tenderuar. Të gjitha fondet e rindërtimit janë tenderuar, si çdo projekt tjetër që tenderohet në Shqipëri dhe jashtë saj. A ka procedura pa tender? Nuk mund të ketë procedura pa tender. Të gjitha janë tenderuar dhe janë subjekte të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe enteve që janë përgjegjëse për të kontrolluar ato fonde.

Gjithashtu, u tha këtu se projektet e tenderuara të rindërtimit janë 3 apo 4 herë më të shtrenjta se ato që janë financuar nga donatorët e huaj apo BE-ja. Kjo është një tjetër gënjeshtër e

madhe. Unë ju ftoj që, kur bëni këto supozime, të sillni shifra për projektet konkrete, me sipërfaqe konkrete dhe jo me supozime të dëgjua nëpër ambiente të ndryshme apo kafene, apo nuk e di se ku i dëgjoni. Unë kam fakte të cilat tregojnë se nuk është kështu. Ndaj do të doja të dëgjoja faktet tuaja.

Programi ynë i rindërtimit ka në thelbin e tij një dimension të qenësishëm social, ku përfituesit kanë qenë: 38500 përfitues nga nënprogrami “Grante rikonstruksioni”; 1800 përfitues nga nënprogrami “Grante rindërtimi”. Këto janë nga grantet për rikonstruksionin. Ndërkohë, sa i takon angazhimin përmes buxhetit të shtetit, për ndërtimin e objekteve të reja: nga nënprogrami i rindërtimit të banesave individuale nga njësitë zbatuese, por edhe donatorët, është financuar rindërtimi i 2552 banesave individuale; nga nënprogrami i rindërtimit të banesave kolektive është financuar rindërtimi i 299 banesave kolektive; janë financuar 216 banesa kolektive dhe 12 banesa individuale; janë rikonstruktuar 2001 banesa kolektive. Sa i takon infrastrukturës publike kanë përfunduar 9 kantiere në zonat e reja për zhvillim; janë 182 objekte arsimore të përfshira në programin e rindërtimit dhe 34 institucione dhe vepra publike të financuara nga fondi i rindërtimit.

Me qëllim realizimin me sa më pak kosto të këtij projekti, ne ndërmorëm një tjetër nismë, atë të përjashtimit të TVSH-së nga i gjithë procesi i rindërtimit dhe të gjitha furnizimeve të lidhura me rindërtimin. Pra, produkti për rindërtimin, i porositur nga entet shtetërore apo strukturat e pushtetit lokal, është përjashtuar nga 20 %-shi i TVSH-së, çka nënkupton uljen e kostove të ndërtimit.

Askush nuk u la vetëm, ne zgjodhëm të mbështesnim këdo dhe t’iu gjendeshim pranë qytetarëve dhe sipërmarrjes. Fatura financiare që duhet të paguam, ishte e lartë. Janë rreth 75,5 miliardë lekë të shpenzuara deri në fund të vitit 2022, vetëm nga buxheti i shtetit. Kjo shumë u financua si nga shkurtimi i shpenzimeve dhe investimeve të tjera, po ashtu edhe nga huamarrja.

Dua të ndalem pak te huamarrja, sepse dëgjova pak më parë që u parashtrua se ne kemi marrë eurobond për të financuar rindërtimin dhe se nuk kemi përfutur nga kreditë e vëna në dispozicion në Konferencën e Donatorëve, pasi

eurobondi, sipas gjykimit tuaj, është shumë më i shtrenjtë se kreditë e vëna në dispozicion.

Dua të bëj një qartësim për ju dhe për publikun: kreditë koncesionare, kreditë e marra apo të premtuara në Konferencën e Donatorëve, janë kredi me norma variabël interesi, janë kredi të cilat, përgjithësisht, negociohen vit pas viti dhe norma e interesit përcaktohet nga euribori dhe një marzh fiks mbi euriborin. Sigurisht që, para dy vitesh euribori ishte negativ dhe ato kredi mund të ishin mjaft pozitive në terma financiarë për qeverinë shqiptare, por sot, pas tre vjetësh, po ato kredi janë më norma më të larta se eurobondi prej 3,75%, pasi eurobondi merret me normë fikse dhe krijon një parashikueshmëri më të madhe se kreditë koncesionare, që sigurisht janë më të mira se çdo lloj kredie tjetër, por norma ndryshon vit pas viti. Pra, nuk kemi marrë borxh më të shtrenjtë.

Nga ana tjetër, dua të ndalem te procedurat e financimit të projekteve që financohen me financim të huaj. Urgjenca dhe nevoja për të filluar menjëherë punën për rikonstruksionin, për rindërtimin e banesave dhe institucioneve na ndikoi zgjedhjen e financimit të këtyre projekteve me buxhetin e shtetit, pasi procedurat që financohen nga BE-ja apo donatorë të tjerë, janë procedura që zgjasin shumë më shumë se procedurat shtetërore. Këtu mund të marr shembullin e shkollave, të cilat nuk po ndërtohen me fondet e buxhetit të shtetit, pasi shkollat që u rindërtuan me fonde të buxhetit të shtetit kanë përfunduar, ndërkohë që shkollat me financim të huaj sapo kanë filluar të ndërtohen për shkak të procedurave. Pra, është nevoja dhe emergjenca që na kanë detyruar ne të angazhojmë buxhetin e shtetit dhe të mos angazhojmë kreditë, për shkak të procedurave të zgjatura. Kjo nuk do të thotë që ne ato kredi nuk i duam dhe që kanë humbur. Ato kredi do të kanalizohen për projekte të tjera dhe të mëdha investimi, që do të realizohen në të ardhmen.

Në diçka tjetër që dua të ndalem, para se të përfundoj fjalën time, është t'ju them se nuk është e vërtetë që ky nuk është një proces transparent. Ju erdhët këtu dhe përmendët shumë shifra, të cilat Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka vënë në dispozicion të Kuvendit dhe të kujt do që ka kërkuar informacion, sa herë që janë kërkuar. Ne kemi një transparencë maksimale për përdorimin e fondeve dhe çdokush, çdo qytetar e

deputet mund të interesohet se sa janë disbursuar, sa janë planifikuar, sa është kostoja totale më vendime të Këshillit të Ministrave.

Pra, është e rëndësishme të mos hidhet baltë mbi një proces për të cilin qeveria shqiptare ka marrë përgëzime dhe merita për mënyrën si është krijuar, për mënyrën si është menaxhuar dhe për mënyrën si po zbatohet.

Unë dua ta përmbyll fjalën time duke ju thënë se është e lehtë të hedhësh baltë, është e lehtë të bësh supozime, por nuk është e lehtë t'i vësh shpatullat çdo gjëje që ndodh. Dua t'ju rikujtoj edhe një herë se kjo është Thumana sot dhe ky është vizioni ynë për përballimin e atyre që na ndodhin.

Faleminderit.

**Lindita Nikolla-** Zonja Tabaku, mund të shpreheni lidhur me përgjigjet e zonjës ministre. Koha në dispozicion deri në 15 minuta.

**Jorida Tabaku** – Të nderuar qytetarë,

Unë shpresoj të ketë qenë një lapsus i ministres dhe shpresoj të mos i ndodhë asgjë e keqe këtij vendi, sepse më shumë se i ka rënë, nuk do t'i bjerë. Por ministrja është kaq largpamëse sa parashikon edhe shumë gjëra të tjera që mund të ndodhin në vijim.

Unë, në fakt, kam shumë vite në parlament dhe ndjej një keqardhje shumë të madhe kur dëgjoj ministra, që nuk janë deputetë të zgjedhur, të cilët vijnë dhe flasin këtu me një arrogancë të jashtëzakonshme dhe që bëhen të gjithë *copy-paste* e liderit. Kjo është fatkeqësia më e madhe e politikës shqiptare.

Kur ti pret që një ministre e Financave të vijë dhe të flasë me shifra, me fakte, me vendime qeverie, ajo vjen dhe tregon fotografi. Unë nuk arrij dot të konceptoj si mund t'u përgjigjesh pyetjeve për kostot me fotografi. Si mundet dikush, që duhet të mbajë përgjegjësinë, barrën për buxhetin e shtetit, të sillet si sillen të gjithë, sikur janë piktorë! Këtë nuk arrij dot ta kuptoj. A kemi shtetarë apo jo?!

Arroganca dhe paaftësia nuk duhet të jenë arsyeja që ne të abuzojmë me buxhetin e shtetit, që ne të shkelim buxhetin e shtetit, madje të abuzojmë me të edhe për qëllime elektorale. Dhe kjo, pikërisht ka ndodhur edhe me procesin e rindërtimit.

Ndërkohë që zonja ministre fliste, mua më vinin mesazhe nga qyteti i Laçit. Qytetarë të tërë më shkruanin se vetëm ngaqë nuk kanë votuar



Partinë Socialiste, nuk kanë përfituar nga procesi i rindërtimit. Në Zall Herr dhe në Zall Bastar kanë marrë shpërblime persona që nuk janë prekur nga procesi i tërmetit dhe nuk kanë marrë ata që u janë rrëzuar shtëpitë.

Kam këtu deputeten e Fushë-Krujës, e cila ka shkuar disa herë në Thumanë, ka shkuar edhe kur ka ndodhur fatkeqësia, ashtu sikurse kanë shkuar edhe deputetë të tjerë të opozitës në momentin që ka ndodhur fatkeqësia, pa e përdorur fatkeqësinë për biznes, pa e përdorur krizën për përfitimin e ditës, por për qytetarët shqiptarë dhe duke iu drejtuar qytetarëve shqiptarë.

Unë e pyeta ministrin sa ka kushtuar procesi i rindërtimit, dhe ministrja m'u përgjigj: "I çuam në hotele me 5 yje". Ju lutem, kë duhet të pyes unë nga qeveria shqiptare se sa ka kushtuar procesi i rindërtimit?! Si ka mundësi që janë tenderuar 1,2 miliardë euro, ndërkohë që, siç tha ministrja, janë paguar, por njëkohësisht edhe shpenzuar pothuajse 700 milionë euro? Kë duhet të pyes unë për këtë? Kush mban përgjegjësi? Unë pak më parë thashë shifrën 400 milionë euro, por kjo shifër qenka më e lartë. Kush mban përgjegjësi që ka hapur tenderë, ka proceduar me tenderë, kur fondet nuk kanë qenë në buxhetin e shtetit?

Po, vërtet ka pasur një ligj të veçantë për procesin e rindërtimit, një ligj i cili është çuar edhe në Gjykatën Kushtetuese, dhe 4 anëtarë të Gjykatës Kushtetuese e kanë konsideruar klientelist procesin e rindërtimit. Nga vendosja e kriterëve për tenderët e rindërtimit, kanë përfituar vetëm 11 kompani. Zonja Ministre, a keni ndonjë lidhje me këto kompani? A ka ndonjë lidhje ish-zëvendëskryeministri me ato kompani? Kësaj i thonë të përdorësh krizën, jetën e qytetarëve, fatkeqësinë për biznes. Kjo ka ndodhur këtu!

Zonja ministre paska pasur mundësinë të parashikojë pandeminë dhe të thotë këtu se "Pas tërmetit na u desh të përgatiteshim për pandeminë", kur nuk e dinte askush që do të vinte pandemia. Ajo tha: "Prandaj nuk i morëm kreditë e buta, sepse normat lëvizin". Po, është e vërtetë, normat e interesit janë më të larta.

Por unë po pyes, pse nuk i more përpara tri vitesh? Vetë sapo e pranove që përpara tri vitesh situata ishte e favorshme, normat e interesit ishin 1%, 2% kreditë e buta.

Qeveria shqiptare refuzoi dhe mori eurobondin me 3,75% dhe arriti të angazhojë 14 milionë euro shtesë vetëm nga normat e interesit,

shtuar kostos 400 milionë euro të rindërtimit, e cila është tenderuar, por nuk është llogaritur në buxhetin e shtetit, dhe shumëzuar me tri vite, e çon shumën në më shumë se 500 milionë euro abuzime me procesin e rindërtimit.

Ja ku është procesi i rindërtimit, që është duke kushtuar dy herë më shtrenjtë sesa vlera reale e atyre projekteve. Jeni në dijeni të raportit të OSBE-ODIHR-it dhe të të gjithë raporteve të tjera, ku thuhet se ky proces është përdorur për fushatën elektorale. Në Durrës i kanë marrë pagesat me lista, por janë ndaluar në ditët pas zgjedhjeve. Në periudhën mars-prill të vitit 2021 pagesat për rindërtimin kanë qenë 46% më të larta se muaji i zgjedhjeve, prilli, por njëkohësisht dhe muaji pasardhës, maji, kur nuk u dha asnjë pagesë. Po për këtë, kush mban përgjegjësi? Kush mban përgjegjësi për bërjen biznes, për kërkimin e votës, për jetën e shqiptarëve? Kush mban përgjegjësi për abuzimet që kanë ndodhur në procesin e zgjedhjeve?

Duhet të kesh një kurajë të jashtëzakonshme të vish këtu edhe të thuash: "Po, është e vërtetë, procesi i rindërtimit kushton 43 miliardë euro për vitin 2023". "Nevojat, - tha ministrja, - janë për 43 miliardë euro për vitin 2023". Por në fakt, a e dini sa ka llogaritur në programin buxhetor afatmesëm? Zero. E dini sa ka llogaritur buxheti i shtetit?! 5 miliardë lekë.

Atëherë, ose je e paaftë, ose je arrogante. Kur ti e pranon dhe thua se duhen edhe 42 miliardë euro për të mbyllur këtë proces, për të paguar kostot shtesë nga ky proces, por ke llogaritur zero në programin buxhetor afatmesëm, ke llogaritur 5 miliardë për buxhetin e vitit, ku do t'i gjes këto para? Apo, të kalojnë zgjedhjet dhe të shohim...

Unë besoj se ky është një shqetësim shumë i madh dhe ne e kemi parë me shumë përgjegjësi këtë proces. Unë jam e sigurt që ministrja ndoshta punët e veta i bën nga kafja, por ju siguroj se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i ka analizuar të gjitha vendimet e qeverisë dhe i ka nxjerrë këtu të gjitha vendimet e qeverisë që kanë ardhur në mbështetje të fondeve të angazhuara për rindërtimin.

Kemi analizuar, gjithashtu, të gjithë buxhetet faktike dhe raportet e Ministrisë së Financave mbi zbatimin e tyre. E vërteta shumë e dhimbshme është që fondet e tenderuara, të mbledhura nga çdo vendim i Këshillit të

Ministrave në vlerën e pothuajse 80 miliardë lekëve janë më të ulta sesa fondet e tenderuara prej 1,1 miliardë eurosh, dollarësh, nuk ka rëndësi. Ky është një abuzim i jashtëzakonshëm, që KLSH-ja duhet ta kishte çuar tek organet ligjzbatuese dhe sot të kishim një përgjegjës përpara drejtësisë, kushdo që angazhon fonde buxhetore pa i pasur ato.

E njëjta gjë ndodhi me inceneratorët, me pandeminë, me rindërtimin dhe u mbyllën sytë, sepse emergjenca sot po përdoret si justifikim për biznesin, me krizën. Unë mendoj se do të vijë një moment që këta zyrtarë duhet të mbajnë përgjegjësi edhe për jetët e shqiptarëve. Nuk po flas fare për ndërtimet dhe cilësinë e tyre në Durrës, se si u prishën pallatet, se çfarë ndodhi në Thumanë, se çfarë ndodhi me ndërtimet e reja. Ashtu siç e kam thënë, për mua, nuk ka formë më të shëmtuar të politikës dhe nekropolitikës të përdorësh vdekjen, pra të përdorësh jetën e humbur për të marrë vota.

Sa herë duhet të presin shqiptarët që të gënjejnë, sa zgjedhje duhet të kalojnë, (në fakt, kjo është e treta herë që ndodh pas 2019-s kur ndodhi tërmeti), pra për të kuptuar që nuk dinë të veprojnë dhe bëjnë ndryshe.

Çështjet që ne kemi ngritur dhe analizuar me shumë përgjegjësi, fondet e tenderuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe vendimet sa u përket banesave individuale, të cilat janë jashtëzakonisht shqetësuese, si: fondet e paguara në periudha zgjedhore; fondet e angazhuara për çdo buxhet të shtetit, ku niset me 5 miliardë dhe përfundohet brenda vitit me pothuajse 25 miliardë, tregojnë jo vetëm korrupsionin, por edhe paaftësinë dhe arrogancën që vjen nga paprekshmëria. Ata zyrtarë, që e kanë kryer dhe i dalin për zot kësaj, duhet të mbajnë përgjegjësi!

Kur u diskutua raporti i KLSH-së në Komisionin e Ekonomisë dhe unë thashë se me procesin e rindërtimit kanë ndodhur abuzime të mëdha, janë tenderuar fonde, të cilat nuk ekzistojnë dhe nuk janë miratuar në buxhetin e shtetit, kolegët socialistë më thanë se nuk është e vërtetë, nuk ndodh kurrë, sepse po të ndodhë edhe ne do të të mbështesim. Sot, kur shifrat janë të qarta dhe personat përgjegjës po ikin, duke i bërë bisht përgjegjësive, askush nuk flet.

Prita që sot ministrja e Financave të na kishte dhënë një shpjegim pse ka ndodhur kjo. Kush është ai zyrtar shteti që ka qas shumë fuqi

dhe autoritet që shkel ligjin, atë që e ka miratuar vetë, që vendos kritere selektive dhe që përzgjedh një grusht kompanish për procesin e rindërtimit? Kush është ai që abuzon me mbi 500 milionë euro për këtë proces dhe që nuk i hyn gjemb në këmbë? A do të arrijmë ne dot sot të ngrihemi mbi llogoret politike, për t'u kërkuar ndjesë qytetarëve dhe për t'u thënë që këtu vepruam gabim, që nuk mbrohet çdo gjë e çdo tender me fanatizëm, çdo shkelje e ligjit e çdo humbje jete me fanatizëm dhe me arrogancë.

Kam ngelur e çuditur sesi një zyrtarë shteti sot, pa asnjë llogaridhënie dhe pa asnjë vlerë për votën që na japin qytetarët, për peshën që mban elektorati, për peshën e përfaqësimit, të mund të arrijë të fyejë deputetët e parlamentit të Shqipërisë dhe qytetarët që janë jashtë banesave të tyre.

Kemi bërë një analizë njëkohësisht, që unë e kam këtu, të të gjithë banesave që nuk kanë përfunduar: në Shijak 26%, në Vorë 52%, në Laç, më thanë, pothuajse 60%. Po çfarë bëri qeveria? Qeveria në vend të merrte masa, që në periudha të vështira të alokonim më shumë buxhet për grupet sociale në nevojë, për ato familje që ministrja thotë që janë duke u gëzuar, duke jetuar në hotele me 5 yje, të cilët kanë qenë edhe të keqtrajtuar nga procesi selektiv që u ndoq, alokon një fond shtesë prej pothuajse 800 milionë eurosh për kompanitë, të cilat kanë marrë tenderë nga koncesione, por që kanë qenë dhe pjesë e procesit të rindërtimit dhe kanë rritur çmimet. Nuk mjaftojnë pothuajse 1,1-1,2 miliardë euro të tenderuara, por gjithmonë duhen shtesa të tjera fondesh. Kjo ka ndodhur me procesin e rindërtimit dhe me çdo proces tjetër.

Më vjen keq që nuk kemi arritur të përdorim 1,1 miliardë euro fonde të donatorëve, të cilat qeveria shqiptare i ka shpërfillur. Është fatkeqësi për popullin shqiptar që nuk kemi kapacitetin t'i përthithim këto fonde, që mburreni kur i merrni dhe pastaj i shkelni me këmbë se nuk ju duhen, sepse e trajtoni buxhetin e shtetit si një fletore qokash, që ndryshon pothuajse 5-6 herë gjatë vitit dhe zbatohet i gjithi në muajin e fundit të vitit, sepse nuk u duhen fondet e donatorëve, as kontrolli që vjen nga këto fonde.

Prandaj them që në parlament njerëzit duhet të kenë përgjegjësi, të kenë peshën politike, por dhe ndjenjën dhe sensin e përgjegjësive ndaj qytetarëve që i kanë votuar.

Prandaj për mua ka shumë rëndësi vota kur jep llogari, sepse, kur nuk votohesh, e ke shumë

të lehtë të flasësh qesim për përgjegjësinë, të shkelësh atë që përfaqëson, të tregosh foto si ishte e si u bë, por që kurrë nuk jep llogari dhe as përgjigje. Sot përpara drejtësisë duhet të jetë ish-zëvendëskryeministri, ish-ministri i Financave dhe ish-ministri i Drejtësisë dhe të gjithë ata pushtetarë lokalë që kanë abuzuar me fondet publike, që kanë abuzuar me detyrën e tyre, me procesin e rindërtimit, me jetët e humbura.

Shpresoj që ky proces të jetë mësim për të ardhmen, të mos menaxhojmë me kriza me tenderë me kritere të përcaktuara, të mos menaxhojmë me tenderë sekretë, që të rrisim transparencën dhe informacionin që u jepet qytetarëve.

Për sa i përket transparencës lidhur me këtë proces, pjesa më e madhe e kritereve të vendosura për tender kanë qenë të gjitha të paracaktuara. Kanë qenë tenderë, për të cilët me vërtetë mund të kishte një procedurë, por ishin tenderë për të cilët kompanitë i kishin filluar punimet dhe mund të përmend pa fund. Meqenëse ministrja ka dëshirë të përmendë shkolla, marrim shkollën “Sami Frashëri”, ku unë dhe ministrja kemi kryer studimet e mesme.

Pa filluar procesi i tenderit, kompania hapi punimet të shkolla “Sami Frashëri”. Në kohën që ishte në proces tenderimi, kompania vazhonte punimet tek ajo shkollë. Në fakt, për këtë çështje unë jam në gjyq me kryetarin e Bashkisë së Tiranës dhe do ta vazhdoj gjyqin deri në fund, sepse kjo është përgjegjshmëria: kur thua diçka, duhet t’i qëndrosh asaj.

Por kjo është mënyra sesi janë zhvilluar tenderët, ndërkohë që tenderi zhvillohej, kompanitë hapnin punimet. Këtë e kam faktuar, e kam provuar dhe do ta faktoj në gjykatë.

Prandaj, duhet patjetër të kemi një klasë politike që mban përgjegjësi për buxhetin e shtetit, për votën, për qytetarët, që mban përgjegjësi edhe për ata që kanë humbur jetën. Fatkeqësisht, sot nuk e kemi!

**Lindita Nikolla** - Zonja Ministre, keni 3 minuta kohë në dispozicion.

**Delina Ibrahimaj** – Unë ndjehem e keqardhur që për të gjithë përgjigjen time, në parashtrimin që bëra, dëgjova vetëm fjalët: paaftësi, arrogancë, e zgjedhur dhe e pazgjedhur.

Dua t’ju kujtoj, zonja Tabaku, se ju jeni deputete e dalë nga lista dhe jo nga zgjedhje në sistem mazhoritar. Pra, të mos merremi me kush

na ka zgjedhur dhe si na ka zgjedhur. Nëse do të flasim për aftësinë, janë shifrat që tregojnë aftësinë dhe nuk është as dalja këtu në foltore duke recituar shifra, që nuk dëgjoni, duke thënë të pavërteta.

Më pyetët sa është kostoja totale e rindërtimit, ju ktheva përgjigje: është 117,6 miliardë lekë, të cilët vijnë nga totali i të gjitha vendimeve të Këshillit të Ministrave. Më pyetët se sa janë disbursuar deri tani dhe ju thashë se totali është 75,5 miliardë lekë. Unë nuk jam këtu për të gënjer dhe nuk jam këtu për t’u ofenduar. Ju thoni në mënyrë të përsëritur, herën e parë se tenderët janë 4-5 herë më të shtrenjtë se ata që bëjnë të huajt, herën e dytë se janë 2 herë më të shtrenjtë sesa çmimet e tregut. Ju lutem, faktojini! Mos përdorni supozime! Nuk e di se ku i gjeni vlerat e tregut, por nëse vini këtu dhe thoni janë 2 herë më të shtrenjta, ju lutem, hajdeni me shifra dhe me fakte, me ato që keni parë, keni studiuar, me ato që ju kanë thënë, jo me supozime. Ne nuk u kemi thënë jo kredive dhe mos keqinterpretimi fjalët që thuhet. Ne kemi marrë kredi, të cilat do të vazhdojmë t’i marrim. Shumica e kredive që u vunë në dispozicion në Konferencën e Donatorëve ishin kredi, të cilat do të rialokoheshin drejt rindërtimit dhe unë e shpjegova shumë mirë se një nga arsyet pse procesi i rindërtimit u financua nga fondet e buxhetit të shtetit, ishte që ndërhyrja të ishte emergjente, imediate dhe të mos priteshin procedura të tejzgjatura.

Unë ndihem e qetë për zbatimin e ligjit, ndihem e qetë për procesin e rindërtimit. Ai është një proces që vazhdon. Ne nuk mund të parashikojmë se sa punime mund të kryhen gjatë vitit 2023, por kemi parashikuar një fond të vitit 2023 dhe nëse fondet e alokuara nuk do të jenë të mjaftueshme për të përballuar të gjitha ndërtimet dhe punimet që do të kryhen në vitin 2023, ka instrumente ligjore, të cilat do të na lejojnë të bëjmë rialokimet e duhura.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** - Zonja Tabaku, edhe ju keni 3 minuta në dispozicion.

**Jorida Tabaku** – Në fakt, e kisha marrë më shumë seriozisht se duhet edhe përgjegjshmërinë, edhe përgjegjësinë për të bërë transparencë për këtë proces, sepse, sigurisht, nuk mund të pres dot nga një ministere e Financave të mos na thotë një shifër të vetme. Për mua është fatkeqësi dhe e

përsëris: është fatkeqësi kjo që ka ndodhur sot, kjo që ka ndodhur me rindërtimin në përgjithësi. Unë shpresoj që qeveria të mbajë përgjegjësinë që i takon në këtë proces, që personat përgjegjës, ish-zëvendëskryeministri, ish-ministri i Rindërtimit dhe ministrja aktuale e Financave të mbajnë përgjegjësitë e tyre për këtë proces, për tenderimet pothuajse 400 milionë euro më shumë se buxheti i miratuar për fondin e rindërtimit, por njëkohësisht edhe abuzimin me kreditë e buta, për abuzimin që ka ndodhur në procesin e rindërtimit, për përzgjedhjet selektive. Ministrja, në fakt, sot ka një fatkeqësi që është vetëm dhe nuk ka kush ta mësojë që të flasë, por nuk dëgjoji mirë. Dy gjëra thashë: kosto totale e procesit të rindërtimit është dyfish. I bie që 600 milionë euro ka qenë vlera reale, ka abuzuar, sot ka shkuar rreth 1,2 milionë euro e tenderuar. Ndërkohë, për objektet arsimore, e faktuar nga raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit, por njëkohësisht edhe nga projekte të ngjashme të Bashkimit Europian për shkollat, të cilat unë i kam parë vetë, kam qenë vetë në shkollën e Bërxullës, (jo në kafe, zonja Ministre, po ta them edhe një herë se ndoshta ashtu punoni ju, jo unë) i kam parë vetë edhe numrin e nxënësve, edhe sipërfaqen, edhe numrin e laboratorëve, edhe numrin e klasave dhe, krahasuar me shkollën “Sami Frashri”, tenderimi për atë objekt është 5 herë më i lartë.

Unë e kuptoj që fjalimet e gatshme me “ne jemi krenarë, ne menaxhuam pandeminë, ne menaxhuam rindërtimin, ne menaxhuam atë, ne menaxhuam këtë” mund të ecin në disa raste, por nuk ecin gjithmonë, sepse shqiptarët mund t’i gënjesht 1 herë, mund t’i gënjesht 2 herë, mund t’i gënjesht 3 herë, por jo përjetësisht. Shpresoj shumë që ky proces të bëhet shembull për zyrtarët që abuzojnë me ligjin, për zyrtarët e korruptuar, për zyrtarët që abuzojnë edhe me jetët e qytetarëve, që ata të jenë përpara drejtësisë për abuzimin edhe të jetëve të humbura.

Kemi 2 kryetarë bashkie, njëri është ish, ndërsa tjetri kandidon përsëri, të cilët duhet të ishin përpara drejtësisë për këtë proces; kemi një ish-zëvendëskryeministër, një ish-ministër financash, që duhet të ishte përpara drejtësisë për këtë proces, të cilët nuk janë akoma. Nuk kam për t’u lodhur ndonjëherë për t’i bërë thirrje SPAK-ut, me aq pak vlerë sa ka. E di që këto duken gjëra të vogla, 400 milionë euro këtu, 400 milionë euro tek inceneratorët dhe nuk bën më përshtypje se po

shkelet ligji, kur në këtë vend po ndodhin gjëra edhe më të mëdha. Këtu fillon llogaridhënia, këtu fillon përgjegjësia!

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Këtu mbyllet interpelanca.

Vijojmë me çështjen tjetër të rendit të ditës, raportin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit për vitin 2022. Në bazë të nenit...

Po, zonja Bakiu, për çfarë e kërkoni fjalën?!

**Merita Bakiu** – Për procedurë.

**Lindita Nikolla** – Urdhëroni!

**Merita Bakiu** – Faleminderit!

Në fakt, zonja ministre paraqiti një foto të ndërtimeve në Thumanë.

Zonja Ministre, kur të paraqisni atë foto, duhet të falënderoni zotin Pacolli dhe zotin Naçi për të gjithë kontributin që kanë dhënë për ndërtimin e banesave në atë zonë dhe pastaj të thoni se sa kanë ecur ndërtimet në zonë.

**Lindita Nikolla** – Kjo nuk është procedurë.

**Merita Bakiu** – Ndërsa për sa u përket ndërtimeve në Krujë, kur ishin zgjedhjet në vitin 2021, keni filluar dhe keni...

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, kjo nuk është procedurë. Nuk mund të abuzojmë kështu! Bëmë komente për interpelancën, kur ishte interpelancë. Nuk mund të bëni komente për interpelancën! Ju lutem, unë jua ndërpres fjalën!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në bazë të pikës 2 të nenit 103 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 31 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” sot do të paraqesë raportin vjetor për vitin 2022 kryetari i Komisionit Rregullator, zoti Ndrëçim Shani.

Zoti Shani, keni fjalën. Keni deri në 20 minuta kohë në dispozicion.

**Ndrëçim Shani** – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Rregullatori, si institucion i pavarur, paraqitet si domosdoshmëri në rastin kur u ofron konsumatorëve shërbime të karakterit monopol, siç është rasti i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve. Ne, si institucion politik zbatues të qeverisë qendrore, luajmë një rol aktiv dhe mjaft të rëndësishëm në menaxhimin e këtyre shërbimeve, në mbrojtje të interesave të konsumatorëve për të mënjeluar rrezikun e

abuzimit të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, të cilat i ofrojnë këto shërbime me cilësi mjaft të ulët dhe me çmime apo me tarifa të pajustificuara.

Në përbushje të misionit të tij, pikërisht në pozicionin e arbitrit ndërmjet konsumatorit dhe shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve ose, siç i quajmë ndryshe, operatorëve, ligji i përcakton ERRU-së 3 kompetenca kryesore: licencimin e operatorëve, pra të shoqërive; vendosjen e tarifave dhe, natyrisht, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, paralelisht me rolin që ne, si institucion, luajmë në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve.

Hartimi i raportit të veprimtarisë së Rregullatorit dhe të performancës së sektorit është një detyrim ligjor i ligjit për Rregullatorin. Gjithashtu, ky raport analizon edhe performancën e Entit Rregullator, bazuar edhe në rezolutën që Kuvendi ka lënë si detyrë për institucionin tonë, për vitin 2022.

Pikërisht, struktura e raportit, të cilin ne do ta referojmë sot, është e bazuar në këto kompetenca: në performancën që ne kemi si institucion, në lidhje me përbushjen e detyrave për licencimin, tarifimin, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, pra të ankesave të tyre dhe, nga ana tjetër, duke iu referuar pikë për pikë të gjitha rekomandimeve që jepen në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për institucionin tonë.

Gjithashtu, raporti përmban edhe një analizë financiare të aktivitetit të ERRU-së, jo të sektorit, përmirësimin e instrumenteve rregullatore, të cilat i kemi pasur parasysh gjatë vitit të kaluar dhe marrëdhëniet me aktorët vendas dhe të huaj të sektorit në fushën e ujit.

Së fundmi, pjesa e dytë, por jo më pak e rëndësishme e raportit, është dhënia e performancës së sektorit për vitin e kaluar në përgjithësi, me anë të treguesve të performancës, duke pasur parasysh që viti i kaluar ka qenë viti i fillimit të një reforme të thellë në sektorin e ujit, reformë e ndërmarrë nga qeveria qendrore. Kjo reformë ka konsistuar kryesisht në agregimin e sektorit, që nga 58 ndërmarrje, të cilat kanë qenë në vendin tonë, i agregon këto në 15 të tilla, duke pasur parasysh objektivin e përmirësimit të qëndrueshmërisë financiare të tyre dhe të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, bazuar në ekonominë e shkallës, por natyrisht edhe në një monitorim akoma edhe më serioz.

E nisim me licencimin. Për t'u licencuar në ERRU, shoqëritë duhet të kenë kapacitetin profesional për ofrimin e shërbimeve, komponentët e sistemeve që duhet të përbushin kushtet higjieno-sanitare, për të garantuar shëndetin publik. Gjatë vitit 2022 janë paraqitur për aplikim 20 shoqëri UK, nga të cilat 17 kanë qenë shoqëri individuale dhe 3 të tjera, që kishin marrë edhe statusin institucional si shoqëri rajonale, pra subjekte me kompetenca të përbashkëta, bazuar në reformë. Nga ERRU-ja janë dhënë 17 licenca, nga të cilat 15 për shoqëritë individuale dhe 2 për shoqëritë rajonale të Korçës dhe të Lezhës, ndërsa Kukësi, që paraqiti gjithashtu kërkesë për licencim, kishte disa probleme dhe procesi vazhdoi në fillim të vitit 2023, pra të këtij viti. Mbeten 2 shoqëri nga shoqëritë individuale, të Rrogozhinës dhe të Divjakës, të cilat nuk kishin përbushur disa kushte ligjore, që janë detyrim ligjor për licencim, kështu që u lamë detyra përkatëse, që së shpejti të aplikojnë si shoqëri në përbërje të shoqërive të agreguara, në të cilat bëjnë pjesë.

Gjithashtu, pavarësisht pritshmërisë së reformës, ku do të dërgohen shoqëritë në bazë të rajonit me një mesatare 5 shoqëri për rajon, kanë aplikuar dhe ne e nxitëm aplikimin për të tarifuar, sepse, në fund të fundit, tarifat i shërbenin një realiteti akoma më objektiv dhe gjithsesi shërbenin për përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë. Kështu, 5 shoqëri aplikuan, kryesisht Kukësi, Konispoli, Bulqiza, Durrësi dhe Elbasani, ku u analizuan dhe u dhanë vendimet përkatëse nga Komisioni Rregullator për këto tarifa. Konkretisht, Bulqiza me tarifat e reja mbulon 100% kostot operative dhe të amortizimit vjetor; Kukësi përfshin edhe shërbimin e zonës rurale dhe me synimin në këtë propozim të mbulojë 100% të kostove operative; Konispoli aplikoi për herë të parë, sepse ishte i palicencuar dhe, pasi u licencua në vitin 2021, i lindi e drejta edhe për tarifat ligjore, si kompetenca jonë, dhe themi se edhe ky ujësjellës u vendos në baza ligjore të rregullta; Durrësi aplikoi për shitje uji me shumicë për 2 pjesë të ish-zonës së shërbimit, pra, të zonës së Vorës, të transmisionit kryesor, dhe të një pjese të Kurbinit, pra, zonës së Fushë Kuqes, të cilat me grupimin e ri, sipas subjekteve me kompetenca të përbashkëta, dalin jashtë kësaj zone shërbimi.

Lidhur me monitorimin e performancës së sektorit, pavarësisht se nga reforma pritet një situatë krejtësisht tjetër institucionale e sektorit, ne vazhduam monitorimin e të gjitha ndërmarrjeve dhe në veçanti në 26 prej tyre, me vizita në terren. Kryesisht kanë qenë ato subjekte, ku dyshimi në lidhje me saktësimin e të dhënave dhe të raportimeve ishte objektiv, prandaj u pa e arsyeshme të bëhej një kontroll dhe një monitorim më nga afër i këtyre shoqërive. Nuk po i citoj, por bëhet fjalë për 26 shoqëri. Në vëmendjen tonë gjithmonë ngelet saktësia e të dhënave, të cilat duhet të paraqiten në gjendjen e tyre reale, në fund të fundit, edhe për objektiva morale.

Në trajtimin e ankesave të konsumatorëve është bërë një hap përpara. ERRU-ja ka kontribuar si anëtare e grupit ndërinstitutional të punës për integrimin europian, për kapitullin 28 “Mbrotjtja e konsumatorit dhe shëndetit publik” të raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë. Kjo ka qenë një qasje më afër konsumatorit. Gjithashtu ka vazhduar edhe aktiviteti me trajtimin e ankesave të konsumatorëve, të cilët, pasi ka mbaruar procedura, nuk e kanë parë të arsyeshëm vendimin që ka marrë ndërmarrja apo shoqëria përkatëse për ankesën e tyre, i drejtohen ERRU-së. Janë trajtuar 10 ankesa, 5 janë zgjidhur në favor të konsumatorit dhe 5 të tjera janë akoma në proces. Ankesat janë trajtuar nëpërmjet strukturës së ngritur pranë ERRU-së, SZAM-i i famshëm, duke organizuar takime me shoqëritë, si dhe verifikime në terren.

Gjithashtu, gjatë vitit të kaluar është lançuar edhe mekanizmi më i ri i pranimit të ankesave të konsumatorëve, sistemi *online* nëpërmjet faqes zyrtare të ERRU-së, [www.ERRU.al](http://www.ERRU.al).

Lidhur me reformën në sektorin e ujësjellësit, viti i kaluar shënoi një hap të rëndësishëm për sektorin, në drejtim të reformimit me anë të agregimit të tij. Në maj të vitit 2022 Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr.302 për riorganizimin e sektorit, i cili parashikon që 58 shoqëritë të rigrupohen, në bazë të ekonomisë së shkallës, në 15 të tilla. Objektivi kryesor është rritja e qëndrueshmërisë financiare, si dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve.

Në mënyrë të përmbledhur, reforma konsistoi në riorganizimin e të gjitha shoqërive në bazë rajonale, në 15 të tilla, me vullnet të lirë të shoqërive aksionare, ku pushteti qendror përbën

edhe 51% të aksioneve dhe pjesa tjetër mbetet për shoqëritë. Gjithashtu, këto shoqëri janë të detyruara të respektojnë marrëveshjet dhe detyrimet kontraktuale ekzistuese dhe të shkuara, përfshirë edhe ato me institucionet ndërkombëtare dhe kompanitë kontraktuese, kryesisht për kreditë që janë marrë për ndërtimin dhe rikonstruksionin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve.

Po ashtu, detyrim ishte që brenda 3 muajve këto shoqëri të aplikojnë për licencë pranë ERRU-së dhe më tej procesi do të vazhonte me kohën e duhur në dispozicion dhe tarifimet. Realisht janë grupuar rreth 50 bashki në 12 shoqëri UK, pra rajonale, dhe mbeten akoma edhe 3 shoqëri rajonale për t'u krijuar: në Shkodër, Vlorë dhe Tiranë. Në fakt vendimet ndaj sjelljeve përkatëse janë marrë, pra ato përfaqësojnë rreth 11 bashki të tjera, por akoma ka disa detaje teknike të problemeve të menaxhimit, që janë ende në diskutim mes shoqërive ekzistuese, bashkive përkatëse dhe pushtetit qendror.

Vlen të theksohet fakti që ERRU-ja ka luajtur një rol mjaft aktiv. Në fakt ka qenë edhe pjesë e vendimit të qeverisjes për lehtësimin e procesit dhe sidomos për akselerimin në drejtim të oportuniteteve, të shkurtimit të kohës burokratike për situatat e krijuara në lidhje me licencimin, (ashtu siç thamë, përgjithësisht janë të licencuara të gjitha këto 12 shoqëri) dhe, gjithashtu, për të qartësuar situatën në lidhje me tarifën, se si do të vazhdohet me të gjitha defektet që kanë qenë në të kaluarën.

Nga ana tjetër, ERRU-ja ka zhvilluar takime mjaft intensive me të gjithë drejtuesit e të gjitha këtyre shoqërive rajonale, madje edhe të atyre që nuk janë agreguar ende, në lidhje me problemet që ato hasin dhe në ndihmë të tyre, sidomos me bazë të dhënash dhe me konsiderata të tjera, duke u bazuar edhe në eksperiencën ndërkombëtare për këtë qëllim.

Lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e ERRU-së, (këtu flasim për shpenzimet e ERRU-së, jo të sektorit, që të mos e krijojmë këtë konfuzion) të ardhurat janë realizuar me 7,5 milionë lekë më shumë se të planifikuarat. Pra, nga 53-54 milionë lekë që ishin planifikuar, janë realizuar 61-62 milionë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në masën 90% ose 5,5 milionë më pak se parashikimi. Realizimi ka rezultuar më pak, për shkak të vonësve në emërimin e 2 komisionarëve

të rinj, të kursimeve nga tenderët, si dhe të disa prokurimeve të lëna *pending* për shkak të pandemisë. Gjithsesi, gjendja financiare e disponueshme në llogaritë e ERRU-së garanton plotësisht projektbuxhetin e vitit 2023.

Për sa u takon bashkëpunimit dhe marrëdhënieve ndërinstitucionale, bashkëpunimi ka qenë mjaft i ngushtë me Kuvendin e Shqipërisë, me AKUM-in, me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, veçanërisht, se ka qenë viti i fillimit të reformës në sektor, në ndjekjen dhe në lehtësimin e zbatimit të procesit në furnizimin me të dhëna e të tjera, patjetër me Autoritetin e Konkurrencës, të cilin ne i referojmë çdo vendim tonin dhe me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, që lidhet me pjesën e burimeve, të cilat menaxhohen pikërisht nga kjo Agjenci.

Me organizatat ndërkombëtare bashkëpunimi ka qenë mjaft i ngushtë, si me WAREG-un, që është Shoqata Europiane e Rregullatorëve të Ujit, ku ne bëjmë pjesë dhe kemi edhe përfaqësinë në Bordin e saj, duke qenë zëvendës-president. Kryesisht, ka qenë angazhim shumë i fortë në drejtim të task forcës për metodologjinë e vendosjes së tarifave dhe për investimet e për rolin e Rregullatorit në to, për sektorët e ujit në vendet përkatëse. Kemi bashkëpunuar me Rrjetin e Rregullatorëve Ekonomikë të OECD-së, NER-in, dhe me Programin e Ujit për Rajonin e Danubit, që është një program i Bankës Botërore.

Nga donatorët, kemi bashkëpunuar me Bankën Botërore dhe GIZ-in, ndërsa me rregullatorët e ujit kemi pasur një bashkëpunim jashtëzakonisht të ngushtë, që është konkretizuar me një marrëveshje bashkëpunimi me rregullatorët rajonalë të Malit të Zi, të Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut. Në maj u lidh një marrëveshje bashkëpunimi me to, për shkak të ngjashmërisë që kemi ne si rregullatorë dhe si vende, sektorët e ujit në vendet përkatëse, në lidhje me eksperiencat, problematikat dhe përballimin e problemeve për të arritur kushtet e *acquis communautaire* dhe kryesisht për direktivat për ujin e pijshëm dhe direktivat për ujin e ndotur. Në këtë kuadër, në Komunitetin Europian u aplikua madje për një projekt, që edhe pse në një shkallë relativisht të vogël, kishte të bënte me rritjen e kapaciteteve të 4 rregullatorëve. Pra, qysh në fillim ky bashkëpunim ka qenë mjaft

i suksesshëm dhe do të vijojë edhe me projekte të tjera. Zbatimi i këtij projekti u konceptua dhe u aprovua vitin e shkuar dhe është vënë në zbatim këtë vit.

Gjithashtu, kemi marrëdhënie bilaterale mjaft të forta me Rregullatorin e Italisë, ARERA, dhe veçanërisht me atë të Hungarisë, si një rregullator me mjaft eksperiencë. Me këtë të fundit në nëntor firmosëm një marrëveshje për një bashkëpunim bilateral, kryesisht, për eksperiencën në metodologjitë dhe proceset e licencimit të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve. Si vende mjaft të avancuara të *know-hows* pritet një përfitim mjaft i madh prej tyre.

Performanca e sektorit u referohet indikatorëve të performancës, që janë rreth 11: uji pa të ardhura; mbulimi i kostove të operim-mirëmbajtjes, kryesisht ato korrente, që është pjesa më e rëndësishme; niveli i matjes; eficientia e stafit; kohëzgjatja e furnizimit me ujë; mbulimi i furnizimit me ujë; mbulimi me kanalizime të ujërave të ndotura; eficientia e energjisë dhe ankesat e klientëve. Eficientia e energjisë dhe ankesat e klientëve janë indikatorë që futen për herë të parë, duke e parë të arsyeshme, bazuar edhe në situatën e energjetikës që kaluam, madje ende janë gjurmët e saj negative në aspektin financiar të sektorit, e cila duhet patjetër të jetë në fokusin e punës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe ERRU-ja duhet të japë kontributin e saj në rritjen e eficientisë së energjisë.

Gjithashtu, duhet të merret në konsideratë, edhe në rolin si rregullator, indikatorit i ankesave të konsumatorëve dhe ky të përfaqësohet me një tregues të veçantë.

Të gjithë treguesit e mësipërm kanë qenë pozitivë, përveç mbulimit të kostove të operim-mirëmbajtjes, ku ka pasur një rënie nga 103,4% në 95,5%, si sektor. Pra, menaxhimi ka qenë në nivele jo fort të kënaqshme, sepse kemi progres në të gjithë indikatorët e tjerë, por mbulimi i kostove të operim-mirëmbajtjes ka qenë i lidhur ngushtësisht me rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Fatura e energjisë elektrike për ujësjellësit u rrit me rreth 65% dhe, duke pasur parasysh që më parë kostot e energjisë elektrike në të gjithë kostot e operim-mirëmbajtjes kanë qenë rreth 36%, rritja në 65% e çoi në 50% rritjen e kostove të energjisë elektrike dhe solli këtë lloj

reduksioni retrospektiv jopozitiv te kostot e mbulimit të operim-mirëmbajtjes.

Kemi një përmirësim të lehtë me 1,4% për treguesin e ujit pa të ardhura, që vjen nga rritja e volumit të ujit të faturuar me 2,7 milionë. Akoma mbetet në vlera mjaft të larta dhe është një nga sfidat kryesore të sektorit.

Për mbulimin e koston folëm. Norma e arkëtimit është rritur me 1% dhe kjo gjithashtu mbetet një sfidë shumë e madhe, që lidhet direkt me performancën e likuiditeteve financiare të shoqërive.

Niveli i matjes është rritur me 2,1%, kjo falë investimeve.

Eficienca e stafit, gjithashtu, ka pasur një përmirësim, 4,66 punonjës për 1000 lidhje nga 4,9 punonjës që ka qenë në vitin 2021. Kryesisht, kjo ka ardhur nga reduktimi i numrit të punonjësve, pavarësisht se duhet të jetë një shifër akoma më e madhe, janë 88 punonjës për të gjithë sektorin, pavarësisht rritjes së lidhjeve të reja.

Kohëzgjatja e furnizimit me ujë është shtuar me 1 orë. Ky është një tregues që lidhet shumë me investimet dhe për këtë ka një program mjaft agresiv të qeverisë qendrore për vitet 2018-2023, projekt i cili ka filluar kryesisht në qendrat urbane, ku synohet furnizimi me ujë për 24 orë, për 58 nga 66 qendra urbane që ekzistojnë në vendin tonë.

Gjithashtu, kemi përmirësim në mbulimin e furnizimit me ujë dhe me kanalizime të ujërave të ndotura, që edhe këto janë kryesisht të lidhura me ...

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, përfundoni, sepse ju ka mbaruar koha!

**Ndriçim Shani** – Në lidhje me eficiencën e energjisë dhe ankesat e klientëve, siç e thamë, akoma nuk ka referenca krahasuese, pra nuk mund të bëjmë *benchmarking* për këtë punë.

Dua të them edhe 2 fjalë për investimet në sektor, që janë rreth 70 milionë nga qeveria qendrore dhe rreth 14 milionë nga donatorët. Detajet do t'i japim në raportin përfundimtar për sektorin dhe për çdo investim në veçanti për vitin 2022, që do ta sjellim të hartuar përfundimisht në fund të qershorit.

Subvencionet kanë qenë rreth 360 milionë lekë, të shpërndarë të mënyrë të barabartë për të gjitha shoqëritë rajonale të krijuara. Kryesisht, ato kanë qenë të orientuara për sigurimet shoqërore, për kostot e energjisë elektrike, për tatimet dhe taksat e papaguara, për paga të papaguara dhe

vetëm për 2 ujësjellës, të Korçës dhe të Pogradecit, që janë nga ujësjellësit më të mirë në vendin tonë, ka pasur edhe një stimul nga këto subvencione.

Si institucion, kemi përcaktuar edhe objektivat tona për vitin 2023. ERRU-ja duhet të jetë shumë proaktive në procesin e riorganizimit të sektorit, sipas të gjithë asaj që shpjeguam më sipër.

**Lindita Nikolla** – Ju lutem përfundoni, pasi kanë kaluar 2 minuta! Ju njoftova!

**Ndriçim Shani** – Dakord!

**Lindita Nikolla** – Përfundojeni fjalinë!

**Ndriçim Shani** – Në fakt, janë shumë objektiva, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me kontributin që ne do të japim në lidhje me këtë reformë, e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme për sektorin dhe të gjithë aktorët, edhe ata politikë. Institucionet dhe aktorët që lidhen me fushën e ujit, duhet të japin kontributin e tyre dhe të bëjnë përpjekjet maksimale që kjo reformë me të vërtetë të arrijë objektivat e saj.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit, zoti Shani!

Zoti Saliانji e ka kërkuar fjalën për procedurë.

**Ervin Saliانji** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Nisur nga mungesa e Kryeministrit dhe e ministrit të Brendshëm, thuajse edhe e të gjithë qeverisë, por edhe duke qenë se në çdo rrugë, rrugicë, qytet, nëpër bare, nëpër institucione, ku mendohet se nuk mund të preken, si media, ka shpërthyer dhuna, a kemi ndonjë risk në këtu që vijmë në punë, apo nisemi nga parimi “nuk bie rrufeja në parlament”?

Së dyti, pa diskutim, në kushte të tilla të një degradimi të rendit dhe të sigurisë publike dhe ku qytetarët ndihen të pasigurt, duhet që Kryeministri dhe ministri i Brendshëm ta lenë luftën nga *twitter*-i dhe të vijnë këtu.

Është seanca e parë pas ngjarjeve të pandodhura në këtë vend, kur Kryeministri dhe ministri i Brendshëm, që të dy, nuk paraqiten, ashtu siç nuk paraqitet drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Këtu kërkoj edhe ndërhyrjen tuaj, si Kryetare e Kuvendit, sepse as ministri dhe as drejtori i i Përgjithshëm i Policisë nuk paraqiten në Komisionin për Sigurinë Kombëtare, për të dhënë shpjegime. Është dita sot, kur Kryeministri dhe ministri duhet të paraqiten për të dhënë llogari



përpara qytetarëve dhe përpara parlamentit dhe pastaj, pa diskutim, jo vetëm fjalët dhe lufta imagjinare në *twitter*, por të bëhet “një luftë” reale dhe një reprezalje e shtetit ndaj bandave kriminale në këtë vend, për të treguar që këtu ka qeveri, ka shtet dhe ka institucione. Sjellja dhe reagimi i qeverisë në kushte të tilla, duke mos u interesuar për jetët njerëzore dhe për rendin e sigurinë në këtë vend, pa diskutim, janë shqetësuese.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Viojmë me diskutimet. Fjalën e kanë zoti Ismet Beqiraj, 7 minuta, zonja Ina Zhupa, 10 minuta, dhe më pas zoti Sali Berisha, 10 minuta.

7 minuta, zoti Beqiraj.

**Ismet Beqiraj** – Faleminderit!

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës mori në shqyrtim raportin vjetor të veprimtarisë së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për vitin 2022. Në përbushje të njëjës prej detyrave kryesore të tij, pra të kontrollit parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet këtij komisioni, bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara të Rregullores së Kuvendit, organizoi seancën dëgjimore për shqyrtimin e raportit vjetor të institucionit të pavarur ERRU, dhe në përfundim të diskutimeve hartoi një projektrezolutë të vlerësimit të punës së këtij institucioni për vitin 2022, me rekomandimet përkatëse për vitin 2023 dhe sot ia paraqet atë seancës plenare për shqyrtim dhe miratim.

Projektrezoluta përfshin vlerësime dhe konstatime lidhur me veprimtarinë e institucionit të pavarur ERRU për vitin 2022, si dhe rekomandimet që institucioni i pavarur duhet t'i ketë në konsideratë gjatë ushtrimit të veprimtarisë në vitin 2023.

Në paraqitjen e veprimtarisë së ERRU-së për vitin 2022, kryetari i këtij Enti, zoti Çani, sikurse e dëgjua edhe para disa minutash, u ndal në disa çështje të rëndësishme të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve (edhe në komision) dhe të aktivitetit të ERRU-së, më konkretisht, lidhur me reformën rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri, e cila e agregon sektorin e ujësjellës-kanalizimeve

në 15 shoqëri rajonale të ujësjellës-kanalizimeve; në licencimin e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në kuadër të reformës së nisur; në performancën e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve; në ndryshimin e tarifave; në trajtimin e ankesave në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit; në ndryshimet e nevojshme ligjore; në përmirësimin e standardeve në sektorin e ujit nëpërmjet instrumenteve rregullatore.

Komisioni e vlerësoi punën e bërë nga ERRU-ja gjatë vitit 2022 dhe përmirësimin që kanë pasur treguesit e performancës gjatë këtij viti, krahasuar me vitin 2021, për të mos shkuar edhe pak më larg në histori, krahasuar me vitin 2016, si dhe përmirësimin e këtyre treguesve në një shtrirje kohore disavejeçare, duke u ndalur veçanërisht në treguesin e ujit pa të ardhura, pra të humbjet. Gjithashtu, komisioni vlerësoi rolin e ERRU-së në kuadër të reformës rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri, reformë e cila e agregon sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në 15 shoqëri rajonale të ujësjellës-kanalizimeve, të krijuara si subjekte me kompetenca të përbashkëta, të regjistruara si shoqëri rajonale të ujësjellës-kanalizimeve, ndërkohë që sektori ka qenë i fragmentarizuar në 58 shoqëri të ujësjellës-kanalizimeve, që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura në 61 bashki në të gjithë vendin. Komisioni ritheksoi faktin se kjo reformë ka si objekt kryesor që, nëpërmjet ekonomisë së shkallës, të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve. Vlerësim të veçantë në komision pati edhe puna e bërë nga ERRU-ja për realizimin e rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit për veprimtarinë e ERRU-së për vitin 2021. Gjatë shqyrtimit të veprimtarisë vjetore të ERRU-së në komision morën vëmendje të veçantë edhe shqetësimet që lidhen me sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe u kërkua që ERRU-ja të luajë një rol proaktiv në lidhje me sfidat dhe zhvillimet e këtij sektori, në kuadër të reformës rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri. U sugjerua vëmendje e shtuar dhe zgjidhje konkrete për performancën në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, si dhe për problematikat që kanë të bëjnë me shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve në qytete të ndryshme, për mbrojtjen e konsumatorit, për cilësinë e

shërbimit, për kohëzgjatjen e furnizimit me ujë e të tjera.

Në përfundim të diskutimeve, komisioni miratoi me shumicë votash projektrezolutën “Për vlerësimin e punës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për vitin 2022” dhe vendosi t’ia paraqesë atë për miratim seancës plenare, me përmbajtjen si vijon (për shkak të kohës, unë do të ndalem vetëm tek ato që besoj se kanë më shumë rëndësi, te rekomandimet për vitin 2023):

“ERRU-ja, në kuadër të reformës rrënjësore në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, e cila e agregon sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në 15 shoqëri, të ketë prioritet në punën e saj bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, AKUM-in, si dhe organet e vetëqeverisjes vendore për të bërë të mundur implementimin me sukses të kësaj reforme të rëndësishme.

ERRU-ja, në kuadër të reformës në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, të marrë masat e nevojshme për t’iu përgjigjur në kohë pajisjes me licencë të shoqërive të reja dhe subjekteve me kompetencë të përbashkët.

ERRU-ja, duke qenë pjesë e grupit ndërinstucional të punës, i ngritur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas urdhrin nr.165 të vitit 2022, të ndikojë në rishikimin e ligjit nr.8102, duke pasur parasysh forcimin e rolit të rregullatorit, si institucion i pavarur dhe të performancës së tij në shërbim të rritjes së performancës së sektorit në përgjithësi.

Në kuadër të hapjes së negociatave me BE-në, ERRU-ja të kontribuojë dhe të jetë pjesë aktive e grupit të punës lidhur me kërkesat që Shqipëria duhet të përmbushë në lidhje me direktivën europiane për ujin e pijshëm, ujërat e ndotura dhe llumrat në këtë sektor dhe në shërbime të tjera.

ERRU-ja, gjatë monitorimeve të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në terren, si dhe gjatë procesit të miratimit të tarifave, t’i kushtojë vëmendje të veçantë rritjes së eficiencës së energjisë përmes përdorimit të burimeve alternative të rinovueshme nga shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, si një nga sfidat kryesore për përmirësimin e performancës financiare të shoqërive, në kushtet kur rritja e çmimit të energjisë elektrike ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përkeqësimin e treguesit të

mbulimit të kostove operative dhe të mirëmbajtjes, dhe të vijojë punën për procesin e monitorimit të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, për procedurat e trajtimit të ankesave të konsumatorëve.

ERRU-ja në kuadër të reformës rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri, duhet të bashkëpunojë me institucionet kryesore, në mënyrë që të ketë një shpërndarje të drejtë të investimeve për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, duke i parë ato të lidhura me përmbushjen e objektivave të caktuar nga ERRU-ja”.

*(Bie gongu.)*

Kam edhe disa gjëra të tjera, por, si gjithnjë, kur bie gongu, e ndërpres fjalën time.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Sali Berisha.

Të përgatitet zoti Fadil Nasufi.

Keni 10 minuta kohë, zoti Berisha.

**Sali Berisha** – Të dashur qytetarë dhe qytetare që ndiqni këtë seancë,

Zonja e zotërinj deputetë,

Zonja Kryetare,

Kjo seancë kushtuar ujit është një turbullirë e vërtetë dhe e përdor atë si një mjet ndëshkimi ndaj qytetarëve. Me aktin e parë e rritët çmimin e ujit me 40%, në një kohë kur Shqipëria është ndër vendet më të pasura me ujëra në rajon dhe një ndër vendet më të pasura me ujëra në Europë. Sipas ligjit, dhe është e moralshme, autoritetet e vendit duhet të shkojnë drejt uljes së çmimit të ujit gjer në dhënien falas të tij, për shkak të rezervave të pafundme natyrore që ne kemi, por ju e rritët çmimin me pretekstin se duhet të sigurojmë furnizimin me ujë 24 orë.

Çfarë ndodhi me rritjen e çmimeve, të dashur qytetarë?

Ujësjellësi i Tiranës garanton humbje 62%, sipas raportit të Entit Rregullator të Ujit. Ujësjellësi i Durrësit, në të cilin u investua një kredi shumë e madhe e Bankës Botërore për të garantuar furnizimin me ujë 100%, ka 71% humbje sot. Pra, ju me lëvizjet që bëtë i dërguat drejt falimentimit të vërtetë këto sipërmarrje të mëdha. Por, në kuadrin e të këqijave që mbillni çdo ditë në këtë vend, kjo është një e keqe që po harrohet, në kuptimin që sot ju po kaloni këtu në parlament një ligj ndëshkues për profesionet e

lira, një ligj i cili krijon kushte të kalkuleshme për shpopullimin e Shqipërisë.

Zonja dhe zotërinj,

Krijimi i kushteve të kalkuleshme për shpopullim vlerësohet në konventën e OKB-së, në nenin 3 të saj, si akt gjenocidi dhe ju vazhdoni në serialin e këtyre kushteve. Keni përzënë në 8 vjet mbi 35% të shqiptarëve nga trojet, nga vendi dhe nga tokat e tyre, dhe nuk jeni të ngopur e tani po i jepni goditjen fatale edhe shtresës së mesme, po e shkatërroni edhe këtë shtresë, ekzistenca e së cilës është jetike jo vetëm për sistemin, por për një seri shërbimesh për shoqërinë shqiptare. Këto shërbime ju i merrni jashtë, i merrni me avionë personalë, me *charter*-a, dhe harroni se qytetarët shqiptarë kanë nevoja jetike për stomatologun, për kontabilistin, për avokatin, pra për të gjitha ato që quhen profesione të lira. Por ju, me një të rënë të lapsit, doni t'i përzini ata nga Shqipëria.

Me zërin tim të protestës, unë e dënoj miratimin e këtij ligji, si një ligj që krijon kushte të kalkuleshme për largimin e ekspertëve nga Shqipëria dhe *de facto* për shkatërrimin përfundimtar të shtresës së mesme, shtresë e cila nuk ju përshtatet, nuk i ndjek politikën tuaja, përkundrazi i denoncon çdo ditë ato.

Teksa po lexoj këtë fjalë para jush, më vijnë lajme se gjykata në Nju-Jork ka bërë zbulime tronditëse për veprimtarinë e McGonigal-it, për lidhjet e tij me Edi Ramën. Është vendosur që gjykata të konfiskojë të gjitha pasuritë e McGonigal-it, kudo që ndodhen. Themi se është jetik komisioni hetimor parlamentar për të zbuluar dhe për të gjetur të gjitha pasuritë e McGonigal-it në Shqipëri, të cilat i vendosi me Edi Ramën, Dorian Duçkën dhe Agron Nezen.

Afera "McGonigal" do ta ndjekë Ramën deri në ditën e fundit të ekzistencës së tij. McGonigal-i ishte një tradhtar i kombit amerikan, një njeri i korruptuar nga Oleg Deripaska dhe Edi Rama, nga Dorian Duçka dhe Shestakov. Në këtë kontekst, një hije e zezë bie sot mbi të gjithë ju, jo se ju keni afera personale me McGonigal-in, porse njeriu që ju mbështesni është korruptuesi dhe njëkohësisht skllavi i tij.

Drejhtësia amerikane çdo ditë po gjen dhe po zbulon fakte të reja. Ne këtu do ngremë një komision hetimor parlamentar për të zbuluar dhe për të gjetur fakte të reja, me të cilat Edi Rama del fund e krye i inkriminuar. A mund ta imagjinoni ju që Duçka, këshilltari privat i Ramës, të vërë

gjyba publike nga një restorant në një restorant tjetër apo nga një lokal në një lokal tjetër, të denoncohet dhe të mos lëvizë drejtësia e kontrolluar shqiptare as edhe gjënë më të vogël?! Ju mendoni se do shpëtoni në këtë mënyrë? E kam fjalën për Edi Ramën me grupin e tij të ngushtë, me ministrat, se dhe ata i kanë bërë fresk McGonigal-it; janë të njohura disa aktivitete. Ku është ky Gjijnuri, zëdhënësi i interesave ruse? Është sekretari juaj i Përgjithshëm. Po, zotëri, është! Takimet e fshehta që ka bërë në Petersburg, me kompanitë e naftës, me kompani të tjera ruse, si dhe me garancitë që ka dhënë janë të pamohueshme. Në një kohë kur në Kongresin Amerikan fliste kundër kompanive, në Petersburg firmoste marrëveshje dhe kontrata. Jeni të zhytur në shkallën më të thellë në këtë aferë. Ndaj, zonja Kryetare, është emergjente ngritja e komisionit për të hetuar marrëdhëniet korruptive Rama-McGonigal.

Së fundi (nuk është këtu ai, ministri i familjes), në 4 ditë ka pasur 4 të vrarë me motot: "Ngrënshin kokat e njëri-tjetrit!", "Licencë për vrasje", "Rendi në duart e kimit" dhe "Policia nuk ekziston". Kjo është siguria dhe këto janë kushte e kalkuleshme për largimin e shqiptarëve, kjo është edhe pjesë e platformës së gjenocidit që ushtrohet ndaj qytetarëve shqiptarë. Një Kryeministër që sulmon me tërbim mediet me tritol, me dinamit, që inkurajon breshëritë ndaj mediave të tjera për qëllimet e tij, është krim-ministër, nuk mund të quhet më Kryeministër, dhe në kulmin e këtyre vrasjeve, prisni kur të deklarojë përsëri se rendi sot është më i mirë se kurrë në histori. Keni humbur përgjegjësinë më minimale edhe ju që e dëgjoni. A ju bën mbledhje apo nuk ju vjen fare në mbledhje ai? Edhe po nuk ju bëri mbledhje, kërkojini mbledhje.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Po, po, zoti Gogu, se unë e shoh që ti u thua qytetarëve të Tiranës se po furnizohen 17 orë me ujë, në një kohë kur 61% e tyre nuk kanë as 8 orë ujë. E kam parë që i bën fresk atij pylltarit 1-milionësh dhe e shoqëron me kënaqësi, atij që thotë "Mbolla 1 milion drurë". Atë e vret Zoti me këtë gënjeshtëri, se ti je dhe besimtar dhe nuk duhet ta pranosh kurrë gënjeshtërinë, ndaj mos i shko afër, se qëllon si dëshmitar i rremë i një njeriu që vjedh paratë e një milion fidanëve! A e dini, zoti Gogu, se çfarë do të thotë 1 milion fidanë? Do të thotë një pyll 10 herë më i madh se

parku i liqenit, kurse ti vazhdon ta duartrokasësh atë...

**Lindita Nikolla** – Mbaroi koha, zoti Berisha.

**Sali Berisha** – Një minutë, të lutem shumë!

**Lindita Nikolla** – Mbaroi koha.

*(Zoti Sali Berisha flet pa mikrofon, pasi i është ndërprerë fjala.)*

Fjala për zotin Fadil Nasufi.

Zoti Gogu kërkon fjalën për replikë.

**Toni Gogu** – Zoti Berisha, unë e kuptoj shumë mirë që juve e vërteta ju shqetëson, por e di shumë mirë që ajo të çliron, kështu që do të ishte mirë ta shihje në sy, sepse pemët që kanë mbjellë qytetarët e Tiranës, dhe jam i sigurt se shumë nga simpatizantët tuaj kujtojnë prindërit e tyre, ditëlindjet e fëmijëve të tyre, martesat e tyre, po deshe, zbukurojnë qytetin, nuk mund t'i asgjësosh me atë gënjeshtër tënde kronike.

E dyta, unë nuk i bëj fresk askujt. Unë u shërbej qytetarëve dhe përpiqem ta bëj këtë me shumë devotshmëri. Mos u merr fare me ne socialistët, sepse ne do të vazhdojmë ta bëjmë këtë punë, se, me sa shoh unë, ti nuk po mbledh dot të tutë, ndaj mos u merr me mbledhjet tona, të cilat, sa herë i dëgjon, të ngjallin frikë, se po ju troket ora e humbjes së radhës, ty dhe atyre të shkoqurave të tjera që të kanë ngelur vërdallë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk ka replikë mbi replikë, e dini tashmë.

Zoti Fadil Nasufi, keni fjalën për 5 minuta.

**Fadil Nasufi** – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raportin e ERRU-së e vlerësoj, sepse ka realizuar rekomandimet e Kuvendit, ka kryer në mënyrë institucionale monitorimet dhe ka përmbushur misionin për të cilin funksionon ky Ent.

Tani t'i kthehem çështjes, se këtu fjala rrjedh edhe për shkak të parafolësit Berisha. Kur u bë transformimi i ujësjellësve të pushtetit vendor rreth vitit 2009, nuk u bë nga dashuria juaj e madhe për decentralizimin, por hoqët nga qeveria një barrë të papërballueshme, duke ia faturuar borxhin dhe të gjitha problemet e përkeqësuar të ujësjellësve pushtetit vendor. Në ujësjellësin e Beratit ishin 217 punonjës, një ndërmarrje e çorganizuar, që drejtohej nga një

militant joprofesionist i PD-së dhe ku ndërmarrja e ujësjellësit ishte shkatërruesja më e madhe e infrastrukturës; hap e mbyll gropa pa fund, sepse nuk dinin asgjë nga rrjeti i shpërndarjes dhe punën e riparimit e bënte një saldator, ndërsa 10 veta të tjerë vëzhgonin duke mbajtur nga një pagurë raki në xhep. Mangalemi, Gorica dhe Kalaja evidentoheshin më shumë nga bojlerët mbi çati sesa nga vlerat arkitekurore dhe shtëpitë karakteristike. Pas programit të KfW-së dhe reformës që nisëm në vitin 2009, e ulëm numrin e punonjësve nga 2017 në fazën e parë, në 182, deri në 160 në vitin 2012. Prandaj, kur ju flisni këtu, nuk i referoheni kohës suaj dhe dominoheni nga sindromi i kohës suaj. Kështu që, duke folur për ujin, ju vetëm dini të rrihni ujin në havan dhe, siç ka thënë Isak Njutoni, bëni sa një pikë ujë dhe nuk dini të bëni sa një oqean, ndërkohë që ju duhet shumë ujë për të larë gojën nga pislleku që lëshoni nga kjo foltore, pisllek ky i kahershëm që nga viti 1991, kur jeni këtu në këtë foltore. Keni pasur një profesioniste shumë të mirë, Enkelejda Gjinalin, një njohëse e mirë e strategjisë së ujësjellëskanalizimeve dhe një bashkëpunuese shumë e mirë, prandaj ajo i di mirë marrëdhëniet me donatorët dhe programin me të cilin është zhvilluar.

Falë këtyre marrëdhënieve që kemi krijuar herët në Berat me bankën gjermane KfW, kemi një miradministrim dhe flasim me tregues komplet optimistë dhe për një situatë të përmbysur që nga koha juaj. Sot, Berati dhe Kuçova kanë 24 orë ujë dhe performanca e sh.a.-ve rajonale është shumë pozitive. Nga përmbyllja e 4 programeve të KfW-së, sot kemi një rrjet shpërndarës të stabilizuar; lidhje familjare me matës; reduktim në maksimum të humbjeve në rrjet, si dhe arkëtime dhe faturime në nivel të kënaqshëm, ndërkohë që furnizohen nga ujësjellësi rajonal i Bogovës Kuçova, Otlaku, Orizaj, Lapardhaja, Bilça, Velabishti, Starova, Remanica, Veterniku dhe Duhanasi. Kjo do të thotë se në kohën tuaj maksimumi i furnizimit me ujë shkonte deri në 8 orë, me nga 3 orare, kurse sot, megjithëse janë shtuar edhe 50 mijë banorë dhe shumë biznese turistike e biznese furnizimi është 24 orë, një ndryshim si nata me ditën.

Kemi një program madhor për Shqipërinë, që është furnizimi me ujë të pijshëm në të gjithë territorin, duke i dhënë fund historisë së tranzicionit por edhe historisë së hershme, ku uji

me bollëk, si dhuratë e natyrës, ka munguar historikisht në familje, në fshatrat dhe në qytetet tona.

Ndoshta duket si paradoks që edhe në vitin 2023 flasim për prioritetet dhe buxhete të konsiderueshme nga qeveria dhe donatorët për programin e furnizimit me ujë të pijshëm, por fragmentarizmi, amortizimi dhe keqmenaxhimi e kanë kthyer këtë sektor nga pikëpamja e shërbimit dhe nga situata financiare në një sektor problematik, jorentabël dhe me borxhe të konsiderueshme.

Ndër vite një pjesë e ndërmarrjeve të ujësjellësve kanë qenë pjesë e problemit dhe jo pjesë e zgjidhjes së tij. Janë shpërfillur nevojat bazë të ndërmarrjeve të ujësjellësve për të pasur kapacitetet teknike dhe burime njerëzore të kualifikuara. Reforma e thellë që po zhvillohet nga agregimi i ndërmarrjeve nga 58 në 15 shoqëri rajonale është rruga e duhur dhe efiçente, që ka filluar të japë impakt të menjëhershëm. Po mbyllet cikli i akumulimit të borxhit dhe i thellimit të humbjeve dhe ka filluar faza e integritimit, e agregimit, e rritjes së performancës, si dhe e krijimit të sinergjive të reja për menaxhimin dhe administrimin e shoqërive rajonale.

**Lindita Nikolla** – Mbaroi koha, zoti Nasufi.

**Fadil Nasufi** – Dakord, por do të doja të jepja një mesazh për ERRU-në: do të doja të hartonte një manual për monitorimin e punonjësve për të rritur kapacitetet që të jetë unik në të gjithë Shqipërinë, si dhe të shmangen vendet parazitike që kanë ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Zoti Berisha, 2 minuta kohë për replikë.

**Sali Berisha** – Kur gënjeshtro të ha dhe të shkatërron memorien, kjo është sindromë e re. I rikujtoj pak zotit Nasufi se në datën 6 gusht të vitit 2011 kam inauguruar me ministrin gjerman, Niebel, dhe me ish-kryetarin e Bashkisë së Beratit, Fadil Nasufi, të cilin në atë kohë gënjeshtro nuk ia kishte ngrënë akoma memorien, ujësjellësin e Beratit, i cili do t'i sillte Beratit 24 orë ujë. Ai më detyroi t'ju rikujtoj një investim, dhe ju, zonjë, do t'ua shpërndani të gjithë deputetëve, që ta shohin të gjithë banorët e Beratit, të Tiranës dhe të Shqipërisë. Kjo faktori që ju e përdorni platformën e parlamentit vetëm

për të mashtruar dhe për të gënjyer qytetarët shqiptarë.

Ktheje pak kamerën këtej, të lutem!

*(Zoti Sali Berisha tregon një foto.)*

Ja, pra, ky ka qenë në krahun tim, i buzëqeshur dhe me gërshërë në dorë teksa priste shiritin!

Fadil, ku je ti? Ja shihe! Pastor, ku jeni? Pandeli, ja ku e keni; të gjithë ju, socialistë!

Kaq kisha unë. Kjo ishte përgjigjja ime.

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka kërkuar zëvendëskryeministrja, e cila merr kohë nga koha e grupit.

**Belinda Balluku** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dyshim që nuk ka ngelur të bëni analiza për sektorin e ujit e as të tregoni historitë e 20 vjetëve më parë, pasi sot parametrat, ashtu siç i prezantoi edhe kryetari i ERRU-së, janë të gjitha të përmirësuar, por jo duke i krahasuar me vitin 2011, se nga ajo kohë nuk kemi më asgjë për të kujtuar, por duke i krahasuar me një vit më parë. Pa dyshim, është një sektor me problematika të mëdha, sepse kemi trashëguar ujësjellës të ndërtuar në vitet '50, që sot janë totalisht të rinovuar dhe të rikonstruktuar. Kujtoj këtu ujësjellësin e Gjirokastrës, i cili para pak ditësh ka filluar të operojë nën parametra komplet të rinj, me një investim i cili mbulon jo vetëm kërkesat e qytetit, por edhe të vizitorëve, sepse qyteti i Gjirokastrës gjatë verës arrin katërfishin e numrit të banorëve të saj.

U përmend këtu çështja e energjisë. Pa dyshim që kostoja e lartë e produktit të ujit vjen për shkak të energjisë elektrike. Sigurisht, gjatë vitit 2022 kemi pasur një ndryshim për sa u përket konsumatorëve të lidhur në tensionin e mesëm. Kjo është reflektuar edhe tek ujësjellësit. Megjithatë, ashtu siç ju e dini, edhe siç e tha edhe kryetari i ERRU-së, ne kemi nisur prej kohësh një program dhe një strategji të mirëfilltë të efiçencës së energjisë së ujësjellësve kudo në vendin tonë. Kemi shembuj konkretë, siç është ujësjellësi i Memaliajit apo ai i Belshit, të cilët sot funksionojnë në mënyrë të pavarur me autoproduhim të energjisë. Ky është një program, i cili do të shtrihet në të gjithë ata ujësjellës që nuk e kanë mundësinë e rënies gravitacionale dhe përdorin sistemet e pompimit, duke ulur kështu koston e produktit.

U fol këtu për rritje të çmimit, dhe këtë ju e bëni çdo vit. Ndërkohë, nuk ka pasur rritje të çmimit të ujit, por pa dyshim ka pasur ulje të rëndësishme të humbjeve teknike të rrjetit, duke qenë se tashmë rrjeti i shpërndarjes dhe ai maestral po zëvendësohen në të gjithë vendin dhe humbjet teknike janë ulur dukshëm, duke i krahasuar shifrat edhe me një vit më parë. Kështu po rritet efienca energjetike, pa dyshim po rritet mbledhja e të ardhurave nga ujësjellësit, gjë që vjen edhe për shkak të reformës së thellë që qeveria shqiptare e ka nisur gjatë vitit 2022 me agregimin e kompanive. Sot kompanitë e agreguara po performojnë në mënyrën më të mirë qoftë për sa u përket kushteve sanitare, qoftë për sa u përket investimeve, mbledhjes së të ardhurave dhe pa dyshim asaj që ka qenë gangrena më e madhe e të gjithë këtij sektori, për humbjet teknike.

Për sa i përket ofrimit të shërbimit, ne flasim me shifra, siç foli kryetari i ERRU-së, dhe këtu nuk diskutohet më sa është rritur koha e shërbimit. Në rang vendi jemi mbi 16 orë me furnizim të plotë, ndërkohë që vetëm gjatë vitit 2022 më shumë se 11 njësi urbane janë mbuluar 24 orë me ujë, duke vazhduar kështu të gjitha proceset. Sigurisht, gjithçka shkon me një strategji prioritare, duke nisur nga zonat urbane, zonat turistike për t'u shpërndarë më pas edhe në zonat rurale.

Ecuria pozitive në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, e shprehur me shifra, për të mos e përsëritur, duke qenë se sot u bë një prezantim i plotë nga kryetari i ERRU-së dhe nga deputetët, pjesë e komisioneve, është e vërtetueshme që nuk është një çështje politike. Nuk mund të jetë një propagandë dhe narrativë e vazhdueshme politike, pasi është një shërbim bazik, i cili ofrohet sot në pjesën më të madhe të vendit në kushtet më të mira dhe në kushte të përmirësuara dhe kështu do të vazhdojë në të gjitha ndërmarrjet e tjera të agreguara me 3 komponentë të rëndësishëm.

E para, efienca e burimeve njerëzore. Të gjithë jemi në dijeni që ka pasur një numër të shtuar punonjësish për frymë, pra ka një numër ekzakt se për një punonjës korrespondojnë 4,7 banorë.

Nga ana tjetër, e rëndësishme është edhe efienca energjetike, e cila, e thashë edhe në fillim të fjalës sime, pa dyshim rrit koston e produktit.

E treta, që është më e rëndësishmja: humbjet teknike në rrjet. Të gjitha këto janë procese që po i aplikojmë dhe rezultatet po i korrim dita-ditës. Siç e thashë, nuk mbetet për t'u bërë shumë narrativë politike nga momenti kur çdo qytetar e ndien përmirësimin e këtij shërbimi, i cili është jetik për të gjithë ne.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit! Fjala për zotin Dashamir Shehi. Të përgatitet zoti Petrit Vasili, 5 minuta në dispozicion.

**Dashamir Shehi** – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Për sa kohë do të jenë depot e ujit mbi Tiranë dhe poshtë e përpjetë Shqipërisë, e gjithë kjo efienca e madhe, e kuptoni edhe ju, është një fjalë boshe. Ditën që depot do të zbresin poshtë, do të hiqen, ne që jemi këtu, qytetarët më shumë, do të kuptojnë se qenka rregulluar diçka në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve! A ka përmirësime? Sigurisht që ka, sepse janë harxhuar miliona për këtë punë. Qeveria që është në këmbë, ka edhe ndonjë sukses, sepse ka 10 vjet që qeveris. Qeveria, qëkur erdhi, na premtoi se Tirana nuk do të ketë më depo (po marr Tiranën, por e gjithë Shqipëria), ndërkohë që nuk kam parë asnjë qytet pa depo, përjashtoj Korçën, Pogradecin, kjo për hir të traditës së mirë.

Ju pretendoni që do të bëhet një reformë e madhe në sektor, se do të rritni ekonominë e shkallës. A thua se është e mjaftueshme që 7 ndërmarrje të bëhen 1 dhe do të rrisin efiençën në mënyrë automatike?! Nuk është kështu e vërteta. Brenda një ndërmarrjeje ka shumë komponentë, duke filluar me mënyrën e organizimit, raportin me territorin, burimet ujore, pra janë shumë gjëra që nuk e bëjnë automatikisht këtë.

E dyta, nuk ka një qendër politike, që e drejton këtë punë. Në çdo shtet normal kjo do t'i ishte deleguar Entit Rregullator, që është përcaktuesi i kësaj pune. Në njëfarë mënyre, ju e keni lënë që kjo punë të drejtohet me të njëjtin stil të vjetër të ministrive, që ta kenë ato nën kontroll. Drejtorja e vjetër e Ujësjellës-Kanalizimeve sot e kësaj dite është e njëjta, në njëfarë mënyre. Ndërkohë, pretendoni për një reformë të madhe europiane, kur në Europë këto punë i drejtojnë entet rregullatore, nuk i drejtojnë ministrat dhe as

drejtoritë që i çojnë paratë ku u intereson sipas fushatave dhe zonave të caktuara.

Kështu që, unë kam të gjitha dyshimet e mia se të gjitha këto fjalë të bukura që po thuhën për ujësjellësit, nuk janë të një realiteti konkret, sepse ne lexuam edhe shifrat (e kemi diskutuar edhe para 1 viti këtu) që thonë se Tirana ka 17 orë ujë. Më sillni disa banorë të Tiranës për ta vërtetuar këtë, sepse këtu në Tiranë banojmë të gjithë ne. Kush ka 17 orë ujë në shtëpitë e tyre? Nëse do të kishte ujë 17 orë, do të hiqeshin depot, nuk ka pse rrinë kot. Nuk ka nevojë për depo pas 17 orëve ujë. Kështu, këto janë disa shifra që nuk e tregojnë aspak të vërtetën.

E gjithë kjo është një vetëmburrje, sikur problemi i ujësjellësve ka filluar dhe ka mbaruar me këtë qeveri. Ministria tha se nuk krahasohemi me vitin 2011, por ndoshta nuk e di se Tirana merr ujë nga ujësjellësi i Bovillës, një vepër që nuk është e vitit 2011, por është e vitit 2006. Të gjitha burimet në Tiranë janë të asaj periudhe dhe nuk është shtuar asgjë, as edhe një litër më tepër. Tirana merr 2400 litra, ka pasur 400 mijë banorë dhe sot ka gati 1 milion banorë, dhe merr gjysmën e konsumit. Cili burim i ri është shtuar në Tiranë për prurjet ujore? Tirana, të vetmen rezervë për të përmirësuar situatën është ujësjellësi i Tiranës, duke ulur humbjet e tij. Nuk ka rrugë tjetër. Në Tiranë janë harxhuar para sa të duash, mirëpo eficientia nuk shkon paralel me këtë.

Në Tiranë kemi një gropë të madhe, sepse nuk e dimë se çfarë bëhet me depuratorin e ujërave të zeza, një projekt madhor, i propozuar 25 vjet më parë nga qeveria japoneze. A di të më thotë gjë njeri se çfarë bëhet me këtë vepër madhore? Deri ku janë punimet? Sa janë shpenzimet? Cili është projekti final? Ku shkojnë të gjitha këto punë? Sigurisht që sektori, është i madh, i pafund dhe ka vuajtur ndër vite nga shpërdorimet dhe abuzimet, por ne nuk jemi sot këtu në situatën e mrekullisë. Ata që janë teknikë dhe marrin pak vesh nga kjo punë, të jeni të sigurt se kanë të njëjtat dyshime që kam unë sot.

E fundit fare, në këto 30 sekonda do ta ftoja qeverinë shqiptare dhe parlamentin, sepse çështja e ujit është një çështje më madhore se sa ujësjellësi, dhe ka ardhur dita: të bëhet një plan më i madh për të gjitha rezervat ujore, jo thjesht për ujësjellësit, por për ujin për vaditje, për ujin për hidrocentralet dhe të gjitha ato elemente që ka qeveria shqiptare sot në dorë, Drejtoria e

Ujësjellës-kanalizimeve, Enti Rregullator që duhet të jetë lideri politik, Komiteti Shtetëror i Ujërave, Ministria e Bujqësisë. Në Shqipëri po vjen thatësira. Keni shitur mend që kemi 13 miliardë rezerva ujore, se kemi 7 lumenj e 7 liqene (në fakt, i kemi si në Bibël), mirëpo gjithë verën Shqipëria është e thatë, sepse kemi prishur rezervuarët dhe nuk kemi ndërtuar të rinj, se nuk kemi eficiencë në kontrollin e ujit dhe kemi prishur edhe ndërmarrjet pyjore. Ka ardhur dita dhe po afron thatësira, siç po afron për të gjithë fqinjët tanë; kjo do të duhej të ishte një temë e madhe që të merrte në diskutim qeveria shqiptare, duhej ta shikonte minimalisht për dekadën që po vjen, jo më për më tepër.

Këtu u tha se ka pasur sukses të madh tek ujësjellësi i Belshit apo se në Libohovë paska 24 orë ujë në ditë! Hallall, edhe Belshi, edhe Libohova, qoftë edhe Klosi kanë nevojë për 24 orë ujë, por, në qoftë se kjo nuk zgjidhet në qytetet e mëdha dhe në zonat turistike, do të vijë dita që do të vijmë të diskutojmë përsëri dhe do të themi të njëjtat fjalë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Zonja Balluku, 2 minuta replikë.

**Belinda Balluku** – Për sqarim, në Belsh nuk është çështja e 24 orëve me ujë, se, kur na referoheni, të paktën na dëgjoni kur ju themi ndonjë gjë, por bëhet fjalë për eficientën energjetike. Pra, që të mos përdoret, siç tha parafolësi, energjia elektrike, kanë filluar dhe janë bërë parqet fotovoltaike në Belsh dhe në Memaliaj, gjë që synojmë ta bëjmë kudo. Për shembull, Durrësi ka 4 sisteme pompimi dhe është një prej ujësjellësve më problematikë për shkak të konsumit energjetik. Kështu që nuk ka lidhje me orët e ujit që ofrojmë në Belsh, se patjetër që i ofrojmë. Kështu që, kur të më referoheni, m'u referoni saktë.

Për sa i përket Tiranës, unë po flas me shifra. Nuk e di kujt i referoheni ju kur thoni se Tirana nuk është kështu. Atëherë, në vitin 2015, meqenëse nuk e keni qejf krahasimin me vitin 2011, Tirana i kishte humbjet teknike 75 për qind, sot i ka 59,8 për qind. Pra, po flas me shifra.

Ndërkohë, për sa u përket burimeve të reja, me shumë të drejtë që doni të informoheni. Unë po ju informoj edhe për burimet e reja, pavarësisht se ju nuk doni t'ju informojnë ministrat, por doni t'ju informojnë të tjerët. Të tjerët e bëjnë punën,

kemi drejtorë, inxhinierët dhe kemi të gjithë ata që punojnë kudo në Shqipëri dhe kontribuojnë, por këtu në parlament janë ministrat dhe nuk i sjellim dot ata që t'jua thonë juve. Tiranës do t'i shtohet burimi i Gurit të Bardhë, i cili tashmë është studiuar dhe është dizajnuar si projekt, madje është marrë edhe kredia nga Banka Europiane për Investime prej Bashkisë së Tiranës.

Kështu që të gjitha pyetjet që ju keni, e kanë një përgjigje dhe e kanë me shifra, me marrëveshje dhe me fakte. Ndërkohë, ju vazhdoni t'i referoheni përgjithësisht duke thënë se nuk e dini apo se nuk ka ujë, por ne ju themi që ujë ka, investimet janë bërë dhe humbjet teknike janë ulur me përqindje të sakta, të relatuara nga ujesjellësi i Tiranës, të cilat po jua përcjell.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Petrit Vasili.

Zoti Vasili, keni 5 minuta në dispozicion.

**Petrit Vasili** – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot, në mënyrë normale, do të ishte diskutimi më i gjatë dhe më intensiv në lidhje me këtë çështje. Besoj se ky është raportimi më i vakët që ka ndodhur ndonjëherë. Nuk do të qëndroj fare te raportimet e institucionit përkatës, sepse praktikisht ndikimi i tij në lidhje me një problematikë kaq të madhe, siç është uji, ndryshe nga misioni dhe detyrat që ka, është thuajse i papërfillshëm. Më mirë të qëndrojmë tek ato deklarime që marrin përsipër qeveria dhe pushteti lokal.

Për sa i takon problematikës së ujit, Kryeministri i Shqipërisë në fushatën e vitit 2021 premtoi sërish 24 orë ujë. Është mirë që kjo foltore të përdoret vetëm për të thënë të vërteta. Unë i qëndroj të njëjtit angazhim që t'u referohem vetëm atyre që thonë ata vetë, sepse, për fat të keq, nuk mbajnë mend as se çfarë thonë. Ky premtoi 24 orë ujë, ndërsa në Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë, e miratuar nga kjo qeveri (këtu besoj se nuk do të keni replika, sepse nuk do t'i replikoni dot dokumentet e njëri-tjetrit), jo vetëm që nuk është një objektivi i tillë, por nga objektivi i vendosur në strategjinë e mëparshme për të pasur 21 orë ujë të pijshëm, ky objektivi është ulur në 16 orë ujë. Kështu që nevojitet një koordinim në lidhje edhe me gënjeshtat që thoni këtu. Po flas gjithmonë me dokumentet tuaja, jo tonat.

Sa u takon dokumenteve politike, një pjesë e mirë e deputetëve jetojnë në Tiranë, edhe ata që vijnë nga rrethet për shkak të detyrave që kanë, kështu që duhet ta dinë se në këtë qytet çmimi është rritur mbi 40 për qind. Ky është fakt, nuk e lëviz topi. Besoj se nuk mund ta mohoni dot, sepse, po e mohuat edhe këtë, jemi në kufijtë e çmendurisë. Çmimi u rrit me angazhimin se do të ketë ujë 24 orë dhe kryetari i Bashkisë së Tiranës ka thënë: “Do të kemi ujë të Korçës me çmimin e Bathores”. Këto nuk janë deklaratat e mia, janë tuajat. Cila është përgjigja sot? Të gjitha tarracat e Tiranës i kemi të mbushura me depozita uji, as që bëhet fjalë për 24 orë ujë, megjithëse ishte parashikuar brenda 5 vjetëve, por kemi hyrë në vitin e gjashtë dhe as që bëhet fjalë për këtë gjë. Me demok dolën edhe urdhra për t'i hequr depozitat, ndërkohë që depozita keni edhe në zonat në qendër të Tiranës deri te njësia 5. Jo që nuk bëhet fjalë për ujë 24 orë, por në periudha të veçanta të vitit uji shitet me bote në mes të Tiranës së Re. Ky është realiteti. Çfarë do të themi? Do të gënjejme tani?

Vetë funksionarë të qeverisë e kanë pranuar se uji nuk mund të konsumohet. Detyrë është që konsumatorët të furnizohen me ujë higjenikisht të pastër, këtë e thotë rregullorja e ujit, e cila është miratuar, qëkur nuk mbahet mend. Ky është minimumi i standardit. Nuk mund t'u imponohemi shqiptarëve, duke u thënë se duhet ta blejnë ujin e ambalazhuar, se qeveria ka ndërmend të gënjejë.

Tani është edhe kjo dëshira e madhe për t'iu referuar gjithmonë kohëve më parë! Kjo është një gjë shumë e mirë dhe legjitime, nuk ka asgjë. Po sa do referoheni, se u bënë 10 vjet? Kujt do t'i referoheni? Mos u referoni më viteve 2011 dhe 2012, por mund t'i referoheni edhe vitit 1938. Ata që ishin paraardhësit tuaj deri në fund të viteve '90 i referoheshin vitit 1938, prandaj Shqipëria përfundoi me tollona dhe me gomone.

Kështu që të gjitha këto janë fakte kaq të rënda, sa gjithçka që ndodh me ujin, është vetëm një spekulim i vazhdueshëm elektoral. Kushdo që në mënyrë të vërtetë jep objektiva apo jep premtime të realizueshme, quhet një njeri pamend. Nëse dikush thotë se do të ketë ujë 14 orë, sepse në zona të caktuara nuk ka ujë fare, do të quhej budalla, sepse ne themi 24 orë, madje e themi në çdo fushatë që vjen. Këto janë faktet. Premtimi i Edi Ramës ishte mashtrim. Premtimi i



Erion Veliajt ishte mashtrim. Kurdo që të shikoni premtime për ujin nga kjo qeveri, dini se vetëm gënjen. Falimentimi i ujësjellësve anë e mbanë vendit dhe rrëmbimi i tyre ishte një dështim i përbashkët mes qeverisë qendrore dhe asaj lokale. Po i shpërdorove dhe po i grive paratë, fondet e ujit të pijshëm, ujë nuk do të ketë dhe falimentimi do të jetë te pragu i derës.

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Xhelal Mziu. Keni 10 minuta në dispozicion.

**Xhelal Mziu** – Të dashur qytetarë,

E nderuar Kryetarë,

Të nderuar kolegë,

Sot kemi të bëjmë me një çështje shumë të rëndësishme, siç është uji. Uji mbetet një element shumë i rëndësishëm për çdo banor, dhe jo më kot ka qenë kryefjala e çdo fushate elektorale në këta 33 vjet. Kujtoj fushatën e vitit 2013 të Kryeministrit të sotëm, i cili deklaroi se nuk do të ketë familje që të mos ketë ujë 24 orë dhe nuk do të ketë parcelë që të mos ketë ujë vaditës. Kjo deklaratë prishi mendjen e mjaft qytetarëve për ta votuar “Rilindjen”, por sot, pas 10 vjetësh, mbetet përsëri kryefjalë furnizimi me ujë i familjeve. Sot kemi pafund familje pa ujë dhe në mes të Tiranës kemi përdorimin e depozitës për furnizimin me ujë.

Kryeministri nuk u mjaftua vetëm me këtë deklaratë që nuk e mbajti në këta 10 vjet, por në vitin 2015 hodhi një tjetër hap të rëndësishëm për ujësjellësit, duke ua kaluar edhe kompetencat e këshillave bashkiakë kryetarëve të bashkisë për këtë produkt mjaft të rëndësishëm. Po çfarë ndodhi pas vitit 2015? Ndodhi që nga 58 ujësjellës që kishte Shqipëria, vetëm 2 prej këtyre ujësjellësve kishin një performancë pozitive dhe 56 ujësjellësit e tjerë kishin një standard negativ. Kjo kishte ardhur vetëm për një arsye: për shkak të futjes së duarve të politikës tek ujësjellësit. Unë do të përmend disa nga indikatorët, të cilët kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë te standardi i ujësjellësit. Si asnjëherë tjetër, nga viti 2015 e deri më sot ndërmarrjet e ujësjellësve e kanë tjetërsuar funksionin e tyre. Ato nuk janë më për ujin e pijshëm dhe për kanalizimet, por kryesisht kanë funksionin e patronazhistëve të djeshëm dhe të aktivistit të sotëm, dhe kjo është për të ardhur keq. Treguesi më kryesor i kësaj është që sot ne kemi 5,6 apo 5,8 punonjës për 1000 lidhje, sipas raportit, por, në fakt, është edhe më shumë, sepse nuk është bërë azhurnimi i pragzgjedhjeve të

datës 14 maj, ku numri i tyre është shtuar pafundësisht. Mesatarja duhet të jetë 3 punonjës për 1000 lidhje, shifër që ishte objektivi kryesor i donatorëve të huaj, të cilët kanë financuar në këto vite si asnjëherë tjetër. Pra, sot kemi punonjës që nuk shkojnë në punë. Sot në disa ujësjellës paguhen dy persona me një kartë banke. Ky është standardi i krijuar.

Një tjetër instrument që u ndërмор nga qeveria, ishte liberalizimi i çmimit të energjisë elektrike. Sot kemi më shumë se 10 apo 15 ujësjellës të cilët kanë falimentuar; kemi 10 apo 12 të tjerë që janë në prag falimentimi për fondin e pagave, në prag falimentimi për sigurimet shoqërore dhe në prag falimentimi për shkak të kostos së jashtëzakonshme të energjisë elektrike. Është e paimagjinueshme se si një produkt kaq i rëndësishëm dhe jetësor, ta blejë energjinë elektrike me çmim të liberalizuar dhe të mos jetë të paktën me koston që është sot në Shqipëri. Një HEC-i i blihej energjia elektrike me 70 lekë, ndërsa ujësjellësit i shitej 3 apo 4 herë më shumë se sa çmimi. Kjo dërgoi në falimentimin e ujësjellësve. Produkti pas 8 vjetësh, pa mbaruar 8 vjet, është që kemi më pak shërbim ndaj qytetarëve, kemi më pak ujë dhe kemi dhjetëra ujësjellës në prag falimentimi.

Ky ishte një terren i përgatitur nga qeveria, dhe jo më kot më 11 maj të vitit që shkoi, u mor një vendim nga Këshilli i Ministrave, me nr. 302, me të cilin 58 ujësjellësit, nën petkun e rajonizimit apo të ekonomisë së shkallës, u konvertuan në 15 ujësjellës. Në fakt, nga e gjithë eksperiencia që kam dhe në komunikimin që kam pasur me donatorët edhe si ish-drejtor i ujësjellësit, por edhe si drejtues bashkie, rajonizimi nuk bëhet me urdhër partie. Rajonizimi bëhet duke shfrytëzuar kushtet gjeografike, ndërkohë edhe duke pasur pëlqimin e sh.a.-ve. Vetëm këtu në Shqipëri ndodh që me urdhër të qeverisë, nga 58 kthehen në 15. Për këtë përdoren 12 bashkitë qendrore dhe qeveria bën edhe 3 qoka, 1 në Pogradec, 1 në Sarandë dhe 1 në Lushnjë, pa asnjë lloj argumenti, dhe krijon tashmë vetëm 15 ujësjellës rajonalë, pa asnjë logjikë. Pavarësisht se pushteti vendor ishte 100 për qind aksioner, qeveria i merr 51 për qind të aksioneve, madje do të rishikohen edhe tarifat e shumë iniciativave të tjera që shkojnë në dëm të qytetarëve. Kjo është e papranueshme dhe skandaloze për këtë shërbim kaq të rëndësishëm. Druhem se kjo kompetencë e marrë nga qeveria

ka edhe erë korruptive, sepse është e papranueshme se si mund të merren 51 për qind të aksioneve.

Në vitin 2009 u bë një revolucion për decentralizimin e këtij sektori mjaft të rëndësishëm, por sot, në vitin 2022 (sepse ky vendim është marrë afërsisht një vit më parë), po kthejmë centralizimin dhe nuk po ndërmarrim hapat e ekonomisë së shkallës. Unë nuk jam kundër ekonomisë së shkallës, por jam për të pasur një balancë investimesh. Sot ne kemi ujësjellës që janë bërë, sidomos nga donatorët e huaj, të cilët kanë një vlerë të konsiderueshme investimi, duke filluar nga Korça, Pogradeci, Tirana, Lezha apo Durrësi, por kemi edhe ujësjellës të tjerë që janë në gjendje primitive, të cilët përdorin vetëm ujin që buron nga natyra dhe nuk e kanë një luks të tillë.

Midis ujësjellësve ka edhe diskriminime të tjera. Nëse shohim të gjithë ujësjellësit që kanë marrë kredi, nuk është se e paguajnë vetë principalin apo interesat, përjashtuar ujësjellësin e Lezhës, i cili i paguan nga të ardhurat e tij. Pra, ky do të thotë një tjetër diskriminim midis ujësjellësve. Këto janë argumentet që tregojnë edhe një herë se ujësjellësi dhe shërbimi ndaj qytetarëve për furnizimin me ujë ka bërë hapa mbrapa, sidomos me centralizimin e tij te pushteti qendror. Nëse u referohem shifrave, duhet ta përgëzoj zotin Shani për profesionalizimin që ka, por duke krahasuar të dyja buletinet e vitit 2021 dhe vitit 2022 për 10 indikatorët kryesorë, shoh që 7 prej tyre i kanë ndryshuar shifrat e referencës. Kjo është e papranueshme dhe druhen se, kur ky informacion rrjedh nga një institucion shumë i rëndësishëm, siç është ERRU-ja, për buletinet e vitit 2021 dhe vitit 2022, imagjino se çfarë ndodh me realitetin në terren. Nuk ka se si të ndodhë ndryshe, sepse mjafton të shikohet uji i paarkëtuar që është 64,8 për qind. A ka ndonjë indikator të saktë që e mat këtë? Pse është 64,8 për qind?

Për të shkuar te një instrument tjetër, që konsiderohej pozitiv për ndërmarrjet, rritja me 2,7 milionëve metra kub ujë për furnizimin e qytetarëve, por nuk ishin shfrytëzuar nga burimet 11,8 milionë metra kub. Kjo më duket pak e paimagjinueshme, sepse në memorien time dhe nga informacioni që kam marrë, janë futur ujësjellës të tjerë, që do të thotë se janë rritur burimet. Kjo shifër përdoret për të treguar artificialisht performancën pozitive, por në të

vërtetë nuk tregon se është ulur prodhimi, kur prodhimi është rritur, sepse ka pasur investime. Kjo shifër nuk mund të përdoret për të manipuluar të dhënat apo ecurinë e kësaj situatë.

Për të mos folur më pas për atë, që është më kryesorja, për numrin e punonjësve për 1000 lidhje. Duke marrë në referencë ministren që tha: “Një punonjës për 4,7 banorë”, nuk e di se ku e ka gjetur këtë, edhe mund t’ia kenë sugjeruar gabim. I vetmi instrument matës për fuqinë punëtore është numri i punonjësve për 1000 lidhje. Ne sot kemi më shumë se 6 punonjës për 1000 lidhje, ndërsa standardi i Bashkimit Europian është 3 punonjës për 1000 lidhje. Pra, këtë shifër e ka sjellë efekti politik i patronazhistëve dhe i aktivistëve.

Uroj që ujësjellësit t’i rikthehen pushtetit vendor, në mënyrë që të kemi një shërbim më të mirë për qytetarët.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Laert Duraj.

Koha në dispozicion 5 minuta.

**Laert Duraj** – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Raportit i Entit Rregullator të Ujit është një fotografi objektive e situatës në këtë sektor, në të cilën edhe pse të gjithë treguesit pothuajse kanë një trend pozitiv, përsëri ritmet e rritjes nuk janë ato që ne të gjithë duam. Ndaj kjo ka qenë arsyeja e ndërmarrjes së reformës më të madhe për ujin në vend, me qëllim përmirësimin e këtij sektori, që ritmi i rritjes të jetë me shifra shumë më të larta se ato që janë deri tani. Në thelb të kësaj reforme kanë qenë edhe raportet periodike të ERRU-së, të cilat falë analizës së hollësishme që kanë bërë për situatën në ndryshme, kanë kontribuar në mënyrë të rëndësishme në reformën që është ndërmarrë.

Falë kësaj reforme do të ketë vetëm 17 shoqëri në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, duke e bërë edhe më të lehtë monitorimin e situatës nga ERRU-ja dhe duke rritur peshën e saj në lidhje me orientimin, këshillimin dhe monitorimin e situatës. Ndaj jemi të bindur se në raportin e vitit që vjen do të ketë shifra edhe më pozitive se këto që janë paraqitur.

Megjithatë, përtej betejës së shifrave, që këtu në parlament është një traditë që nuk mbaron asnjëherë, ajo që ka më shumë vlerë është

realiteti. Unë flas për qarkun e Gjirokastrës, të cilin e njoh relativisht mirë.

Qytetarët e Përmetit kanë një jetë që jetojnë buzë Vjosës dhe në shpatet e Dhëmbelit, por vetëm kohët e fundit kanë pasur 24 orë ujë. E njëjta gjë është edhe për Këlcyrën, Tepelenën, Memaliajn, Gjirokastrën, e cila ka pasur një situatë problematike. Edhe në fshatrat e Dropullit, që për shkak të karakteristikave të natyrës kanë një problem shekullor me ujin, sidomos ato që shtrihen në luginën e Drinos, problemi i ujit është zgjidhur një herë e mirë.

Edhe në Bashkinë e Libohovës situata është në test, pra shumë shpejt ujësjellësi do të merret në dorëzim dhe qytetarët do të përfitojnë 24 orë ujë të pijshëm. Por, duhet pranuar se shtrirja në zonat rurale lë shumë për të dëshiruar. Për disa fshatra, ato më kryesoret, ky problem është zgjidhur, por për fshatrat e largëta, për shkak të ndryshimeve demografike, ka qenë e vështirë të bëhej një investim efikas nga ndërmarrjet e vogla të ujësjellësit që ishin sipas bashkive.

Ne kemi 7 bashki dhe ishte e pamundur që një ndërmarrje të kishte infrastrukturën dhe forcën e duhur për të zgjidhur çdo problem, por falë reformës ne kemi një ndërmarrje, pra një shoqëri, për të gjithë qarkun, e cila është e aftë që në mënyrë kapilare dhe të përgjithshme të zgjidhë çdo problem të zonës. Për shembull, kemi rastin e fshatit Cerrilë në Memaliaj, ku problemin e ujit nuk e zgjidhte dot ujësjellësi i mëparshëm i këtij qarku, por me bashkimin e forcave dhe krijimin e ndërmarrjes së përbashkët unë besoj se ky problem do të zgjidhet shumë shpejt dhe do të jetë një shembull konkret se si rritja e efikasitetit do të shoqërojë këtë ristrukturim.

Nga ana tjetër, meqenëse jemi te Gjirokastra, dhe bëhet fjalë për luginën e Vjosës dhe shndërrimin e saj në park kombëtar, ka qenë një shqetësim i banorëve në lidhje me ujërat e ndotura, të cilin e kam ndarë me drejtuesit e Entit gjatë fjalës dhe analizës së punës së tyre në komision. Është një lajm i mirë që dua ta ndaj me të gjithë ju, pasi shndërrimi i Vjosës në park kombëtar do të shoqërohet me benefite për të gjithë, por edhe për banorët e zonës.

Për sa u përket ujërave të ndotura, falë një projekti me Bankën Botërore, për të gjitha fshatrat kryesore do të zgjidhet në mënyrë profesionale njëherë e mirë problemi i ujërave të ndotura. Ky

është një lajm i mirë, të cilin dua ta ndaj me ju, por edhe me qytetarët e qarkut të Gjirokastrës.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjala për zotin Arben Pëllumbi.

Koha në dispozicion 10 minuta.

**Arben Pëllumbi** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot diskutohet raporti i Entit Rregullator të Ujit.

Në fillim të fjalës sime, dua të falënderoj drejtuesit, bordin dhe të gjithë punonjësit e këtij enti, në radhë të parë, për korrektësinë e paraqitjes në afate të këtij raporti në Kuvendin e Shqipërisë dhe, në radhë të dytë, për korrektesën me të cilën kanë paraqitur në raportin e tyre, me të gjithë treguesit e situatës reale që kemi në terren për ujësjellës-kanalizimet.

ERRU-ja është një ent i pavarur që mbikëqyr, tarifon dhe licencon, pra ka detyra të qarta, të cilat besoj se i ka realizuar më së miri.

Nga ana tjetër, dua ta nxis ERRU-në që t'i ketë parasysh ato detyra, të cilat do t'i lërë Kuvendi i Shqipërisë të materializuar në projektrezolutën që do të aprovojmë sot. Për çfarë e kam fjalën?

E para, të vazhdojë përpjekjet për nxitjen, kontrollin dhe monitorimin e procesit të agregimit të ndërmarrjeve, sepse kemi akoma disa ndërmarrje që nuk e kanë përmbyllur këtë proces. Por në mënyrë të veçantë dua ta nxis për përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorët, vërejtjeve e shqetësimeve që ata kanë. Për këtë është ndërtuar një platformë elektronike, ku këto shqetësime materializohen, por duhet të jemi korrektë ndaj qytetarëve.

Përse e them këtë? Këtë e them se furnizimi me ujë nuk është një problem aq i thjeshtë, pra nuk është thjeshtë çështje projektesh dhe parash, uji është një element shumë i vështirë për t'u menaxhuar. Unë nuk di nëse e kemi pasur ndonjëherë të zgjidhur dhe nuk bie dakord me disa kolegë parafolës që thanë: “Kemi bërë hapa mbrapa”. Uji në Shqipëri ka qenë gjithmonë problem, por avash-avash ka marrë zgjidhje të caktuara në periudha të ndryshme.

Mënyra se si ishte menduar organizimi i tij në shoqëri, në pronësi të bashkive, nuk ishte adekuat me kohën dhe premtimet për të sjellë sa

më shpejt 24 orë ujë në të gjitha shtëpitë, ndaj u pa një zgjidhje e re, zgjidhja e agregimit, e cila ka në funksionin e saj përmirësimin e investimeve dhe të cilësisë së shërbimit edhe atje ku nuk ka qenë e mundur; kur ndërmarret kanë qenë të vogla, të mund të sjellim ekonominë e shkallës. Për këtë arsye, besojmë se do të kemi zgjidhje të mira në të ardhmen.

A do ta zgjidhim shpejt këtë problem, 100%? Unë besoj se jo, por të gjithë duhet të jemi koshientë, përtej politikës, se të jesh i pasur me burime ujore, sikurse është Shqipëria, nuk do të thotë se uji duhet të jetë automatikisht në rubinetin e shtëpisë. Uji i burimeve, për të cilat falënderojmë Zotin që i kemi në Shqipëri, kërkon investime të rëndësishme që ky produkt të sillët në shtëpi, të cilat nuk janë thjesht investime në para. Këtu më lejoni të përmend disa tregues që kanë të bëjnë me ujësjellësin e Tiranës, ku është përqendruar pjesa më e madhe e qytetarëve. Pas aprovimit që kemi bërë, disa muaj më parë në këtë seancë, të një kredie për ujësjellësin e Tiranës, e cila është rreth 80 milionë euro, me garanci sovraane nga qeveria, mendoj se në vitin 2025 Tirana ta ketë të zgjidhur problemin e ujit, pra do të ketë 24 orë, duke bërë një investim në një unazë presioni, e cila do të rrethojë të gjithë qytetin, ndaj thashë që nuk është vetëm çështje parash, por edhe çështje konceptesh.

Sot ujësjellësi i Tiranës ka një nivel matjeje mbi 90%, niveli i arkëtimeve është rreth 96% dhe furnizimi me ujë është 17 orë.

Dikush nga kolegët tha: “Nëse kemi 17 orë ujë, atëherë duhet të heqim depozitat”. Qëllimi është të hiqen depozitat, por me 17 orë ujë nga 24, janë akoma 7 orë pa ujë. Pra, askush nuk dëshiron të qëndrojë 7 orë pa ujë në shtëpi. Heqja e depozitave do të përfundojë kur investimi që ka filluar ujësjellësi i Tiranës për të gjithë unazën e presionit, për rritjen e burimeve të furnizimit edhe me burimin e ri të Gurit të Bardhë, i cili do të rrisë nivelin e furnizimeve, të përfundojë. Atëherë besoj se do të kemi mundësi të heqim depozitat, të cilat janë jo vetëm të shëmtuara, por edhe të dëmshme për shëndetin nëse nuk mirëmbahen.

Tirana ka një efikasitet të stafit me 2,64 për 1000 lidhje. Këtu dua të ndalem pak më gjatë, sepse treguesit mesatarë në të gjithë Shqipërinë i kemi me 4,64 punonjës për 1000 lidhje. Sigurisht, mund të ketë ujësjellës të cilët kanë një numër të shtuar të punonjësve, por duhet të kemi parasysh

se çdo ujësjellës ka specifikat e veta. Nuk mund të jetë njësoj një ujësjellës që ka një zonë të përqendruar të shpërndarjes së ujit, me një ujësjellës që ka një zonë shumë të shtrirë. Pra, varet nga nevojat që kanë ujësjellësit për punonjës për të kontrolluar matësit e shpërndarë në atë territor.

E dyta, që është e rëndësishme, ne e kemi theksuar edhe në rezoluta të tjera dhe vazhdon të ngelet një problem, është çështja e sigurisë së objekteve të furnizimit me ujë, ku për sigurinë e tyre kemi një numër të madh punonjësish sigurie. Pra ERRU-ja duhet t'i nxisë këto kompani që të kalojnë në mënyra moderne për sigurinë, me teknologji për të ulur numrin e punonjësve, të cilët figurojnë si mesatare e lidhjeve.

Vazhdojmë të kemi një nivel jo të kënaqshëm të ujit pa të ardhura. Tirana është diku te 59,8%, e tha edhe ministrja, nga 74% ka zbritur në 59,8% falë investimeve dhe menaxhimit shumë të mirë që i është bërë, gjithsesi vazhdon të jetë i lartë.

Duhet të kuptojmë se uji nuk është njësoj si energjia elektrike. Për energjinë elektrike mjafton të shtrihet një kabull, të vendoset një transformator i ri dhe ulen humbjet e energjisë, ndërsa uji ka problematika të caktuara.

E para, nuk mund të shtrohen tuba pa fund. Tubat e mëdhenj dhe të presionit janë rreth 6 metra dhe në çdo 6 metra duhet të ketë një lidhje, pra secila nga ato lidhje mund të jetë një pikë e dobët për të pasur humbje nesër. Humbjet fillojnë me pika, të cilat me kalimin e kohës rriten deri në momentin që bëhet humbje e madhe. Pra, në përgjithësi niveli i humbjeve në ujë dhe ujësjellës ka për të qenë një tregues jo i ulët, i cili do të na shoqërojë edhe kur të kemi 24 orë ujë.

E rëndësishme është se sot mbulimin me ujë në territorin e Tiranës e kemi 100%. Pra, nuk ka konsumator që nuk furnizohet me ujë nga ujësjellësi i Tiranës. Siç e thashë, do të bëjmë një rrjet presioni 49 kilometra, me tubacione të reja që do të shtrohen rreth e rrotull Tiranës për të garantuar ujë si në katin e parë, ashtu dhe në katin e fundit të ndërtesës më të lartë që ndërtohet në Tiranë, pra të kemi presionin e nevojshëm.

Meqenëse këtu u hap tema e largimit, më lejoni që në fund të fjalës t'ju them edhe dy të dhëna që ka publikuar ministria gjermane e Emigracionit, ku shqiptarët zënë një numër, por jo të rëndësishëm, sepse janë rreth 40 mijë rumunë,

20 mijë bullgarë, 3500 spanjollë, 15 mijë kroatë dhe rreth 8 mijë shqiptarë në vitin 2020, të cilët kanë kërkuar të qëndrojnë në Republikën Federale të Gjermanisë. Pra, kjo nuk është një sfidë vetëm për ne, por edhe për Europën Jugore, për Ballkanin Perëndimor në mënyrë të veçantë, e cila kërkon një adresim brenda mundësive që ka secili shtet. Unë mendoj se diskutimet që kemi bërë dhe vendimet që kemi marrë, qoftë në lidhje me rritjen e shpejtë të pagës minimale përpara premtimeve dhe planeve që kishim bërë, qoftë edhe diskutimi që po hapim për rritjen e pagave në përgjithësi, për diskutimin që po bëjmë për rritjen e pagës në administratë, por edhe në bashkëpunim me bizneset shqiptare për të rritur pagat në të gjithë sektorët, do t'i shërbejë, brenda mundësive që ka Shqipëria, edhe këtij argumenti.

Duke nxitur edhe një herë ERRU-në që të jetë në lartësinë e sfidave që kemi marrë përsipër për agregimin e kompanive të ujësjetësve për zgjidhjen sa më shpejt të këtyre problematikave, ju falënderoj për vëmendjen.

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Këtu mbyllet debati për këtë pikë të rendit të ditës.

Vijojmë me projektligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”. Referuar nenit 73 pikës 2 të Rregullores, a ka pyetje? Nuk ka.

Fillojmë diskutimin me paraqitjen e projektligjit nga nismëtarja.

Zonja Ibrahimaj, keni fjalën. Koha në dispozicion është e pakufizuar.

**Delina Ibrahimaj** – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sjellim sot përpara jush një projektligj jashtëzakonisht të rëndësishëm, i cili do të sjellë një reformim të plotë të sistemit tatimor shqiptar. Ky projektligj do të hapë një kapitull të ri në legjisllacionin fiskal për t'i dhënë fund kështu një odiseje 25-vjeçare. Modernizimi i legjisllacionit, paralelisht me të edhe i Administratës Tatimore, ka qenë një ndër objektivat bazë të punës sonë në këtë fushë, sepse ne besojmë te parimet e taksimit të drejtë, tek taksimi progresiv, te përmbushja vullnetare e detyrimeve dhe te ndërgjegjësimi i tatimpaguesve për të drejtat dhe detyrimet e tyre, pa pasur si fokus primar ndëshkimin. Për të gjitha këto arsye, ne ndërmorëm një proces të gjatë dhe dinamik konsultimi jo vetëm brenda

institucioneve tona, por edhe me grupet e interesit.

I njëjti angazhim diskutimesh u bë edhe gjatë shqyrtimit në Komisionin parlamentar për Ekonominë dhe Financat, të cilin gjej rastin ta falënderoj, për konsultimin e gjerë dhe për vëmendjen e shtuar ndaj këtij ligji kaq të rëndësishëm.

Qëllimi ynë ishte të hartonim një projektligj të plotë që do t'u jepte zgjidhje shumë aspekteve tatimore, të cilat ndër vite kishin krijuar hapësira për evazion apo keqinterpretime. Vizioni që kemi është i qartë: të fuqizojmë ekonominë, të nxisim investimet, të rrisim mirëqenien, të minimizojmë tërësisht informalitetin dhe evazionin fiskal mbi parimet e së drejtës, barazisë, ekuilibrave të qëndrueshëm, si dhe në mbrojtje të interesit publik e privat.

Ligji në fuqi i “Tatimit mbi të Ardhurat” është miratuar në dhjetor të vitit 1998. Ai ka pësuar një sërë ndryshimesh të kushtëzuara nga etapat e zhvillimit ekonomik, duke reflektuar përpjekjet në përgjigje të politikave fiskale, si dhe të nevojave të biznesit. Në veçanti në 10 vjetët e fundit kanë ndodhur ndryshime të ndjeshme në fushën e taksimit ndërkombëtar, shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit në fushën e taksimit, me qëllim pengimin e konkurrencës së pandershme në fushën e taksave.

Gjithashtu, si rezultat i amendimeve të ndryshme të ligjit në kohë dhe për shkak të incentivave, përjashtimeve, tarifave të reduktuara të miratuara në vite është cenuar vende-vende parimi i neutralitetit të tatimit. Një pjesë e këtyre incentivave, përjashtimeve dhe tarifave e kanë plotësuar tashmë misionin e tyre, ndaj nuk ka arsye që të vazhdojnë të aplikohen.

Ndërhyrjet në tarifa, regjime, përjashtime, kanë ndikuar në shmangien e tatimit, duke nxitur tatimpagues individë, persona fizikë tregtarë apo persona juridikë, që të kërkojnë boshllëqe ligjore dhe të kalojnë nga një regjim me tatim më të lartë, në një regjim me tatim më të ulët.

Ndërkohë, përveç këtij aspekti problematik, kanë lindur edhe risi në fushën e taksimit të të ardhurave personale dhe fitimit korporativ, të cilat ende nuk janë pasqyruar dhe as janë rregulluar nëpërmjet amendimeve ligjore.

Nga ana tjetër, procesi i integritit evropian, që kemi nisur, nxit nevojën për harmonizimin dhe përputhshmërinë graduale të ligjit “Për tatimin

mbi të ardhurat” me direktivat e BE-së. Ndaj u pa e nevojshme një qasje e re e kuadrit ligjor për taksimin e individëve dhe të ardhurave të tyre nga burime të ndryshme, nëpërmjet hartimit të një ligji tërësisht të ri për tatimin mbi të ardhurat.

Në këtë kudër, në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe ekspertët e tij, ne hartuam dhe paraqitëm projektligjin, i cili sot është në seancë për votim. Ky projektligj ka tre objektiva kryesorë:

1. Krijimin e një sistemi tatimor vetëdeklarativ bashkëkohor, ku individë dhe entitetet paguajnë pjesën e ndershme të tatimit mbi të ardhurat që realizohen dhe që kërkon kthimin e këtij kontributi në formën e përfitimeve dhe shërbimeve të përmirësuara publike.

2. Rritjen e kontributit në buxhetin e individëve dhe entiteteve nëpërmjet tatimit të të ardhurave, duke balancuar peshën e tatimeve indirekte;

3. Ofrimin e një sistemi tatimi më të ndershëm dhe të gjithëpranuar.

Po cilat janë risitë që do të sjellë ky ligj? Ky ligj përcakton taksimin e të ardhurave në dy kategori: taksimi i individëve dhe personave fizikë, me qëllim tatimin e të ardhurave personale dhe taksimin e entiteteve juridike me tatim mbi fitimin korporativ. Pra, bëhet një ndarje e tatimfitimit që është paguar ndër vite dhe e konceptit të tatimfitimit, ndryshe për individët dhe personat fizikë, të cilët paguajnë tatim mbi të ardhurat dhe ndryshe për entitetet që paguajnë tatimfitim korporativ.

Kategorizon 3 grupe të të ardhurave personale, të cilat realizohen nga individët dhe personat fizikë tregtarë, të cilët i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale:

1. Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi.

2. Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi për personat fizikë.

3. Tatimi nga të ardhurat nga kapitali pasiv.

Të ardhurat nga punësimi taten sipas skemës aktuale progresive. Të ardhurat nga biznesi taten me 15% të fitimit neto. Të ardhurat nga kapitali pasiv dhe të ardhurat e tjera takohen me normën 15%, me përjashtim të dividendit, i cili taten me 8%.

Për të ardhurat nga biznesi me qarkullim deri në 10 milionë lekë në vit është parashikuar skemë e thjeshtë taksimi duke deklaruar shpenzimet në një shumë të vetme, pa pasur detyrimin e mbajtjes

së kontabilitetit. Kjo është një incentivë që shkon në vazhdimësi e incentivave që kemi bërë dhe do të vazhdojmë të bëjmë dhe të mbajmë për biznesin e vogël, me qëllim që t'i ofrojmë biznesit të vogël sa më shumë lehtësira, jo vetëm në mënyrën e taksimit të tyre, kur bizneset në qarkullim deri në 10 milionë lekë e kanë tatimin mbi vlerën e shtuar zero dhe bizneset në qarkullim deri në 14 milionë lekë e kanë tatimfitimin zero, por edhe procedurat e kostot e tyre të mbajtjes së librave të jenë të reduktuara dhe të thjeshtësuara.

Nga ana tjetër, për tatimin mbi të ardhurat e korporatës ka një normë tatimore prej 15%.

Në asnjë rast, barra fiskale për të punësuarit nga ky ligj nuk do të rritet, siç është thënë e rithënë në medie apo në komisione, përkundrazi. Nëpërmjet këtij ligji do të ulim më tej barrën fiskale, pasi tashmë kemi ndërmarrë një angazhim që nuk do t'i tatojmë pagat e ulëta. Nëpërmjet këtij ligji ne do të rrisim pragun e të ardhurave të patatueshme për individët, nga 40 mijë lekë që është sot në 50 mijë lekë, nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Janë rreth 65 mijë individë që përfitojnë nga kjo lehtësi, të cilët do të paguajnë 15 700 lekë më pak taksë në vit.

Njëkohësisht, barra fiskale lehtësohet për të gjithë tatimpaguesit me të ardhura nga punësimi nga 50 mijë deri në 60 mijë lekë, të cilëve nga 30 mijë lekë, që ishte e ardhura e tatueshme me 0%, tashmë u njihet një zbritje tatimore prej 35 mijë lekësh në muaj, duke lehtësuar barrën tatimore për 44 mijë individë me 7,800 lekë në vit.

Gjithashtu, projektligji parashikon një zbritje prej 48 mijë lekësh nga baza e tatimit për punëmarrësin për çdo fëmijë në ngarkim të tij më pak se 18 vjeç dhe një zbritje me 100 mijë lekë për arsimin e çdo fëmije në ngarkim. Në këtë mënyrë, nëpërmjet zbritjeve nga baza e tatueshme, ngarkesa fiskale për të punësuarit ulet akoma më tej, që do të thotë se norma efektive e tatimit që paguhet do të ulet ndjeshëm.

Projektligji, në mënyrë të balancuar, përcakton tatimin e individëve tregtarë dhe të vetëpunësuar. Projektligji ka parashikuar që për të vetëpunësuarit dhe tregtarët të taten me 15% të fitimit neto (pra, të ardhura minus shpenzime), ku fitimi neto është deri 14 milionë lekë në vit dhe me normën 23% të fitimit neto, vetëm për pjesën e fitimit mbi 14 milionë lekë në vit.

Unë dua të ndalem një moment këtu, pasi në komision, por edhe në medie, ka pasur debate të

gjera për normën e tatimit 15% dhe pragun 14 milionë lekë të fitimit neto, i cili do të fillojë të tatohet me 23%.

Së pari, dua të bëj të ditur se janë rreth 300 biznese, të cilat janë të regjistruara si persona fizikë dhe kanë një fitim neto mbi 14 milionë lekë. Arsyeja përse e bëmë këtë ndërhyrje në ligj është shumë e thjeshtë: ne nuk duam që bizneset të zgjedhin formën e tyre të regjistrimit për shkak të lehtësirave fiskale apo për shkak të normave më të reduktuara të tatimit. Ajo që dua të them është se, nëse një biznes, një sh.p.k, një korporatë regjistrohet, paguan 15% tatimfitim dhe 8% dividend, e çon normën tatimore në total në 23%. Deri dje personat fizikë kishin tatimfitim 15%, por edhe nëse gjeneronin të ardhura të tjera, kjo vlerë ishte e pandryshueshme.

Norma e tatimit 23% do të bëjë që bizneset të mos zgjedhin të regjistrohen si persona fizikë vetëm për shkak të përqindjes më të ulët të tatimit dhe për shkak të mospagimit të dividendit, pra do të bëjë një shpërndarje më të drejtë dhe një zgjedhje më të drejtë të formave të regjistrimit.

Dua të ritheksoj se tatimi i fitimit për bizneset që kanë qarkullim deri në 14 milionë lekë, do të vijojë të jetë zero deri në vitin 2029.

Është diskutuar shumë gjatë ditëve të fundit në komisione, por edhe në medie për përfshirjen e profesioneve të lirë në tatim, duke akuzuar qeverinë se po heq dorë nga tatimfitimi zero për bizneset e vogla. Kjo është totalisht e pavërtetë. Janë më shumë se 85% e bizneseve që do të vijnë në këto normë të tatimit zero për qarkullim deri në 14 milionë lekë. Arsyeja përse qeveria shqiptare vendosi që të ndjekë një politikë të tatimfitimit zero dhe të TVSH-së zero për pragje kaq të larta, është sepse ne duam të nxisim biznesin; duam të incentivojmë biznesin e lirë; duam që biznesi i vogël si iniciativë familjare, biznes, i cili vendos të regjistrohet për të rritur të ardhurat familjare, të vazhdojë të mbështetet.

Nga ana tjetër, nëpërmjet këtij ligji patëm një dukuri, e cila ishte e paparashikuar më parë. Ajo që ndodhi është: shumë tatimpagues, të cilët punësonin profesionistë apo profesione që lidhen me profesionet e lira (dhe këtu e kam fjalën për financiarët, për kontabilistët, për avokatët e të tjerë) filluan të ulnin numrin e të punësuarve dhe t'u kërkonin profesionistëve të hapnin NIPT-e, me qëllim që edhe profesionisti të mos paguante tatim mbi të ardhurat, por edhe biznesi të merrte

fatura shpenzimesh, të cilat janë të njohura, me qëllim pagimin e një fitimi më të ulët. Pra, na u shfaq një dukuri e erozionit të listëpagesave të tatimpaguesve për këto profesione, me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore.

Numri i personave fizikë të regjistruar gjatë 3 vjetëve të fundit me përshkrim të objektit të aktivitetit me profesione të lira është rritur në mënyrë të ndjeshme. Nuk ishte ky qëllimi i lehtësimit fiskal që ne bëmë, nuk ishte qëllim ynë krijimi i hapësirave për abuzim, por ishte nxitja e biznesit të vogël dhe do të vazhdojë të jetë kështu.

Nga ana tjetër, të gjithë të punësuarit të cilët vijonin të qëndronin në listëpagesa, shfaqën pakënaqësitë e tyre, sidomos të punësuarit me paga të mesme dhe të larta, pasi një avokat, i cili është i punësuar në një kompani paguan 7 herë më shumë tatime dhe kontribute sot sesa një avokat, i cili hap NIPT-in si person fizik. Unë do të doja që këtë t'ju paraqisja me shifra.

Nëse do të marrim për bazë një avokat, i cili merr një pagë 257 mijë lekë në muaj, të barabartë me pagën e Presidentit të Republikës...

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)*

Të lutem!

**Lindita Nikolla** – Mos flisni nga vendi, ju lutem!

**Delina Ibrahimaj** – Ky avokat paguan 35 mijë e 210 lekë tatim mbi pagën ose 13,7%. Gjithashtu, ai paguan 19 mijë e 500 lekë kontribute ose 7,6% të pagës bruto, duke e çuar diferencën ndërmjet pagës bruto dhe pagës neto në 54 mijë e 700 lekë. Pra, ky avokat paguan sot 21,3% të pagës për taksa dhe kontribute.

Nga ana tjetër, sot profesionisti i lirë, pra një avokat, i cili ka hapur NIPT si person fizik i vetëpunësuar, paguan 8 mijë lekë kontribute për sigurime shoqërore, pra 3,1%. Një avokat që ka të ardhura të barabarta me pagën e një avokati tjetër, i cili është i punësuar, paguan 7 herë më pak. Si do të ndryshojë ky raport me hyrjen në fuqi të projektligjit? Një avokat, i cili do të hapë NIPT-in si person fizik, tashmë do të paguajë 19 mijë e 950 lekë tatim mbi biznesin dhe përsëri 8 mijë lekë kontribute si i vetëpunësuar, ose 10,8% të të ardhurave që gjeneron. Pra, në çdo rast, një person fizik i vetëpunësuar, i cili ushtron aktivitetin si profesionist i lirë, do të paguajë 50% më pak barrë se të punësuarit, me qëllim që incentiva e lirë të vijojë të mbështetet, por, nga ana tjetër, të mos

jetë një incentivë për të shmangur tatimet dhe taksat e listëpagesave.

Në fakt, unë kam disa shembuj të tjerë për nivele të ndryshme pagash, të cilat do të hyjnë në fuqi nga viti 2024 e më tej. Pra, nëse një individ ka një pagë bruto 100 mijë lekë, ai ka një normë efektive tatimi mbi të ardhurat 9,1%, ndërkohë si i vetëpunësuar do të ketë një normë efektive 6%. Një individ, i cili ka një pagë 250 mijë lekë, do të ketë një normë efektive 13,4%, ndërkohë si i vetëpunësuar në profesionet e lira do të ketë një normë efektive të tatimit mbi të ardhurat 8,7%. Pra, dua të them se në çdo rast norma efektive e tatimit do të jetë më e ulët se norma e një të punësuarit, sepse, sigurisht, tatimpaguesi merr risqe më shumë, tatimpaguesi është subjekt edhe i taksave lokale dhe ka përgjegjësi të tjera, ndërkohë që i punësuarit ka një siguri në punën që bën.

Ky ligj përcakton taksimin e të ardhurave në dy kategori:

Së pari, taksimi i individëve dhe personave fizikë tregtarë me tatim mbi të ardhurat personale.

Së dyti, taksimi i entiteteve juridike me tatim mbi fitimin korporativ. Ne kemi vendosur që tatimin korporativ ta mbajmë të pandryshuar, siç është aktualisht me ligjin që është në fuqi.

Gjithashtu, dua të ndalem te skema e tatimit progresiv. Pra, risi është që norma e tatimit progresiv për fitimin neto deri në 14 milionë lekë mbetet 15% dhe shkon 23% në të ardhurat me fitim neto më të lartë. Kjo normë vijon të mbetet më e ulëta e mesatares së rajonit.

Unë dua t'ju sjell shembullin e një vendi të rajonit, si Serbia, e cila e ka tatimin mbi të ardhurat bruto për personat fizikë 20%. Pra, e theksoj: tatimi mbi të ardhurat bruto e përkthyer në tatim mbi të ardhurat neto, kjo normë është e barabartë me 40%. Dua t'ju sjell shembullin e Italisë, ku profesionistët e lirë paguajnë 43% tatime për të ardhura neto mbi 50 mijë euro në vit. Pra, me legjislacionin që ne propozojmë të hyjë në fuqi, vijojmë të mbetemi vendi me normat e tatimeve më të ulëta dhe preferenciale në krahasim me rajonin.

Projektligji, gjithashtu, në dispozitat e tatimit mbi fitimin korporativ përfshin disa zhvillime të tjera në fushën e tatimit ndërkombëtar, duke lehtësuar njëkohësisht korporatën nëpërmjet: zgjatjes së periudhës së mbartjes së humbjeve nga 3 vjet në 5 vjet;

thjeshtimit dhe lehtësimit të shpenzimeve afatgjata nëpërmjet amortizimit linear individual të grupeve makineri/pajisje dhe *soft/hardware*; njësimi të rregullave të taksimit për kontratat afatgjata; vendosjes së rregullave të zbatueshme për riorganizimet e biznesit dhe transferimin e aktiveve të biznesit; njohjes si të zbritshme të vlerës së mbetur të një aktivi që del jashtë qarkullimit; vendosjes së rregullave transparente në lidhje me borxhin e keq, si dhe vendosjes së rregullave të gjithëpranuara në lidhje me alokimin dhe kufijtë e interesave të kredidhënies.

Projektligji parashikon edhe rregullat e taksimit të dhuratave dhe trashëgimive, duke parashikuar njëkohësisht edhe përjashtimet nga tatimi për dhuratat dhe trashëgimitë brenda trungut familjar.

Të nderuar deputetë,

Projektligji, sa u takon të ardhurave, përgjithësisht propozon ruajtjen e tarifave tatimore ekzistuese, ndërsa cakton një kufi kohor në lidhje me incentivat, tarifat zero dhe tarifat e reduktuara të tatimit për sektorë, industri dhe grupe të caktuara biznesesh.

Gjithashtu, projektligji lehtëson barrën tatimore për tatimpaguesit me të ardhura të ulëta, konkretisht i referohet kategorisë me të ardhura nga punësimi në fashën 40-50 mijë lekë, të cilat do të jenë me 0% tatim mbi të ardhurat. Njëkohësisht lehtësohet barra tatimore për të gjithë tatimpaguesit me të ardhura nga punësimi në fashën 50-60 mijë lekë.

Efektet në buxhetin e shtetit parashikohet të jenë negative, me rreth 1,1 miliardë lekë.

Projektligji propozon që në fushën e shërbimeve, kryesisht të furnizimit të shërbimeve profesionale, për shkak të arsyeve që përmenda më sipër, si dhe të riskut dhe deformimit të tregut, taksimi i personave me të ardhura deri 14 milionë lekë të fillojë nga 1 janar 2024. Ndërkohë, do të mbetet në fuqi tatimfitimi 0% për qarkullimin deri në 14 milionë lekë për të gjitha bizneset, të cilat nuk ofrojnë shërbime profesionale apo që operojnë në fushën e aktiviteteve tregtare. Kjo masë do të jetë në fuqi deri në vitin 2029.

Ne e kemi lehtësuar kategorinë e biznesit të vogël për shumë vjet. Ndërkohë, edhe profesionet e lira do të vijnë ta kenë shkallën e tatimit mbi vlerën e shtuar, zero.

Ne tashmë kemi kaluar në një fazë të re të zhvillimeve ekonomike, ku për biznesin nuk ka



më vend qasja e informalitetit, si një mekanizëm për të rritur përfitimet. Ne e shohim biznesin si një partner të besueshëm dhe me të cilin bashkërisht grumbullojmë të ardhura për t'i shndërruar ato në të mira sociale, në shërbime më cilësore dhe në mirëqenie më të lartë për qytetarët tanë.

Në përfundim të fjalës sime do të doja që ta votonit këtë projektligj, sepse ai do të revolucionarizojë mënyrën e mbledhjes së të ardhurave dhe do të rregullojë të gjithë parametrat dhe hapësirat, të cilat deri tani kanë qenë të paqarta dhe të pakuqteshme dhe kanë lejuar hapësira për evazion.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Hapim diskutimet.

Fjala për zonjën Enslemvera Zake.

Të përgatitet zoti Dashnor Sula.

**Enslemvera Zake** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Projektligji i propozuar nga Këshilli i Ministrave do të sjellë risi në legjislationin tatimor shqiptar, duke synuar neutralitetin e tatimit, rritjen e transparencës dhe aplikimin e një sistemi sa më të drejtë tatimi për individët dhe entitetet në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë kuadër, qëllimi i prezantimit të këtij projektligji lidhet me krijimin e një sistemi tatimor vetëdeklarativ, ku individë dhe entiteti paguan pjesën e ndershme të tatimit mbi të ardhurat që realizon dhe kërkon kthimin e këtij kontributi në formën e përfitimeve nga shteti dhe shërbimeve publike më të mira. Ky ligj synon përafrimin gradual të sistemit tatimor me direktivën e BE-së, duke ofruar një sistem të ndershëm dhe të gjithëpranuar.

Objekti i këtij projektligji është përcaktimi i rregullave në lidhje me tatimin mbi të ardhurat e personave fizikë dhe entiteteve, si dhe tatimin mbi të ardhurat nga trashëgimitë, dhurimet dhe fitimet nga lojërat e fatit për personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, por edhe jashtë saj. Pra, praktikisht i përfshin të gjithë.

Projektligji propozon futjen në një skeme tatimi nga 1 janari i vitit 2024 të bizneseve furnizuese të shërbimeve, kryesisht profesionale, duke adresuar në këtë mënyrë fenomenin e identifikuar në lidhje me ofrimin e shërbimeve, kryesisht të profesioneve të lira, të cilat kanë krijuar pakënaqësi në radhët e të punësuarve me paga mesatare dhe të mesme në lidhje me politikat

e tatimit që zbatohen për profesionet e lira apo për furnizuesit e shërbimeve të tjera në përgjithësi.

Në lidhje me të ardhurat, projektligji propozon ruajtjen e tarifave tatimore ekzistuese, ndërkohë që propozon, gjithashtu, caktimin e një kufiri kohor në lidhje me incentivat, tarifat zero dhe tarifën e reduktuar të tatimit për sektorë të ndryshëm, industri dhe grupe të caktuara bizneseve. Pra, do të aplikohet një normë tatimore 0% mbi biznesin e vogël, siç është prodhimi, tregtia, ushqimi social, pra bare dhe restorante, transporti e të tjera me qarkullim deri në 14 milionë lekë, qofshin këta individë tregtarë, individë të vetëpunësuar ose entitete, deri në fund të vitit 2029. Pra, edhe me ligjin e ri mbahet skemë e njëjtë e tatimit 0% për biznesin e vogël për disa fusha apo sektorë të tregtisë.

Po ashtu, projektligji propozon që në fushën e shërbimeve, kryesisht të furnizimit të shërbimeve profesionale, për shkak të riskut dhe deformimit të tregut, taksimi i personave fizikë dhe juridikë me të ardhura deri 14 milionë lekë do të fillojë nga 1 janar 2024, sepse periudha 5-vjeçare që kanë pasur këto biznese me tatim 0% dhe periudha 2-vjeçare para saj me tatim 5% mbi fitimin neto, kanë qenë incentiva të mjaftueshme për ta zhvilluar këtë sektor. Besoj se tani ka ardhur momenti që të futen në skemën e tatimit. Përsëri barra fiskale e tyre do të jetë më e ulët se barra fiskale që do të paguajnë të punësuarit.

Projektligji ka parashikuar dy grupe si subjekte të tatimit mbi të ardhurat:

Në grupin e parë bëjnë pjesë: individët, të vetëpunësuarit dhe personat fizikë tregtarë.

Në grupin e dytë bëjnë pjesë personat juridikë, të cilët do të jenë subjekt i tatimit mbi të ardhurat e korporatës apo shoqërive.

Sipas projektligjit, të ardhurat personale të tatueshme janë klasifikuar në 3 kategori: të ardhura nga punësimi, të ardhura nga biznesi dhe të ardhura nga investimi. Këto kategori janë parashikuar të taten në këtë mënyrë: dy grupet e para, pra të ardhurat nga punësimi dhe të ardhurat nga biznesi, do të taten sipas një sistemi progresiv. Konkretisht: të ardhurat nga punësimi do të taten progresivisht në masën 13% deri në 23%, ndërsa të ardhurat nga biznesi do të taten, gjithashtu, progresivisht në masën 15% deri në 23%.

Ndërkohë, në grupin e tretë janë të ardhurat nga investimet apo nga kapitali pasiv, të cilat do

të taten me normën tatimore 15%, me përjashtim të dividendëve, që do të vazhdojnë të taten në masën 8%. Pra, për të ardhurat nga punësimi nga 0 deri në 2 milionë e 40 mijë lekë do të taten në masën 13% dhe për të ardhurat mbi 2 milionë e 40 mijë lekë do të taten në masën 23%, ashtu siç është edhe skema aktuale e tatimit progresiv.

Për fitimin e tatueshëm, pra për të ardhurat deri në 14 milionë lekë, minus shpenzimet e bizneseve, do të taten në masën 15% dhe për të ardhurat mbi 14 milionë lekë do të taten në masën 23%, me qëllim që këto biznese të rregullojnë formën e tyre ligjore nga persona fizikë për t'u kthyer në shoqëri apo në sh.p.k.

Njëkohësisht, projektligji ka parashikuar zbritje në masën 48 mijë lekë nga baza e tatimit të të punëmarrësit për çdo fëmijë në ngarkim të tij në moshën më pak se 18 vjeç. Pra, për një fëmijë ulja vjetore do të jetë 6240 lekë në vit; për dy fëmijë ulja vjetore do të ketë 12 mijë e 480 lekë në vit dhe për tre fëmijë ulja do të jetë 18 mijë e 720 lekë në vit. Pra, barra fiskale do të ulet për çdo kategori në rast se kanë një, dy apo tre fëmijë.

Gjithashtu, tatimpaguesi me të ardhura vjetore të tatueshme më pak se 1 milion e 200 mijë lekë në vit mund të zbresë nga barra tatimore një shumë prej 100 mijë lekësh për arsimin e fëmijëve në ngarkim të tij. Pra, barra tatimore e tyre do të ulet edhe 13 mijë lekë.

Barra fiskale për të punësuarit nuk rritet, përkundrazi, do të ulet për shkak të këtyre lehtësirave që kjo skemë e tatimit mbi të ardhurat parashikon. Gjithashtu, jo vetëm pagat nga 0 deri në 40 mijë lekë në muaj, por edhe pagat në fashën nga 40 në 50 mijë lekë nuk do të taten. Pra, një tatimpagues me të ardhura nga punësimi në masën 50 mijë lekë në muaj nuk do të paguajë tatim mbi pagën, që do të thotë se do të ketë plus 15 mijë e 600 lekë të ardhura në vit ose 1300 lekë në muaj më pak tatim mbi të ardhurat nga punësimi. Numri i tatimpaguesve që do të përfitojnë nga kjo skemë, është 65 mijë tatimpagues. Njëkohësisht, lehtësohet barra tatimore për të gjithë tatimpaguesit me të ardhura nga punësimi në fashën 50 deri 60 mijë lekë, të cilëve nga 30 mijë lekë që ishin të ardhurat e tatueshme me 0%, tashmë u njihet një zbritje tatimore prej 35 mijë lekësh në muaj, duke lehtësuar barrën tatimore të tatimpaguesve me 7 mijë e 800 lekë në vit. Në këtë mënyrë, nëpërmjet zbritjeve nga baza e

tatueshme, ngarkesa fiskale për të punësuarit ulet edhe më tej, që do të thotë se norma efektive e tatimit që paguan në vit çdo pagamarrës do të ulet ndjeshëm.

Për të ardhurat nga biznesi deri në 10 milionë lekë në vit është parashikuar një skemë e thjeshtë tatimi, duke i deklaruar shpenzimet në një shumë të vetme, pa pasur detyrimin e mbajtjes së kontabilitetit të tyre me qëllim uljen e kostove të biznesit të vogël për pagesat që kryejnë në këtë shërbim. Njohja e shpenzimeve të supozura është përcaktuar në një përqindje fikse mbi të ardhurat e realizuara në varësi të llojit të biznesit, por, gjithashtu, edhe në bazë të historikut të vetëdeklarimit që këto biznese kanë bërë tek organet tatimore.

Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë të ardhurat nga investimet apo nga kapitali pasiv dhe të ardhurat e tjera, të cilat do të taten me normën tatimore 15%, me përjashtim të dividendit që, po ashtu, do të jetë me normën tatimore 8%. Këtu bëjnë pjesë personat juridikë, të cilët do të jenë subjekt i tatimit mbi të ardhurat e korporatës.

Ky projektligj mundëson edhe disa lehtësi për korporatat dhe personat juridikë: së pari, do të zgjatet periudha e mbartjes së humbjeve nga 3 vjet në 5 vjet; do të njehsohen rregullat e taksimit për kontratat afatgjata; do të vendosen rregullat për riorganizimet e biznesit dhe transferimin e aktiveve të biznesit; do të njihen si të zbritshme vlerat e mbetura të një aktivi, që del jashtë qarkullimit; do të vendosen rregullat transparente në lidhje me borxhin e keq, si dhe do të vendosen rregullat e gjithëpranuara në lidhje me alokimin dhe kufijtë e interesave të kredidhënies e të tjera.

Lehtësitë dhe përjashtimet tatimore do të vazhdojnë të zbatohen për personat, të cilët zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", me shkallë tatimore mbi të ardhurat në masën 5%, deri më 31 dhjetor të vitit 2029, si dhe për strukturat akomoduese bare, restorante dhe hotele me katër dhe pesë yje, me status special, të cilët janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht si "brand name".

Për entitetet që zhvillojnë veprimtari ekonomike në shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor shkalla e tatimit mbi të ardhurat do të vijojë në masën 5% dhe do të zbatohet deri në fund të vitit 2029. Gjithashtu, për personat juridikë të regjistruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilët

ushtrojnë veprimtari ekonomike për prodhimin apo për zhvillimin e *software*-ve, tatimi mbi fitimin do të jetë në masën 5% dhe do të zbatohet deri në fund të vitit 2029. Po ashtu, edhe për entitetet, të cilat ushtrojnë veprimtari ekonomike në industrinë automotivë shkalla e tatimit mbi të ardhurat do të jetë në masën 5% dhe do të zbatohet deri në fund të vitit 2029.

Për të gjitha këto risi që sjell ky projektligj në përmirësimin dhe në uljen e barrës fiskale për të punësuarit, por edhe për të gjithë tatimpaguesit në Republikën e Shqipërisë, ju ftoj ta votoni.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjala për zotin Dashnor Sula.

Të përgatitet zoti Edmond Spaho.

**Dashnor Sula** – Faleminderit, zonja Kryetare e Kuvendit!

Këtu në parlament ministrja e Financave apo deputetët e mazhorancës fillojnë të flasin me shifra, a thua se këto shifra janë një realitet jashtëzakonisht i lumtur për të gjithë shoqërinë shqiptare, ndërkohë që situata është vërtet shumë keq dhe kjo duhet pranuar. E kam thënë edhe herë tjetër se mjafton të marrësh vetëm dy indikatorë: e para, këta të rinj e të reja që po ikin çdo ditë, çdo javë dhe çdo muaj nga Shqipëria (nuk janë pak, por janë me qindra e me mijëra që ikin çdo vit); a po ikin nga mirësia, nga lumturia, nga pagat e larta që janë këtu dhe mirëqenia, apo po ikin nga halli?

Ju, zonja Ministre e Financave, që përmendët këtu të gjitha shifrat, a e dini se në 3-mujorin e fundit të vitit të kaluar dhe në 3-mujorin e parë të këtij viti, konsumi në Shqipëri ka rënë? Konsumi ka rënë për një arsye shumë të thjeshtë, sepse qytetarët shqiptarë tani kanë më pak të ardhura dhe nuk mund të shpenzojnë dot më shumë. Kjo do të thotë se ata kanë frikë t'i shpenzojnë ato para që mund t'i kenë grumbulluar, sepse situata ekonomike është e vështirë. Pa diskutim, këtë nuk e themi ne si opozitë, por e thotë Banka Botërore dhe e dinë të gjithë.

A e dini ju, zonja Ministre, që 20% e popullatës jeton me 1 dollar në ditë? A e dini ju, zonja Ministre, se 40% e popullsisë në Shqipëri jeton me më pak se 5 dollarë në ditë? Sipas INSTAT-it janë rreth 700 mijë individë në Shqipëri, të cilët janë në prag të rrezikut për t'u bërë të varfër. Këto janë shifrat, ky është realiteti. Ndërkohë, ju vini dhe flisni këtu, jepni një paradë

komplet ndryshe, përdorni shifra për t'u trullësuar mendjen njerëzve, duke na thënë se ne jemi mirë. Jo, nuk jemi mirë. Pa diskutim, mirë është për ju këtu në Tiranë; mirë është, pa diskutim, edhe për ata oligarkët, të cilëve kur e kishin pagesën për dividendin në masën 15%, ju ua bëtë 8%; mirë është edhe për ata, të cilët marrin nga ju koncesione dhe i paguajnë me 8%. Ndërkohë, të gjitha profesionet e lira, që janë rreth 17 mijë persona, ju do t'u merrni miliona euro nëpërmjet tatimeve, duke e detyruar "trurin" e vendit të ikë çdo ditë.

Pa diskutim, plaga më e madhe në këta 9 vjet ka qenë largimi i "trurit" të vendit. Së fundi, e konfirmoi edhe vetë Kryeministri ynë në një takim rreth 10 ditë më parë në Britaninë e Madhe, ku u shpreh se Shqipërisë po i ikin të rinjtë dhe profesionistët e mirë, të cilët do ta zhvillonin vendin. Pse po ikin? Të rinjtë e arsimuar dhe profesionistët e mirë po detyrohen të ikin nga vendi për shkak të politikave diskriminuese të qeverisë.

A e dini se çfarë parashikon qeveria në këtë projektligj? Po u drejtohem inxhinierëve elektronikë, të cilët e përdorin zgjuarsinë e tyre mbi një kompjuter për të fituar 2 mijë euro në muaj, që kjo qeveri nga 13% të taksës që u merrte, tani do t'u marrë 23%. Po ju drejtohem juve, të cilët me paratë e prindërve tuaj paguani shkollën, paguani shtëpinë me qira në Tiranë sa frëngu pulën, se tani në vend që t'ua çoni familjeve 10% të fitimit si një investim të kthyer, përsëri këtë investim do t'ju marrë kjo qeveri për t'ua shpërndarë më pas koncensionarëve.

Juve, studentëve të ekselencës së Ekonomikut, që kaloni netët pa gjumë për të përfunduar me paratë e prindërve studimet me rezultate të mira dhe më pas do të kërkonin një pozicion të mirë pune, që paguhet 2 milionë lekë të vjetra në muaj, kjo qeveri nuk do t'ju lerë para në xhep që ju të investoni më tej në dijet tuaja apo për të ndihmuar prindërit, të cilët kanë investuar për arsimimin tuaj, pasi do t'ju marrë mbrapsht duke rritur taksat. E gjithë kjo ndodh, sepse qeveria parashikon t'u marrë pothuajse 17 mijë profesionistëve të lirë rreth 20 milionë euro, duke i diskriminuar të vetëpunësuarit, duke shkëlur barazinë dhe duke ofruar pabarazinë. Vlerësimi i punës dhe mudi i investimit do të shkelen me këmbë, po ashtu edhe standardet kontabël.

Pa diskutim, këtu u fol dhe u diskutua për barrën fiskale, të cilën kjo qeveri e ka ulur.

Zonja Ministre, qeveria juaj është e vetmja qeveri që në kohë krize mburret se në vitin 2022 ka grumbulluar rreth 480 milionë euro më shumë taksa se një vit më parë, më shumë sesa të gjitha qeveritë e tjera të rajonit. Pse erdhi kjo rritje e taksave në buxhetin e shtetit? Ajo erdhi për një arsye shumë të thjeshtë: për shkak të rritjes së çmimeve, për shkak të marrjes së TVSH-së nga ana e kësaj qeverie. Pa diskutim, kjo ka ndikuar tek të gjithë qytetarët shqiptarë, ndërkohë që të gjitha vendet e rajonit e kanë ulur TVSH-në e produkteve të shportës. Ju e dini shumë mirë se Maqedonia e Veriut e ka ulur në masën 5% TVSH-në për produktet e shportës për të gjithë shtresën vulnerabël që është atje; Kosova e ka ulur në masën 8% TVSH-në e produkteve të shportës dhe Serbia e ka ulur në 8%.

Zonja Ministre, edhe pse në buxhetin e shtetit mblidhen para nga taksat që paguan shoqëria shqiptare, përsëri ju keni vënë në dispozicion për të gjitha shtresat në nevojë vetëm 0,3% të prodhimit të brendshëm bruto, ndërkohë që Maqedonia ka vënë në dispozicion për këto shtresa 3,6% të PBB-së nga buxheti i shtetit, kurse Kosova, një vend shumë më i varfër se ne, ka vënë në dispozicion 0,7% të PBB-së.

Mbrëmë unë kam qenë në dy takime në dy fshatra të Njësisë Administrative Gjoçaj, të rrethit të Peqinit, në Kurtaj dhe në Hasmashaj. Problemi më i madh që kanë fshatarët dhe fermerët në këto zona janë taksat, zonja Ministre, sepse kur ju thoni se biznesi i vogël e ka taksën 0%, harroni të gjitha taksat e pushtetit lokal, të cilat janë dhjetëfishuar. Ju thoni se nuk i merrni taksa biznesit të vogël, ndërkohë që po ia merrni në një drejtim tjetër. Të kam pyetur këtu edhe një herë tjetër, zonja Ministre: a ka logjikë që një biznes i vogël, pra ai fshatari që ka një dyqan të vogël në fshat, të paguajnë rreth 8 deri në 9 taksa? Po të doni, mund t'jua numëroj. A e dini ju, zonja Ministre, që fshatari atje, i cili ka një dyqan të vogël apo një biznes të vogël paguan në bashki taksa ndriçimi, ndërkohë që nuk ka ndriçim? Fshatarët e fshatit Kurtaj dhe Hasmashaj më thanë pikërisht kështu: "Ku është ndriçimi këtu, zoti deputet, sepse ne paguajmë taksa?!"

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Verifikojini dhe pastaj më thoni! Taksa është me faturë dhe në këto dy fshatra paguajnë taksa ndriçimi.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Po, sepse është banor i një bashkie dhe llogaritet si çdo banor tjetër në qytet. Kjo është e vërteta.

Fshatarët paguajnë taksa për pastrimin. E dini këtë, zonja Ministre? Ata paguajnë taksa për pastrimin, por në fshat nuk bëhet asnjë pastrim. Shanset zero në Kërrabë, në Zall-Bastar, në Gramsh, në Përrenjas apo kudo në vendet e tjera! Fshatarët paguajnë taksa për pastrimin. U vjen taksa dhe e paguajnë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, Erion, është e vërtetë.

Fshatarët paguajnë taksa për gjelbërimin. Edhe bizneset e vogla në fshatra paguajnë taksa për gjelbërimin, sepse të gjithë e dinë që bashkitë janë zgjeruar, pasi përveç qyteteve, kanë marrë edhe ish-komunat dhe paguhen taksa.

Po ashtu, paguajnë taksa për varrezat, taksa për bujqësinë, taksa për infrastrukturën arsimore, taksa për truallin dhe taksa për tabelat informuese. Pra, janë shumë taksa. Ju thoni se nuk kanë taksa, por jo, kanë taksa, të cilat ju i merrni në një mënyrë tjetër. Thoni "zero", por "zero" do të ishte nëse nuk do t'i merrnit asnjë taksa biznesit të vogël.

Të flasim për profesionet e lira.

E dini që ato ishin biznese të vogla? E patët deri më 1 janar të vitit 2029, por një pjesë e diskriminuat, e kaluat më 1 janar të vitit 2024.

Unë mendoj dhe gjykoj se mënyra e taksimit në Shqipëri nuk është e drejtë. Kam bindje për këtë, zonja Ministre. Është e turpshme ta them në parlament, por nëse në Shqipëri nuk do të hyjnë paratë e pista, do të falimentojë ekonomia, pikë! Do të falimentojë!

Zonja Ministre, ju nuk i taksoni ata që sjellin paratë e pista nga trafiku i drogës dhe i kokainës, ata që ndërtojnë kulla në mes të Tiranës, që kanë dhjetëra e dhjetëra dyqane, dhjetëra e dhjetëra banesa e paratë e tyre qarkullojnë jashtë sistemit bankar, por kapni të gjitha bizneset e ndershme.

Zonja Tabaku e ka paraqitur projektligjin, por jam i sigurt se ju do ta rrëzoni. Në Shqipëri, nga 10 kompani që zhvillojnë aktivitetin në Tiranë, 6 prej tyre kanë burime financiare jo thjesht të dyshimta, por pa diskutim të ardhura në mënyrë të jashtëligjshme. Vetëm 4 kompani

ngelen. Të jeni të sigurt që nga 10, do të përfundojnë në 9 kompani, sepse 1 kompani do të ketë mundësi, pasi çdo ditë, ata që marrin para në sistemin bankar... A ka logjikë të ndërtohet një kullë me qindra e miliona euro dhe kompania të mos marrë kredi bankare?! Ku i gjen paratë? Ku i gjen financimet kompania? Ju duhet të shkoni tek ata, për të gjetur nga u vijnë paratë, jo të shkoni tek avokati apo te kontabilisti. Edhe këta duhet të paguajnë, sigurisht, nuk jemi të mendimit të mos paguajnë, por, së pari, merruni me paratë e pista të oligarkëve që investojnë në Shqipëri, përpara syve tuaj, zonja Ministre. Jo më kot ne jemi i vetmi vend, bashkë me Turqinë, në listën gri të MONEYVAL-it. Pse jemi në listën gri? Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar e kanë shumë të qartë që këtu është një pisllek jashtëzakonisht i madh dhe paratë e pista janë përditë në përdorim. Kjo vazhdon dhe do të vazhdojë për sa kohë ju do të keni këtë mendje.

Faleminderit!

*(Drejtimin e seancës e merr nënkryetarja, zonja Felaj.)*

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Sula!

Ministrja e Financave ka kërkuar fjalën.

**Delina Ibrahimaj** – Do të flas shumë shkurt, sa për t'ju informuar për shifrat dhe të dhënat.

Shifrat e prodhimit të brendshëm bruto për 3-mujorin e katërt sapo dolën sot dhe nuk është aspak e vërtetë që konsumi është në rënie.

Zoti Sula, nuk e di ku e keni parë, por në 3-mujorin e katërt në ekonomi konsumi është rritur me 4,5% në krahasim me vitin e kaluar. I gjithë produkti i brendshëm bruto është rritur me 4,73%.

Po, konsumi final i administratës publike ka qenë në rënie, duke reflektuar një tkurrje të të gjitha shpenzimeve të administratës publike gjatë 3-mujorit të katërt, por edhe gjatë të gjithë vitit të kaluar, pasi na është dashur të bëjmë disa rishikime, me qëllim rialokimin e fondeve aty ku ka qenë më shumë e nevojshme.

Unë kam dalë shumë herë këtu dhe kam shpjeguar se ku kanë shkuar të ardhurat shtesë që nuk ishin planifikuar, por ju nuk doni t'i dëgjoni, nuk doni të kuptoni dhe doni të keqinformoni.

Ju lutem, referojuni shifrave zyrtare dhe bëhuni më seriozë në parlament!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Ministre!

Zoti Sula, shikoj që keni kërkuar fjalën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për çfarë doni të bëni replikë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, lexojeni me kujdes nenin 50 të Rregullores dhe besoj se do të bini dakord që nuk ka vend për replikë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ministrja nuk shprehu asnjë fjalë fyese ndaj jush, por thjesht solli në referencë të dhënat. Ajo ka të drejtë të ndërhyjë në çdo kohë, si nismëtare e ligjit për të cilin po diskutohet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pikërisht sepse dua të zbatoj Rregulloren, po ju sjell në vëmendje nenin 50.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Sula, ju lutem, uluni! Nuk keni të drejtë për replikë.

Zoti Spaho e ka fjalën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

Zoti Sula, nuk ka asgjë për të replikuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Askush nuk jua tha një fjalë të tillë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Sula, ju lutem, konsumojeni replikën tuaj!

**Dashnor Sula** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Zonja Ministre, do t'ju jap edhe një shifër tjetër, të cilën jemi duke e ndjekur ne, si Parti Demokratike.

A e dini ju, zonja Ministre, se shitjet në pakicë përgjatë vitit 2022 në të gjitha pikat e karburanteve në Shqipëri janë rritur me 8,5% krahasuar me 1 vit më parë, në një kohë kur importi i lëndëve djegëse, i naftës ose i benzinës, ka rënë me 4,5%-6%, (nuk e kam të saktë këtë shifër)? Po jua them, sepse është e kundërta, pra rritet tregtia me pakicë e karburanteve, por bie importi i produkteve të lëndëve djegëse, siç janë nafta dhe benzina. Çfarë emri i vihet kësaj, zonja Ministre? Kjo ka vetëm një emër: kontrabandë. Aty janë paratë, kontrollojini dhe gjejini atje!

Në cisternat e anijeve në Durrës janë kapur mijëra tonë naftë, por qeveria juaj, institucionet tuaja ligjzbatuese nuk kanë lejuar të shkojnë te porositësit, i kanë kapur më parë. Pse i keni kapur më parë? Sepse keni frikë, se do të dalin njerëz të lidhur me segmente të caktuara të pushtetit. Kjo është e vërteta, zonja Ministre. Pa diskutim, këtu

do të jemi në muajt në vazhdim dhe do të na kujtoni për gjithçka çfarë po themi ne.

Kur zonja Tabaku dhe unë, në fund të vitit 2022, folëm për uljen e TVSH-së nga 20% në 6% për fshatarët, për punëtorët dhe për varfanjakët, nuk e morët parasysh, por çuat 120 milionë euro vetëm për rindërtimin. E kam thënë edhe një herë tjetër: në Rrogozhinë nuk është shembur asnjë shtëpi, por kanë marrë 5 herë para. Më thoni, zonja Ministre! Ju nuk kujtoheni për fshatarët e shkretë dhe për njerëzit e varfër. Ky është qëllimi juaj, që t'i mbani sa më mirë bizneset dhe njerëzit me të cilët kemi interesa të lidhura...

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Sula!

U ezaurua koha e replikës.

Fjala për zotin Spaho.

Të përgatitet zoti Gjijnuri.

**Edmond Spaho** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

I dashur koleg,

Kjo nuk ka fare synim të dijë se me sa pak lekë e me sa euro jetojnë njerëzit në fshatra, në qytete, që mezi e nxjerrin bukën e gojës. Synimi, modeli i saj është të flasë me gjuhën dhe me metodologjinë e ustait të vet. Po t'i shikosh, sikur e ka nxjerrë nga hundët, flasin me të njëjtën gjuhë! Sipas asaj që ka thënë një ekspert: “Shpif, shpif, gënje sa më shumë të jetë e mundur, sepse diçka do të ngelet”, bën edhe kjo; është kthyer në mjeshtrë dhe ia ka kaluar edhe vetë Edi Ramës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë po e krahasoj me Edi Ramën. Pse po e fyej?!

Shprehet se kemi taksat më të ulëta në botë; pagat më të larta; konsumin më të lartë, njësoj siç foli ustai i vet, kur u godit “Top Channel” dhe vdiq një qytetar i pafajshëm: “Rendi dhe siguria nuk kanë qenë kurrë si sot”. Të nesërmen u vranë 4 të tjerë. A mos u shqetësua ndopak për ata të katërt? Hiç fare, fjeti si qengj atë natë!

Ky propozim është pjesë e strategjisë për ta zbrazur Shqipërinë, është pjesë e qëndrimit historik të Edi Ramës, që e urren shtresën e mesme, i urren më të diturit, i urren më të zotët, i urren ata që janë në gjendje t'ia dalin jetës vetë, dhe për rrjedhojë do t'u bjerë kokës.

Dëgjojeni: “Unë jam pa shkollë”, thotë. “Ata me shkollë duhen dënuar”, prandaj po e bën këtë gjë. Avokatëve, kontabilistëve, dentistëve, mjekëve në profesione të lira do t'u bjerë kokës, ata do të paguajnë 23%, megjithëse janë shtresa

që e mbajnë gjallë konsumin e Shqipërisë. Atyre u duhet rënë kokës! Kjo thotë një herë: “marrin pagë”; herën tjetër thotë: “janë biznese”. Kështu ua kërkon puna: një herë t'i paraqesin sikur marrin pagë... Nga kush marrin pagë ata? Kush i paguan ata? Ata punojnë vetë, kanë investuar, kanë blerë pajisje të sofistikuara, të cilat duhet t'i shlyejnë.

Më pas mburren se japin incentiva më shumë se çdokush në rajon! Çfarë incentivash?! Ti po u bie kokës me 23% të ardhurave të tyre!

Ligji është diskriminues dhe do të përfundojë në Gjykatën Kushtetuese.

Nëse do vërtet t'i trajtosh në mënyrë të barabartë dhe t'i quash biznese, trajtoji me 15%, siç trajton biznesin, por jo me 23%. Pse e taton dividendin e bizneseve me 8%? Madje, ua dhe edhe me efekte prapavepruese për 2-3 vjetët që nuk e kishin paguar, e morën dividendin me 8%, ndërsa këtyre u duhet rënë kokës!

Strategjia për të zbrazur Shqipërinë vazhdon prej 10 vjetësh. Nuk është e rastësishme që pagat në vendin tonë janë ndër më të ulëta jo vetëm në rajon, por në të gjithë Europën; i mbajnë me qëllim. Pagat e administratës publike nuk janë rritur prej 10 vjetësh, përveç disa kategorive, për të rrahur gjoksin. Janë bërë të gjithë bashkë, në një apo në dy fasha. E gjithë administrata e lartë shtrihet në një apo në dy fasha, që edhe ata të vuajnë për bukën e gojës.

Pagat janë ndër më të ulëta, ndërsa çmimi i energjisë elektrike është më i larti në rajon; pagat janë më të ulëta, ndërsa çmimi i karburantit më i larti në rajon, për të mos thënë që jemi të dytët apo të tretët në Europë; pagat janë më të ulëta, ndërsa për produktet ushqimore dhe për kostot e jetesës jemi të dytët ose të tretët në Europë sot. Ky është realiteti, nuk ia fus kot.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk është e rastësishme që bujqësia dhe blegtoaria nuk ndihmohen, nuk subvencionohen, se këtë e ka edhe me qejf Erioni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ua hoqën 6%-shin e kompensimit të TVSH-së, u shtuan edhe një taksë tjetër, 10% për inputet. Pse? Që ata të vuajnë, t'u nxihet jeta, të ikin e t'i lënë tokat. Dhe ata po ikin. Dilni dhe shikojini fshatrat e qarkut të Korçës, duket sikur u ka rënë bomba! Fshatrave me 5 mijë banorë u bie tejmbanë dhe nuk gjen këmbë njeriu! Nuk do t'ia dijë fare zonja, as kjo e as ajo tjetra e bujqësisë!

Pse, e rastësishme është që ka rënë lindshmëria në këta 10 vjet qeverisjeje të këtyre? Nga 3,1 për 1000, ka rënë në 1,28.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mund të bësh fëmijë, por fëmija do të hajë bukë, do të shkollohet, do të vishet, do shtëpi. Ka shumë kërkesa, nuk është kaq e thjeshtë sa e mendon ti, Erion.

Një çift i ri duhet të harxhojë 37 vjet për të blerë një shtëpi, por duhet të durojë edhe talljet, kur i thonë: “Bëni fëmijë”. Ata mund të bëjnë fëmijë, por u duhen 37 vjet të blejnë shtëpi. Këtu është më shtrenjtë se në Paris dhe në Nju-Jork. Ju qeshni, në vend që t’i thërrisni mendjes: pse jemi në këtë gjendje dhe çfarë duhet të bëjmë për ta korrigjuar?

Kanë ikur shqiptarët. Kanë ikur të rinjtë, i dashur Erion.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më dëgjo!

Kanë ikur 700 deri në 900 mijë qytetarë në 10 vjetët e fundit. Kjo shifër përbën 26% të popullsisë dhe duhet të të shqetësojë ty.

Së dyti, deri në vitin 2018 janë 400 mijë shqiptarë me dokumente të rregullta, që kanë marrë strehim në Europë.

Së treti, 78% e të larguarve, Erion i dashur, janë nën moshën 34 vjeç. Kjo duhet t’ju shqetësojë, sepse po ikën mosha më produktive e punës. Ju qeshni, i merrni me shaka këto dhe thoni: “Nuk ka problem, emigrim ka gjithandej”. Ka emigrim, por nuk ikën 26% e popullsisë!

E rastësishme është që në vitin 2022 kanë ikur në Angli 11 mijë të rinj shqiptarë? Të gjithë kanë qenë të moshës 14-34 vjeç.

A ju shqetëson kjo juve kur rrisni taksat, kur rrisni çmimet në mënyrë të pakontrolluar apo kur rrogat rrinë statuskuo prej 10 vjetësh? Këto kërkojnë njerëzit, që, kur të hyjnë në një punë, të sigurojnë jetën, të blejnë një shtëpi dhe të rrisin fëmijët. Me këto që u jepni ju, nuk e bëjnë dot. Pse ndodhin këto? Sepse ua keni vrarë shpresën. Ua keni vrarë shpresën dhe po ikin.

Jemi vendi më i shquar për nivelin më të lartë të korrupsionit në çdo hallkë e qelizë të shoqërisë. Kudo që do të trokasësh, do të të kërkojnë lekë. Jo vetëm këta hajdutët e Enverit, që i kemi këtu pas, por në çdo hallkë të administratës të kërkojnë lekë. Pse? Sepse nuk u del rroga që marrin, dhe thonë: për sa kohë e kemi këtë punë, o burra! Madje, edhe Kryeministri u thotë: “Kap

ça të kapësh” dhe më pas del, siç doli dje, e vazhdon me teoritë e gënjeshtrove: “Do t’ju rris pagën mesatare nga 650 euro në 900 euro”. Do të rrisë pagën mesatare ai që hapi 300 mijë vende pune; ai që bëri shëndetësinë falas; ai që luftoi korrupsionin! A mund ta besosh këtë?! As nuk skuqet, as nuk zverdhet, por me pafytyrësinë më të madhe del e thotë: “Do t’ju bëj rrogën 900 euro”, kur për këtë duhen minimumi 400 milionë euro në vit.

**Ermonela Felaj** – Konkludojeni, ju lutem!

**Edmond Spaho** – Ty nuk të lënë oligarkët; nuk të lënë ata që vjedhin nëpër koncesione, ku ndërtohet një rrugë me 20 milionë euro kilometri. Ndaj, këto ai i hedh vetëm si shashka elektorale, do që t’i gënjejë njerëzit edhe një herë dhe t’i japin votën më 14 maj. Nëse do të gënjehen, qytetarët nuk do të kenë kujt t’ia kërkojnë fajin, përgjegjësinë do ta kenë vetë. Prandaj, mos e votoni!

**Ermonela Felaj** – Zoti Spaho, ka përfunduar koha e diskutimit.

Zoti Braçe dhe zonja Zhupa kanë kërkuar fjalën.

Ju lutem, kolegë!

**Erion Braçe** – Zoti Spaho, a kanë një burim të gjitha shifrat të cilave iu referove?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nga EUROSTAT-i.

Atëherë, EUROSTAT-i, që ka si burim INSTAT-in...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Vazhdojeni fjalën, ju lutem, sepse kështu është e vështirë, se ju vetë e vendosni këtë marrëdhënie në sallë!

**Erion Braçe** – E para, EUROSTAT-i, që ka si burim INSTAT-in, një pjese të shifrave iu referuat nga INSTAT-i, thotë se emigracioni neto i të gjithë këtyre viteve është 25 mijë.

E dyta, kam një pyetje, për të cilën nuk kam nevojë për përgjigje: çfarë u jepnit çifteve të reja në kohën tuaj? Zero shtëpi, zero kredi! Kur lindnin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Paga jote minimale në fund të vitit 2013, më e larta në rajon, ka qenë 191 mijë lekë. Pra, ti, një burri dhe një gruaje, në kohën tënde, në kohën e Sali Berishës, u jepje 191 mijë lekë! Ndërkohë, sot paga minimale për një çift të rinjsh është 400 mijë lekë, plus 400 mijë lekë. Për fëmijët që ata lindnin ti jepje zero lekë! Pyeti sa lekë marrin sot!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Braçe!  
Zonja Zhupa.

**Ina Zhupa** – Faleminderit, drejtuese e seancës!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – E njoftova radhën e fjalës. Ju lutem, më ndiqni! Mos e shtypni mikrofonin pasi kam njoftuar radhën e fjalës!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ina Zhupa** – Gjatë gjithë kohës, kur zoti Spaho mbajti fjalën në foltore, dy kolegë, zonja Gjylameti dhe zoti Braçe, komentnin dhe ndërhynin duke marrë kohë nga koha e tij. Ju, si drejtuese e seancës, e para, duhet t'u tërhiqnit vëmendjen dhe, e dyta, duhet ta zëvendësonit kohën e harxhuar në zhurma e replikë në fjalën e plotë të zotit Spaho, pasi këto janë rregullat e parlamentarizmit. Nëse nuk mbajnë dot etikën në sallë dhe janë të padurueshëm për të bërë zhurmuesin, ka kafene ku mund të shkojnë dhe të komentojnë edhe proceset e tjera se si i ndërtojnë ata marrëdhëniet me njëri-tjetrin, sepse këtu jemi në një sallë parlamentare dhe kur flet dikush në foltore, kolegët duhet të dëgjojnë e më pas të marrin fjalën, siç e morën, për replikë apo për procedurë.

E fundit, kur krahasoni pagat, krahasoni edhe fuqinë blerëse, se sa mund të blihej atëherë dhe sa mund të blihet tani me ato para dhe me normat e inflacionit që kemi.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Zhupa!

Zonja Açka.

**Flutura Açka** – Faleminderit!

Nuk kam diçka konkrete, por do të flas për volumin e zërit.

Siç e shikoni, ju kam ndjekur dhe ka shumë të bërtitura në mikrofon, aq sa nuk e di sa mund të ketë arritur decibeli në parlament. Bëni mirë të këshilloni kolegët, këdo që bërtet, sepse e bërtitura nuk plotëson asgjë: ta mbajnë pak më larg mikrofonin, ose uleni foninë këtu, sepse kjo është çmenduri! Këtë e kam vërejtje. Kjo zhurmë duhet ta ketë kaluar 50 decibelin në këtë vend.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Açka!

Kolegë, unë nuk dëshiroj të ndërhyj në fjalën e çdo kolegu, por, gjithsesi, u kujdesa që edhe zoti Spaho të merrte 47 sekonda shtesë për ta përmbyllur fjalën e tij.

Ju lutem, kur flisni, mos flisni me njëri-tjetrin në sallë, që të mos ndodhë debati që këtu ndodh rëndom! Këtë e kam për të gjithë kolegët.

Të mundohemi që të përcillen siç duhet te publiku gjërat për të cilat flasim dhe të jemi të dëgjueshëm.

Fjalën e ka zoti Gjijkuri.

Të përgatiten zoti Shehu dhe zonja Gjylameti.

**Damian Gjijkuri** – Mirëdita, të nderuar kolegë dhe qytetarë që na dëgjoni!

Ligjet me karakter fiskal, siç është edhe ligji për të cilin po diskutojmë sot, duken si ligje teknike dhe ndoshta të sofistikuara, por e rëndësishme është të shikosh frymën nga e cila niset qeveria, objektivat që kërkon të arrijë, dhe ta shohësh këtë në një prizëm shumë më të gjerë për stadin në të cilin po kalon shoqëria jonë.

E para, ligji synon të adresojë disa probleme, që të gjithë ne këtu në sallë i dimë, siç është ai i profesioneve të lira. Pse e them? Profesionet e lira janë patjetër biznese shumë të nevojshme. Unë vij si profesionist i lirë dikur, përpara se t'i bashkohesha politikës, dhe të gjithë duhet ta pranojmë që këto profesione kanë qenë jashtë vëmendjes së rregullimit fiskal të qeverisë, duke lënë hapësira të shumta, ku ka nevojë për formalizim. Ky projektligj synon ta normojë më mirë këtë gjë, gjithmonë me qëllimin për të mos e dëmtuar atë grupim të popullatës, por përkundrazi, për të krijuar rregullshmëri dhe benefite për grupe edhe më të mëdha të shoqërisë.

Nga ana tjetër, realisht, duhet përgëzuar kjo iniciativë e mazhorancës për këtë çështje, që meriton vlerësim dhe diskutim, sepse ka të bëjë me lehtësirat që do të krijohen duke ulur barrën tatimore për pjesën më të madhe të punonjësve në Shqipëri, të cilët, së pari, do të përfitojnë nga fakti që paga minimale do të rritet në 40 mijë lekë dhe, së dyti, do të ulet barra tatimore për personat që marrin 40 deri në 50 mijë lekë në muaj apo për ata që marrin nga 50 deri në 60 mijë lekë. Këtu janë bërë disa llogari, por mjafton të merren parasysh shifrat që ka nxjerrë qeveria: për grupin e parë janë 15 mijë e 600 lekë të rinj të kursyer direkt për këta individë dhe për grupin e dytë janë 7 mijë e 800 lekë të rinj të kursyer direkt për këta individë. Çfarë do të thotë kjo: masë sociale apo barrë rënduese? Pse nuk doni ta thoni këtë? Kjo është masë sociale. Kjo është pjesa më e madhe, ky është *backbone*-i, shtylla kurrizore e popullatës



shqiptare, sepse këto janë përgjithësisht edhe të ardhurat e atyre njerëzve që e mbajnë gjallë industrinë. Të mos harrojmë se kemi të bëjmë me punonjës në korporata të ndryshme, të cilët e mbajnë gjallë ekonominë shqiptare.

Sot biznesi ka një problem, që e hasim çdo ditë, dhe kjo është e vërteta që e dini edhe ju nga kontaktet që keni, por edhe ne nga kontaktet tona: po rrallohet fuqia punëtore. I dimë fenomenet e emigracionit dhe historitë e tjera, që ka një deformim për sa i përket popullsisë shqiptare dhe moshës, të cilat po krijojnë mangësi dhe skarcitet, por ky fenomen nuk ndodh vetëm në Shqipëri. Ju nuk doni ta thoni këtë, sepse doni t'ia lini fajin qeverisë "Rama", por e dimë shumë mirë që në Ballkanin Perëndimor, vende si Greqia, pjesë e Bashkimit Europian, kanë vështirësi për krahë pune, ndaj kanë filluar të marrin masa respektive sociale. Cila është arsyeja? Arsyeja është që punëtorët, njerëzit që punojnë, të kenë më shumë të ardhura, të qëndrojnë në vendin e tyre dhe të jenë pjesë e ekonomisë sonë. Nëse njerëzit ikin, si do të mbahet kjo ekonomi? Qeveria duhet të tregohet patjetër e kujdesshme, që të mos shkojë e gjithë barra te sipërmarrësit. Për këtë është menduar formula e kompensimit pikërisht për vitet e para, derisa konkurrueshmëria t'i mbajë këto biznese në këmbë. Pra, shteti ka marrë përgjegjësinë e vet dhe dua ta përgëzoj për këtë masë sociale, sepse është një ndër masat bashkëkohore që e bëjnë edhe vende të tjera për të nxitur mbajtjen e ekonomisë kombëtare me punonjësit në fjalë. Ju nuk doni ta përmendni këtë.

Ju tërboheni pse Kryeministri deklaroi se pensionistët do të marrin shpërblime muajin e ardhshëm. Disa tërbohen, ndërsa disa të tjerë fillojnë të bëjnë llogari elektorale. Grupimi i parë që vjen këtu, thotë: "E bën për vota". Ai tjetri, që doli dje në televizor, një syresh, thoshte: "Le ta bëjë, se e ka të humbur". Nga ana tjetër, plaku i vjetër, e di shqetësimin, nuk e sulmon direkt, por vendos kasnecët e vegjël të thonë: "Po shkelet Kodi Zgjedhor". E kuptoni çfarë problemi kemi? Ju nuk doni që kjo qeveri të ndërmarrë asnjë masë për të përfutur popullata. Ju krijoni kakofoni vetëm e vetëm se nuk dini si të reagoni.

E vërteta është që qeveria po e bën këtë në dobi të njerëzve që do të përfitojnë. Do të përfitojnë pensionistët, pjesa më në nevojë. Vetëm këtë vit që ka hyrë, po t'i mbledhim të gjitha së bashku, përfshirë edhe këtë që do të

marrin, janë mbi 10 apo 11 mijë lekë të rinj që kanë shkuar direkt në ekonominë e njerëzve më të prekur, pa i ndryshuar çmimet, siç e tha mirë edhe Erioni pak më parë, sepse çmimi i energjisë nuk lëvizti asnjëherë, pasi buxheti i shtetit mbajti barrën e 500 milionë eurove. Çfarë është kjo: masë sociale apo mbrojtje për oligarkët? E kam thënë edhe një herë tjetër: është masë e pastër sociale nga qeveria e majtë.

Unë jam krenar për qeverinë time, që i ka ndërmarrë këto masa. Jam i majtë dhe mendoj se qeveria po bën gjënë e duhur duke i ndihmuar shtresat në nevojë, njerëzit më të prekur nga inflacioni dhe rritja e çmimeve. Kjo është e vërteta, ndaj mos hidhni dokra të tilla, që Shqipëria është vend i dytë apo më i shtrenjti në Europë, sepse nuk i beson njeri! Këto janë përralla. Çmimet janë rritur vërtet në Shqipëri, siç janë rritur kudo, por me këtë minimum të ardhurash, nuk vdes njeri në Shqipëri për bukë dhe nuk e ka bërë për varfëri, të cilën ju doni ta trumbetoni. Përkundrazi, shikoni artikujt ndërkombëtarë se çfarë thonë për Shqipërinë, për shembull, për fenomenin e ri, të fundit, që ka filluar për lëvizjen e nomadëve digjitalë. Po të shikoni artikujt pozitivë, të cilët ju tërbojnë, pasi juve çdo gjë e bukur ju shkatërron sytë, ju mbush me lot dhe ju turbullohet vështrimi, ata thonë: "Shqipëria është vendi më atraktiv për sa u përket çmimeve, jetohet mirë, përveç avantazheve të tjera natyrore që ka ky vend". Realisht Shqipëria e ka këtë mundësi dhe ne, të gjithë krahët politikë, duhet ta përkrahim, jo thjesht t'ia nxjerrim sytë njeri-tjetrit. Jua kam thënë edhe herë të tjera, nëse ju doni perspektivë zhvillimi, qoftë edhe për të ardhur në pushtet nesër (nëse do të vini ju, jo ti, Mondit, sepse ti nuk je për ato punë, por ata të tjerët që pretendojnë, brezi tjetër), do t'ju duhet një vend stabil nga pikëpamja institucionale demokratike, që vjen vetëm me zhvillim ekonomik, jo me llafe e as me letra. Zhvillimi ekonomik do edhe masat e duhura sociale, njëkohësisht, të mos godasë konkurrueshmërinë në ekonomi. Mendoj se ndërhyrja që po bën qeveria, qoftë duke formalizuar dhe duke e normuar më mirë barrën fiskale, duke lehtësuar punonjësit e vërtetë, njëkohësisht, duke i ardhur vitet e para në ndihmë industrisë për të kompensuar efektet financiare që ka, është masa e duhur, është masa sociale, e cila edhe i adreson njerëzit, por, njëkohësisht, jep edhe

qëndrueshmëri në ekonomi. Këto janë masa të vështira. Jo gjithçka politike e qeverisë dihet se si do të shkojë. Ne jemi në proces. Prandaj ligjet fiskale në të gjithë botën rishikohen, shikohen, sepse ndodhin ngjarje, ka luftëra, ka kriza ndërkombëtare, ka efekte të tjera që nuk i parashikojmë, pasi jeta është plot me të papritura si për njeriun, ashtu edhe për kombet, por qeveria duhet të jetë e gatshme të reagojë përnjëherë. Këto ligje nuk janë të gdhendura në gur, që u bë kjo dhe do të jetë kështu, sepse nesër qeveria do të shikojë ecurinë dhe do t'i përshtatë politikat e saj, por, në fund të fundit, duhet ta pranojmë se ajo që po bëjmë tani, është në dobi të qytetarëve, gjë që ju nuk doni ta pranoni, por kjo është e vërteta.

Meqenëse e kishit merak 14 majin, patjetër që qytetarët duan ta vlerësojnë dhe dinë ta vlerësojnë. Ku e kuptoj unë këtë?! Ngaqë çirreni ju, sepse, po të ishte e mirë, ju do të rrinit të heshtur, dhe ngaqë ai plaku i vjetër kishte frikë ta prekte këtë temë, sepse e di që qytetarët i mirëpresin të gjitha bonuset dhe efektet financiare, sidomos pensionistët dhe njerëzit më në nevojë. Në fakt, qeveria socialiste duhet të marrë më shumë masa të tilla, dhe më vjen mirë që në këtë pjesë të mandatit që ka mbetur fokus i qeverisë kanë qenë aspektet sociale, jo thjesht se jemi të majtë si filozofi, jo thjesht se jemi “populistë” për të adresuar nevojat elektorale, por kuptohet: për të pasur sa më shumë incentiva për njerëzit, për të ndërtuar familjen këtu dhe për të qëndruar këtu. Fenomeni i emigracionit është fenomen global, ndodh në të gjithë botën, por problemi është se çfarë bën ti. Të keqen nuk e parashikon, atë mund ta zbutësh dhe qeveria po e bën këtë shumë mirë. Shpresoj që në të ardhmen edhe ato programet, që ka thënë Kryeministri Rama për bonuse për strehimin e çifteve të reja, sidomos për njerëzit që punojnë në administratën shtetërore, si dhe masat e fundit që janë deklaruar për rritjen e pagës në administratën shtetërore, pikërisht të shkojnë në këtë drejtim: për rritjen e kapaciteteve të shtetit, por, mbi të gjitha, për t'i mbajtur shqiptarët këtu, të qëndrojnë këtu për të ndërtuar vendin. Këtë po bëjmë, por edhe me fytyrë sociale, dhe për këtë jemi krenarë.

Suksese!

Sa më shpejt të kalojë ky ligj, aq më mirë është për vendin!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Zoti Spaho, nuk jua përmendi emrin.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Nuk jua përmendi në sensin që një Rregullorja për të marrë fjalën për replikë, të jemi seriozë. Ju e keni shumë të lartë standardin e replikës kur e pretendoni për vete, por për të tjerët...

Urdhëroni, zoti Spaho!

**Edmond Spaho** – Damian, unë nuk jam si ti, nuk bëj dot ato që bën ti. Ti je i deklaruar si përfaqësues i investimeve ruse në Shqipëri, si “djalka i Deripaskës”. Ki kujdes, sepse sot u sekuestruan pasuritë e McGonigal-it, kushedi se çfarë do të dalë edhe për ty atje, pastaj do të detyrohesh të mbash përgjegjësi ligjore. Kështu si po shkojnë punët, nuk shoh kandidat ndonjë koleg tjetër, por të shoh ty kandidat për në Guantanamo. Kur të shkosh atje, të jap fjalën se do të të sjell dy pako me puro, se ti nuk pi cigare, por pi puro, që të rrish atje me gjithë Edin e të qani hallet.

**Ermonela Felaj** – Zoti Gjijknuri.

**Damian Gjijknuri** – O Moni, ke fantazi shumë të dobët. Unë të thashë “përgatit çunin për pushtet”, ta bëra qejfin....

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Je dobët. Ta kam thënë një llafla... E di ku tipizohet bota jote, qëkur të morën në fushatën e Dibrës (e di që do t'i kthehesh prapë) dhe të lanë një rol kryesor politik, dhe ishe figurë e lartë: do të shpërndaje tollonat e karburantit për fushatën elektorale. Aty e kuptova që ekonomisti i fshatit ngelet aty dhe nuk mund të bëhet më lart, por unë prapë të vlerësoj, sepse, në fund të fundit, më nxore në nivel ndërkombëtar me ato që the. Gjithsesi, je qenie e butë dhe nuk mund të nxehtësh njeri, kështu që nuk nxehem me ty.

**Ermonela Felaj** – Zoti Shehu.

**Tritan Shehu** – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Ne po i festojmë festat sot me lajmë të mira. Sot është Dita Ndërkombëtare e Mjekut. Ne e festojmë këtë ditë duke rritur ngarkesën tatimore për mjekët, pra duke i rrënuar akoma më shumë mjekët në nivelin ekonomik. Nuk ka dhuratë më të mirë se kjo që ky parlament, kjo mazhorancë, kjo qeveri bën për mjekët dhe personelin shëndetësor. Mjekët në aktivitetin e tyre të lirë bëjnë pjesë në profesionet e lira, tatimet e të cilëve ju i rritni nga 15% në 23%, duke kapur, pak a shumë, një vlerë totale rreth 20 milionë euro në

vit. Pra, e gjitha kjo është një barrë tatimore që bie mbi mjekët. Kështu e festoni ju Ditën e Mjekut. Qeveria juaj është mësuar me cinizëm; është mësuar të qëndrojë dhe të qeverisë me një popull, të cilin e varfëron çdo ditë e më tepër, e mban me kërbaç, duke ia mohuar të drejtat. Psikologjia dhe mentaliteti i qeverisë suaj është një psikologji otomaniste, pra ju mendoni që, sa më shumë t'i varfëroni njerëzit, sa më shumë t'ua prisni bukën e gojës, sa më shumë t'ua prisni të drejtat, sa më shumë t'i poshtëroni, aq më lehtë do t'juja puthin dorën. Ky është një otomanizëm i thellë dhe shumë i rrezikshëm. Ja, kështu jeni mësuar ju, prandaj i bëni këto gjëra. Edhe sot të njëjtën gjë po bëni me këtë ligj që na keni sjellë. Ju na thoni: "Revolucion i sistemit tatimor, modernizim e të tjera më radhë", por cila është esenca e profesioneve të lira për mjekët, për personelin mjekësor, për avokatët, noterët e të tjerë?! Rritja e barrës tatimore dhe fiskale mbi ta, pra varfërimi i mëtejshëm i tyre. Duhet të jemi shumë të sinqertë me këtë gjë. Ky ligj që sillni ju këtu, është diskriminues dhe krijon pabarazi në sektorë të ndryshëm në nivel tatimesh; është diskriminues, sepse në këtë mënyrë ju godisni shtresat më intelektuale të shoqërisë. Në një rënë anë për biznesin e vogël thoni që e ka 0%, dikush e ka deri në 15%, ndërsa për intelektualët e çoni 23%. Pse keni frikë nga intelektualët, të nderuar zotërinj?! Keni frikë nga mendjet, keni frikë nga dijet, keni frikë nga shkolla, keni frikë nga ndonjë vizion i hapur. Kjo është psikologjia juaj otomaniste, prandaj ju jeni otomanistë në të gjitha karakteristikat tuaja, prandaj kërkoni ta mbani popullin këtu të shtypur pikërisht me mjete otomaniste. Kështu është: ju keni frikë nga zhvillimi, nga Perëndimi, nga europianizmi, sepse idhujt tuaj janë në Lindje, atje ku ka akoma shenjë të otomanizmit. Kjo është e vërteta, prandaj i varfëroni edhe mjekët, të cilët janë një nga pjesët më intelektuale të Shqipërisë. Personeli mjekësor, stomatologët, farmacistët janë pjesa më progresive e këtij vendi, por ju keni frikë nga ata dhe doni t'i mbani nën kërbacin e otomanizmit. Kjo është çështja: sa më të varfër, sa më të rreckosur, sa më pa dinjitet, aq më lehtë i sundoni. Këta jeni ju dhe këtë po e bëni edhe sot, në Ditën Ndërkombëtare të Mjekut. Vini e gënjeni, talleni me mjekët dhe me personelin shëndetësor dhe thoni: "Rritëm rrogat për specialistët", por a e dini se ne i kemi më të ulëta se Kosova, me gjithë

rritjen e premtuar?! Jemi akoma në nivelet më të ulëta, jo të Europës, por edhe të rajonit. Shikoni shifrat, sepse i keni të shkruara. Tani shtoni tatimet mbi "kokat" e tyre, sepse keni frikë nga iniciativa e tyre e lirë, sepse ajo forcon personalitetin, individualitetin dhe pavarësinë nga ju. Edhe ky është otomanizëm. Ju thoni që pjesës tjetër të personelit shëndetësor ua rritni rrogën 7%, më duket (6 muaj i bie, sepse ka kaluar pjesa tjetër), pra 3,5-4% i bie në vit, ndërkohë që inflacioni është 8%. Pra, ju nuk realizoni dot as inflacionin, nuk e indeksni inflacionin, që është një detyrim kushtetues. Çfarë rrogash rritni ju?! Ju i varfëroni çdo ditë e më tepër dhe sot sillni këtë ligj paçavure, diskriminues, me të cilin e varfëroni me thellë personelin mjekësor, të gjitha profesionet: arkitektët, inxhinierët dhe juristët, që janë profesione të lira. Pra, e godisni në zemër pjesën më intelektuale të këtij vendi, sepse keni frikë nga ata. Kjo është e vërteta dhe këtu duhet të qëndrojmë. Këtu midis jush ka mjekë të shquar, ka juristë, ka inxhinierë që rrinë e qeshin sot, por harrojnë që nesër (nuk do të jenë gjithë jetën deputetë) do të kthehen në profesionet e tyre dhe do ta pësojnë nga ky ndryshim ligjor edhe në numër, por edhe do të diskriminohen. Prandaj, ju lutem, kolegë, ngrini zërin, mos rrihi në heshtje, sepse kjo shtypje dhe ky otomanizëm është edhe mbi ju, nuk është vetëm mbi popullin shqiptar! Sa më shumë të rrihi kështu, aq më shumë do të shtypemi të gjithë së bashku. Ju keni mazhorancën, jeni më shumë në numër në këtë parlament, pra, po të rebeloheni edhe ju, nuk do të guxojë qeveri në botë ta bëjë këtë gjë, në kundërshtim me parimet, së paku të barazisë dhe të dëshirës për të zhvilluar sektorët e rëndësishëm që zhvillojnë vendin, pasi intelektualizmi është baza e zhvillimit të një vendi, është themeli i zhvillimit të një vendi, është prirja e një populli, por ju kërkoni ta dekapitoni atë, ta mbani të shtypur, ose ta detyroni të largohet.

A e dini që kemi arritur në nivele katastrofike për sa i përket numrit të mjekëve?! Por, kështu çfarë bëni?! Ju bëni që ata të falimentojnë në punën e tyre (jo vetëm mjekët, por e gjithë kjo kategori intelektuale), të mos përballojnë dot as shpenzimet dhe të largohen. Edhe Europa i ka hapur dyert për këta që do të largohen. Ju doni të përzini nga Shqipëria pjesën më intelektuale të vendit, ta varfëroni, ta shkëlmi me këmbë, ta diskriminoni që të largohet nga

Shqipëria. Ku do të shkojmë kështu si vend?! A e keni menduar ndonjëherë se ku po e çoni këtë vend duke dekapituar nivelet intelektuale të këtij popull? A e keni menduar ndonjëherë se me politikat tuaja po rrënohet dhe po bie niveli intelektual i këtij vendi? Nuk ka gjë më të keqe se kjo për Shqipërinë. Ju nuk bazoheni në rritjen ekonomike, por në politikat tuaja ekonomike, në taksat e larta, në korrupsionin, në PPP-të, në investimet korruptive, ku 1 kilometër rrugë shkon 10 herë më shumë sesa është në realitet, duke shkallmuar kështu ekonominë e duke rritur varfërinë, si dhe duke i detyruar shqiptarët të largohen. Çmimet e ushqimeve, të naftës dhe të medikamenteve po shkojnë në stratosferë, prandaj largohen shqiptarët. Në radhë të parë, po humbni ata që janë thelbi i zhvillimit të një vendi, intelektualët dhe intelektualizmin, sepse ata e zhvillojnë një vend, ta dini mirë këtë punë. Ju doni pikërisht ta dekapitoni atë me këtë ligj, të godisni në mënyrë selektive pjesën më intelektuale të Shqipërisë. Prandaj ju thashë se ju jeni otomanistë dhe politikat tuaja janë otomaniste, aspak europiane, aspak perëndimore, aspak progresive, përkundrazi, të prapambetura, për ta mbajtur këtë vend edhe një herë në parametrat për ta sunduar dhe njerëzit të trajtohen si sklevër, ata që do të ngelin, sepse më të mirët po ikin, të jeni bindur për këtë. Më të aftët ikin, ata që nuk durojnë dot shtypjen tuaj ikin. Juve kaq ju mjaftojnë në Shqipëri, 800 000 veta, jo më shumë, sa për të sunduar veten tuaj në një vrimë, si Esat Pasha dikur, kaq ju mjafton juve dhe ky është qëllimi juaj. Prandaj, unë ju them që nuk ecët kështu. Shqipëria ka nevojë për intelektualizëm, ka nevojë për europianizmin, për Perëndimin dhe ky ligj është në kundërshtim të plotë me këto parime të thella të zhvillimit dhe të ekzistencës së Shqipërisë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Shehu!  
Fjala për zonjën Gjylameti.

Të përgatiten zoti Isuf Çelaj, zoti Braçe dhe zonja Zhupa.

**Blerina Gjylameti** – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky është një nga projektligjet që është diskutuar më gjerë e më gjatë në Komisionin e Ekonomisë, për të cilin kemi pasur shumë diskutime dhe kemi dëgjuar shumë grupe interesi.

Nuk i kemi bërë pa qëllim orë e orë dëgjesash, por i kemi bërë për të pasur një nga ligjet më kryesore që do të adresonte të gjitha shqetësimet e grupeve të interesit, por, po ashtu, edhe të kolegëve deputetë.

Me shumë keqardhje them se në dëgjesat që kemi pasur, por edhe në mbledhjet e komisionit, të gjithë ata kolegë, që sot ngrenë zërin këtu, nuk kanë ardhur as thjesht për të marrë pjesë dhe as për të dëgjuar, më pak akoma për të propozuar ndonjë ndryshim dhe më pak akoma për të ardhur me alternativa, por të vetmen gjë që bënë kolegët e opozitës, ishte marrja pjesë me mosprezencën e tyre. Ditën e fundit, kur duhej ta votonim, edhe gjatë votimit pjesa më e madhe nuk ishte prezente, një që ishte prezent, solli propozime atë dite. Nëse e kishit kaq seriozisht, të nderuar kolegë, dhe jeni kaq të shqetësuar se si ky projektligj do të prekë shtresa të caktuara, minimalisht të kishit edhe vullnetin ta tregonit këtë duke qenë prezentë, duke diskutuar qoftë edhe me grupet e interesit, që shpeshherë merrni përsipër t'i përfaqësoni, ndërkohë nuk jeni as kur janë prezentë.

Ky është një projektligj që është diskutuar, ka adresuar një sërë problematikash dhe, mbi të gjitha, boshllëqet që janë krijuar në 23 vjet, qoftë edhe për faktin e ndryshimeve për përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Europian.

Gjatë diskutimeve që u bënë këtu, dëgjova shumë të pavërteta, nuk dua të them gënjeshtër, sepse, po të them gënjeshtër, normalisht, e di që u është bërë karakteristikë dalluese që thotë dikush një gënjeshtër, fillojnë të gjithë e përsërisin, e zmadhojnë me shpresën se do t'u besojnë dhe akoma më shumë me shpresën se ndoshta marrin ndonjë përfitim politik. Qëkur kemi ardhur në pushtet, në vitin 2013, e kemi pasur pjesë të programit tonë elektoral dhe më pas pjesë e programit tonë qeverisës parimin e taksimit të drejtë, pra të gjithë ata që fitojnë më pak, do të duhet të paguajnë me pak dhe të gjithë ata që fitojnë më shumë, do të duhet të paguajnë më shumë. Që nga ajo ditë deri më sot, kemi rishikuar të gjithë bazën e tatueshme për të gjithë ata që fitojnë më pak, fillimisht duke i përjashtuar të gjithë ata që kishin një pagë deri në 30 mijë lekë, duke e rritur në 40 mijë lekë dhe duke ardhur sot nëpërmjet këtij projektligji duke bërë përjashtimin deri në 50 mijë lekë.

Dëgjova këtu gjatë gjithë kohës shqetësimin për një grup të profesioneve të lira; dëgjova edhe

shumë të pavërteta në lidhje me faktin se ata kanë shpenzime, ata shpenzojnë për t'u trajnuar.

Të nderuar kolegë,

Minimalisht ata që kanë pak njohuri, e dinë se trajnimet duhen deklaruar, sepse hyjnë te shpenzimet. Kur flasim për fitimin deri në 14 milionë lekë, nuk flasim për të ardhura, por flasim për fitim, që do të thotë se janë ulur të gjitha llojet e shpenzimeve. Po të shikojmë të dhënat që paraqiti ministria më parë, por po ashtu edhe të dhënat që kanë qenë pjesë e tryezës së diskutimeve në Komisionin e Ekonomisë, profesione të tilla shpenzimet nuk i kanë njëlloj si biznesi i vogël. Edhe kalimi në person fizik e ka deformuar tregun, sepse një avokat, i punësuar në një studio dhe një avokat i vetëpunësuar, që ka kaluar në person fizik, e kanë tatimin mbi të ardhurat shumë të ndryshëm: njëri e ka zero, kur është i vetëpunësuar apo ka dalë person fizik, dhe tjetri sipas shkallës progresive. Nëse për ju kjo është e drejtë, unë besoj se për ne si socialistë kjo nuk është e drejtë.

Ne flasim për mjekët, dëgjova të fliste edhe kolegu parafolës dhe, meqenëse është dita sot, patjetër, për mjekët ne kemi bërë shumë ndryshime, jo vetëm që ata të përfitojnë nga të gjitha përjashtimet për pagat e ulëta dhe duke lehtësuar barrën fiskale në pagat më të larta, por, gjithashtu, duke pasur një rritje për çdo mjek specialist me 50 mijë lekë të rinj. Juve ju duket asgjë, patjetër, nëse krahasoni mjekët që punojnë në sistemin publik, me mjekët që punojnë në klinika private, por ato janë biznese dhe do të duhet të tatonen si biznese, nuk tatonen si të vetëpunësuar, nuk tatonen si biznes i vogël. Prandaj ka një normë taksimi më të drejtë, që është përfshirë në këtë projektligj.

Dëgjova shumë shpesh faktin se jemi të padrejtë. Jo, nuk jemi të padrejtë, jemi të drejtë në këtë që po bëjmë, sepse, realisht, çdo gjë që kemi bërë deri më sot, qoftë duke marrë dhe duke ndër marrë reforma shumë të rëndësishme strukturore në ekonomi, por edhe duke tentuar e duke punuar çdo ditë për të ulur evazionin dhe informalitetin, kemi bërë të mundur rritjen e pagave, kemi bërë të mundur indeksimin e pensioneve, do të bëjmë të mundur përsëri rritjen e pensioneve dhe do të vijojmë përsëri me rritjen e pagave. Kjo ecuri ka nisur që në vitin 2013. Deri në vitin 2014 ishte për të kaluar fazën e krizës, në të cilën e latë buxhetin e shtetit (nuk dua të them

faliment, por ishte pothuajse në faliment), më pas vijua më mundësinë për t'i rritur të ardhurat për më shumë mbështetje dhe politika sociale.

Të thuash sot që jemi të padrejtë në këtë tatim, unë besoj se është tërësisht e gabuar, nuk dua të them se është e qëllimshme. Të gjitha bizneset e vogla, nuk janë pak, por janë mbi 97 mijë biznese të vogla, vijojnë të kenë zero tatim deri në vitin 2029. Kjo është shtylla kryesore e ekonomisë shqiptare. Ne dimë që karakterizohemi nga biznese të vogla e të mesme. Nuk e di se si mund të vini këtu e të thoni të pavërteta, sikur kjo nuk është asgjë për 97 mijë biznese, por do të thotë që 97 mijë biznese të kontribuojnë në ekonominë shqiptare, duke konsumuar çdo të ardhur që kanë dhe duke e kaluar përsëri në ekonomi.

Diskutuat pak më parë që norma e përjashtimit deri në 50 mijë lekë nuk është asgjë, por është shumë, sepse, duke e arritur këtë, janë mbi 110 mijë të punësuar që përfitojnë nga përjashtimi deri në 50 mijë lekë, të cilat janë përsëri të ardhura që shkojnë në buxhetin e familjeve shqiptare.

Dëgjova koleget e mia kur folën për pjesën e përjashtimit, ose për uljen nga pjesa e tatimeve deri në 40 mijë lekë në vit për ata që kanë fëmijë nën 18 vjeç, dhe nuk është pak. Ajo çfarë pritet, është që të jenë mbi 200 mijë veta që përfitojnë. Gjithashtu, edhe ata që përfitojnë nga interesat bankare për shkollimin, për arsimimin përsëri janë në numra të konsiderueshëm. Unë nuk e di si merret guximi këtu për të thënë disa të pavërteta, gënjeshtër të vazhdueshme me shpresën se do t'ju mbështesin njerëzit.

Dëgjova pak më parë të thuhej se është rritur ky çmim dhe ky çmim, por dua t'ju them se çmimet janë rritur jo për shkak të asaj çfarë mund të bëjmë ne, sepse aty ku ka dorë qeveria, e ka mbajtur çmimin e energjisë elektrike të parritur për të gjithë abonentët familjarë dhe bizneset e vogla, sepse ata që janë më të prekurit do të ndihmohen. Gjithashtu, qeveria ka ndihmuar për pjesën e rritjes së çmimit të shportës duke bërë indeksimin.

Të nderuar kolegë,

Dëgjuam pak më parë se të gjithë ata që kanë përfituar nga statusi i personit fizik, është shumë të paguajnë 15% mbi 14 milionë fitim dhe 23% mbi 14 milionë fitim, por, të nderuar kolegë, nëse doni të thoni diçka që qëndron, të paktën, lexojini

shifrat siç janë, 23% është për çdo lek që fitohet mbi 14 milionë lekë fitim dhe fitimi vjen pasi janë zbritur të gjitha shpenzimet. Mos dilni këtu të flisni për shpenzimet, sepse po flasim për fitimin. Ndërkohë, flisni për bizneset e mëdha, por bizneset e mëdha kanë 15% tatim fitimin dhe 8% normën e dividendit. Unë nuk e di se ku është favorizimi që i bëhet, absolutisht jo. E kemi bërë këtë diskutim, e kemi rishikuar disa herë bazën tatimore, kemi bërë diskutime dhe debate për pjesën se si duhet të rritet baza tatimore dhe, mbi të gjitha, se çfarë duhet bërë në vijim për t'i mbështetur të gjitha shtrësat në nevojë.

Unë, pavarësisht se çfarë dëgjohej këtu, jo vetëm që jam pro këtyre ndryshimeve, por i mbështes të gjithë ata që mundësitë i kanë më të pakta.

Me keqardhje jua them, kur e formuat Partinë Demokratike, kishit në krye një doktor zemre, tani, më 14 maj, po e mbyllni me doktorë që merren me vdekjen. Të paktën, kolegu që foli më parë, te merret me vënien në gjumë. Qytetarët nuk duan as lindjen, as vdekjen tuaj, por duan të shikojnë këtu të gjithë ata që i kanë votuar, të diskutojmë për alternativat dhe jo për gënjeshtat, duke i zmadhuar me shpresën se dikush i beson dhe i voton.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Fjalën e ka zoti Tritan Shehu.

**Tritan Shehu** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Kam një replikë të shkurtër. Unë nuk dua të hyj në banalitetet e diskutimeve “jo në gjumë, jo zgjuar”, por dua të them këtë: unë nuk thashë që profesionet e lira nuk janë biznese, përkundrazi, thashë që janë biznese të përfaqësuara nga pjesa më intelektuale e vendit. Unë prandaj thashë që po diskriminohet pjesa më intelektuale, sepse tatimi për ata nuk është 0% si për biznesin e vogël, nuk është as 15% si për biznesin tjetër, por vihet një nivel tatimi 23%, diskriminues dhe ndryshe nga bizneset. Pra, kërkohet të goditen bizneset intelektuale, të cilat përfaqësohen nga intelektualët, siç janë mjekët, inxhinierët, arkitektët, juristët, farmacistët, stomatologët e të gjithë me radhë. Ndaj, unë them që këtu kërkohet të goditet klasa intelektuale e Shqipërisë, kërkohet të dekapitohet pjesa më me vlerë e këtij vendi edhe në mënyrën e tatimeve, përveç të tjerave, me

dhunë, me diskriminim, me mungesë të të drejtave dhe me çdo gjë tjetër. Kjo është e vërteta. Duke i konsideruar këto si biznese, duhet të trajtohen si biznese të tjera dhe jo në mënyrë diskriminuese, siç e bëni ju, sepse keni frikë nga intelektualizmi dhe nga vlerat intelektuale të një vendi. Prandaj ju akuzova për otomanizëm, sepse doni të dekapitoni vlerat intelektuale të vendit, t'i varfëroni njerëzit, t'i mbani gjithnjë nën thundër që t'ju puthin dorën, por ky është një koncept mjaft primitiv, shumë larg atyre koncepteve që mund të zhvillohen në këtë vend dhe të mund ta afrojnë këtë vend me Europën dhe Perëndimin. Këtë thashë, nuk thashë që nuk janë biznese, përkundrazi, thashë që janë biznese dhe duhet të trajtohen si të gjitha bizneset e tjera, pa u diskriminuar, sepse janë biznese të realizuara nga intelektualët.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Çelaj.

**Isuf Çelaj** – E nderuara drejtuese e seancës,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Projektligji “Për tatimin mbi të ardhurat” që ka sjellë sot qeveria për miratim në seancë plenare nuk është një rregullim ligjor dhe fiskal, siç pretendon ajo, por një goditje për profesionet e lira, për intelektualët e këtij vendi, si mjekët, avokatët, noterët, kontabilistët, të cilët me shumë mund dhe sakrifica kanë investuar në profesion dhe sot bëjnë biznes apo nesër duan të fillojnë të bëjnë biznes. Një draft antiligjor dhe antikushtetues që, në rast se miratohet, do të ketë pasoja të rënda për këtë kategori dhe më gjerë.

Përpara se të rendis faktet përse ky draft është antikushtetues dhe nuk duhet t'i marrë sot votat tuaja, së pari, Kryeministri të pranojë që u tërhoq nga premtimi i tij për taksën 0 për biznesin e vogël. Ai dhe qeveria e tij kanë premtuar në këtë sallë, dhe jo vetëm, se do ta përjashtonin nga taksat biznesin e vogël. Por çfarë po ndodh sot?! Po takson nga 15%-23% të vetëpunësuarit, që janë një pjesë e biznesit të vogël. Madje, taksimin e profesioneve të lira e keni shtyrë për në janar të vitit të ardhshëm, pasi të përfundojnë zgjedhjet vendore të 14 majit. Kjo qeveri nuk harton ligje fiskale bazuar mbi parime ekonomike, por mbi interesat vetjakë dhe elektorale të momentit. Pasi i përjashtoi nga taksat profesionet e lira dy vjet më parë, sot qeveria po vendos për intelektualët e

këtij vendi, për ata që deklarojnë dhe janë në rregull me detyrimet ndaj shtetit një barrë të rëndë fiskale, jo pak, por një taksë 15% deri në 23% Pse? Sepse, sipas qeverisë, në kuadër të kësaj lehtësie fiskale të bërë dy vjet më parë, janë bërë shmangie fiskale, duke u hapur NIPT-e nga ata që janë të punësuar, me qëllim që të mos paguajnë taksa. Pra, qeveria dhe administrata e saj tatimore pranojnë haptazi dështimin përballë evazionit fiskal. Duke dëshmuar paafësinë për ta luftuar këtë dukuri, qeveria vendosi t'i taksojë të gjitha profesionet e lira. A është e drejtë kjo? A nuk duhej t'i kishte bërë këto llogari qeveria përpara se ta ndërmerre këtë lehtësi fiskale dy vjet më parë? Çfarë qeverie është kjo që harton dhe zbaton ligje fiskale, pa bërë më parë një vlerësim ekonomik dhe ligjor për efektet? Të njëjtën gjë po e bën sot me projektligjin e propozuar, ku profesionet e lira kërkon t'i taksojë 15%-23%. Si është vendosur ky nivel taksimi? Nëpërmjet projektligjit që qeveria ka sjellë sot për miratim, të ardhurat e të vetëpunësuarve trajtohen si të ardhura nga paga, duke i taksuar njësoj, por kjo është antiligjore. Të vetëpunësuarit janë biznese që marrin përsipër rreziqet e tregut. Të vetëpunësuarit nuk kanë të ardhura fikse, si i punësuarit, dhe të ardhurat e tyre nuk mund të quhen të ardhura nga paga. Të vetëpunësuarit nuk kanë përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, si i punësuarit. Të vetëpunësuarit nuk paguhen për ditët e pushimit dhe të festave zyrtare. Të vetëpunësuarit nuk kanë leje të zakonshme. Si mund të tatonen të ardhurat e profesioneve të lira si të ardhura nga paga, kur kanë të tjerë të punësuar? Profesionet e lira punësojnë të tjerë dhe janë biznese, nuk janë të punësuar me pagë, siç i trajton projektligji që sot na kërkohet të miratojmë. Ky është një draft evaziv dhe antiligjor.

Klasifikimi që qeveria u bën profesioneve të lira në këtë projektligj, është i gabuar. Trajtimi i të vetëpunësuarve me tarifa deri në 2 milionë e 40 mijë lekë të rinj në 15% dhe mbi këtë nivel 23% nuk i vendos në kushte të barabarta me bizneset e tjera. Një biznes i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, që mund të fitojë të ardhura deri në 5 milionë lekë, paguan 15% tatimfitimin, ndërsa një i vetëpunësuar për të ardhurat mbi 2 milionë e 40 mijë lekë të rinj, do të paguajë 23%. Qeveria deklaroi se nëpërmjet këtij projektligji do të bëjë barazi fiskale. Për çfarë barazie fiskale flet

qeveria, kur një pjesë e bizneseve të vogla nuk do të paguajnë asnjë taksë deri në vitin 2029, ndërsa profesionet e lira duhet të paguajnë? Për çfarë barazie fiskale flet qeveria, kur oligarkët paguajnë dividendin 8%, ndërsa profesionet e lira 15% deri në 23%?

Qeveria po godet me këtë projektligj shtresën e mesme, atë shtresë që çdo qeveri në botë synon ta zgjerojë dhe ta shëndoshë, pasi mban në këmbë konsumin dhe ekonominë. Por kjo vlen për qeveri të përgjegjshme, jo si qeveria e "Rilindjes" që i ndryshon ligjet disa herë brenda vitit, duke krijuar çoroditje të biznesi për një interes të momentit.

Drafti juaj është një kampanë alarmi, pasi, nëse miratohet, do të çojë në mbylljen e mijëra NIPT-ve. E thënë ndryshe, këta profesionistë të lirë nga 1 janari i vitit të ardhshëm do t'i mbyllin bizneset e tyre dhe bashkë me to do të shkurtojnë edhe vendet e punës që kanë hapur. Këta profesionistë të lirë do të detyrohen të emigrojnë, pasi nuk do të kenë me se të jetojnë në Shqipëri. Do të emigrojnë pjesa e shkolluar e popullsisë, ajo që ka investuar në profesion, dije dhe eksperiencë profesionale, duke i shkaktuar një dëm të pallogaritshëm tregut të punës dhe ekonomisë së vendit. Do t'i mbyllin dyert e zyrave të tyre, pasi, nga një përlllogaritje e përafërt, shteti do t'u marrë atyre vitin që vjen nga rritja e taksës nga 15% në 23% një shumë mbi 20 milionë euro, shumë kjo e mjaftueshme që këto kategori të përmirësojnë shërbimin ndaj qytetarëve, duke mos bërë rritje të tarifave, të cilat do të rëndojnë xhepat e qytetarëve shqiptarë.

Kukësi, Hasi dhe Tropoja janë ndër zonat më të varfra të Shqipërisë. Ky qark ka një nivel të lartë shpopullimi dhe nivelin më të lartë të varfërisë në vend. Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave, vitin e kaluar popullsia e Kukësit u tkurr me 2,4%. Ky projektligj që qeveria sjell sot për miratim, do t'i detyrojë profesionistët e lirë, ata pak që ende kanë mbetur në këto zona, që t'i mbyllin bizneset dhe të largohen. Duke qenë se, siç thashë edhe më lart, ky projektligj është antikushitetues, Partia Demokratike në bashkëpunim me kontabilistët, avokatët, mjekët, noterët, stomatologët e të tjerë do ta dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese, pasi krijon pabarazi dhe diskriminim për këto profesione!

Qeveria "Rama" po nxit zbrazjen e mëtejshme të këtyre zonave, teksa në asnjë

moment, që prej vitit 2013 kur erdhi në pushtet, nuk mendoi për Kukësin, Hasin dhe Tropojën apo shumë zona të tjera që po braktisen çdo ditë nga njerëzit, pasi u është vrarë shpresa. Por Kryeministri ynë nuk ka kohë, as dëshirë të thellohet në analiza të tilla. Në fakt, ka të tjera halle. Ka hallin e zgjedhjeve të 14 majit, pasi e kanë zënë ethet e dështimit. Për këtë arsye ka hapur thesin e premtimeve dhe të karameleve elektorale; për këtë arsye rriti pagën minimale në 40 mijë lekë, duke ua shitur shqiptarëve se qeveria mendon për ta, kur rritja e pagës minimale është taksë mbi biznesin; për këtë arsye premtoi bonus 5 mijë lekë për pensionistët, kur ka mbledhur miliona euro si TVSH nga rritja e çmimeve. Këto para shqiptarët i kanë paguar në çdo produkt që e kanë blerë më shtrenjtë, por ai nuk ua ka shpërndanë atyre, por po ua premtton me pikatore një muaj e gjysmë para zgjedhjeve; për këtë arsye premtoi rritje të pagës mesatare në sektorin publik në 900 euro, por nuk tregoi se ku do të gjenden paratë. Nuk tregoi se, nëse kjo ndodh, shqiptarët i pret rritja e taksave, siç po kërkon ta bëjë sot me profesionet e lira dhe intelektualët e këtij vendi. Në shumë institucione po zhvillohen sot tenderë me flamur të kuq, pa garë dhe me fond limit, në një kohë kur të gjitha këto veprime janë të ndaluara me ligj 4 muaj përpara zgjedhjeve. Të njëjtën gjë po bëjnë edhe të emëruarit e “Rilindjes” në Kukës, Has dhe Tropojë duke shpallur procedura tenderësh, edhe pse nuk kanë financime për ta, duke shtuar numrin e punonjësve në ndërmarrjet e bashkive, si dhe të atyre institucioneve që varen nga qeverisja qendrore, si OSHEE-ja, spitalet e të tjera. Më presionin që po u bëhet atyre pak bizneseve, të cilat kanë mbetur akoma pa u mbyllur në këto zona, biznese të cilat i kanë zhvilluar me shumë sakrificë, ata po i terrorizojnë në këmbim të votave për kandidatët e “Rilindjes”. Po ashtu, ata kanë hapur thesin e premtimeve, të cilat nuk janë gjë tjetër veçse gënjeshtër elektorale, pasi aty ishin katër vjet, dhe tani kujtohen të propagandojnë projekte e sistemime në punë, por qytetarët kuksianë, hasjanë dhe tropojanë janë aq të zgjuar, sa të mos bien pre e këtyre mashtrimeve, të cilat kanë regjinë e Kryeministrit nga Tirana. Ata do t’ju ndëshkojnë me votë më 14 maj, duke u ndarë njëherë e mirë nga modeli juaj që në thelb ka abuzimet dhe korrupsionin me fondet e taksat e tyre!

Të gjitha këta janë tregues se “Rilindja” është në alarm dhe ethet e humbjes së zgjedhjeve të 14 majit e kanë kapluar.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Çelaj!

Fjalën e ka zoti Braçe.

Të përgatiten zonja Ina Zhupa dhe zoti Taulant Balla.

**Erion Braçe** – Të them të drejtën, i ndoqa me shumë vëmendje dy kolegët nga opozita, ata që folën më herët në radhë. Sinqerisht, më bën përshtypje që për mjekët në sektorin publik nuk flet kush për tatimin, për të njëjtin mjek në sektorin privat këtu bëhet nami. Natyrisht, ka një periudhë shumë të gjatë kohore që sektori publik shikohet me një sy komplet ndryshe nga sektori privat, veçanërisht sektori publik i shërbimeve dhe më veçanërisht, sektori publik i shëndetësisë. Pra, bëhet fjalë për të njëjtët njerëz që punojnë edhe në sektorin publik, edhe në sektorin privat. Megjithatë, kjo është një gjë, të cilët do të mundohem ta sqaroj më pas.

Në fakt, unë kam ardhur të flas për disa elemente të këtij ligji, për të cilat pa diskutim jam pro dhe për disa elemente të tjera të këtij ligji, për të cilat kam edhe kundërshtimet e mia.

Së pari, dhe, mbi të gjitha, jam këtu pikërisht për lehtësimin shumë të madh tatimor që u bëhet punëtorëve. Të ardhurat e atyre që sot paguhen nga 400-500 mijë lekë të vjetër do të taten me 0%. Natyrisht, ky është një lajm i mirë për të gjithë ata punëtorë që militojnë në sektorët publikë ape edhe në sektorët privatë, në çdo degë të ekonomisë kombëtare.

Së dyti, për ata që janë përsëri punëtorë, por që janë në fashën nga 500-600 mijë lekë, të cilët marrin një lehtësim tatimor, e cila, pa diskutim, është një gjë e mirë për të ardhurat e tyre nga puna.

Së treti, kam ardhur pikërisht për të konfirmuar edhe një herë atë që ndodh me biznesin vogël, që do të vazhdojë të jetë me tatim zero mbi fitimet e tij deri në vitin 2029, dhe kjo nuk cenohet.

Së katërti, kam ardhur për atë konfirmim që bëhet edhe më tutje në këtë ligj që të gjithë bujqit, si njësi ekonomike më vete apo edhe të bërë bashkë, do të paguajnë zero lekë tatim mbi të ardhurat e tyre.

Pak më herët e dëgjova me shumë vëmendje zotin Sula (dhe e çmoj, sepse është një njeri që



lëviz në territor e merr kontakt me bujqit), por të gjitha ato që listoi si taksa, janë thjesht tarifa vendore, pa të cilat nuk mund të funksionojë as bashkia, as njësia administrative. Pa diskutim, një pjesë e tyre janë tarifa vendore si zëra, por paguhen vetëm për ato shërbime që merren, prandaj e sfidova të tregojë faturën e tarifave vendore që i shkon çdo bujku atje ku është. Është e rëndësishme që bujku deri në 140 milionë lekë të ardhura vjetore do të paguajë zero lekë tatim. Kjo është e rëndësishme, dhe këtë duhet ta dëgjojnë të gjithë. Çfarë është detyrë për ne?! Detyrë për ne është një tjetër hall shumë i madh që, pavarësisht se bujqit po punojnë dhe po arkëtojnë para, edhe falë rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, në eksporte, apo të rritjes së çmimeve brenda vendit, nuk kanë asnjë lloj mundësie që sot t'i depozitojnë paratë nga puna dhe prodhimi i tyre në sistemin bankar. Ky është një problem i madh, sepse një bujk që shkon e paraqitet atje me 10 milionë lekë, me 20 milionë lekë nga cikli i prodhimit, me 30 milionë lekë, sepse ka edhe bujq që kanë rritur shpërfaqjen dhe kanë 40 milionë lekë në vit të ardhura, në momentin që paraqiten atje, hyjnë në ato rregullat e famshme të pastrimit të parave, sepse nuk i justifikojnë dot me fatura të ardhurat e tyre. Këtu ia vlen që ta përsëris kërkesën, zonja Ministre, që, sa më parë që të jetë e mundur, sektori i bujqësisë të hyjë brenda sistemit të fiskalizimit realisht, jo në letra, sepse ja ku është sikleti: me një hektar serrë, po jua them unë me tri cikle prodhimi, i arrin 10 milionë lekë të rinj të ardhura në fund të vitit, por këto para nuk mund të mbahen në shtëpi, sepse ky është një hall që po shtohet në të gjitha zonat rurale që kanë bujqësi intensive serrash, por edhe në fusha.

Së katërti, pa diskutim që erdha këtu për evazionin fiskal, të cilin dua ta detajoj: nga 109 mijë tatimpagues aktivë, mbi 50 mijë ose 46% janë në fushën e shërbimeve sot që flasim. Në vitet e fundit, në mënyrë që të përfitojnë nga tatimi 0% për biznesin e vogël, ritmi i regjistrimit të subjekteve të reja në fushën e shërbimeve profesionale dhe largimet nga listëpagesat janë rritur shumë.

Së pesti, tatimpaguesit po shmangin tatimin, duke kaluar nga ofrimi i shërbimeve si i punësuar, ku aplikohet tatimi progresiv 0%, 13% dhe 23% për çdo lekë mbi dyshemenë e vendosur, në ofrimin e shërbimeve si i vetëpunësuar, ku norma

e tatimit është 0% për të ardhurat deri në 14 milionë lekë, sepse nga 100 miliardë lekë, që është fitimi neto i deklaruar nga subjektet deri në 14 milionë, që e kanë tatimin zero, 54 miliardë lekë ose 54% e këtij fitimi realizohet nga furnizuesit e shërbimeve. Këtu më lejoni t'ju them se 54 miliardë lekë ose 540 milionë dollarë nuk janë më rroga, dhe këtë doja t'ia thosha zotit Shehu, janë ekzaktësisht fitime dhe fitimet nuk mund të taten siç taten rroga.

Për të vijuar më tej: është shkelur parimi i neutralitetit, ku 1 i punësuar dhe 20 të punësuar, të cilët bëjnë të njëjtën punë, kanë diferencim të papranueshëm të barrës fiskale, i pari 0% dhe i dyti 13% dhe 23% tatimi mbi të ardhurat. Pra, në këtë segment të ekonomisë, në këtë segment të sipërmarrjes ka evazion fiskal që krijon pabarazi. Në qoftë se e mora pak më herët shembullin, por e ripërsëris, një mjek që punon në sektorin publik (punon në të gjitha qendrat shëndetësore apo në qendrën spitalore universitare) i nënshtrohet për të ardhurat e tij atje tatimit progresiv mbi të ardhurat, pra nuk mundet që i njëjti mjek për të njëjtat shërbime, që ofron në sektorin privat, të paguajë zero lekë tatim. Edhe brenda sektorit privat një mjek, që është i punësuar brenda një klinike, nuk mundet të paguajë tatim progresiv mbi të ardhurat brenda asaj klinike, ndërkohë që dikush tjetër, i cili është përsëri po brenda asaj klinike, por në letra shkruhet si ofruer shërbimi brenda asaj klinike, të paguajë zero lekë tatim. Nuk shkon, është e padrejtë, është e pabarabartë, dhe këtu vij te konteksti flagrant që kam. I gjithë sistemi ynë tatimor ndjek pas statusin juridik: të vetëpunësuar, person fizik, person juridik, shoqëri tregtare e kështu me radhë, ndërkohë që sistemi fiskal duhet të ndjekë pas parane, duhet të tatonë parane, nuk mund të tatonë statusin juridik. Akoma më keq, nuk mundet që sistemi ynë të tatonë degën e asaj ekonomie që prodhon të ardhura. Nga se vjen kjo?! Vjen nga fakti që ne duam t'ua bëjmë të lehtë punën tatimorëve, organeve fiskale. Ne nuk duam t'i grumbullojmë të ardhurat atje ku janë, por ne duam t'ua bëjmë punonjësve të shtetit sa më të lehtë grumbullimin e të ardhurave. Ne duam ta bëjmë lehtësisht planin. Ne nuk duam ta bëjmë planin e të ardhurave duke u qëndruar mbi kokë atyre sektorëve dhe të ardhurave që krijohen nga këta sektorë. Ky është një problem shumë i madh. Pa diskutim, kjo lidhet me qeverinë edhe në atë

sektor. Pa diskutim që qeveria duhet përmirësuar, përndryshe do të biem në një element që nuk vlen: në atë pabarazinë që nuk duhet të vijë nga politikat fiskale apo nga mënyra se si ushtrohen politikat fiskale, si ekzekutohen politikat fiskale. Natyrisht shtresëzimi i shoqërisë duhet të vijë nga merita, nga aftësia e gjithkujt për të punuar dhe për të siguruar para me dije dhe me përkushtim në punën e tij, jo thjesht dhe vetëm nga ajo që ne bëjmë fiskalisht apo që ne bëjmë fiskalisht përmes korrupsionit. Ky është një problem shumë i madh.

Së fundi, pa diskutim që këtu mund të sillen për progresivitet vazhdimisht të gjitha këto, pra për të cilat mund të thuhet se janë progresive apo që kemi vendosur tatim progresiv dhe në disa sh.a, ama atje ku kapitali është thujtë i vdekur, ne nuk kemi tatim progresiv, por kemi tatim regresiv. E kam thënë edhe një herë: kjo llogaria që bëhet këtu që te korporatat e mëdha ne kemi 15% tatim mbi fitimin dhe pastaj 8% tatim mbi dividendin, nuk vlen, sepse, në fund të fundit, unë jam thjesht një aksioner brenda një korporate dhe si aksioner nuk marr asgjë tjetër nga aksionet e mia brenda përveçse dividendin e marr dhe e përdor për vanitet, e bëj makinë...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Kështu është, Bujar, ke shumë të drejtë, sepse je i djathtë, por kjo që ka ndodhur, nuk është e djathtë. Prandaj po them se duhet të përqendrohemi te paratë e vanitetit për të marrë të ardhura, te paratë që janë mburrje e gjithkujt për të dalë në një listë atje si më i pasuri i Shqipërisë, si më i bukuri i Shqipërisë e kështu e radhë; te fëmija që nuk i përdor ato para për shkollë, por për t'u mburrur rrugëve të Tiranës me makina të shtrenjta e më pas në det dhe me jahte; te paraja që nuk investohet për t'u kthyer në të mirë publike për të gjithë, jo thjesht për biznes...

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, përfundojeni!

**Erion Braçe** – ... jo thjesht për të pasurit, por që investohen për t'u kthyer në punë për mijëra të tjerë, si mundësi që shoqëria ka krijuar edhe për këta.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Zhupa.

Të përgatitet zoti Balla.

**Ina Zhupa** – Faleminderit, e nderuar!

Së pari, dua ta nis fjalën time duke dënuar ashpër dhunën ndaj gazetares Odeta Gjevori dhe

operatorit Igli Zela të emisionit investigativ “Stop” në televizionin “Klan”, të cilët për shkak të funksionit të tyre dhe për shkak të punës së tyre për raportimin e së vërtetës janë vënë përballë goditjeve dhe dhunës së ushtruar nga ata që denonconin. Mendoj se ky parlament, duke qenë se të hënën e kësaj jave prezantova në Komisionin e Ligjeve ndryshime në Kodin Penal pikërisht për të rritur dënimin dhe për ta ashpërsuar Kodin Penal për ata që godasin punonjësit e medias, gazetarët, fotoreporterët dhe operatorët, që janë në krye të detyrës për shkak të funksionit të tyre, duhet të reagojë dhe të mos e lërë në sirtarët e tij. Pra, ne duhet të jemi proaktivë si parlament për ta adresuar këtë problematikë.

Sigurisht, në këtë rast u bëj thirrje organeve ligjzbatuese që të japin dënimin më të rëndë dhe të mos e kalojnë me moskokëçarje, si një konflikt banal apo si një konflikt i momentit, sepse të dy janë sulmuar për shkak të profesionit, duke kërkuar të vërtetën për interesin publik.

Sot diskutojmë një projektligj, i cili, në fakt, nuk është surprizë. Këtë e kemi cekur kur diskutonim paketën fiskale dhe projektbuxhetin, sepse ishte e pritshme dhe dallohej se do të vinte momenti që do të miratohej. Janë 20 milionë euro që parashikohen të merren nga xhepat e shtresës së mesme, 20 milionë euro që u merren 17 mijë profesionistëve të lirë në këtë vend, të cilët për shtetin nuk janë asgjë më shumë sesa 1 kilometër rrugë e vjedhur, ndërsa për profesionistët e lirë, për dentistin, për mjekun, për laborantin, për noterin, për avokatin janë shumë, janë para më të cilat mbajnë familjen. E them me përgjegjësi të plotë, ndryshe nga bizneset e tjera të vogla, të cilat mund t'i iniciojë çdokush me pak iniciativë personale për të hapur një dyqan lageje, për të hapur një shërbim të caktuar, që këto profesione nuk mund t'i ushtrojë çdokush, sepse kanë nga mbrapa një kosto të jashtëzakonshme, të cilën ju nuk e llogarisni, koston e shkollimit në profesione shumë të vështira, të cilat kanë interes të lartë publik. Këtë kosto ju nuk e merrni parasysh kur flisni për një doktor, kur flisni për një noter, kur flisni për një dentist, të cilët janë aty falë mundit dhe profesionit të tyre, të cilët me paratë e tyre, sepse kanë punuar me vite jetë, kanë investuar në klinikat e tyre private apo në njësitë e tyre të shërbimit, por ju doni vetëm e vetëm ta godisni shtresën e mesme, ta godisni qytetarin, t'i merrni atij çdolloj fitimi për ta çuar në buxhetin e shtetit,

ku, në fakt, fillon edhe drama e dytë: mospërdorimi i tyre qoftë për shtresën në nevojë, qoftë për politika sociale, por përdorimi i tyre për vjedhje. Edhe një herë jua them: 20 milionë euro për ju janë 1 kilometër rrugë e vjedhur.

Në politikat tuaja antiqytetare dua sot të denoncoj vjedhjen, masakrimin që ju doni t'i bëni konceptit të pronës private, në kujtim edhe të metodave të partisë mëmë nga e cila vini, të Partisë Komuniste, e cila nuk e njihte pronën private dhe i kishte zët pronarët që kishin pronë private.

Projektvendimi që ka qeveria për auditimin, me pretekstin e auditimit teknik të banesave 50-vjeçare, nuk është gjë tjetër veçse një projektvendim antikushtetues për interesin e marrjes dhe të përvetësimit të truallit të tokave në mes të pozicioneve, ku duan të ndërtojnë klientët e pushtetit. Auditim teknik nga shteti, auditim teknik për të vendosur nëse do të shemben apo jo, ku pronari i ligjshëm nuk ka asnjë rol as në procesin e auditimit, as në procesin e negocimit me palët e treta në rast se do të rindërtohet. Ky është shpronësimi i ri i metodës së vitit 2023, ku pronarëve u hiqet e drejta e tyre për pronën private, në shkelje flagrante të nenit 41 dhe të nenit 42 të Kushtetutës, që thotë: “E drejta e pronës private është e garantuar dhe prona fitohet me dhurim, trashëgimi, blerje dhe çdo mënyrë tjetër.” Nuk fitohet prona duke ia marrë shteti pronarit të ligjshëm dhe duke ia dhënë një ndërtuesi, dhe pronari i ligjshëm të degdiset, ose të marrë një vlerë, aq sa e vendos shteti, ose, ashtu siç po bëjnë me qytetarët e Kombinatit, që i çojnë të jetojnë në një vend tjetër, të cilin zgjedh shteti.

Kjo është metoda e re e vjedhjes së pronës private, e kolektivizimit, e kooperativizimit, të cilat nuk kanë asgjë të përbashkët me shtetin e së drejtës, me mbrojtjen dhe me liritë kushtetuese që duhet të ketë individit. Ky është plan juaj për t'i marrë çdo qytetari edhe sigurinë juridike të pronës private dhe për ta bërë që të ikë nga sytë këmbët nga Shqipëria.

Në rast se ligji e parashikon, institucionet shtetërore mund të shikojnë për interes publik sesi janë ndërtuar banesat, por kurrësi të zëvendësojnë rolin e pronarit në marrëdhënien me palët e treta, në vendimmarrjen për banesën e tij apo në vendimmarrjen se çfarë do t'i ndodhë banesës së tij më vonë. Ky projektvendim është

thjesht, i thënë me fjalë të tjera: vëri syrin një pallati, shpalle të degraduar, jepja ndërtuesit që do, ndërtuesi të ndërtojë atje kullat që do, në bashkëpronësi me këta këtu, që do të japin firmat, dhe pronari i ligjshëm, ai që e ka ndërtuar me djersë, ai që e ka ndërtuar me mund, të mos marrë asgjë ose, edhe kur të marrë, të marrë dëmshpërblim sipas asaj që vendosni ju; në fund të degdiset të jetojë në periferi apo në rrethina ku e doni ju, ku e vendos shteti që të jetojë, si në vitet e komunizmit që e vendoste shteti se ku do të jetonte qytetari.

Mos thoni që nuk është kështu, sepse është skenar i nisur sot në zonën e Kombinatit, ku shembet banesa në mes të Kombinatit, e cila është e rregullt, dhe shpallet e parregullt nga ju dhe banorët çohen të jetojnë jo atje ku do të ndërtohet përsëri, por në një zonë tjetër, në një cep tjetër të Kombinatit apo të fshatrave përreth, dhe mos thoni që nuk është e vërtetë, sepse, duke vendosur një kufi 50-vjeçar, që sot është viti 1973, vitin tjetër është '74-tra, vitin më pas është '75-sa, të gjithë qytetarët duhet ta dinë që janë të rrezikuar.

Të nderur qytetarë,

Nëse pronës suaj ia vë syrin një oligark, ai bashkëpunon me shtetin dhe të dy bashkë vijnë dhe jua marrin, i vendosin kryqin e kuq dhe ju thonë: kjo pronë do të shembet, sepse përbën rrezik. Ndërkohë, ju, të nderuar qytetarë, nuk keni asnjë të drejtë për auditim alternativ, nuk keni asnjë të drejtë gjyqësore, nuk keni asnjë të drejtë të kërkonit negociim me palën ndërtuese për të marrë pronën tuaj dhe pjesë nga trualli juaj në ndërtimin e ri që do të bëhet atje.

Ky vend ka ligje. Trualli i një pallati është në bashkëpronësi me të gjithë pronarët e atij pallati dhe shteti nuk mund ta marrë si truall privat për t'ia vënë në dispozicion një privati tjetër (negociatat që bën shteti me privatit), por duhet të jetë vetë pronari që, nëse do të ndërtohet aty, nëse ndien rrezik apo çdo ndryshim të dëshirave të tij për të ndërtuar aty, të negociojë me privatit tjetër. Nuk është parë kjo gjë, ky është një vendim që shkon kundër interesave të qytetarëve, kryesisht atyre që jetojnë në zonat me çmimet më të larta preferenciale, kryesisht të qyteteve kryesore, si: Tirana, Durrësi, Saranda, Vlora, ku i kanë shtrirë sytë oligarkët dhe mendojnë se duhet të gjejnë sheshe të reja ndërtimi, sepse edhe sheshet e ndërtimit sot janë ato që janë, për shkak

se janë mbushur me kulla dhe me ndërtime. Metoda e re është: vidhi pronën qytetarit, ndërto aty dhe degdisë qytetarin në një vend tjetër, pa konsensusin e tij.

Unë do t'i ndjek deri në fund këto raste dhe do t'i denoncoj fort. Ju nuk mund t'i bini me shkëlqim pronës private, ju nuk mund të shkatërroni shtresën e mesme të këtij vendi dhe nuk mund të bëni politika, që në thelb nuk janë asgjë tjetër veçse politika antishqiptare.

Shumë faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Zhupa!

Zoti Balla keni fjalën.

**Taulant Balla** – Shpeshherë ndiej keqardhje për shumë kolegë të opozitës që e marrin fjalën në Kuvend dhe, për shkak të pozicionit që kanë, për shkak të detyrës, që duhet të jenë gjithmonë kundër gjithçkaje që bën qeveria, e humbasin edhe atë kontaktin njerëzor, human me ata që na kanë votuar për të ardhur në këtë sallë.

Ne duhet t'i themi disa gjëra, që rezonojnë me qytetarët. Unë jua kam thënë para disa ditëve dhe po jua përsëris, një pjesë e madhe jona vijmë nga besimi islam dhe të paktën këtë muaj është mirë të mos gënjeni; është mirë t'i themi disa gjëra ashtu siç janë...

*(Ndërhyrje nga salla)*

Do të dal edhe aty.

Nuk po keqpërdor, përkundrazi, meqenëse e përmenda, ka një citat të shenjtë profetik, e dashur Flutura, që thotë: “Jepi atë që i takon punëtorit, përpara se t'i thahet djersja e mundimit”.

Në fjalën time dua të ndaj me ju pikërisht një përpjekje, që duhet ta bëjmë të gjithë, edhe ne këndeje, edhe ju andej; një përpjekje që e ka nisur Kryeministri dhe që duhet ta vazhdojmë të gjithë, që të komunikojmë sa të kemi mundësi me biznesin, jo vetëm për shkak të detyrimit që ka hyrja në fuqi më 1 prill e vendimit që paga minimale bazë të jetë 400 mijë lekë të vjetër, gjë që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik, fizik, vendas apo i huaj, por ne duhet të flasim me të gjithë, sepse e vërteta është që në këtë vend pagat reale janë më të larta se ato që deklarohen. Nëse unë do të isha në opozitë, pra, po të isha në vendin tuaj sot, do të kisha shumë për të thënë për këtë çështje, por ju e keni humbur rrugën dhe nuk dini të flisni për gjëra që kanë qejf t'i dëgjojnë qytetarët.

Ne të gjithë e dimë se janë qindra e mijëra të punësuar që marrin rrogë shumë herë më të lartë, por, në fakt, në bordero rezultojnë me rrogë minimale, duke kompromentuar atë ciklin e plotë ekonomik, që lidhet me sigurimet shoqërore. Paguajnë një normë të sigurimeve shoqërore shumë të ulët me idenë se po jetojnë mirë sot, po marrin disa para më shumë sot.

Në lidhje me 400-mijëlekëshin e pagës minimale, jam shumë krenar të them se qeveria jonë ka ditur të solidarizohet apo të mbështesë pikë së pari bizneset, mbi të cilat bie kostoja shtesë e sigurimeve nga rritja e pagës. Unë dua t'i them çdo biznesi, kryesisht këtyre që preken nga këto paga, se qeveria do të paguajë të gjithë diferencën e sigurimeve shoqërore, pra do t'i rritet rroga punëmarrësit, por punëdhënësi do të mbështetet nga qeveria.

Po ashtu, jam shumë i kënaqur dhe këtë nuk e fsheh, duke qenë se jam drejtues politik i PS-së në qarkun e Fierit, ku kemi trashëguar një bombë të madhe sociale me një privatizim të korruptuar të rafinerisë së Ballshit (dhe është vërtet), që kjo qeveri edhe në kushtet e impaktit negativ që ka sjellë lufta e Putinit, edhe 6 muaj të tjerë ka siguruar që çdo ish-punonjës i rafinerisë së Ballshit ta marrë 400-mijëlekëshin si pagë. Kjo është qeveri e majtë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kemi shtuar.

Meqenëse ju, zonja Tabaku, kishit marrë mundimin të merreshit edhe me gjërat që ndodhin në Shqipëri dhe na akuzuat ne për tatimin socialist, ai që ta ka thënë, ka dashur të ta hedhë. Shumë faleminderit që e quan tatim socialist! Po, po, tatim socialist është, sepse prirja jonë prej ditës së parë, kur kemi marrë përgjegjësinë për të qeverisur vendin, është e qartë: paguajnë më shumë taksa ata që fitojnë më shumë dhe paguajnë shumë pak taksa ose aspak, ata që fitojnë më pak. Kjo është e thjeshtë, është socialiste, Joridë! Nuk është turp të jesh socialist, përkundrazi është krenari, sepse mendon për ata që fitojnë më pak, që paguhen më pak.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ty nuk të përgjigjem, sepse ti je e paedukatë! Ti je komplet e paedukatë, sepse nuk mund t'i thuash tjetrit duke folur: këta këtu janë hajdutë! Ti qenke e ndershme! Je e paedukatë! Po të tërheq vëmendjen, nëse do të bësh politikë, se

je edhe gocë e re! Këtyre këtu t'u vish anës, këtyre kënde!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Sa për qeverinë tonë, dua të ndaj me të gjithë qytetarë lajmin: po, ne do t'i rritim pagat. 900 euro do të jetë paga mesatare për ekonominë shqiptare në muajt në vijim. Ne synojmë që për 10-15 ditë, ndoshta këtu në Kuvend apo sipas planit që do të përcaktojë Kryeministri, të prezantojmë një plan të madh kombëtar për pagat, në mënyrë që çdo punonjës në Shqipëri të marrë atë pagë që natyrshëm ka sot fuqinë, kapacitetin ta paguajë ekonomia shqiptare. Ka ndodhur, nuk është se do të ndodhë, që prej 1 marsit ushtarakëve u janë rritur pagat me 7%; i qëndrojmë angazhimit tonë për të rritur me 7% pagat për mjekët dhe infermierët, sikurse ka filluar pagesa e shtesës prej 500 mijë lekësh për çdo mjek specialist.

Tani, meqë Mond Spaho nuk është këtu, dua t'ju them se në vitin 2013, kur Mond Spaho dhe Sali Berisha ishin në pushtet, 500 mijë lekë merrte mjeku specialist rrogë; sot është vetëm shtesa me një ngritje. 500 mijë lekë merrte një mjek specialist në buxhetin e votuar për herë të fundit, ndërsa tani 500 mijë është vetëm shtesa, që të jemi korrektë; meqë Mond Spaho thoshte se rrogat kanë qenë më të larta kur ata ishin në qeverisje të vendit. Po ashtu dua t'ju them se edhe kategori të tjera do të kenë rritje.

Në fund, si qershia mbi tortë, nuk e fshehim aspak, ne, pensionistët i duam shumë. Janë ajo shtesë që ka hequr mbi kurriz të gjitha problematikat dhe të gjitha hallet e këtij tranzicioni të tejzgjatur. Puna na ka krijuar mundësinë që të njohim njerëz të ndryshëm, kemi njohur nga ata që rrinin dhe luftonin dyerve të gjykatave për të marrë pensionin dhe kur u dilte vendimi i gjykatës, nuk kishin çfarë e donin më, sepse kishin ndërruar jetë. Ne do të vazhdojmë t'i mbështesim pensionistët, natyrshëm do të ketë përsëri një shpërblim nga taksa e veçantë që kemi aplikuar për ata që fituan më shumë nga lufta. Me shpresë të Zotit dhe me punë të mirë, siç e ka kjo qeveri, ne do të kemi mundësi që të ofrojmë edhe një shpërblim tjetër për pensionistët! Gjërat kanë ardhur mbarë, sepse në tri javët në vijim i kemi të gjitha: edhe Pashkën Ortodokse, edhe Pashkën Katolike, edhe Bajramin, pastaj do të jetë edhe Dita e Punëtorëve, 1 Maji. Kështu që, festa paçin shqiptarët gjithmonë!

Ne do të vazhdojmë të qeverisim për ta; për llafe ju kemi ju, që nuk jua del askush!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Balla!

Zonja Tabaku, keni fjalën.

**Jorida Tabaku** – Për zotin Balla dhe për të gjithë ata që kishin pyetje se çfarë është tatimi socialist: tatimi socialist është ai 23%-shi, që taton shtresën e mesme; tatimi socialist janë ata 17 mijë profesionistët, që do të paguajnë 20 milionë euro shtesë; tatimi socialist janë të gjitha bizneset e vogla, që futen në skemë; tatimi socialist është rritja e pagës minimale, që po rrit pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; tatimi socialist është ai që i jep 8% dividendit, por 23% taton punën; ai është tatimi socialist. Një parti e majtë, që nuk njeh dhe nuk vlerëson punën, vetëm ju jeni dhe vetëm ju qofshi!

Për atë 50-mijëlekëshin, mëshirën e radhës, që do t'ju jepni pensionistëve, mendoni se po bëni ndonjë nder të madh që po u jepni 50 mijë lekë, që, në fakt, janë 5 mijë lekë, një muaj para zgjedhjeve?! Kujtoni se po u bëni ndonjë nder të madh pensionistëve, të cilët do të shtyhen nëpër radha për të marrë atë 5 mijë lekësh?! Këtë e bëni për t'u kërkuar votën. Ju kujtoheni për ta sa herë që keni nevojë, ndërkohë që 665 mijë pensionistë janë në mëshirë të fatit çdo ditë, nga rritja e çmimeve, nga rritja e çmimit të karburantit, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike, nga rritja e çdo takse dhe tarife tjetër. Ky është tatimi socialist, tatimi më i padrejtë që ka pasur ndonjëherë në 32 vjet Shqipëria. Të jesh krenar se po largon e zbon shtresën e mesme nga vendi, vetëm këta qofshin!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Koliqi.

**Emilja Koliqi** – Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Është e çuditshme se si Ministria e Financave, kur harton ligje apo ndryshime ligjore që kanë lidhje me taksat, gjithmonë ka për qëllim vështirësimin e punës së biznesit. Qeveria nuk harton ligje të thjeshta, të lehta në implementim, por ligje që penalizojnë qytetarët shqiptarë si individë, persona fizikë apo entitet, në kundërshtim me ato që ka përsëritur FMN-ja edhe në janar të këtij viti, ku theksonte "Ndërtimi i një sistemi tatimor më të drejtë, më efikas, më të thjeshtë dhe më transparent mund ta bëjë Shqipërinë më tërheqëse për investimet e huaja,

ndërkohë që do të fuqizojë aktivitetin e brendshëm ekonomik, duke futur stimujt e duhur ekonomikë dhe duke u përballur me nivelin e lartë të informalitetit”.

Pas depozitimit në parlament të këtij projektligji, që në fillim të muajit dhjetor të 2022-shit, grupet e interesit, si me shkresa dhe në dëgjesa, shprehën vërejtje nga më të ndryshmet. Këtu përfshihen: Dhoma Amerikane e Tregtisë, institucionet e parasë elektronike, Shoqata Shqiptare e Bankave, Instituti i Kontabilistëve të Miratuar, rrjeti shqiptar i profesionisteve “ALTAX” dhe profesionistët të ndryshëm, duke filluar që nga termat ligjorë e deri tek teknikalitetet. Megjithëse këto grupe interesi kishin paraqitur vërejtje edhe gjatë fazës së konsultimit publik të projektligjit, ato nuk ishin marrë parasysh.

Ligji ishte i gjithi për rishikim, sepse ai transmetonte një mungesë të theksuar të profesionalizmit, harmonizimit të termave ligjore dhe të standardeve të kontabilitetit. Dhoma Amerikane shprehej se ligji duhej të parashikonte ristrukturimin e sistemit tatimor, me synim formalizimin e ekonomisë, trajtimin e barabartë të tatimpaguesve, pavarësisht statusit të tyre ligjor të regjistrimit, si dhe të harmonizohej me standardet ndërkombëtare dhe kombëtare të kontabilitetit.

Pas ripunimit të ligjit, përsëri në fillim të marsit, Dhoma Amerikane e Tregtisë, në një shkresë drejtuar Komisionit të Ekonomisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shprehet: “Projektligji nuk është ende në formë përfundimtare për t’u miratuar në Kuvend, pasi nuk reflekton rekomandimet e grupeve të interesit. Përmirësimet që mund të bëhen gjatë shqyrtimit në komision nuk mund të mënjanojnë problematikën e mëdha të këtij projektligji”. Projektligji nuk iu kthye nismëtarit, por, përkundrazi, vazhdoi rrugën e miratimit me shpejtësi, pa kaluar as në Komisionin e Ligjeve dhe pa u konsultuar me grupet e interesit.

Instituti i Kontabilistëve të Miratuar dhe Instituti i Ekspertëve të Kontabilistëve të Autorizuar kërkuan zhvillimin e një seance dëgjimore pas rishikimit të ligjit. Për më tepër, komentet e Institutit të Kontabilistëve të Miratuar, pas draftligjit të ripunuar, nuk iu vunë në dispozicion opozitës në komision. Por, faleminderit që ekziston revista “Monitor”, ku ishin botuar këto komente!

Ligjit iu bënë disa ndryshime, por në thelb ai mbeti një ligj me objektiv goditjen e shërbimeve profesionale, me xhelozë dhe urrejtje për shtresën e mesme intelektuale të shoqërisë, pjesës që është e formalizuar.

Në dallim nga të gjitha llojet e aktiviteteve, për ata që furnizojnë shërbimet profesionale, me të ardhura neto deri 14 milionë lekë, taksimi do të fillojë në vitin 2024 me 15% dhe 23%. Janë rreth 16 700 tatimpagues të regjistruar, të cilët ofrojnë shërbime profesionale. Nga këta janë rreth 7 000 mjekë, avokatë, kontabilistë, ekspertë kontabël, inxhinierë, stomatologë, veterinerë, pjesa që i ka mbetur vendit tonë nga puna intelektuale dhe profesionale.

Te kjo pjesë e të vetëpunësuarve dhe profesioneve të lira konstatohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë shmangia nga detyrimet fiskale dhe shembull merrej mjeku që punon në 2 klinika, i cili për të minimizuar tatimin regjistrohet si person fizik. Kategorisë së mjekëve, të cilët po largohen në mënyrë të frikshme nga vendi, i vendos tatimin dhe nuk i përjashton si bizneset e tjera tregtare.

Ju, qëllimisht, me politikat tuaja, nxitni emigrimin në masë të intelektualëve, të shtresës së mesme, të rinisë, që nuk sheh asnjë perspektivë në këtë vend. Pse nuk merren në konsideratë investimet që janë bërë nga qeveritë, nga Banka Botërore, nga vetë profesionistët dhe organizatat profesionale të tyre, për këto profesione të rregulluara? Pse nuk bëhen trajnime të detyrueshme për mbajtjen e licencave, specializime? Pse nuk organizohen pjesëmarrje në konferencat ndërkombëtare dhe shpenzime të tjera? Vëmendja e organeve tatimore duhet të përqendrohet tek ata që e ushtrojnë aktivitetin dhe nuk janë të organizuar në organizata profesionale apo edhe të peregjistruar, ata që e ushtrojnë profesionin e tyre të parregulluar.

Disa herë shtrova pyetjen: a e humbet individi i vetëpunësuar këtë status në qoftë se kthehet në të vetëpunësuar me punëmarrës, pra në qoftë se punëson të tjerë? Por nuk mora asnjë përgjigje as nga ministria, as nga vetë ministrja që ishte në komision.

Një problem madhor dhe me pasoja në çdukimin dhe rritjen e informalitetit është neni 14: “Regjimi i veçantë për individët tregtarë dhe të vetëpunësuar”, të cilët me qarkullim vjetor deri në 10 milionë lekë, për qëllime të njohjes së

shpenzimeve të zbritshme, kanë të drejtë të zgjedhin një nga metodat e mëposhtme: pranimin e një regjimi të veçantë, përmes të cilit shpenzimet e supozuara zbriten apriori me përqindje sipas llojit të aktivitetit, ose përlllogaritjen e shpenzimeve të zbritshme, bazuar në dokumentacionin dhe faturat respektive për çdo shpenzim. Patjetër që të gjithë do të zgjedhin metodën e parë, që nuk ka kosto, pasi nuk do të mbajnë dokumentacion. Ata nuk do të kenë interes për të marrë ose pranuar faturën për furnizimin e kryer, çka do të krijojë anomali dhe një shteg për informalitet. Furnitorët do të kenë mundësinë të bëjnë evazion, duke mos i deklaruar shitjet e tyre për këto biznese.

Ku shkoi i gjithë investimi për fiskalizimin, me të cilin qeveria ka 2 vjet që mburret, 15 milionë euro plus 6,5 milionë euro të tjera për mirëmbajtjen? Pse duhet të vendoset kjo pikë, kur nga organet tatimore kryhet analizë krahasimore e të dhënave të fiskalizimit? Cilat janë efektet e pritshme të këtij ligji në drejtim të rritjes së të ardhurave nga tatimet dhe si do të ndikojë ai në këtë drejtim? Në raportin e tatimeve të vitit 2022, detyrimet tatimore të papaguara në fund të vitit 2022 u rritën me 12 miliardë lekë, arritën në 146,8 miliardë lekë, nga 134,9 miliardë që ishin në fund të 2021-shit.

Cilat kanë qenë defektet e nivelit të ulët të mbledhjes së tatimeve nga pikëpamja administrative dhe politikave fiskale të ndjekura? Raporti i FMN-së evidenton se niveli i aftësive teknike dhe kompetencave në të gjithë stafin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve duhet të përmirësohet; mungesa e ekspertizës teknike redukton produktivitetin dhe cilësinë dhe mund të ketë ndikim negativ në dhënie e asistencës për taksapaguesit dhe ndërmjetësit.

Sipas rekomandimeve të përsëritura të FMN-së, në sistemin tatimor nuk duhet të ketë përjashtime për sektorë të veçantë, ndërkohë në dispozitat transitorë vazhdojnë përjashtimet, që do të jenë në fuqi deri në vitin 2029 dhe më tej. Në argumentimin e përjashtimeve, Ministria e Financave dhe Ekonomisë shprehet se këto janë në linjë me politikën e qeverisë. Po, janë pikërisht këto politika, për të cilat rekomandon vazhdimisht FMN-ja dhe ne nuk veprojmë.

Ky ligj, në mënyrë të pashmangshme, do të dërgojë në falimentim dhe mbylljen e shumë bizneseve, sidomos kategorinë e individëve të

vetëpunësuar; do të rrisë tendencën e mosdeklarimit të të ardhurave të bizneseve të vogla; do të nxisë evazionin; do të ulë kulturën tatimore dhe do të rrisë korrupsionin e administratës tatimore.

Tendenca e qeverisë duhet të jetë zgjerimi i bazës fiskale, duke formalizuar biznesin informal dhe atë që bën evazion, jo të rritet barra fiskale tek ata që punojnë të formalizuar.

Trajtimi i të ardhurave të të vetëpunësuarve, si të ardhura nga paga, është antiligjore. Shtrirja e ligjit tek të vetëpunësuarit e profesioneve të lira për shumë arsye do të sjellë efekte negative. Të vetëpunësuarit janë biznese, marrin përsipër rreziqe, nuk kanë të ardhura fikse dhe nuk mund të quhen të ardhura nga paga.

Kjo është në kundërshtim me Kushtetutën, ku të gjithë janë të barabartë para ligjit, dhe, sipas deklarimit nga shoqatat e grupeve të interesit, ligji do të dërgohet në Kushtetuese.

Dua të them edhe diçka tjetër në lidhje me rritjen e pagave në sektorin shtetëror: pagat nga nga viti 2005 deri në vitin 2013 janë rritur 95%, ndërsa nga viti 2013 deri në vitin 2023 janë rritur vetëm 40%. Në sektorin privat, në vitin 2013 në krahasim me vitin 2005 rritja kanë qenë 70%, ndërsa tani është 48%.

Kur flasim për pagën minimale, rritja e pagës minimale për 8 vjet, 2005-2013, ka qenë në masën 86%, ndërsa me rritjen që po bëni ju gjatë dy vjetëve të fundit përsëri jeni në nivelin e 81%-shit.

Ju faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Zonja Zhupa dhe zonja Gjylameti kanë kërkuar fjalën.

Ju lutem, pse e keni kërkuar fjalën?

**Ina Zhupa** – Faleminderit, e nderuar drejtuese e seancës!

Për të qenë korrekte, pashë Fjalorin e Gjuhës Shqipe dhe fjala “hajdut” perifrashohet: njeriu që merr diçka që nuk i takon...

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, zonja Zhupa, mos abuzoni në këtë mënyrë në seancë.

Nëse kishit nevojë ta merrnit fjalën për replikë, shumë mirë mund ta thoshit që e kërkonti fjalën për replikë, por jo të sqaroni se çfarë thotë fjalori.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk më duket as korrekte, as me vend, as në respekt të parlamentit.

Kështu që, ju lutem, ne kemi një rend dite dhe mos na shfokusoni nga rendi i ditës me këto ndërhyrje. Besoj se rendi i ditës është shumë i rëndësishëm, sepse flitet për ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat personale”. Nëse ka diçka nga kolegët për të thënë si argument dhe kundërgargument, le të qëndrojmë këtu, sepse kjo është me interes, jo çfarë thotë Fjalori i Gjuhës Shqipe. Secili prej nesh mund të konsultohet me Fjalorin e Gjuhës Shqipe, por nuk është ky interesi i Kuvendit.

Zonja Gjylameti keni fjalën.

**Blerina Gjylameti** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Dua të bëj një sqarim në cilësinë e një prej relatoreve të këtij projektligji, si dhe nënkryetare e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në lidhje me të gjithë procedurën dhe procesin e konsultimeve për ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Unë dua t’ju them se jo vetëm u është vënë në dispozicion të gjithë anëtarëve të komisionit çfarëdolloj propozimi që ka ardhur nga grupet e interesit, por po ashtu ato janë edhe në platformë, të cilat mund të aksesohen nga gjithkush. Po ashtu, çdo ndryshim i bërë pas adresimit të shqetësimeve që kanë pasur grupet e interesit është lexuar në komision, ku është zhvilluar seanca më e gjatë, duke reflektuar të gjitha ndryshimet. Kështu që, më vjen keq që thuhet disa të pavërteta.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Toni Gogu.

Pastaj fjalën do ta marrë zonja Tabaku. E bëra këtë ndryshim për ta harmonizuar pak radhën e diskutimeve.

**Toni Gogu** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Është folur shumë sot, por pas përfundimit të kësaj seance gjëja më e rëndësishme është se: do të jetë në kundërshtim me ligjin që më 30 prill të gjithë ju, që me punën tuaj të ndershme dhe me punën tuaj dinjitoze siguron minimumin e të ardhurave, të paguheni më pak se 40 mijë lekë. Është e kundërligjshme nëse ju paguheni nga punëdhënësit tuaj më pak se 40 mijë lekë të rinj, 400 mijë lekë. Ky është thelbi i këtij ligji, kuptohet edhe nga pjesë të tjera që u përshkruan

shumë mirë nga të gjithë kolegët këtu, sepse ky ligj që po diskutojmë sot, e ka nisur rrugëtimin e tij para 8 vjetësh dhe ka pasur nevojë për këtë korigjim të madh, të cilin po e realizojmë sot, që puna të ketë dinjitetin e vet dhe të taksohet sipas dinjitetit të vet. Më në fund, kjo po bëhet realitet. Më vjen jashtëzakonisht keq, sepse paga minimale nuk është çështje politike, ideologjike, por është t’u japësh një shans dhe mundësi të gjithë atyre, që me punën e tyre marrin minimumin e një page sot në këtë vend, që të mos zgjedhin më të paguajnë qiranë apo të paguajnë ushqimin, sepse e thanë kolegët, jo në një të shkuar të largët, vetëm 10 vjet më përpara, paga minimale ishte 190 mijë lekë të vjetër, pra dy paga minimale të atëhershme janë më pak se dy paga minimale sot. Sot një punonjës rojë, një punonjës krahu, një punonjës shërbimi, me gjithë respektin që kam për ta, sepse puna është tërësisht e denjë, merr më shumë pagë sesa ai dhe gruaja merrnin 10 vjet më parë. Paga minimale nuk është vetëm çështje e Shqipërisë, është çështje urgjente e kohës. Të gjithë ju, kolegë të nderuar, që ndiqni dhe lexoni zhvillimet ekonomike në botë, e dini shumë mirë që kjo është sfida, dhe është sfidë për disa arsye, të cilat do të doja t’i rreshtoja.

Në radhë të parë, sot, me ngritjen e pagës minimale në 40 000 lekë të rinj, krijojmë një cikël të virtytshëm, për shkak se ai punëtor, ai specialist, ai ose ajo qytetare e këtij vendi, që siguron minimumin me pagën që merr, do të ketë mjaftueshëm dhe do të mund të hedhë edhe ca lekë më shumë në ekonomi, në këtë mënyrë do të mund të kontribuojë që ekonomia të mund ta rritë punësimin, në këtë mënyrë do të mund të krijohen vende të reja pune, sepse pikërisht rritet kontributi i konsumit në ekonomi nga një njeri që fiton më shumë.

Pra, sot një çift, që sapo kanë nisur punën e tyre dhe marrin të dy 40+40, 80 000 lekë, mund të konsumojnë më shumë në një ekonomi si jona, ndërkohë që më përpara të dy së bashku merrnin 38 000 lekë. Nga 38 000 në 80 000 po flasim për një diferencë të madhe që hidhet në ekonomi. Ky cikël i virtytshëm i jep fuqi ekonomisë sonë.

E dyta, bëjmë drejtësi shoqërore. Nuk mund ta lëmë punën të jetë e pavlerësuar, nuk mund ta lëmë njeriun punëtor, i cili të vetmen të ardhur ka pagën, si të harruar, absolutisht që do t’i japim mundësi duke taksuar ata që fitojnë më shumë.



Meqë ra fjala, se po flitet sikur në sektorin e shërbimeve ne po bëjmë gjëmën, po jap disa shifra: ata që do të taksohen me 15%-23%, edhe sot po taksohen po aq, 15%-23%, pikërisht sepse ne duam të rritim pagën minimale të këtij vendi. Atëherë, shifrat janë: nga 50 000 tatimpagues me statusin e personit fizik (të gjithë këta profesionistët e lirë, për të cilët u shqetësuan kolegët e opozitës), vetëm 6 persona fizikë deklarojnë fitimin neto mbi 100 milion lekë, 36 persona fizikë deklarojnë fitim neto mbi 30 milion lekë, 119 persona fizikë deklarojnë fitim neto mbi 14 milion lekë. Pra, e shikoni se nga 50 000 janë vetëm disa qindra, më pak se 300, po t'i mbledhësh të gjithë së bashku, të cilët, nëse do të ttoheshin si persona juridikë, tatimi mbi dividendin teorik që do të paguhej, do të ishte 320 milionë lekë. Pra, duket qartë që këto janë krijuar në sistem nga keqadministrimi, nga ana tjetër edhe nga mosushtrimi i asaj përgjegjësie shoqërore që bën ky ligj sot, vetëdeklarimi. Kjo është prova që kemi në këtë shoqëri: të deklarojmë atë që fitojmë dhe, meqenëse devijimet janë të këtyre niveleve, patjetër që shteti duhet të ndërhyjë.

Në fund fare, do të doja të thosha se rritja e pagës minimale është çështje e solidaritetit shoqëror. Ne e bëjmë shoqërinë tonë më të mirë, prandaj nuk mund të bëjmë sikur s'e shohim atë. Është pikërisht paga minimale, e cila e ndihmon profesionistin e lirë, e ndihmon profesionistin e punësuar në sektorin publik, e ndihmon profesionistin në sektorin privat që, ashtu si ju përpiqeni ta denonconi, t'i ketë kuptim puna në vendin e tij. Po, paga minimale bën të të ketë kuptim puna në vendin tënd dhe të të japë vlerë e dinjitet në atë që ti bën, sepse pastaj ti me produktivitetin tënd rrit edhe të ardhurat e tua, të cilat ne sot i kemi në kategori të ndryshme: të ardhurat që krijohen nga puna janë më vete, të ardhurat që krijohen nga biznesi janë më vete dhe të ardhurat që krijohen nga investimi janë më vete.

Patjetër që duhet ta vazhdojmë këtë ndreqje, patjetër ata që krijojnë të ardhura vetëm nga puna, duhet të kenë vëmendjen tonë, sidomos vëmendjen e shumicës socialiste.

Meqë ra fjala, të dashur kolegë, ju që jeni të shqetësuar nga shpopullimi dhe që e dëgjuat sot devizën, doktrinën e partisë së re neokonservatore, por me tabiate shumë të vjetra, mundohuni të populloni partinë tuaj, mbusheni

plot atë, bëjeni tërheqëse për rininë, për të cilën qenkeni shumë të shqetësuar, mos nxirrni të rinj me kostume të vjetra, pastaj do të shikoni si do të ndryshojnë gjërat në këtë vend. Sa për ne, socialistët, lexoni sondazhet. Ne jemi me njerëzit punëtorë, prandaj vijmë sot jo vetëm për të menduar për ta, por për t'ua ngritur atyre pagën minimale, madje edhe mesataren. E shikoj se si ai 900-euroshi në muajt në vijim, pra në vitin 2024, ju ka ngritur dhe hardallosur.

Me që ra fjala, të gjithë ju që e denonconi ende si një premtim...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, kolegë, mos ndërhyjni nga vendi!

**Toni Gogu** – Ali Asllani na e ka dhënë të dyve si fjalë që ta përdorim, sidomos kur ajo ngritja është e stimuluar.

Në fund fare dua të them: mos u shqetësoni, më 14 maj do të takohemi, kurse me Edi Ramën, si dhe me qeverinë e tij do të takoheni në vitin 2025. Ai nuk është duke bërë gjë për zgjedhje, ai është duke zbatuar programin e tij politik pikë për pikë, për të cilin e kanë votuar qytetarët. Më 14 maj do të takohemi për të parë se si do t'i qeverisim qytetet për t'i bërë ato edhe më europiane sesa i kemi bërë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Fjala për zonjën Tabaku.

Ju lutem, të përgatiten koleget Dhima dhe Bano.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Zoti Leskaj, lista bëhet nga shërbimet, sipas regjistrimit të kolegëve dhe drejtuesi i seancës ka për detyrë t'i harmonizojë diskutimet, në mënyrë që të dëgjohet një folës nga opozita dhe një folës nga mazhoranca. Në rastin konkret ka më shumë folës nga opozita, për këtë arsye, sipas mundësive, do të dëgjojmë argumente dhe kundërargumente.

Ju lutem, që të mos zgjatem, se nuk jeni deputet i ri që të mos i kuptoni këto gjëra!

**Jorida Tabaku** – Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar profesionistë të lirë, në fakt, 17 mijë,

Besoj se po i ndiqni me interes diskutimet intelektuale të parlamentit të Shqipërisë që të kuptoni se çfarë do të ndodhë me taksën tuaj, se çfarë do të ndodhë me punën tuaj, se çfarë do të

ndodhë me pagesën normale që ju keni marrë deri dje.

Kam marrë mesazhe pa fund nga kolegë të Fakultetit të Ekonomisë, të cilët sot punojnë si profesionistë të lirë, të cilët ushtrojnë profesionin e kontabilistit të miratuar dhe janë jashtëzakonisht të shqetësuar për ndryshimet që sjell ky ligj, për ndryshime, të cilat zoti Gogu, po të kishte qenë i sinqertë dhe t'i sqaronte ashtu siç duheshin sqaruar, penalizojnë punën. Pse e penalizojnë punën? E penalizojnë punën, sepse, fatkeqësisht, kjo qeveri nuk e vlerëson profesionistin, nuk e vlerëson atë që fiton të ardhura të ndershme. Kjo qeveri sot, fatkeqësisht, nuk e vlerëson shtresën e mesme.

E dëgjova zotin Gogu, i cili, me gjithë elokuencën e tij, shpjegoi pse kërkon një shoqëri më të mirë. Si thotë Bibla, zoti Gogu? Një të dhjetën takso, jo 23%. Të paktën të jemi të ndershëm me qytetarët, të jemi të ndershëm edhe me ata që do t'u ndryshojë tatimi dhe taksa brenda ditës: 20 milionë euro më shumë do të paguajnë 17 mijë profesionistë të lirë: avokatë, kontabilistë, noterë, mjekë, dentistë, farmacistë. Kjo është shtresa e mesme e shoqërisë.

Pyesin kolegët se çfarë është “tatimi socialist”? Ky është “tatimi socialist”, që taton atë që punon më shumë, taton atë që është më i ndershëm, sepse, po të mos jesh i ndershëm, do të kesh amnisti fiskale; po vodhe, po bërë korrupsion, do të bësh legalizimin e kanabisit; ti do të kesh mundësi, nëse je i korruptuar, edhe t'i legalizosh paratë e tua nëpërmjet amnistisë fiskale. Por jo, po punove, ty do të tatojnë deri në 23%.

Pse gjykoj unë që ky ligj është, së pari, i padrejtë? Nuk flas për barazinë në një vend, ku ka ikur çdo gjë për drejt, e ka shkuar çdo gjë keq. Biznesi i vogël në këto vite, nga 2013-ta e këtej, ka qenë biznesi më i penalizuar: kanë bërë prova, kanë bërë eksperimente, e kanë futur në skemën e TVSH-së, e kanë hequr nga skema e TVSH-së. Sa herë afrohen zgjedhjet, i premtojnë taksa të ulura. Sot me këtë ligj formalizohet më në fund që në vitin 2029 qeveria do ta prezantojë, siç çdolloj forme tjetër biznesi. Po cila është ajo qeveri që vendos taksa pas 8 vjetëve? Ku e gjejnë guximin, kurajën, të thonë: “Pasi të kem ikur nga qeverisja, ju do të keni këtë taksë”. Politika e taksave është mandati i qeverisë aktuale.

Së pari, kjo është antikushetuese edhe për parimin e ndryshimit të taksave me një efekt kohor të shtyrë në kohë.

Së dyti, a ka mundësi që të tatohet si një biznes i vogël një person fizik, i cili ka një risk të shtuar në punë, që vjen nga shumë aktivitete, të cilat besoj se, kush e njeh konceptin e sipërmarrësit, e di që vijnë pikërisht nga marrja përsipër e rrezikut?! Një person fizik ndryshon në koncept nga një i punësuar, sepse ky i fundit punon me një afat kohor të caktuar si një menaxher shitjeje, marketingu, i cili ka një punë, sigurisht të vlerësuar, të nderuar, por nuk mundet kurrsesi të paguhet sa një profesionist i lirë, i cili sot, fatkeqësisht, do të futet në skemën e qeverisë. I vetëpunësuar ka riskun e tregut, nuk ka përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, ka persona të tjerë të marrë në punë, ka një sërë elementesh, që e bëjnë atë të ndryshëm nga gjithë të tjerët dhe nuk mund ta konsiderosh të ardhurën nga fitimi i një kompanie njësoj si një e ardhur personale e një biznesi.

Ky ligj duhej të ishte ndryshuar dhe duhej të ishte koordinuar edhe me një sërë ligjesh të tjera, që unë i kam mbajtur shënim, i kam ngritur edhe në Komisionin e Ekonomisë kur është diskutuar herën e parë. Ligji “Për të ardhurat lokale” sot ka nivelin 5 miliardë, 8 miliardë, 10, miliardë, 14 miliardë. Cili është biznesi i vogël në Republikën e Shqipërisë? Cilin njeh ligji si biznes të vogël? Nuk e di as ministrja, nëse e pyet. Për taksa lokale përdoret një nivel tjetër, për taksën një nivel tjetër, për TVSH-në një nivel tjetër, pastaj ankohet ministrja se sistemi ka prodhuar informalitet. Sigurisht që prodhon informalitet, sepse, sa më shumë nivele që të kesh, aq më shumë e nxit informalitetin. Sa më shumë nivele, aq më shumë e detyron atë të deklarojë një lekë më pak se niveli më i lartë.

Prandaj, ju kemi thënë që në krye të herës se “tatimi socialist” është inflacioni që sot ka prodhuar në ekonomi, së pari. Së dyti, është informaliteti që ka tregu. Pse ka informalitet? Se ke bërë një tatim me 6 nivele. Pse ka informalitet? Sepse punën e taton 23% dhe dividendin e taton 8%. Pse ka informalitet? Sepse vetë shteti biznesin e vogël për qëllime të taksave lokale e njeh 8 milionë, për qëllime të TVSH-së 10 milionë, për qëllime të taksës 14 milionë. Kur vetë shteti është i paqartë, çfarë duhet të bëjë tatimpaguesi? Kur vetë shteti është i paafte, çfarë

duhet të bëjë tatimpaguesi? Ky informalitet sot është nxitur vetëm nga ligji, është nxitur vetëm nga sistemi që është ofruar. Ky sistem, dhe nuk ka asnjë dyshim, është sistemi socialist, që është “tatimi socialist”, i cili fatkeqësisht ka penalizuar rëndë shtresën e mesme.

Unë kam folur shumë për ligjet e taksave, por besoj se kishte ardhur koha të ndryshohej ligji. Po, është e vërtetë, ligji “Për tatimin mbi të ardhurat” duhej të ndryshohej me një koncept të ri për t’u bërë së pari një ligj integral; së dyti, sepse përmbledhte shumë koncepte, të cilat ishin vjetruar me kohë. Në fakt, qëkur u përgatit plani i Partisë Demokratike për fushatën elektorale të vitit 2021, kishim propozuar të vendosej një kod fiskal që të biem dakord të gjithë për disa rregulla, pastaj politikën e taksave e cakton çdo qeveri, por rregullat bazë për biznesin nuk duhet të ndryshojnë. A e dini që në 9 vjet ligjet për taksat kanë ndryshuar 60 herë? A e dini që janë bërë 170 udhëzime të ministrave në zbatim të këtyre ligjeve?

Cila është sfida më e madhe që kanë sot bizneset? Është paqëndrueshmëria fiskale, është paparashikueshmëria fiskale, është fakti që një ligj ndryshon sot, ndryshon nesër, janë përjashtimet nga rregulli. Janë përjashtimet, të cilat e kanë nxitur këtë sistem. Nëse po bën një ligj të ri, ku do të futësh 17 mijë profesionistë të lirë në sistem dhe do t’i trajtosh ata si çdo i punësuar tjetër, ndërkohë që biznesin e madh e ke me 15%, këtë do ta tatosh deri edhe në 23 %, sigurisht në varësi të kategorive të biznesit, atëherë pse nuk i heq të gjitha përjashtimet, pse vazhdon dhe mban akoma përjashtime për hotelet me 5 vje, për TVSH-në për jahtet, pse mban akoma përjashtimet në sektorë të veçantë? Përjashtimet që duhej të ishin përjashtim nga rregulli, sot janë bërë rregulli.

Sot biznese të mëdha vijnë këtu në parlament dhe imponojnë politikën e taksave, ndërkohë që këta 17 mijë profesionistë të lirë nuk kanë arritur dot, sepse ata bëjnë punë të ndershme, nuk sponsorizojnë ligje, këta punojnë dhe rregullojnë sektorë të tërë, nga të cilët varem çdo ditë ne të gjithë. Ky është “tatimi socialist”, është i pabarabartë, thanë kolegët, është i padrejtë, është i pandershëm për shoqërinë, por aq më tepër është i pandershëm për shtresën e mesme.

Sot kemi një sfidë reale për ekonominë shqiptare, që është emigrimi. Pa e pranuar të

gjithë në këtë parlament se emigrimi po ndodh, më në fund po e pranon edhe qeveria, pa e pranuar të gjithë në këtë parlament që duhet të marrim masa sot, që duhet të ndryshojmë sistemin, që duhet të ndryshojmë shumë gjëra, nesër fatkeqësisht nuk do të kemi mundësi të kemi njerëz që të na votojnë. Kjo është sfidë edhe e ekonomisë shqiptare.

Zoti Majko atje në Kukës gjysmën e Kukësit e ka të larguar. Në fakt, duhet të shkojnë të bëjnë fushatë në Londër, sepse nuk ka kush t’i votojë në Kukës.

Kjo është sfida që kemi ne si politikanë, kjo është sfida që ne duhet të shohim përpara: sesi ka mundësi që një miliard euro i ikin ekonomisë shqiptare në vit nga këta persona që largohen.

Kam ndjekur me interes diskutimet e fundit për sa u përket propozimeve të qeverisë për pagën minimale, njëkohësisht edhe për rritjen e pagës mesatare. Unë nuk e di se në cilin vend të botës paga mesatare rritet me urdhër të peshkut, a me urdhër të liderit, a me urdhër të ministres. Pagën mestare e rrit tregu, i krijon kushtet biznesit, biznesi investon dhe rrit pagën. Nuk ndodh në asnjë vend të botës të rritësh pagat në sektorin publik për 2 vjet 54%, ndërkohë që për 10 vjet i ke rritur 45%. Nuk ndodh në asnjë vend të botës që ti të rritësh pagat e sektorit publik dhe t’i thuhet privatit: “Rriti ti, se ia kam rritur unë publikut”. Jo, ndodh e kundërta. I rrit sektori privat, se është rritur, është zgjeruar, se ka më shumë mundësi dhe e ndjek publiku, sepse ka merak shteti se do t’i ikin punonjësit në sektorin privat dhe sigurisht që ky do të ishte problem. Po se kush i ka mësuar, se kush u ka thënë: “Po i rritim te publiku dhe do ta detyrojmë të gjithë privatit t’i rritë me zor dhe me taksa të rritura”, unë nuk e di.

Besoj se ka ardhur koha që në këtë parlament të mendojmë një herë për njerëzit dhe për qytetarët. E di, kërkoj shumë që të bëhet në vitin e dhjetë të kësaj qeverie, por të pretendosh që sot të bësh një ligj të ri për tatimet, ku përfshihen 17 mijë profesionistë, që i penalizon dhe e quan këtë si një nder që u bën qytetarëve, besoj se do shumë kurajë.

Falënderoj të gjithë kolegët e Komisionit të Ekonomisë që kanë punuar me shumë dëshirë për të dhënë mendimet e tyre për këtë ligj! Nuk është zonja Gjylameti këtu?

Zonja Gjylameti, ne nuk jemi këshilltarë të qeverisë që të vijmë dhe të përmirësojmë ligjet

tuaja, ne jemi opozita. Ne bëjmë amendamente, bëjmë politikën tonë të taksave, bëjmë propozimet tona të taksave, por nuk jemi aty që të bëhemi aksesorët tuaj, që ju të shkruani ligje jo të mira dhe ne të vijmë t'i rregullojmë në komision. Kjo është çështje vizioni. Ju doni t'i taksoni, ne nuk duam të taksohen. Ne duam që të qëndrojnë në Shqipëri, ju doni që të largohen. Kjo është shumë e thjeshtë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Fjalën e ka kërkuar ministrja e Financave.

**Delina Ibrahimaj** – Vërtet, nuk ka qeveri në botë që të dojë të rritë taksat dhe të dojë të taksojë. Por, në fakt, ka qeveri, që janë të përgjegjshme dhe të ndërgjegjshme, të cilat duan të vendosin barazinë dhe duan të nxitin biznesit të vogël.

Ju nuk mund të thoni në asnjë moment që biznesi i vogël në këta 10 vjetët e fundit është goditur dhe nuk është mbështetur. Sot që flasim, si në asnjë vend të botës, biznesi i vogël nuk paguan as tatim fitimi dhe as TVSH.

Dua t'ju sjell në vëmendje që politikën tuaja e tatonin më shumë biznesin e vogël, 10%. Pra, sot që flasim, biznesi i vogël tatóhet më pak se në kohën e tuaj.

Nga ana tjetër, dua t'ju kujtoj se politikën tuaja fiskale dhe të taksave, jo vetëm që prodhuan informalitetin më të lartë të të gjitha kohëve, dhe që nga ajo kohë informaliteti ka ardhur në rënie (këtë e thonë shifrat e ILO-s), por prodhuan edhe një destabilizim makro-ekonomik në vend.

Dua t'ju kujtoj se borxhi në vitin 2013 ishte 69,4% dhe në vitin 2014 shpërtheu, pasi dolën të gjitha detyrimet e prapambetura që ju kishit mbajtur, se nuk kishit para t'i paguanit, sepse nuk mblidhni mjaftueshëm taksat. Ndërkohë që sot, pas 2 krizash, madje 3 krizash të njëpasnjëshme, borxhi publik është 67%, pra më i ulët se në vitin 2013 dhe deficitin është 3,3%, ndërsa në vitin 2013 ishte 5%.

Kur bëhen analiza mbi taksat, mbi të ardhurat, bëhen analiza korrekte, konkrete dhe jo analiza populiste. Kur thuhet që ne po taksojmë biznesin e vogël, është e pavërtetë. Ne po futim në taksim një kategori, e cila ka përfituar gjatë gjithë periudhës kur tatimi mbi biznesin e vogël ka qenë zero, duke u larguar nga listëpagesat si punëmarrës dhe duke hapur NIPT si persona fizikë, duke goditur kështu shtetin në dy forma: në radhë të parë duke mos paguar kontributet dhe

tatimin mbi të ardhurat; në radhë të dytë duke shtuar shpenzimet e bizneseve, të cilat janë shpenzime të zbritshme, për rrjedhojë duke ulur fitimin e bizneseve. Kjo është një nga arsyet që unë e shpjegoj fare mirë pse kemi vendosur të vendosim tatim mbi profesionet e lira.

Megjithatë, dua të theksoj dhe të nënvizoj se tatimi mbi profesionet e lira është më i ulëti në rajon. Profesionet e lira do të vazhdojnë të paguajnë më pak barrë fiskale sesa të punësuarit me po të njëjtin profesion, pikërisht për arsyet që përmendët edhe ju, sepse marrin riskun për të qenë biznes, sepse paguajnë edhe taksat të tjera që lidhen me taksat lokale. Pra, nuk janë të vërteta ato që thoni.

Ju thoni: “Si ka mundësi që biznesi i vogël paguan tatim mbi të ardhurat? Janë bazat dhe themelet e legjislacionit tatimor ndërkombëtar, ku personat fizikë kategorizohen si forma të zhvillimit të aktivitetit tregtar apo të shërbimeve, të cilat duhet të paguajnë tatim mbi të ardhurat dhe jo tatim mbi fitimin. Pra, ndahet koncepti i korporatës me konceptim e personit fizik. Ka shumë elemente të tjera të këtij ligji që ne i përafrojmë me praktikën më të mira ndërkombëtare. Për më tepër, është një ligj, i cili nga fillimi dhe deri në fund është hartuar me ekspertizën dhe mbështetjen e FMN-së, ndryshe nga sa u tha këtu më parë.

Pra, do t'i lutesha zonjës Tabaku dhe të gjithë deputetëve të tjerë të Partisë Demokratike që, nëse duan të flasim për koncepte dhe për parime tatimore, mund të flasim, mund të lëmë seanca të veçanta të flasim për këto, por nuk mund të vihet këtu dhe të thuhet se ne po rritim tatimin mbi biznesin, ne po rritim padrejtësisht tatimin për qytetarët që punojnë, ndërkohë që në të gjithë këta vjet kemi bërë të kundërtën.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Ministre!

Zoti Gogu ka fjalën për replikë.

**Toni Gogu** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

E nderuar zonja Tabaku, të krahasosh modelin biblik të taksimit 6-mijëvjeçar, 6 mijë vjet përpara, me modelin e piramidave të Saliut dhe të mburresh me to, besoj se janë aq larg, sa është Lindja nga Perëndimi. Po, meqenëse e përmende, më duhet ta sqaroj se kemi hyrë edhe në Kreshmë: kur Krishti u ballafaqua me atë model që përmende, që ishte e dhjeta, u tha kështu

atyre mësuesve fetarë: “Hipokritë, kujdes, sepse merreni me të dhjetën, jepni të dhjetën e mendrës dhe të borzilokut, dhe keni harruar thelbin e ligjit që është drejtësia”. Është e padrejtë, zonja Tabaku, që ata që mbajnë mbi shpinë ekonominë shqiptare, të taksohen njëllor si mua dhe si ty. Është e padrejtë që atyre t’u merrje edhe 18-mijëlekëshin dhe t’ua çoje rrogën 172 mijë lekë të vjetër, ndërkohë që sot ata e kanë taksën zero, madje jo vetëm që janë të fundit me pagën minimale, por edhe ata që e kanë deri në 50 mijë lekë, e kanë taksën zero. E, pra, nëse duam të bëjmë drejtësi, ky është thelbi i ligjit.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Gogu!

Zonja Tabaku, ju lutem, saktësoni përse e keni kërkuar fjalën.

**Jorida Tabaku** – E kam kërkuar për replikë me ministren, e cila e mori kohën për fjalën e saj. Kjo ishte ndërhyrje.

Mua më vjen mirë që më në fund ministrja pranoi që sistemi ka dështuar, që sistemi i taksave me 6 nivele i vendosur nga qeveria ka nxitur informalitetin. Ministrja tha se ata regjistroheshin si persona fizikë dhe nuk paguanin taksa. Ne jua thamë që në fillim: sistemi që ju po ngrini, do të nxisë informalitetin. Kjo vërtetohet me mënyrën që po zbatohet sot në praktikë, të cilën ministrja e ka pranuar sot disa herë. Të njohësh dështimin, kërkon kurajë, kështu që të falënderoj, e nderuar zonja Ministre!

Së dyti, është një varfëri e jashtëzakonshme mendimi që vazhdojmë e krahasohemi akoma me vitin 2013. Unë e kuptoj që atë nivel taksimi që ka qenë, ju nuk keni për ta arritur kurrë, por të vazhdosh mbi 10 vjet dhe të krahasohesh me përpara vitit 2013, sigurisht që është e pakonceptueshme.

Së treti, edhe unë mendoj që të gjithë duhet të paguajnë taksa. Po, nuk duhet të ekzistojë askush në Republikën e Shqipërisë që nuk paguan taksa. Nuk ka se si të mbahet shteti pa taksa, sepse pastaj ju duhen edhe juve të bëni tenderë, koncesione; ju duhen, sepse keni plot punë. Por sistemi duhet të jetë i drejtë, i barabartë, sistemi duhet ta stimulojë punën, këtë po them, jo ta penalizojë atë. Nuk mundesh dot të tatosh atë që sot me shumë mundime, me shumë shpenzime kualifikohet dhe arrin një nivel të caktuar kualifikimi njësoj si një biznes i madh. Është e padrejtë, është e pandershme për njerëzit, është

penalizuese për shtresën e mesme. Kjo është një fatkeqësi që nuk e kuptoni akoma.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Kolegë, ju lutem!

Edhe një herë, ministrat kanë të drejtë ta marrin fjalën sa herë e kërkojnë. Këtë e thotë Rregullorja, këtë e thotë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Së dyti, shpeshherë, në fjalën tuaj ju i referoheni njëri-tjetrit dhe brenda së njëjtës fjalë krijoni replikë.

Së treti, të drejtën për të siguruar zbatimin e Rregullores e ka drejtuesi i seancës, prandaj, ju lutem, kur ju pyes: për çfarë e kërkon fjalën, të ma bëni të ditur nëse e kërkon për procedurë apo për replikë. Përndryshe, besoj se është e padrejtë që dikush të marrë fjalën dhe ta shfrytëzojë kohën e plotë të fjalës duke pretenduar që kishte të drejtë të fliste. Sepse, sipas atij arsytimi, i bie që unë t’ia jap tani fjalën sërish ministres, dhe të them se e kishte për ndërhyrje, jo për replikë apo procedurë. Le t’u japim mundësinë të gjithë kolegëve, sepse realisht janë regjistruar shumë kolegë për këtë pikë të rendit të ditës, ndaj do të ishte me vend t’i respektonim që të gjithë për të thënë fjalën e tyre.

Fjalën e ka zonja Dhima. Pastaj zonja Eralda Bano.

*(Debat në sallë)*

Po, zonja Açka!

**Flutura Açka** – Zonja Felaj, ju duhet ta kuptoni se në asnjë vend të Europës nuk kalohen ligjet kështu, pa replikë. Këtu nuk ka replikë. Nuk mund të më ndërpresësh. Është diçka për të cilën ti nuk je dakord, ke nevojë të diskutosh me tjetrin, por nuk replikon dot. E kupton se ka një problem me këtë Rregulloren tonë? Prandaj i përdorim procedurat ne. I përdorim sepse nuk ka mundësi replike. Duhet bërë rregullimi me kohë, se nuk shkon kështu.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Zonja Açka, Rregullorja e përcakton qartë se çfarë është replika, ndaj ju siguroj se në Rregulloren e çdo parlamenti replika përkufizohet sipas të njëjtit kuptim. Nëse shtrembërohet fjala e një kolegu, lind e drejta për replikë. Nëse fyhet ose poshtërohet një koleg, lindet e drejta për replikë. Çështjet e procedurës janë të përcaktuara në mënyrë ezauruese dhe nuk i është ndërprerë askujt fjala. Përkundrazi, në emër të një tolerance, që mazhoranca e ka edhe

detyrim ta tregojë, ka ndodhur kjo më shumë se sa e kundërta.

Vijojmë me diskutimet.

Fjalën e ka zonja Dhima!

**Antoneta Dhima** – E nderuara zonja nënkryetare!

Të nderuar kolegë!

Të dashur qytetarë!

Jemi duke diskutuar projektligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”, miratimi i të cilit prek çdo familje shqiptare, kategorinë e punësuarve, të vetëpunësuarve dhe njëkohësisht biznesin.

Ndryshe nga zonja Tabaku, unë e përshëndes këtë nismë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe vullnetin e qeverisë shqiptare për ta çuar përpara hartimin e një ligji të ri, pas një sërë ndryshimesh dhe modifikimeve që ligji aktual ka pësuar për 24 vjet rresht. Është për t’u përshëndetur nisma për të hartuar një ligj që i përgjigjet kohës, konteksteve të reja në të cilat jetojmë pas tërmetit, pas pandemisë dhe pas luftës, por edhe për faktin se ai sheh në të ardhmen.

Ligji që është ende në fuqi është hartuar në vitin 1998, ndërkohë që gjatë 24 vjetëve Shqipëria ka kaluar sfida të mëdha dhe shpesh të paparashikuara, gjatë të cilave janë ndërmarrë e janë reflektuar shumë amendamente dhe ndryshime ligjore. Sipas specialistëve të ekonomisë dhe financave, ndryshimet e reflektuara e kanë tejkaluar vlefshmërinë dhe misionin e tyre, ndërkohë që nuk mund ta mohojmë faktin se tashmë kanë lindur risi të tjera në fushën e tatimit të të ardhurave personale dhe të fitimit korporativ.

Nga ana tjetër, në 10 vjetët e fundit kanë ndodhur ndryshime të ndjeshme dhe janë ndërmarrë iniciativa globale, pjesë e të cilave është edhe Shqipëria, në fushën e taksimit ndërkombëtar, në fushën e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit në fushën e taksimit, me qëllim pengimin e konkurrencës së pandershme në fushën e taksave.

Është një projektligj i matur, i studiuar, i konsultuar me grupet e interesit, i shqyrtuar për një kohë të gjatë në komisionet parlamentare, kryesisht në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, asistuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, një tjetër hap i sigurt në rrugëtimin tonë drejt Bashkimit Europian.

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, si dhe specialistët e kësaj ministrie në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, sqaruan dhe argumentuan me fakte e shifra arsyet.

Së pari, pse duhet rishikuar sistemi i taksimit të shërbimeve. Argumente këto, që u sollën këtu gjatë diskutimit të kolegut Braçe.

Së dyti, pse është e nevojshme norma progresive për të ardhurat nga vetëpunësimi dhe tregtia, për personat fizikë 15 % dhe 23 %.

Së treti, pse tarifa progresive 23 %, e parashikuar për të vetëpunësuarit dhe tregtarët me fitim neto mbi 14 milionë lekë në vit, nuk e dëmton biznesin e vogël në tërësi.

Së katërti, pse barra fiskale e të vetëpunësuarve dhe tregtarëve do vazhdojë të jetë më e ulët se barra fiskale e të punësuarve.

Projektligji jo vetëm që respekton dhe mbështetet në Kushtetutën e Shqipërisë, por edhe synon përafrimin e tij me direktivën e BE-së.

Të nderuar kolegë,

Miratimi i këtij projektligji ka një efekt me rreze shumë më të gjerë se thjesht efekt ekonomik. Patjetër që ka edhe një efekt social, duke pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në buxhetin familjar. Ai synon krijimin e një sistemi tatimor vetëdeklarativ bashkëkohor, ku individit dhe entiteti paguan pjesën e ndershme të tatimit mbi të ardhurat që realizon dhe kërkon kthimin e këtij kontributi në formën e përfitimeve dhe shërbimeve të përmirësuara publike, shumë të domosdoshme dhe të kërkuara nga qytetarët tanë, më shumë të ardhura në buxhetin e shtetit, të ardhura që përkthehen më shumë shërbime cilësore në sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë, në shëndetësi, ujësjellës-kanalizime, në mbrojtje sociale, në arsim, në mjedis, në bujqësi, në turizëm. Njëkohësisht, ky projektligj synon ofrimin e një sistemi tatimi më të ndershëm dhe të gjithëpranuar.

Po ndalem në veçanti tek impakti që ky projektligj ka te individit, si bërthama e shoqërisë dhe e familjes. Në projektligj të ardhurat personale të tatueshme janë klasifikuar në tri kategori: të ardhura nga punësimi; të ardhura nga biznesi; të ardhura nga investimi.

Të ardhurat personale nga punësimi dhe biznesi do të tatonen sipas një sistemi progresiv, me normat 13 % dhe 23 %, dhe me normat 15 % dhe 23 %. Të ardhurat nga investimet apo kapitali pasiv do të tatonen me normën tatimore 15 %

ndërkohë që dividendët tatohen me normën tatimore 8 %.

Projektligji ruan skemën aktuale të taksimit me tarifa 13 % dhe 23 % për taksimin e të ardhurave nga punësimi. Projektligji parashikon lehtësim të barrës tatimore për tatimpaguesit me të ardhura të ulëta, gjë të cilën Partia Socialiste e ka treguar dhe do ta tregojë në vazhdimësi, që edhe zoti Balla e theksoi në fjalën e tij.

Projektligji parashikon se një tatimpagues me të ardhura nga punësimi në masën 50 mijë lekë në muaj nuk do paguajë tatim mbi pagën, që do të thotë se do të ketë 15 600 lekë më shumë të ardhura në vit se sa para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kjo do të thotë se pragu i patatueshëm i pagës rritet nga 40 në 50 mijë lekë në muaj. Sa i takon tatimit të individëve tregtarë dhe të vetëpunësuar, projektligji ka parashikuar që këto kategori të tatohen me normën 15 % mbi fitimin neto, duke zbritur nga të ardhurat shpenzimet, kur fitimi neto është deri 14 milionë lekë në vit, me normën 23 % të fitimit neto vetëm për pjesën e fitimit mbi 14 milionë lekë në vit.

Ky sistem synon të trajtojë në mënyrë të barabartë dhe të ndershme të gjithë tatimpaguesit, pavarësisht formës juridike të tyre, të ulë nivelin e shmangies së tatimit nëpërmjet kalimit nga marrëdhëniet e punësimit në marrëdhëniet e biznesit si të vetëpunësuar, por edhe të përdorimit të statusit të personit fizik dhe shkallës tatimore ekzistuese zero të tatimit, si një mekanizëm për zhvendosjen e fitimeve nga entiteti që taksohet me 15 %, te personi fizik pa tatim.

Projektligji propozon ruajtjen e skemës ekzistuese të tatimit me tarifë 0 %, kryesisht për biznesin e vogël familjar, ku përfshihen prodhimi, tregtia, transporti, ushqimi social, artizanati etj., ku personat fizikë dhe personat juridikë me qarkullim deri në 14 milionë lekë, do të paguajnë 0 % tatim, përkatësisht mbi të ardhurat nga biznesi i vogël dhe nga të ardhurat e korporatës deri në vitin 2029.

Pa u ndalur në detaje, që i thashë edhe më lart, projektligji është diskutuar imtësisht në komisionet parlamentare dhe u parashtrua sot mjaft qartë nga ana e ministres së Ekonomisë dhe Financave, e po ashtu edhe nga kolegët deputetë, të cilët ishin jo vetëm relatorë, por edhe pjesë e komisioneve, ku ky projektligj u diskutua. Unë do t'ju ftoj ta votojmë këtë projektligj, i cili siguron një tatim të drejtë dhe të ndershëm, u vjen në

ndihmë familjeve dhe krijon mundësi për shërbime cilësore për qytetarët, për ata qytetarë që me datën 14 maj do të votojnë Partinë Socialiste, do të votojnë Kryeministrin Rama, për të ndryshuar qytetet, të cilat sot janë bërë të jetueshme. Kështu që, pavarësisht opinionëve të opozitës, ne do të tregojmë se më 14 maj do të vazhdojmë të qeverisim, ndërsa në 2025-ën Partia Socialiste do t'i fitojë përsëri zgjedhjet.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Zonja Bano, fjala është për ju!

Të përgatiten zoti Baçi dhe zonja Resulaj!

**Eralda Bano** – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Ky projektligj “Për tatimin mbi të ardhurat” përbën një problem për shumë arsye, të cilat në fakt janë shprehur nga organizatat profesionale të profesioneve të lira dhe nga shumë aktorë të tjerë, por që nuk janë marrë në konsideratë nga qeveria shqiptare. Sigurisht, motivi i këtij projektligji mbetet favorizimi i pabarazive fiskale të vetëpunësuarit e profesioneve të lira dhe biznesi i vogël, nxitja e evazionit fiskal dhe pastrimi i parave. Sa u takon këtyre dy të fundit, jam e bindur se qeveria i ka qëndisur bukur dhe do t'i votojë për interesat e saj, në fakt si çdo projektligj tjetër që dëmton interesat e shqiptarëve.

Ky projektligj vjen ekzaktësisht në këtë moment ekzistencial, në një kohë eksodi masiv, kur bijtë e nënave shqiptare rrezikojnë jetën me gomone për një jetë më të mirë, një jetë që politika jonë ka dështuar t'ua japë.

Moralisht dhe politikisht, për t'ju rikthyer shifrave më tej, qeveria aktuale si garancinë e saj të vetme për të qëndruar në pushtet, ka largimin e shqiptarëve. Një mision shpopullimi që po e arrin finalen e tij çdo ditë, në mënyrë progresive, duke mbjellë varfëri, duke mbjellë korrupsion, duke mbjellë gënjeshtër, duke shkërmoqur institucionet dhe duke e kthyer Shqipërinë në vendin më të pasigurt në rajon e më gjerë.

Në nenin 14 për individët tregtarë dhe të vetëpunësuar, trajtimi opsional i parashikuar për tatimpaguesit me qarkullim deri në 10 milion lekë, duke zbritur nga të ardhurat e realizuara nga veprimtaria ekonomike shpenzimet e supozuara sipas përqindjes specifike për secilën kategori, pa mbajtur regjistrime në kontabilitet, lë hapësira për

interpretim, duke krijuar një dualitet që favorizon abuzime nga ana e tatimpaguesve, për të mos marrë fatura të fiskalizuara dhe për të justifikuar shpenzimet e kryera në kuadër të veprimtarisë ekonomike. Kjo situatë dëmton formalizimin e ekonomisë, duke krijuar kështu të njëjtin deficit të biznesit të vogël për të lëshuar fatura fiskale, fenomen i cili ka vite që luftohet, dhe për rrjedhojë ky projektligj do të na kthejë përsëri pas në kohë.

Në një vend ku bëhen projektligje që favorizojnë evazionin fiskal dhe pastrimin e parave, domosdoshmërisht dhe me një algoritëm të thjeshtë kuptojmë që krimi i organizuar gjallëron, sepse në favor të tij bëhen politika dhe projektligje. Çuditërisht, qeveria mohon me qëndrim stoik se nuk ka asnjë lidhje me atë çka ndodh nën hundën e saj nga bandat kriminale. Sa e besueshme është kjo, në një kohë kur survejimi i patronazhistëve dhe i aktivistëve me aplikacione, kalon kufijtë e privatësisë si një drejtë themelore e njeriut?

Vrasjet mafioze të kohëve të fundit, pa autorë dhe pa gjurmë, janë kampionë alarmi që na bëjnë të kuptojmë se jeta jonë nuk është më e sigurt. Kjo bëhet edhe më e dukshme me ditët që kalojnë, sepse kjo qeveri dhe kjo ministri linje, pikërisht me këtë projektligj po legjitimon me çdo lloj forme paranë e krimin të organizuar.

Të dashur qytetarë,  
Të nderuar kolegë,

Pak ditë më parë, televizioni i madh kombëtar në vend, Top Channel, u sulmua nga një akt terrorist i paprecedent. Veç dramës familjare dhe psikologjike të atyre njerëzve që punojnë për këtë televizion dhe të afërmeve të tyre, në fakt atë mëngjes u sulmua fjala e lirë. U sulmua demokracia e një vendi, ndaj për rrjedhojë përgjegjësia kolektive duhet të jetë e madhe. Pa dashur të drejtoj gishtin ndaj askujt, dua të marr pak çaste për t'u shprehur ngushëllimet e mia familjarëve të të ndjerit Pal Kola. Dua t'i drejtohem Top Channel-it, duke i inkurajuar të gjithë që të vazhdojnë punën e tyre si një media e lirë. E di që nuk është aspak e thjeshtë. Po jetojmë një situatë të vështirë politike, ekonomike dhe njerëzore, por e kam bindje se e drejta, edhe pse vonon, dikur del në sipërfaqe. U bëj thirrje autoriteteve ligjzbatuese të bëjnë maksimumin për zbardhjen e një ngjarjeje, e cila, veç aspektit

njerëzor, mbart në thelb një rëndësi jetike për demokracinë e një vendi të lirë.

Për ta përmbyllur fjalën time, të gjithë do të kujtojmë shumë shpejt se në kohën e Edi Ramës do të ndodhnin ngjarje, të cilat nuk kanë se si të mos kenë lidhje me Kryeministrin personalisht. Arrestimi i ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri, çështja e nxehtë dhe aktuale e inceneratorëve, që përfshin vetë Kryeministrin, zëvendëskryeministrin Ahmetaj, çështja “Alqi Bllako” dhe shumë zyrtarë të tjerë, të cilët janë sot pas hekurave, nën hetim apo dhe në arrati, të gjitha këto janë kryer nën drejtimin e Edi Ramës. E megjithatë, ngjarja që do të mbahet mend si më e rënda është çështja “McGonigal”, e cila rëndon drejtpërdrejt mbi Edi Ramën, një ngjarje e cila dëshmon planin malinj të Edi Ramës për të shkatërruar opozitën shqiptare.

Kjo është trashëgimia që po lë Edi Rama, që ka infektuar çdo ministër dhe çdo person që qëndron afër këtij njeriu, i cili dalëngadalë po merr termin e qoftëlargut, njëlloj ai paraardhësi i tij.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Zoti Baçi, fjala është për ju!

**Luan Baçi** – Të nderuar qytetarë,  
Kolegë deputetë,  
Zonja drejtuese e seancës,

Jemi një muaj e gjysmë përpara zgjedhjeve, ndërsa Kryeministri nga njëra anë kërkon të bëjë bamirësin, duke u dhënë nga një pesë mijëlekësh lëmshë pensionistëve, e nga ana tjetër po grabit edhe më shumë biznesin e ndershëm e atë profesional. Këtë po e bën me ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Tatimi me 23 % për profesionistët e lirë është një litër në fytyrë për 7 mijë profesionistë të lirë, të cilëve u merren edhe 20 milionë euro.

Për këtë ligj folën dhe diskutuan shumë nga kolegët e mazhorancës e të opozitës. Nisur nga një pikë tjetër, një çështje tjetër e rendit të ditës, ajo e raportit të veprimtarisë për vitin 2022 të Entit Rregullator të Ujit, ku minutat në dispozicion ishin shumë të pakta, unë do të fokusohem te kjo pikë.

Një javë më parë ju miratuar projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për



Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjiellës-Kanalizimeve në Shqipëri”.

Si marrëveshja që ratifikuat të enjten e kaluar për të realizuar reformën e thellë të ujësjiellësit, edhe raporti i sotëm i veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit, është në fakt një certifikim, që ju si mazhorancë po i bëni kontrollit edhe më të rreptë të pushtetit të qeverisë ndaj aseteve të mëdha publike; në këtë rast, furnizimi me produktin shumë të domosdoshëm të ujit për familjet shqiptare. Patjetër, edhe ne si opozitë nuk jemi aspak kundër reformave që synojnë të harmonizojnë zhvillimin e vendit sipas standardeve ndërkombëtare dhe kërkesave të kohës, po kur këto reforma shkelin autonominë e pushtetit dhe decentralizimin e pushtetit vendor, kur këto reforma shkelin ligjet funksionale të institucioneve, konkretisht vetë ligjin e administrimit të bashkive; kur këto reforma ndërmerren pa asnjë konsultim me ekspertët e fushës, me vetë komunitetin, dhe për pasojë bien ndesh me interesin publik, atëherë ne si opozitë kemi shumë të drejtë për t’i kundërshtuar ato.

Në thelb, ajo çfarë synon kjo reformë është përqendrimi i kontrollit të ekzekutivit mbi të ardhurat e ujësjiellësve dhe investimeve në sektorin strategjik.

Pyetjes që i bëme drejtuesit të këtij enti në Komisionin e Veprimtarive Prodhuuese, se përse shteti, në kuadër të kësaj reforme, do të ketë 51 % të aksioneve dhe bashkitë do të kenë 49 %, drejtuesi i entit iu përgjigj se kjo është një pyetje njëmiliondollarëshe dhe s’mund të jepte përgjigje. Kjo është me vendim të Këshillit të Ministrave, tha ai. Atëherë, është normale që dikush të përgjigjet në lidhje me këtë raport të vendosur midis aksioneve të shtetit e të pushtetit lokal.

Për rrjedhojë, kjo e jo vetëm kjo, i hap rrugë rritjes abuzive të çmimit të ujit në muajt në vijim, si dhe një sërë shkeljeve të tjera. E them këtë, sepse deri më tani, në këta dhjetë vjet pushtet lokal dhe qendror tuajin, furnizimi me ujë ka qenë problematik dhe një hapësirë e jashtëzakonshme abuzimi me tendera dhe me pagesat e shqiptarëve. I marrim me radhë disa nga problematikat dhe shkeljet, sipas

sipas raportit të Entit Rregullator të Ujit.

Vetëm 77,6% e territorit mbulohet me ujë të pijshëm dhe vetëm 52 % mbulohet edhe me kanalizime. Sot, në mars të vitit 2023, shqiptarët furnizohen me afro 16 orë ujë në ditë, pra rreth 60

% . Sigurisht, kjo shifër vjen për arsye të keqmenaxhimit të fondeve, mungesës së theksuar të investimeve efikase, vjedhjes dhe shpërdorimit të ujit. Ndërkohë, 64,8 % e ujit që prodhojnë ujësjiellësit, sipas Entit Rregullator të Ujësjiellësve, evidentuar kjo edhe nga raporti i KLSH-së për vitin 2022, nuk faturohet, pasi një pjesë e konsiderueshme humbet si pasojë e amortizimit të rrjetit, ndërsa një pjesë tjetër vidhet nga ndërhyrjet e paligjshme, por sidomos nga faturimi aforfé.

Po t’i referohemi Fierit, fshatra të tëra dhe lagje qyteti vazhdojnë dhe sot të jenë pa ujë të pijshëm, pas shume vitesh drejtim të pushtetit qendror e vendor nga ana juaj. Me shumë probleme paraqiten shumë njësi vendore. Në njësinë vendore Levan, në fshatrat Qarr, Pish Poro, Boçovë, Shtyllas, në njësinë vendore Frakull, sidomos fshati Peshtan, është shumë e konsiderueshme mosardhja e ujit nëpër çezma. E njëjta gjë edhe në njësitë e tjera vendore, si Dermenas, Topojë, Libofshë, Mbrostar, Qendër, Portëz dhe shumë fshatra të tjerë të këtyre njërive vendore, të cilat vuajnë mungesën e ujit të pijshëm për shkak të humbjeve në rrjet, dhe mungesa e furnizimit me ujin e pijshëm, që në të vërtetë është i papijshëm dhe shpeshhere nuk përdoret as për t’u larë, pa përmendur këtu faktin se të gjitha lagjet e qytetit përdorin pompa dhe depozita uji nëpër tarracat e pallateve. Absolutisht që shumë lagje të qytetit janë pa kanalizime të ujërave të zeza, ndërkohë që vazhdohet ende me gropat septike.

Banorët ankohen për faturimet aforfé dhe për cilësinë e ujit, i cili përmban shumë materiale inerte, që jo pak herë ka nxjerrë jashtë funksionit pajisjet hidraulike në shtëpitë e banorëve si në fshat ashtu, edhe në qytet. Po kështu, tarifa mujore që prej dhjetorit të vitit 2021, nga 2350 lekë u rrit në 3130 lekë në muaj. Tek shumë konsumatorë mungesa e sahateve nëpër shtëpi është një nga shkaqet kryesore për këto pagesa të larta.

Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit konstaton se Ujësjiellësi i Fierit merr më shumë pará nga konsumatorët në raport me ujin që ata konsumojnë. “Afro 30 % e konsumatorëve nuk janë të pajisur me matës, duke bërë që shitja e ujit të mos llogaritet në bazë të konsumit real të vlerësuar nëpërmjet aparateve matës”

Ujësjiellësi i Fierit nuk e ka bërë bilancin e ujit, nuk ka bërë një analizë të humbjeve teknike

apo menaxheriale, dhe as ka një plan të detajuar për numrin e konsumatorëve që nuk kanë matës. Nuk po zgjidhen shumë problematika që kanë të bëjnë me cilësinë e furnizimit, kohëzgjatjen, faturimin, por dhe vetë çmimin e ujit.

Për ironi, ju theksoni se është krijuar dhe funksioni i pranimit online të ankesave të konsumatorëve nëpërmjet faqes së re zyrtare të Entit Rregullator të Ujit. Nuk arrij të kuptoj se ku e keni kufirin midis propagandës dhe realitetit. Ju e dini po aq mirë sa dhe ne, që në Shqipëri institucionet nuk të përgjigjen edhe kur shkon e ankoresh fizikisht, e jo më online. Ankesat e klientëve bien në vesh të shurdhër ose ndeshen me arrogancën e heshtjes së zyrave tuaja. Nga ana tjetër, duhet të theksojmë se plot banorë të Fierit ankohen për taksat lokale, që ndryshojnë vazhdimisht sipas oreksit të bashkisë dhe hidhen gjithmonë te faturat e ujit. Nuk jepet asnjë lloj shpjegimi në lidhje me këto gjëra.

Një nga problematikat e tjera më të mëdha, sikurse në të gjithë shërbimet publike, mbetet edhe punësimi partiak. Mbi 70 % janë rritur punësimet në ndërmarrjen e ujësjellës-kanalizimeve, aq më tepër tani, në prag të fushatës elektorale për zgjedhjet vendore është zakoni të shtohen sa ma shumë, madje duke u dhënë gjysmën e pagës për të shtuar numrin e punonjësve e për të shtuar votat.

Në raportin e tij, Kontrolli i Lartë i Shtetit vë në dukje se ka shkelje të rënda procedurale në rekrutimin e punonjësve të rinj. Rritja e madhe e të punësuarve militantë, por dhe shumë shkarkime me kontekst politik, kanë ndodhur këto vitet e fundit edhe në Ujësjellësin e Fierit. Ka një disbalancë të madhe mes parave që shkojnë për investime dhe parave që shkojnë për pagat e punonjësve. Më shumë para shkojnë për pagat e punonjësve, për të punësuar sa më shumë njerëz, sa më shumë vota, sidomos në prag fushate.

Kolegë deputetë.

Reforma në sistemin e Ujësjellësve është po aq e rëndësishme e me dobi strategjike sa edhe ajo në arsim, shëndetësi, drejtësi, siguri e rend. Në këtë kuptim, unë mendoj se Kuvendi duhej të kishte zhvilluar një debat të gjerë dhe të gjatë në komisione parlamentare, por dhe në hapësirën publike, me të gjitha institucionet, me ekspertët e pavarur të sektorit, biznesit e të tjera si këto. Asgjë nuk u bë nga këto konsultime, sikurse dhe shumë herë të tjera kur diskutohet për reforma

strategjike, dhe ja ku vijmë sërish në një proces rutinë dhe shumë burokratik votimi si për këtë ligj, ashtu edhe ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Për shembull, ne nuk e kemi të qartë se çfarë do të rezultojë nga kjo reformë, reforma e ujësjellësve, lidhur me tarifat e reja të ujit që do të diktohen nga politikat e reja të 15 shoqërive lokale të ujësjellësve, që ju destinoni nëpërmjet kësaj reforme...

*(Bie gongu.)*

... investimet, humbjet në furnizimin me ujë, lidhjet e paligjshme, mbi dhe nën faturimet e të tjera si këto.

Gjithsesi, e di se të gjitha ato që ne themi këtu ju i merrni në mënyrë të ndërgjegjshme si diskutime politike dhe bëni çmos të dezinformoni qytetarët, kur në të vërtetë nuk janë të tilla, gjë që e tregojnë vetë faktet. Por për këtë situatë, të paktën në sektorin e ujit, qytetarët që na dëgjojnë, qofshin demokratë apo socialistë, na ndjekin me vëmendje dhe e dinë vetë se cila është e vërteta, për arsye se u rëndon mbi kurriz.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Baçi!

Neni 48 i Rregullores, pika e parë, paragrafi i fundit, thotë qartësisht: kur diskutimi është jashtë thelbit të çështjes...

*(Deputeti Baçi flet nga salla.)*

Ju lutem, uluni!

Drejtuesi i seancës, kur e sheh të arsyeshme, i tërheq vëmendjen deputetit. Nëse ai e përsërit, mund t’ia ndërpresë fjalën.

*(Deputeti Baçi ndërhyr nga salla.)*

Edhe një herë, zoti Baçi, ju sugjeroj që herë tjetër të mos i nënshtroheni masës së ndërprerjes së fjalës, por t’i përmbaheni rendit të ditës ose të regjistroni te diskutimet e lira, nëse nuk keni asgjë për të thënë për rendin e ditës.

*(Deputeti Baçi ndërhyr nga salla.)*

Ju folët vetëm 30 sekonda për rendin e ditës dhe shpenzuam më shumë se nëntë minuta të tjera për çështje që s’kishin lidhje me rendin e ditës. Rendin e ditës nuk e imponon drejtuesi, por e miraton Konferenca dhe Kuvendi. Askush këtu nuk mund të marrë fjalën për çështje që s’kanë të bëjnë me rendin e ditës. Ky ishte një paralajmërim për ju, një kujtesë për ju në lidhje me Rregulloren, në mënyrë që pastaj të mos ju vijë çudi pse ju ndërpritet fjala.

*(Deputeti Baçi ndërhyr nga salla.)*

Zoti Baçi, ju kujtoj edhe një herë që folët më shumë se dhjetë minuta dhe folët jashtë rendit të ditës.

Zonja Resulaj!

**Pranvera Resulaj** – Faleminderit, e nderuar drejtuese e seancës!

Në fakt, çdo ndryshim ligjor i propozuar në legjislacionin fiskal, që nga koha kur Partia Socialiste është mazhorancë në këtë vend, ka vetëm një qëllim: taksim i drejtë dhe i ndershëm, në fakt bazuar në logjikën e artë fiskale, sipas të cilës kush fiton më shumë, paguan më shumë.

Ndonëse, për hir të së vërtetës, ndryshimet e shpeshta në legjislacionin tatimor nuk janë të pëlqyera, e jo vetëm për sipërmarrjen, po edhe për administratën fiskale, për shkak të çorientimit që ato mund të krijojnë, ato kanë pasur një qëllim të vetëm: të përmirësojnë sistemin tatimor shqiptar, i cili është i bazuar në vetëdeklarimin dhe monitorohet e kontrollohet nga administrata fiskale, fokusi i të cilës ka qenë përmbushja vullnetare në lidhje me deklarimin dhe pagesën e detyrimeve tatimore në nivel entiteti e individit. Nxitja e vetëdeklarimit dhe e vetëkorrigjimit ka qenë, gjithashtu, në mënyrë të drejtë e të ndershme fokusi i kësaj administrate, për të kapërcyer mangësitë e krijuara qoftë për shkak të administratës, qoftë për shkak të hapësirave boshe që kanë pasur sipërmarrjet si rrjedhojë e mungesës së kulturës fiskale.

Në këtë frymë, edhe projektligji “Për tatimin mbi të ardhurat” ka për qëllim përmirësimin e sistemit tatimor shqiptar, përputhjen me direktivën e BE-së dhe adresimin e mangësive e të boshllëqeve legislative, të konstatuara gjatë periudhës 23-vjeçare të aplikimit të ligjit ekzistues. Projektligji propozon futjen në skemën e tatimit nga 1 janari i vitit 2024 të bizneseve furnizuese të shërbimeve, kryesisht profesioneve të lira, duke tentuar të frenojë fenomenin e diferencës së tatimit të paguar nga punonjësit me paga të mesme apo të larta, krahasuar me tatimet e paguara nga profesionet e lira ose ofruesit e shërbimeve në tërësi.

Meqenëse jemi tek tatimi me 23%, në fakt, dua të risjell në vëmendje se kemi dëgjuar me shumë kujdes, me shumë respekt të gjithë përfaqësuesit ose grupet e interesit të profesioneve të lira, kryesisht ekspertët kontabël dhe kontabilistët e miratuar, të cilët kanë ngritur një shqetësim. Dhe me thënë të drejtën, unë

mendoj se ky është shqetësimi më i drejtë që ata kanë ngritur, pasi ka të bëjë jo thjesht me shkallën tatimore të aplikuar tashmë, por edhe me informalitetin ose me bazën e tatimpaguesve. Në fakt, ai është një shqetësim që edhe ne e kemi ngritur gjithmonë, por edhe pse ka përmirësim të jashtëzakonshme, kjo për shkak edhe të konsolidimit dhe të miradministrimit fiskal, përsëri ka vend për të përmirësuar rritjen e bazës të tatimpaguesve.

Në njëjtën kohë, duhet që kjo barrë të mos ngarkohet vetëm tek ata që kryesisht janë të rregullt në pagesa. Dua të them me shumë respekt se të gjithë ekspertët kontabël, të gjithë kontabilistët janë ajo kategori e profesioneve të lira, të cilët ne i kemi dëgjuar më së shumti, pasi kanë edhe përgjegjësinë morale, që të edukojnë tatimpaguesit për të qenë korrektë dhe të rregullt me zbatimin e legjislacionit tatimor.

Për të vazhduar më tej, projektligji e ndan tatimin mbi të ardhurat në 3 kategori: të ardhurat nga punësimi, të ardhurat nga biznesi, të ardhurat nga investimi. Të ardhurat nga punësimi dhe të ardhurat nga biznesi do të taton sipas një sistemi progresiv, ashtu siç u përmend gjatë gjithë ditës sot, me shkallë tatimore 13% dhe 23%, 13% për pagat nga 0 deri në 200000 lekë në muaj dhe 23% për pagat mbi 200000 lekë në muaj, ndërsa të ardhurat nga biznesi do të taton progresivisht me normat 15% dhe 23%. Kështu, norma 15% do të jetë për të ardhurat e tatueshme vjetore deri në 14 milionë lekë dhe 23% për të ardhurat e tatueshme vjetore mbi 14 milionë lekë.

Ndërkohë, dua të ndalem në një moment tjetër të projektligjit, te shqetësimi që për çdo ndryshim ligjor mund të krijohet mundësia për evazion. Kuptohet që çdo shtrëngesë e barrës fiskale do të shoqërohet me tendencën që ka sipërmarrja (ndodh zakonisht, por nuk është taksative) për të gjetur hapësira, për të shmangur detyrimet apo për të kryer evazion. Në fakt, edhe nga diskutimet që kemi pasur në komision me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, pyetja, shqetësimi që kemi ngritur ka qenë: nëse tatimi do të shkojë 23% për mbi 14 milionë të ardhura vjetore, sa do të ndikojë kjo gjë, që sipërmarrja të tentojë ta mbajë këtë të ardhur nën 14 milionë, në mënyrë të tillë që të shmangë kalimin e tatimit nga 15% në 23%?

Edhe një herë dua të ritheksoj dhe të sjell në vëmendje se përmirësimet e vazhdueshme në

administrimin fiskal kanë bërë që informaliteti dhe evazoni të reduktohet ndjeshëm, por përsëri, për sa kohë që jemi ende duke folur për këtë lloj argumenti, do të thotë se ky është me të vërtetë një shqetësim real, të cilin e kemi edhe ne si mazhorancë.

Për të vazhduar më tej, të ardhurat nga indeksimi, nga kapitali pasiv më saktë, do të tatonen me 15% veç tatimit mbi dividendin, që është 8%. Pikërisht, qëllimi është që personat fizikë, të cilët nuk kanë detyrimin të deklarojnë dividendin, të përfitojnë nga ky 15%-ësh, duke shmangur tatimin mbi dividendin 8%. Në këtë rast kemi një lloj barazie për sa i përket tatimit që paguan një person fizik me 15% dhe 8% të dividendit që paguan një person juridik. Pra, ka një lloj barazimi, 23% me 23%. Pikërisht ky është edhe qëllimi i këtij projektligji, i cili ka parashikuar, gjithashtu, edhe zbritjet nga barra tatimore me 48000 lekë nga baza e tatimit të punëmarrësit, për çdo fëmijë në ngarkim të tij me moshë më pak se 18 vjeç, dhe zbritje 100000 lekë për arsimimin e çdo fëmije në ngarkim të tij. Kjo do të thotë se barra fiskale për të punësuarit nuk rritet, përkundrazi, do të ulet më tej.

Projektligji ruan skemën aktuale të taksimit me tarifën 13% dhe 23%, sikundër e thamë. Tarifa 0% zëvendësohet me sistemin e zbritjes nga baza e tatimit dhe, gjithashtu, për ta theksuar edhe një herë, barra fiskale nuk është ashpërsuar për ato që në të vërtetë janë shtresat që fitojnë më pak dhe që kanë më tepër nevojë. Kjo do të thotë se pagat 0 deri në 40000 lekë muaj, por edhe pagat në fashën mbi 40000 deri në 50000 nuk do të paguajnë tatim. Për një tatimpagues me të ardhura në masën 50000 lekë në muaj, tatimi për të ardhurat nga punësimi do të jetë 15600 lekë më pak.

Ndërkohë, numri i përfituesve është 65000 tatimpagues. Njëkohësisht, lehtësohet barra tatimore për të gjithë tatimpaguesit me të ardhura nga punësimi në fashën 50000 deri në 60000 lekë, të cilëve nga 30000, që ishte e ardhura e tatueshme me 0%, tashmë u njihet një zbritje tatimore prej 35000 lekësh në muaj, duke pasur edhe këta përfitimet përkatëse.

Dua t'i rikthehem edhe një herë asaj që është e rëndësishme dhe që ne e përsërisim vazhdimisht: barra tatimore për këta punonjës nuk është ashpërsuar. Kjo është një tendencë për shkuar drejt tatimit të drejtë. Sigurisht, kemi edhe diferencime dhe kjo mund të përkthehet në ndonjë

moment të caktuar edhe si diskriminim. Në fakt, diskriminimi nuk vjen për shkak të diferencave apo të shkallëve tatimore të ndryshme (përfshirë këtu edhe përjashtimin nga tatimi, nga TVSH-ja apo nga tatime të tjera për të gjithë tatimpaguesit me qarkullim deri në 14 milionë lekë në vit), pasi këto përjashtime kanë pasur dhe kanë një qëllim të vetëm: përdorimin e tyre si stimuj fiskalë për të nxitur biznesin në këtë vend, për të nxitur biznesin e vogël dhe biznesin e mesëm kryesisht, si dhe për t'i dhënë mundësi dhe hapësirë frymëmarrjes ekonomike të vendit. Sigurisht, ky lloj përjashtimi është i kufizuar në kohë, pasi do të jetë deri në vitin 2029, ashtu sikundër e thekson edhe ky projektligji, për t'i dhënë hapësirën e nevojshme të gjithë biznesit të vogël dhe të mesëm, të gjithë të vetëpunësuarve për të përfituar nga kjo lehtësirë fiskale, sepse, ashtu sikundër e kemi thënë, qëllimi është që, si Parti Socialiste, me politikën tona sociale të jemi në mbështetje të të gjithë atyre që kanë më tepër nevojë, edhe kur është një përjashtim nga ai që quhet "rregulli fiskal".

Për ta përfunduar, për të kërkuar mbështetjen për këtë projektligj, si dhe për të bashkuar votën time me kolegët, dua të them se nga të gjitha pafuqitë që mund të ketë një forcë politike, ajo më shkatërruesja mendoj se është pafuqia morale për t'u ballafaquar dhe për t'u përballur me zgjedhësit e vet. Për fat, ne nuk e kemi këtë lloj pafuqie, pasi jemi gjithnjë në përkrahje të njerëzve, duke u përmirësuar, sepse nuk jemi duke thënë se kemi bërë më të mirën për qytetarët, por themi se çdo ditë po vazhdojmë të bëjmë më të mirën për ta.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Leskaj.

Teknika, ju lutem, zoti Leskaj e kërkon fjalën nga vendi!

**Bujar Leskaj** - Diskutimin e sotëm dua ta filloj disi ndryshe.

Së pari, dua të falënderoj deputeten që sapo foli, doktoren e shkencave Pranvera Resulaj, sepse ishte nga të paktët deputetë të mazhorancës që foli me profesionalizëm, larg politizimit të diskutimit të ligjit! Shumë më mirë bëri, sepse foli larg atyre që dëgjuam sot, pasi pjesa më e madhe e deputetëve të mazhorancës përpiqen t'i japin leksione opozitës. Qëllimi i diskutimit të këtij projektligji nuk është që ju të jepni vlerësimet, konsideratat, mësimet dhe rekomandimet tuaja

për opozitën, por ne duhet të diskutojmë për projektligjin.

Këtu pati edhe deputetë të veçantë që folën, dhe unë, personalisht, ruaj respekt për zotin Gogu, por ai arriti deri aty sa na quajti “opozitë e hardallosur”, domethënë, pa kuptim fare, pa lidhje, sepse ne po diskutojmë një projektligj tërësisht teknik, për të cilin mund të debatojmë, të flasim për pikëpamjet tona, të debatojmë me ministren, me kryetarin e Komisionit të Ekonomisë dhe me deputetët e tjerë, por jo të atakojmë njëri-tjetrin.

Për të kthyer një përgjigje, por jo me ndonjë tendencë, m'u kujtua një histori që e kam lexuar te romani “Mashtuesi” i shkrimtarit të mirënjohur Shpendi Topollaj, ku tregohet një histori në malësi nga një veteran partizan, për partizanët që qëndruan në Malësi deri në vitin '45, për t'ua mbushur mendjen malësorëve që të votonin për Partinë Komuniste, duke u thënë se do të hanin me lugë flori. Ndërkohë, në një odë tipike malësore ishin mbledhur të gjithë malësorët (në roman shkrimtari e përshkruan që kanë qenë te xhaxhai i Muharrem Bajraktarit) dhe në një moment, xhaxhai i Muharrem Bajraktarit, malësor fin, tipik, fisnik, i zgjuar, i thotë komandantit të kompanisë, që ishte lab, kuptohet, edhe atyre partizanëve të tjerë: “Këtu në malësi, kur martohet dikush, kur bëhet dasmë, bien daullet dhe gëzojnë njerëzit. Kur zbulohet nusja dhe ajo del e bukur, daullet pushojnë dhe atëherë njerëzit thonë: “Lum ata për nusen që kanë marrë”. Kur zbulohet nusja dhe del e shëmtuar, daullet vazhdojnë të bien, që të mbulojnë zhurmën e madhe dhe njerëzit thonë: “Të shkretët ata për nusen që kanë marrë!””.

Tani, të gjithë profesionistët që po ju dëgjojnë ju sot, që flisni me daulle dhe tamtame, duke mbrojtur këtë ligj me ditirambe dhe sulmoni opozitën, thonë: “Të shkretët ne për qeverinë që kemi, të shkretët ne për mendimet dhe për konsideratat që ju keni për të vetëpunësuarit, për profesionistët e të tjerë”. Mund t'ju tregoj edhe faqen e librit që mora si shembull, sepse, për fat, librin e kam këtu. Nuk është sagesë imja, kuptohet.

Projektligji i rishikuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili ndër të tjerash parashikon normë tatimi 15% për individët tregtarë dhe të vetëpunësuarit me xhiro deri në 14 milionë lekë, si dhe normë tatimi 23% për subjektet me qarkullim vjetor mbi 14 milionë lekë, vijon të

karakterizohet nga një pabarazi e theksuar tatimore, pavarësisht rishikimeve që u bënë, pasi tejkalon bazën tatimore të biznesit të vogël në raport me biznesin e madh. Ky projektligj, si frymë, nuk e përkrah, por, përkundrazi, e godet shtresën e mesme dhe grupin e profesionistëve. Drejtpërsëdrejti ky projektligj thellon dhe inkurajon, përmes politikës tatimore që vendos, largimin e ekspertëve nga vendi, largimin edhe të kësaj shtrese të mesme.

Për oligarkët tuaj, për klientët e qeverisë, ju jeni treguar shumë të kujdesshëm. Për shembull, ju kujdesoheni të theksoni përsëri në dispozitat kalimtare të ligjit, në nenin 69/“b”, përjashtimin nga tatimfitimi për pronarët e hoteleve *brand name* me 4 apo 5 vje, ndërsa shtresën bazë të shoqërisë, që dikton konsumin, shtresën e mesme, e lini pa përkrahje.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk tërhiqet nga zbatimi i tatimit progresiv nga 15% deri në 23% për profesionet e lira dhe për biznesin e vogël. Kontabilistët, ekspertët fiskalë dhe avokatët, përmes shoqatave të tyre ngrenë shqetësimin se rishikimet e fundit në draft nuk sjellin asnjë ndryshim, përveç disa përmirësimeve teknike. Sipas tyre projektligji nxit pabarazinë mes tatimpaguesve dhe evazionit. Juristët, nga ana tjetër, të inkuadruar edhe në shoqatat e tyre, pohojnë se drafti është antikushetues, për shkak të trajtimit të pabarabartë tatimor. Kjo është një armatë e madhe njerëzish me mbi 17000 profesionistë.

Të gjitha shoqatat e biznesit, si Dhoma Amerikane e Tregtisë apo shoqatat e profesioneve të lira, si Instituti i Kontabilistëve të Miratuar, IEKA, Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Shoqata e Avokatëve Penalistë e të tjera, janë shprehur kundër draftit të qeverisë, janë shprehur edhe në këtë periudhë 4-5 mujore, që nga nëntori, gjatë së cilës ju po e diskutoni projektligjin.

Pak ditë më parë, për shembull, Dhoma Amerikane e Tregtisë kërkoi që ky projektligj, që është baza e sistemit tatimor, të garantojë nxitjen e produktivitetit të ekonomisë dhe punës së kualifikuar. Në fakt, drafti, edhe pse ju pretendoni që është i përmirësuar (ka shumë përmirësime kozmetike), bën të kundërtën. Instituti i Ekspertëve të Certifikuar Kontabël (IEKA) apo Instituti i Kontabilistëve të Miratuar, theksoi se vërejtjet e tyre nuk janë marrë në konsideratë. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë nuk ka bërë ndryshime për profesionet e lira nga varianti që është paraqitur në periudhën nëntor - dhjetor 2022, që është diskutuar

atëherë. Profesionet e lira do të tatonen me 15%. Ky projektligj i taton profesionistët e vetëpunësuar, duke i konsideruar në mënyrë të paligjshme dhe jokushtetuese të ardhurat e tyre si të ardhura nga paga, duke i trajtuar me 23%.

Përveç rishikimeve teknike, siç e theksova më parë, thelbi i projektligjit mbetet i njëjtë. Të gjithë profesionistët shprehen se ky trajtim i të ardhurave të të vetëpunësuarve si të ardhura nga paga është antiligjor. Shtrirja e ligjit tek të vetëpunësuarit e profesioneve të lira, për mendimin tim, për shumë arsye, do të sjellë efekte negative. Të vetëpunësuarit janë biznese, marrin përsipër rreziqe, nuk kanë të ardhura të fikse dhe të ardhurat e tyre nuk mund të quhen kurrsesi të ardhura nga paga. Projektligji është evaziv, pasi i konsideron njësoj si të vetëpunësuarit, ashtu dhe të punësuarit në sektorin privat apo shtetëror. Klasifikimi është i gabuar. Nuk po jap shembuj për efekt kohe.

Ndryshimet te draftligji i rishikuar krijojnë njësoj pabarazi mes tatimpaguesve. Askush nuk është kundër pagesës së taksës për profesionet e lira, por nëse një kategori biznesesh nuk paguan, nuk kanë pse të paguajnë profesionet e lira. Projektligji që shënjestron profesionet e lira, në thelb është në kundërshtim me frymën që duhet të ketë një qeveri kombëtare për të inkurajuar, për të krijuar, për të konsoliduar shtresën dhe klasën udhëheqëse edhe në biznes, për të siguruar punësim, të ardhura dhe zhvillim. Është kjo shtresë që në thelb trajton ekonominë dhe konsumin. Ajo nuk duhet të goditet, përkundrazi duhet të mbështet që të ketë mundësi të investojë, të zhvillojë vetveten sa më shumë. Pavarësisht përmirësimeve teknike të vogla, që i janë bërë projektligjit, praktikisht tatimi ndaj profesioneve të lira barazohet me tatimfitimin e korporatave. Tatimfitimi 23% është njësoj sa tatimfitimi 15%, plus dividendin që paguhet te korporata. Në raport me volumin, në raport me potencën, kuptohet që kjo normë tatimi është shumë e lartë. Ne të gjithë e dimë, ne të gjithë e kuptojmë, por ju s' doni ta pranoni, sepse jeni të detyruar të votoni, por bizneset e lira janë promotoret e ekonomisë. Ato nuk duhet të trajtohen me norma tatimore të barabarta me ato të korporatave, pasi kurrsesi nuk ka asnjë shpjegim teorik apo praktik në literaturë në të gjithë botën që mund t'i konkurrojnë ato. Në këtë mënyrë, me këtë politikë që po ndiqni, në thelb ju kontribuoni për shtimin, për zgjerimin e emigracionit. Pas infermierëve, pas mjekëve, pas të tjerëve shumë shpejt do të shikojmë që edhe grupe juristësh,

avokatësh, kontabilistësh do të vazhdojnë të largohen nga vendi. Kjo nuk është politikë. Ju trumbetoni se punë ka, por nuk ka profesionistë. Me këtë që po bëni jeni duke i goditur edhe këta profesionistë, jeni duke goditur të ardhmen e vendin, që, për hir të së vërtetës, në vendin tonë, në Shqipëri janë krijuar dhe po konsolidohen mbas vitit 2000.

Të nderuar deputetë, duhet të kemi në vëmendje që këta profesionistë janë të konsoliduar në një shtet të brishtë si Shqipëria dhe me problematikat që ajo ka. Me këtë ligj, kur të hyjë në fuqi, ju riçelni një sezon tjetër të 'gjuetisë së shtrigave' për biznesin dhe profesionet e lira. Kjo më tepër do të ngajë apo do të ketë efekt si një lloj tjetër lufte klasash, e cila, për fat të keq, e ka mbajtur vendin tonë 45 vjet dhe ende e mban, pasi ka reminishencat e saj në momente dhe në zhvillime të caktuara të vendit.

Nga ana tjetër, ky projektligj ushqen evazionin fiskal. Taksimi i të ardhurave të të vetëpunësuarve me 15% do të nxisë informalitetin, duke rritur nivelin e ekonomisë gri. Projektligji rishikuar "Për tatimin mbi të ardhurat" e nxit dhe e ushqen çdo çast shmangien tatimore. Problemi kryesor te ne, krahas politikave fiskale apo barrës tatimore të të drejtave të barabarta, është edhe administrimi tatimor. Rryshfeti, klientelizmi dhe mungesa e ekspertizës në të gjithë vertikalletin e piramidës tatimore, janë elementet që e deformatojnë sistemin, duke e shndërruar në mosfunksional. Këtu bashkohem me shqetësimin që ngriti kolegu Braçe, në një formë tjetër për sa i përket kësaj. Drafti qeveritar...

**Ermonela Felaj** – Zoti Leskaj, ka mbaruar koha dhe keni marrë gati 2 minuta më shumë mbi kohën e caktuar.

**Bujar Leskaj** - Edhe 37 sekonda.

**Ermonela Felaj** – Po si ta bëjmë këtë gjë?

**Bujar Leskaj** - Si të doni. Kisha ndër mend të thosha disa fjalë të mira për ligjin, por nuk...

**Ermonela Felaj** – Kur do të mësojmë të flasim 10 minuta?

**Bujar Leskaj** – Jemi të mësuar, por, për të thënë të drejtën...

**Ermonela Felaj** – Unë edhe *relax*-in që na dhuroat me përshkrimin e romanit të Shpend Topollajt, jua njoha si gjë.

**Bujar Leskaj** - Mbulove veshët nga daullet.

**Ermonela Felaj** – Mbaroi koha.

Ju lutem, t'u lëmë kohë kolegëve të tjerë!

**Bujar Leskaj** - Në rregull.

**Ermonela Felaj** – Radhën e ka zoti Agron Shehaj, por nuk është në sallë.

Zoti Xhafaj është tërhequr.

Zoti Vasili, fjala është për ju.

**Petrit Vasili** – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa diskutim, ligji që kemi nëpër duar dhe që po diskutojmë sot, është një ligj shumë i veçantë, por jo për sa i takon peshës ekonomiko-financiare të tij, pasi kuptohet që në fillim se kjo është një peshë ekonomiko-financiare e papërfillshme në raport me të ardhurat dhe problemet e buxhetit, por nga të gjitha pikëpamjet që ta shikosh, ky është absolutisht një ligj provokativ.

Së pari, është një ekzaltim i pabesueshëm të shikosh se si diskutojnë kolegët në të majtë për atë të ashtuquajturën “drejtësi e madhe” që bëhet me ligjin. Kushdo që e dëgjon do të pyesë: cila është drejtësia? Sepse të njëjtat kategori biznesesh të ndryshme, që realizojnë një xhiro të caktuar dhe disa të tjerë me të njëjtën xhiro, disa janë me 0%, ndërsa disa mund të shkojnë deri në 23%. Kjo është drejtësia? Ju keni të drejtë të flisni dhe të thoni çfarë të doni, por hiqini iluzionet që njerëzit janë budallenj dhe që do t’u impononi një budallallëk të padëgjuar. “Drejtësi, se do t’i trajtojmë në mënyrë të pabarabartë”, këtë thotë ky projektligj. Çfarë tregon tjetër projektligji? Ka qëndrueshmëri fiskale? Ka seriozitet fiskal? Zero! Po si mund të ndryshojë kjo në mënyrë të vazhdueshme? Po mirë, le ta heqin veten e tyre nga kjo sallë dhe të kthehen të bëjnë biznes. Po si mund t’i bëjnë llogaritjet e tyre kur këto ndryshime janë të njëpasnjëshme dhe të vazhdueshme? Po çfarë plani biznesi do të bëjnë këta? Si do t’i bëjnë llogaritë, kur nga sot, nesër i teket qeverisë të shpikë këto barazitë e pabarabarta që vetëm këta i kuptojnë? Për çfarë bëhet fjalë tjetër? A shkon ky ligj në një drejtim tërësisht negativ lidhur me varfërimin e vendit në vlera dhe në kapitale profesionale? Absolutisht po. Merreni, shikojini se cilat janë kategoritë që trajtohen në të, janë mbi 17000 mijë. Po cilët janë? Pa dëgjoni: janë mjekët. Mjekët po na ikin, ndërkohë këta u shtojnë edhe tatimet mjekëve, që të ikin edhe më shumë. Kaq është mendjehapja e këtyre, se po bëjnë drejtësi që ata të ikin. Janë agronomët. Po, më mes të natës na i kërkon e gjithë Europa, pa vështirësi fare, pa njohje diplome, aq i preferuar është profesioni i agronomit në Europë. Edhe ky profesion është në këtë ligj. Veterinerët po ashtu, mjekët e laboratorëve, gjithashtu, janë shumë të kërkuar në shumë vende të mëdha të Europës. Ndërkohë, ne këtu zbatemi. Sigurisht, nëse shërbimet që ofrojnë këta profesionistë i merr gjëkund se ke para, patjetër që nuk është problem, por jo për njerëzit e thjeshtë.

Po më tutje çfarë profesione ka? Arkitektë, gjithashtu. Po më tutje çfarë ka? Vlerësues të pasurive, ekspertë kontabël, dentistë dhe plot të tjerë, avokatë po e po. Po kaq të pasur jemi ne si popull, me 2 milionë e ca njerëz, që mpaket e mpaket, sa edhe këtyre profesionistëve po u japim dërrmën e fundit dhe duam t’i largojmë? Po mirë, le të mbetet këtu ndonjë fillestar mediokër, i cili do të mbyllë sytë dhe do të bëjë kamikazin, duke vënë firma për t’u futur në shtet dhe ne të mbetemi të shkretuar në këtë drejtim. Kjo pjesë e shoqërisë përbën jo vetëm shtresën e mesme shqiptare, por njëkohësisht përbën atë që është truri i vendit. Vendi ka nevojë për tru, nuk është i decelebruar si listat që sillni ju, të decelebruara nga themeli në krye. Ky decelebrim shpjegohet vetëm me ekzaltimin, me buzëqeshjen dhe me kënaqësinë duke thënë: “Ftojme popullin shqiptar ta mirëkuptojë nismën, se ne po e sakatojmë”.

Po sa janë efektet e nismës? Janë 2 miliardë lekë të rinj. Po mirë, a skuqeni një çikë? Po ju rreth 20 milionë euro keni një kilometër rrugë dhe nuk e keni problem që ua kërcisni bap e bap parave. Llogarinë jua prishkan këto 17 milionë eurot që do t’i merrni gjithësesi nga këta?! Këtu u prish llogaria? Po ju i keni me miliarda historitë, sepse lini nga 90 milionë euro në ditë për inceneratorin këtu në Tiranë, pasi fatura e inceneratorëve në total është firifiu. Fatura e inceneratorëve është aq sa do të merrni nga profesionet e lira për 30 vjet. S’ju vjen zor! Kaq është, 2 miliardë, vetë e keni shkruar. Edhe thoni: “Kjo e siguron drejtësinë sociale, kjo e konsolidon buxhetin”. Na i kurseni këto budallallëqe, aman të keqen! Na i kurseni, se është vërtet qesharake. Pastaj, shkoni e shikoni çfarë bëhet lart e poshtë! Si përpiqen të mbrohen këta profesionistë? Ata nuk janë thjesht profesionistë, por janë kualitete intelektuale. A e vrisni mendjen ndonjëherë sesa kohë i duhet secilit prej tyre të formohet, që të marrë atë status profesional, që mund të bëjë një punë thellësisht profesionale, ku mund të ketë edhe elemente shkencore brenda? Por ju, meqenëse u keni thënë “sikter” librave, nuk e keni fare problem, çdolloj sharlatani, kushdo që të jetë, mjafton t’i jepni vetë ndonjë diplomë të sajuar, se këta profesionistë të mirë nuk ju duhen.

Sigurisht, projektligji në formën e tij, qoftë për arrogancën, qoftë për arbitraritetin, qoftë për mënyrën sesi i trajtojnë këta profesionistë është një neveri, kur shikon se atje ku duhet të ishte përkujdesja për ta mbajtur, për ta ruajtura këtë shtresë, për të bërë të gjithë së bashku një sakrificë, kjo nuk ndodh.

Siç e thashë, në këtë periudhë decelebrimi të shoqërisë, të humbjes së jashtëzakonshme të vlerave, shpopullimi i ka kapur të gjitha shtresat përveç njerëzve me një arsim më të kufizuar (por që me sa duket nuk e ka kursyer edhe këtë shtresë), në mënyrë të veçantë disa profesione më delikate, ku në krye të listës kemi mjekët. Po çfarë po bëjmë me këtë projektligj? Po u japim atë që quhet “*colpo di grazia*”. Merreni edhe këtë goditje tjetër, që të mos keni asnjë motiv për të ndenjur këtu, sepse kjo është qeveria e padrejtësive, që i shet për drejtësi.

Është e qartë që ky veprim nuk ka për të sjellë asgjë gjë të re, por, sigurisht, do të stimulojë një evazion fiskal të paevitueshëm, që lidhet me mbijetesën; do të sigurojë që të gjithë këta profesionistë të jenë të shqetësuar, pavarësisht se puna e tyre është shumë më e vështirë. Këto profesione nuk kanë të adhurua fikse të garantuara. Këta profesionistë luftojnë përditë për mbijetesën e tyre, për të mbajtur veten e tyre dhe përveç problemit të madh të tregut dhe të një shoqërie ku lahen dhe shpëlahen paratë...

Të paktën këtë nuk na e mohoni, sepse në listën gri të pastrimit të parave nuk ju ka futur opozita, por ju ka futur Europa.

Pra, në këtë lloj informaliteti, ku valon paraja e pistë, ku valon konkurrenca e pandershme, në këtë mjedis punojnë këta njerëz, dhe sikur të mos mjaftojë kjo u shtohet edhe armiku përfundimtar: shteti. Nuk mjafton sfida e mbijetesës çdo ditë, por kanë edhe korbin e zi, shtetin, aty në kurriz, që u flet për barazi në emër të pabarazisë, sepse ky ligj kryekëput është vetëm pabarazi. Njëkohësisht, këta u tregojnë shqiptarëve që vizionin e kanë sot e për gjashtë muaj, sot e për një vit. Kështu bëjnë me taksat dhe tatimet, kështu bëjnë me energjinë, që sot mendojnë t'i vënë fashë dhe nesër në mëngjes, nëse bie një re shi, e heqin fashën. Me një fjalë, qeveri 24-orëshe. Një turp i madh për kualitetin e performancës së saj. Dhe në fund të fare, kjo qeveri gjeti zgjidhjen e mrekullueshme, duke menduar se zhvillimi i madh, hovi i madh që do të merrte buxheti, është pikërisht te 2 miliardë lekët e profesioneve të lira.

Sot ju them me bindje të plotë që secili që do ta votonte këtë ligj, duhej të skuqej shumë kur të dilte në rrugë dhe të shikonte (flas për ata që kanë profesion) kolegët e vet, profesionistët, e t'u thoshte: “Unë ju godita, jua dhashë edhe një goditje tjetër, përveç këtyre taksirave që keni, se ashtu më urdhëroi partia dhe qeveria”.

Një turp i tillë është që mediokriteti, pazotësia, budallallëku shtetëror, qëndrimi i egër

antisocial, sigurisht nuk kanë kufij. Ama, është e qartë se të gjithë do të reagojnë në mënyrën e tyre. Mos shpresoni që me këtë ligj do të jeni të lumtur dhe të gjithë ata do të thonë: shyqyr që na goditët dhe na futët pas shpine thikën e radhës!

Sigurisht, për këto arsye jo vetëm do të jetë një votë kundër, por edhe nuk do të lodhem duke e shpjeguar këtë votë kundër kudo nëpër Shqipëri.

Së pari, të gjithë kolegëve të profesionit të tim do t'u them: ky është armiku i egër që, pasi u bëri ditirambe në kohën e pandemisë dhe të Covid-it, që ishin seç ishin, në shpërblim u dha edhe këtë nga mbrapa.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Vasili!

Fjalën e ka zoti Salianni, i cili nuk është në sallë. Konsiderohet se është tërhequr.

Zoti Berisha? Po ashtu, konsiderohet që është tërhequr.

Zoti Spaho, dëshironi ta merrni fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Spaho, fjala është për ju.

**Florenc Spaho** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Në fakt, sot u fol gjerë e gjatë mbi ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”, por u fol edhe për pjesën e rrogave, për pagat që nuk janë ngritur, që janë njësoj. Në fakt, nuk është e vërtetë.

Një fakt i pakundërshtueshëm, eksperiencë imja, në vitin 2007, kur kam filluar punë në spitalin e Elbasanit, pagat e mjekëve dhe të infermierëve përafërsisht ishin 30 mijë lekë të rinj në muaj, ndërsa sot janë trefishuar dhe katërfishuar. Madje, mbi këtë pagë, që është katërfishuar, Kryeministri Rama, në fakt, bashkë me ministren e Financave dhe atë të Shëndetësisë, vendosën të japin për çdo mjek specialist 500 dollarë plus mbi rrogën. Në fakt, edhe infermierëve, të cilëve u është shtuar apo u është trefishuar paga mujore që nga viti 2007, do t'u rritet 7% nga 1 janari i vitit 2024 dhe do të vazhdojë të rritet akoma më shumë.

Unë nuk dua të zgjatem me pjesën e shifrave dhe të teknikaliteteve, sepse e bënë më mirë kolegët e Komisionit të Ekonomisë. Në fakt, do të dëshiroja që ky ligj, i cili prek shumë shtresa, të vinte edhe në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, pasi aty kemi kolegë të nderuar mjekë, por edhe kolegë të nderuar që



marrin vesh shumë mirë nga shifrat, janë ekonomistë apo kanë punuar në sektorin e shëndetësisë dhe kanë menaxhuar institucione nga ana ekonomike dhe financiare.

Profesionet e lira janë për ne një partner i vërtetë, sepse shumë profesionistë (avokatë, ekspertë kontabël, mjekë, logopedë, fizioterapistë) kanë ndërtuar bizneset e veta dhe, përveç kësaj të fundit, kanë pasur edhe mundësi të afrojnë kolegë të tjerë në bizneset e tyre.

Do të dëshiroja, në fakt, që mendimet tona, të kolegëve të Komisionit të Shëndetësisë, të ishin të pasqyruara edhe në këtë ligj.

Ne kemi sot një turizëm mjekësor shumë të mirë. Pacientë nga vende të ndryshme të Bashkimit Europian dhe të rajonit vijnë dhe i marrin trajtimet nga kolegët profesionistë që punojnë në Shqipëri. Kjo do të thotë që iniciativat e qeverisë shqiptare kanë bërë të mundur që kolegë profesionistë, sidomos të profesionit të shëndetësisë, të investojnë jo vetëm në burime njerëzore dhe në infrastrukturë, por edhe në teknologji, gjë e cila do të thotë që ne sot jemi një vend i cili konkurren bindshëm vendet e rajonit, por edhe Bashkimin Europian për sa u përket profesionistëve shumë të mirë, anës teknologjike dhe investimeve që janë bërë në këto biznese.

Gjithashtu, do të dëshiroja, zonja Ministre, që në udhëzimet që do të nxirri nga 1 janari 2024 të shikohet pak e ndarë fasha e profesionistëve të shëndetësisë, pra e profesioneve të lira që e kapin këtë fashë.

Nuk jam me ata profesionistë që bëjnë shpeshherë zhonglerin, nuk jam as me ata profesionistë që u shmangen taksave, por jam me ata profesionistë të cilët me mundin e tyre kanë ngritur një biznes, jam për ata profesionistë të cilët meritojnë të stimulohen. Sot këta profesionistë janë bindshëm nga më të mirët që ne kemi dhe na bëjnë krenarë duke dhënë shërbimin e tyre për pacientë të cilët vijnë, siç e thashë më lart, nga vendet e rajonit, por edhe nga Bashkimi Europian.

Si mund t'i stimulojmë? Unë mendoj që për sa i përket fashës së bizneseve të vogla deri në 14 milionë, ndoshta në udhëzim, zonja Ministre, mund të shikohet pak që të ulet fasha. Sepse nga 1 janari i vitit 2021, edhe pse, në fakt, në një vit pandemik, ne arritëm ta zëronim tatimfitimin dhe TVSH-në.

Nuk është njësoj fasha e profesioneve të lira, me gjithë respektin maksimal për ata kolegë

juristë apo ekonomistë, që ndoshta hapin NIPT-e personale, të veçanta, brenda një biznesi për t'iu shmangur taksave. E thashë, nuk jam për ata të cilët abuzojnë për t'iu shmangur taksave apo bëjnë këto lojëra, që ndoshta edhe zhonglerët më të mirë do t'i kishin zili, por jam për ata profesionistë që punojnë ndershmërisht dhe kanë nevojë të stimulohen, si dhe që t'i rrisin kapacitetet e tyre edhe duke punësuar kolegët e vet në bizneset e tyre, sepse ne sot jemi për të stimuluar profesionistët që janë në fashën e profesioneve të lira.

Absolutisht, është gjë shumë e mirë për pagat heqja e taksave për pagat që do të jenë 40 mijë lekë deri në 50 mijë lekë të rinj apo për uljen e taksës së pagave që është mbi 50 mijë lekë, por do të dëshiroja që tek udhëzimet të shikohet ndjeshëm fasha e profesionistëve të shëndetësisë.

Ne që jemi në Komisionin e Shëndetësisë dhe i përkasim këtij profesioni e dimë mirë se të punosh në institucione shtetërore është një gjë dhe sot, në fakt, mjekët, infermierët, fizioterapistët, i gjithë stafi mjekësor punon në një klimë shumë herë më të mirë sesa punonte më parë, shërbimin e jep në një klimë edhe më të mirë seç e jepte dhe pacienti bindshëm ndihet edhe më mirë. Por të ndërtohet një biznes në shëndetësi nuk është aspak e lehtë. Nuk flasim vetëm për ata profesionistë që mund të kenë 10 vjet, 15 vjet apo edhe më shumë që kanë klinikat e tyre, që kanë ndërtuar biznesin e tyre.

Ta mendojnë pak si është hapja e një biznesi për një profesionist që ka mbaruar për stomatologji, mjekësi, fizioterapi, logopedi.

Që të konkurrosh sot, duhen të ardhura mjaftueshëm. Të blesh pajisjet mjekësore është e kushtueshme. Atëherë, të mendohet si të gjendet një mekanizëm i tillë që të paktën për ata profesionistë, që sapo e kanë hapur biznesin dhe janë të vetëpunësuar apo kanë punësuar edhe kolegë në atë biznes, të gjendet një mekanizëm për t'iu shmangur nga kjo taksë.

Jam besimplotë që me punën tuaj, zonja Ministre, sidomos me rritjen e pagave të mjekëve, që, në fakt, sot është pagë që konkurren edhe rajonin (e theksoj, nuk është e vërtetë që janë pagat më të ulëta), të ndihmohen edhe me stimuj të tillë për sa u përket të ardhurave mbi tatimfitimin.

Ligji i fiskalizimit, në fakt, shpeshherë nuk mund të parashikohet për të parë se si mund të

pritet apo se çfarë benefitesh mund të sjellë, prandaj shpeshherë ligjet fiskale kanë edhe përmirësime, mund edhe të rishikohen.

Unë jam besimplotë, zonja Ministre, ndaj, ju lutem, rishikojeni udhëzimin për sa u përket fashave të profesionistëve të lirë të mjekësisë.

Faleminderit!

*(Drejtimin e seancës e merr Kryetarja e Kuvendit, zonja Lindita Nikolla.)*

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Xhemal Qefalia.

**Xhemal Qefalia** – Faleminderit, zonja Kryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Në fakt, ky është një ligj që kërkon ekspertizë dhe unë nuk pretendoj të jem ndër ata ekspertët e mirë të ekonomisë që ta kuptoj dhe interpretoj, por një gjë është e thjeshtë për qytetarët, për ata që na dëgjojnë dhe kanë interes që nga kjo seancë ta dinë se një ndërmarrje dhe një veprim i tillë nga ana e qeverisë është produktiv.

Pse është e nevojshme norma progresive 15% dhe 23% për të ardhurat nga vetëpunësimi dhe tregtia për personat fizikë? Shumë kolegë e përmendën, madje u ndalën edhe në statistika, në shifra, ndërsa unë po ndalem konkretisht. Vetëm 6 persona e deklarojnë fitimin neto mbi 100 milionë lekë secili, 36 persona të tjerë deklarojnë fitimin mbi 30 milionë lekë secili; 119 persona të tjerë, pra veç, janë ata që e deklarojnë fitimin mbi 14 milionë lekë secili. Po t'i mbledhësh të gjithë këta, sipas një llogarie të thjeshtë, bëjnë 161 persona, shifër tek e cila unë besoj shumë, pasi janë mbledhur tamam me seriozitetin që ka, me të drejtë, zonja Tabaku, si një ekonomiste e zonja, dhe nuk besoj të jenë shifra që i ngatërron përherë ai “7 herë 7, 42” e të tjerë.

Në këtë këndvështrim, do të ndalem edhe në disa momente që kanë qenë objekt diskutimi gjatë seancës së sotme.

Ishit të shqetësuar, madje të brengosur, të sikletosur, pse ne ndajmë taksën e luftës për pensionistët. Po ta thoshim dhe të mos e konkretizojmë, do të na thoshit: “Ju kështu i gënjeni. Ju kështu i mashtroni. Bëni premtime para fushatës elektorale”.

Në fakt, ne e bëjmë konkretisht. Pse ndiheni keq? A nuk besoni që edhe prindërit, të afërmit

tuaj, ata që janë pensionistë do ta përfitojnë këtë? Pse duhet t'i kategorizoni edhe pensionistët?

Pra, kjo është një gjë shumë pozitive, të cilën duhet ta mirëprisni dhe ta thoni.

Njësoj u shqetësuar edhe për ushtarakët, që përfituan vitin e kaluar në masën 30%, që përfituan sivjet në masën 7%. Të njëjtin shqetësim patët edhe për Policinë e Rendit, të Krimeve, por edhe për Policinë e Burgjeve.

A menduat dhe a jeni inkurajues për t'i përkrahur edhe mjekët, ku mjekëve specialistë do t'u rritet paga në masën 500 mijë lekë të vjetër? Pra, ky është një tregues dhe vëmendja e jashtëzakonshme që ka Kryeministri Rama dhe kjo qeveri për t'i mbështetur individët, pse jo, për të qenë gati-gati të barasvlerësuar me punën që bëjnë.

Çfarë themi ne? Që paga minimale të jetë 400 mijë lekë të vjetër.

Sa e kishit ju? 190 mijë. Po pse bëheni keq për këtë? Ju duhet ta duartrokisni këtë nismë, pasi është një gjë pozitive që i detyron edhe sipërmarrësit privatë t'i trajtojnë me dinjitet qytetarët e thjeshtë. Edhe këtë nuk keni pse ta anashkaloni, duke përmendur shifra për të çoroditur elektoratin. Boll e çoroditët me këto listat e fundit që nxorët për kandidatë; disa me vulë, disa pa vulë.

Çfarë po bëni? A e kuptoni se si i keni çoroditur apo jo? I futët në listë tani së fundi këta dhe i detyroni të dorëhiqet njëri, të dorëhiqet tjetri. A pyesni një herë pse po ndodh kjo? Çfarë po ndodh?

Jam shumë i kënaqur si deputet i Tiranës që ka shumë kandidatë në Tiranë, se ka më shumë alternativa, ka më shumë program, ka më shumë mundësi që qytetarët të zgjedhin. Dhe kjo është një gjë. Nuk kam asgjë me kandidatin e caktuar së fundi, nuk dua t'ia përmend as emrin, se nuk e njoh nga afër, por është një produkt pozitiv i pluralizmit në vend. Por ju keni filluar edhe disa fushata këtu në Tiranë, duke thënë gjëra që nuk realizohen, gjëra që nuk ndodhin.

Çfarë thoni ju? A nuk thatë kështu nëpër fushatat elektorale: “Mos paguani drita, mos paguani ujë” dhe në fund fare i morët njerëzit më qafë?

Jo, mor, jo, të gjitha arritjet në Tiranë, flas konkretisht si deputet i Tiranës, nuk janë në 3D, janë reale! Por ju kështu e kundërshtuat.

Harruat që shumë pak metra nga këtu ku jemi, te sheshi “Skënderbej”, që të shkoje te kali, flas për ata që vinin nga rrethet, duhej të hiqje këpucët, sepse shkelje barin? E kundërshtuat.

A e kundërshtuat Pazarin e Ri? Ja ku është. Pra, është realitet, nuk është 3D!

A e kundërshtuat Parkun? Po stadiumin këtu e kundërshtuat? Pra, gjërat ndodhin realisht, nuk janë gjëra që jepen sa për të përcjellë mesazhin që nuk ndodhin.

A thatë se shkollat nuk bëhen? Janë bërë shkolla. Madje, thatë për shkollën “Sami Frashëri”, se kishit informacione të sigurta që kjo shkollë do të bëhej në Paskuqan. Po, ju e bëtë prapë. A e keni parë sot?

Po ç’t’ju them, mor?! Se në Tiranë i shikoni ju, se i keni afër! Madje, thoni se Tirana është shumë e zhurmshme, Tirana ka ajër të ndotur, ndërkohë që të gjithë vini në Tiranë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Madje edhe statistikën, tiranasja ime Tabaku, tregojnë që në një vit, vijnë për të jetuar në këtë Tiranë, rreth 25 mijë persona. Përse e zgjedhin Tiranën? Kjo i ka bërë që ata të jenë shumë kandidatë që aspirojnë të jenë kryetarë bashkie në Tiranë.

Prandaj unë nuk po ndalem vetëm me qytetin, por si deputet që mbuloj edhe zonat në periferi të Tiranës, them që nuk është vetëm shkolla “Kosova” apo “Sami Frashëri”, por janë edhe shkolla të tjera. Shkoni te “Fresku”, te njësi administrative nr. 12, keni dy shkolla të reja moderne, shkolla “Luan Hajdaraga” dhe “Klodian Tanushi”.

Doni shkollë tjetër moderne, që kurrë nuk është menduar ndonjëherë dhe nuk do të ndodhte t’u bënte, siç është bërë në Mangull, në Petrelë, siç është bërë në Tapizë, në Zall-Herr?

Rrugët. Natyrisht, ka rrugë ku nevojitet të ndërhyhet, por janë bërë ndërhyrje të tilla që nuk janë bërë ndër vite dhe ato njësi administrative, nëse kjo mazhorancë nuk do ta kishte miratuar reformën administrative, nuk do t’i bënte kurrë. Për 77 vjet mund të bëhej rruga në Kërrabë, rruga për në Zall-Bastar. Pra, këto gjëra janë bërë. Ama, jam i bindur që alternativat e kandidatëve që janë këtu në Tiranë, sidomos të kandidaturave të fundit, do ta vënë në punë patjetër kryetarin e Bashkisë së Tiranës, që është fitues edhe për mandatin tjetër, për të paraqitur alternativa bindëse, alternativa fituese.

Unë shpresoj që edhe pala tjetër, pavarësisht vullës apo bashkimit nga shtëpia në “apartamentin e lirisë”, të bëjë një garë dinjitoze dhe të fitojë më i miri. Dhe më të mirë janë ata të Partisë Socialiste.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Eduard Shalsi, në emër të grupit.

**Eduard Shalsi** – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

I kam dëgjuar me vëmendje sot, në fakt, të gjithë kolegët deputetë dhe më duhet ta sqaroj, edhe në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, që në krye të herës procesin.

Nuk jam i surprizuar nga sjellja e opozitës, në fakt, por ligji erdhi në parlament në fund të nëntorit dhe, për shkak të disa detyrimeve që kishim marrë përsipër para partnerëve tanë financiarë, në rastin konkret Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore, ligji duhej të kalonte në fund të muajit dhjetor.

U ulëm bashkërisht, shprehëm shqetësimet tona dhe rakorduam, gjithmonë në linjë edhe me ministrinë, që ligji kishte nevojë për disa rregullime dhe saktësime. Jua shtrimë dorën edhe juve si opozitë, pavarësisht grupimeve brenda jush, sepse besonim fort që është një ligj të cilën duhet ta mbështesim të gjithë në parlament.

Ligji i vjetër daton në vitin 1998, i amenduar me dhjetëra, qindra, e nuk e di, ndoshta, mijëra herë. Pra, të gjithë konsideronim që ka ardhur koha për një ligj të ri, të mirëstrukturuar dhe të thjeshtë.

Përgjatë muajve janar, shkurt, mars kemi zhvilluar me dhjetëra e dhjetëra mbledhje në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, edhe pasditeve të vona, dhe u kemi dhënë mundësi të gjitha grupeve të interesit dhe cilitdo, qoftë edhe individ që kishte diçka për të thënë, që të dëgjohej.

Pas tre muajsh, një nga kolegët e nderuar deputetë të opozitës na kërkoi, pra në mbledhjen e fundit, të thërrisnim një grup interesi, ndërkohë që ai grup ishte dëgjuar mbi 2-3 herë.

E pra, nuk mund ta fsheh zhgënjimin tim për një pjesë tuajën që, gjatë tre muajve jo vetëm nuk mori pjesë në mbledhjet e komisionit, jo vetëm nuk dha ndonjë *feedback* apo edhe kritikë pozitive, por sot, edhe brenda fjalimeve tuaja ka (nuk di ta them, por ndoshta-ndoshta nuk e keni

kuptuar as frymën e ligjit, as thelbin e ligjit) kontradikta në ato që thoni, le më pastaj se çfarë i keni bërë ju biznesit të vogël dhe çfarë i kemi ofruar ne.

Ama, ne nuk e kemi fshehur që duam një sistem të drejtë tatimi, nuk duam një sistem të bazuar mbi statusin juridik qoftë të personit fizik, por duam që secili të paguajë në mënyrë *fair play* pjesën që i takon. E pra, ky ligj ka strukturuar pikërisht këto shqetësime dhe kemi dëgjuar, po themi, Shoqatën e Bankave, që, po, kishte një problem, por kemi pasur debat edhe me Ministrinë e Financave e cila kërkonte që borxhin e keq të mos e përfshinin brenda bilanceve të tyre, ndërkohë që kishte një vendim të formës së prerë të Gjykatës.

E rakorduam, i dëgjuam, dhe kemi sot një variant më të mirë.

Kishim një shqetësim nga *Fintech*-u, është një industri që po zhvillohet në Shqipëri, e cila donte të merrnim në konsideratë shqetësimet e tyre që kishin të bënin me trajtimin e barabartë që donin me sistemin bankar. E morëm në konsideratë.

Kemi dëgjuar edhe grupet e kontabilistëve, shoqatat, por edhe kontabilistë të veçantë, të cilët shprehën shqetësimet e tyre. Kishte një numër, po themi, jo të vogël në aspektin e terminologjisë që përdorte ligji, që duhej sqaruar akoma më mirë.

Por unë dua të falënderoj, në radhë të parë, për këtë punë voluminoze disavjeçare, Ministrinë e Financave, specialistët e saj, që arritën më në fund, pas kaq e kaq vitesh, të na prezantonin një ligj.

Së dyti, dua të falënderoj kolegët deputetë, madje do t'ju falënderoja sinqerisht nëse gjatë kësaj periudhe do të ishit bërë pjesë e atyre takimeve dhe debateve të panumërta që kemi pasur në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, qoftë edhe deputetët e opozitës. Ju e dini, unë nuk e kam fshehur ndonjëherë konsideratën për disa prej jush dhe as e kam pasur zakon të mos ju falënderoj kur keni kontribuar, sepse kemi nevojë për debate të tilla, në fakt.

Kemi nevojë për debate të tilla cilësore, por rrallë qëllon edhe në këtë parlament që të bëhen debate cilësore për tema konkrete dhe ekonomia është një gjë tek e cila duhet të përqendrohemi shumë e shumë më tepër.

Por çfarë kundërshtuat sot? Kundërshtuat 40-mijëlekëshin apo 50-mijëlekëshin e të

ardhurave të asaj kategorie njerëzish që padrejtësisht paguante? Nuk arrita ta kuptoj nga debatet tuaja. Ishit kundër? Çfarë kishit me to?

Ky ligj merr përsipër të rregullojë edhe një problem të evidentuar, që kishte të bënte me personat fizikë, të cilët në 2-3 vjetët e fundit u shumuan padrejtësisht në kurriz të disa shtresave të tjera. Po i qanit hallin kujt?

Me grupin e ekspertëve kontabël kemi pasur sesione të veçanta, pikërisht për të adresuar atë shqetësim tonin që secili në këtë vend të paguajë pjesën e tij dhe jo një klasë të rrojë në kurriz të shtresave të tjera. Pra, ka masa konkrete. Ky ligj, përveçse është i thjeshtë, i strukturuar mirë, ka edhe masa konkrete të cilat targetojnë fashën e atyre që paguajnë deri në 400 mijë lekë të vjetër ose 40 mijë lekë të rinj. Përfshihen ata që shkojnë deri në 50 mijë lekë.

Statusi ligjor nuk është qëllimi ynë. Jo, ne po nisemi në këtë ligj nga të ardhurat, nga fitimi. Ishte e padrejtë që një person fizik të përjashtohet për një aktivitet, ku shifrat na dhanë të kuptojmë që nuk paguanin, ndërkohë që duhej të paguanin.

Është një moment, në fakt, që duhet t'ju bëjë të reflektoni në lidhje me sfidat që kemi dhe mënyrat se si duhet t'u qasemi. Ndoshta një pjesë juaja nuk e ka problem kur dëgjon një kandidat të thotë se do të ofrojë falas biletat e autobusëve. Ndoshta nuk e keni fare problem të mos jeni të vetëdijshëm për çfarë thonë disa nga kandidatët tuaj, por ne kemi përgjegjësi në qeverisje.

*(Zhurmë teshtitjeje në sallë.)*

Shëndet, zonja Aça dhe meqenëse të urova shëndet, dje më qëlloi rastësisht të shihja...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Zonja Aça, dje më qëlloi t'ju shoh si kurrë ndonjëherë debatuese të fortë këtu...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Më qëlloi dje të shihja pak televizor dhe të them të drejtën u revoltova nga disa demokratë se ç'thoshin për ty e për disa nga kolegët, po ia thosha edhe Joridës. Ishte e tmerrshme...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Edhe për ty, edhe për ty!

Kur i drejtohesh me inat kësaj palës këtu nganjëherë, dhe kur po dëgjoja ç'thoshin dje, rastësisht, teksa po bëja një *zapping* në televizion, thashë: kjo është e padrejtë!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Zoti Leskaj, jua thashë edhe në komision...

*(Bie gongu.)*

...se do ta çmoja nëse do të kontribuonit në ligj dhe nuk do të kujtoheshit ditën e fundit për të folur për të gjitha ato grupe interesi që, në fakt, i kemi dëgjuar me shumë vëmendje.

Po, është e vërtetë, jo çdo gjë e kemi marrë në konsideratë.

Është e vërtetë që do ta monitorojmë zbatimin e ligjit me shumë prurësi dhe këtu i lind një përgjegjësi e madhe Ministrisë së Financave, sidomos Drejtorisë së Tatimeve të Shqipërisë, për të implementuar dhe monitoruar saktë efektet e këtij ligji.

Edhe një herë, duke e falënderuar gjithsecilin për punën e bërë, mezi presim aplikimin e këtij ligji, i cili do të hapë në mënyrë definitive një kapitull të ri në historinë e taksimit dhe menaxhimit të taksave në Shqipëri.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Këtu mbyllet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Në rendin e ditës janë edhe dy projektvendime, të cilat i keni në sistem, por i keni marrë edhe në rrugë elektronike.

Bazuar në projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”, deputeti Shpëtim Idrizi caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Bazuar në të njëjtin projektvendim, deputeti Shpëtim Idrizi caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

Këto projektvendime votohen pa diskutime.

Ju bëj me dije se në Konferencën e Kryetarëve, në kuadër të diskutimit të programit të punimeve të Kuvendit për periudhën 10 prill – 19 maj dhe kalendarit të punimeve, nga kryetarët e grupeve parlamentare u diskutua edhe harmonizimi i punës së Kuvendit me pjesëmarrjen e deputetëve në fushatën zgjedhore për zgjedhjet vendore të 14 majit. Gjithashtu, në Konferencë u soll në vëmendje edhe tradita e mëparshme parlamentare, si dhe nevoja e ruajtjes së kontrollit parlamentar në cilësinë e legjislatorit dhe çdo roli tjetër që ka Kuvendi.

Për sa më sipër, tri seancat e parashikuara në këtë program do të zhvillohen gjatë programit pasardhës të punimeve të Kuvendit. Seanca e datës 13 prill do të zhvillohet siç është

parashikuar, ndërsa, në varësi të nevojave të punës së Kuvendit, do të zhvillohet edhe një seancë tjetër, e cila do të njoftohet sipas nenit 27/1, pika 3, të Rregullores.

Faleminderit!

Bëhemi gati për të kaluar në procesin e votimit.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

80 deputetë janë prezentë.

Vazhdojmë me votimin e akteve.

Fillojmë me votimin e projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit për vitin 2022”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit është një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 71 vota pro, 9 kundër, 1 abstenim.

Projektrezoluta miratohet.

Vazhdojmë me votimin e projektligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedura e votimit është dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Ju lutem, votoni!

Zoti Xhelili, nuk keni votuar.

Mbyllet votimi.

Janë 69 vota pro, 12 kundër, asnjë abstenim.

Zoti Xhelili votoi me karton.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të komisionit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

*(Nenet nga 2 deri në 68 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)*

Përpara se të votojmë nenin 69, në bazë të nenit 76 të Rregullores së Kuvendit, do të votojmë amendamentin e zonjës Tabaku.

Zonja Tabaku, keni 7 minuta kohë për të paraqitur amendamentin tuaj.

**Jorida Tabaku** – Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Fatkeqësisht, me këtë ligj 17 mijë profesionistë të lirë do të përfshihen në skemën e tatimeve. Njëkohësisht, të gjithë kolegët e mi të Fakultetit të Ekonomisë, të cilët më kanë shkruar dhe e kanë ndjekur me shumë interes këtë seancë, pyesin veten si ka mundësi që në Shqipërinë e vitit 2023, kur thuhet se do të rritet paga mesatare,

puna dhe profesionisti nuk kanë vlerë; si ka mundësi që një person, i cili ushtron një profesion dhe investon për të, sot do të mbitaksohet.

Unë ia thashë pak më parë edhe ministres së Financave që kjo seancë të paktën kishte një lajm të mirë: ministrja tha që këta persona abuzonin. Po, abuzonin, sepse sistemi i tatimit socialist u krijonte atyre mundësi të abuzonin. Niveli me gjashtë taksa, që kjo qeveri ka prezantuar, por njëkohësisht edhe katër nivelet e ndryshme të biznesit të vogël: 5 milionë lekë, 8 milionë lekë për taksat lokale, 10 milionë lekë, 14 milionë lekë për kufirin e biznesit të vogël, nxisin informalitetin. Sot sistemi është informal, sepse është ndërtuar i tillë. Sistemi sot është përjashtues për një grup biznesesh, por nga ana tjetër nuk e vlerëson punën.

Unë i kam ndjekur me interes të gjitha diskutimet e ditëve të fundit për këtë ligj, por edhe për pagën mesatare në Shqipëri, e cila po tentohet të rritet me urdhër dhe vendim qeverie në një nivel të caktuar. Pagën mesatare e rrit tregu, e rrit investimi i biznesit, e rrit ekonomia, nuk e rrit dot qeveria. Është e pamundur të rritësh pagën mesatare në administratën publike dhe njëkohësisht t'i thuash edhe sektorit privat ta rrisë. Kur privati e rrit pagën, atëherë mund ta shoqërojë edhe administrata publike, sepse e ka të pamundur t'i mbajë ata persona në punë, por jo të ndodhë e kundërta.

Le t'i krijojmë mundësi ekonomisë shqiptare të rritet, të krijojmë një model ekonomik që ndoshta sjell edhe zhvillim, por kjo është e pamundur nëse të vetmet opsione që diskutohen sot janë amnistia fiskale dhe legalizimi i kanabisit, sepse nuk mund të jenë këto të vetmet burime për të gjeneruar rritjen e ekonomisë.

Mendoj se është e padrejtë, e pandershme dhe e pabarabartë që këta 17 mijë profesionistë të taksohen sot deri në 23% për shkak se qeveria socialiste është e paaftë të kontrollojë sistemin në mënyrë që të mos ketë informalitet. Pse duhet të vuajë një grup prej 17 mijë individësh nga paaftësia që shteti ka për të menaxhuar dhe administruar taksën, por duhet të paguajnë patjetër taksa? Është e pamundur të ekzistojë një shtet pa taksa, sepse buxheti i shtetit ka nevojë për të ardhura, por nuk është kjo mënyra.

Në fakt, ishte e nevojshme që ligji i tatimit të ndryshonte, sepse bëhej fjalë për një ligj të vitit 1998, i cili ishte i ezauruar. Unë i përshëndes të

gjitha konceptet e reja që janë prezantuar në ligj, konceptet që lidhen me borxhin e bankave, diskutimet që janë bërë në Komisionin e Ekonomisë, por në fund të ditës të gjitha ndryshimet e reflektuara në ligj ishin thjesht kozmetikë, sepse nuk e prekën thelbin e ligjit. Ndryshimet nuk bënë të mundur që sot ky grup profesionistësh të mos konsiderohet si çdo biznes tjetër normal, sepse nuk kanë si të jenë si çdo biznes tjetër normal. Ky grup profesionistësh (e dëgjova me shumë interes zotin Spaho) i përbërë nga mjekë, fizioterapistë, avokatë dhe farmacistë duhet të paguajë tatim, por duhet t'u ofrojmë mundësinë e një sistemi të ndershëm, e një sistemi që ta nxisë pagesën e taksave, jo që ta dekurajojë pagesën e taksave, sepse shteti nuk mund të qëndrojë përherë në këmbë si xhandar për t'i ruajtur bizneset.

Sigurisht, forcat politike ndahen për sa i përket politikës së taksave, që është tagër i qeverisë, por ky ligj është antikushtetues, sepse përcakton që biznesi i vogël do të fillojë të paguajë një taksë në vitin 2029. Një qeveri nuk mund të përcaktojë taksat që do të aplikohen pas 8 vjetësh. Nëse doni, rritini taksat sot, përfshijeni biznesin e vogël në skemë, bëni eksperimente ashtu siç keni bërë në 9 vjetët e fundit, por të thuhet që në vitin 2029 biznesi i vogël do të ketë këtë taksë, unë nuk besoj se mund të ekzistojë në ndonjë shtet të botës që qeveria të përcaktojë pas dy mandatesh se çfarë do të ndodhë me taksën e biznesit të vogël.

Disa ndryshime që bëhen sot në ligj mund t'i kisha përshëndetur dhe votuar, sidomos përjashtimin deri në 40 mijë lekë. Unë insistova që ky ligj të vinte me buxhetin e shtetit pikërisht për arsyen që të mos bëheshim ne pengesë (po, e drejtë, zoti Braçe) për përjashtimin deri në 50 mijë lekë, por ju nuk të lini as të përshëndesësh, as të miratosh apo aprovosh asnjë ligj.

Po në të njëjtin vend keni futur një taksë të re për një kategori të re, që unë besoj se duhet të paguajë, por jo në këtë mënyrë. Për këtë arsye, në amendamentin që kam prezantuar unë kam propozuar që të paktën të ketë të njëjtin trajtim si bizneset e vogla: të mos futet në fuqi në vitin 2024, por në vitin 2029.

Dëgjova dikë të thoshte që çështja e buxhetit është një gropë, që në fillim është e padukshme, pastaj bëhet e dukshme dhe më pas na merr të gjithëve përpara. Kështu është edhe sistemi i

taksave që ka ndërtuar qeveria. Taksën me gjashtë nivele dhe sistemin progresiv shtresa e mesme nuk e kuptonte në fillim, sepse ishte e padukshme, por pastaj filloi t'i kuptonte efektet, filluan të largohen masivisht dhe të tatonen gjithmonë e më shumë, sepse ato janë atje.

Pse nuk miratojmë të gjithë bashkë një ligj për të hequr përjashtimet nga TVSH-ja për hotelet me pesë yje? Në qendër të Tiranës ka filluar të ndërtohet një kullë e lartë, por i kanë vendosur një emër hoteli. Përdorin të gjitha përjashtimin nga ligji për të abuzuar me ligjin dhe për të marrë favore fiskale. Pse të mos miratojmë të gjithë bashkë një ligj për të eliminuar të gjitha këto përjashtime? Ju po hiqni një përjashtim për 17 mijë profesionistë, por nga ana tjetër po lejoni të gjitha përjashtimet e tjera të mundshme për bizneset e mëdha. Prandaj, kjo është qeveria e pakicës.

Në fund, dua t'i them disa fjalë edhe zotit Shalsi. Zoti Shalsi, është e vërtetë që më keni kërkuar disa herë të përfshihem në diskutimet e ligjit në komision, për të cilat jo gjithmonë kemi genë dakord.

Diversioni dylekësh, që disa demokratë shajnë disa demokratë të tjerë, nuk më bën fare përshtypje në këtë fazë që kam arritur. Nuk u pëlqejmë dot të gjithëve, zoti Shalsi, por të paktën mbajmë një qëndrim, sepse nuk mund të jenë të gjithë pa shtyllë kurrizore.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** - Kush e do fjalën nga anëtarët e komisionit?

Po, zonja Gjylameti.

**Blerina Gjylameti** – Faleminderit, Kryetare!

Do t'i dëgjoja me shumë kënaqësi të gjitha këto propozime të zonjës Tabaku nëse do ta kishte marrë fjalën gjatë mbledhjes së komisionit dhe do të ishte bërë pjesë e të gjitha diskutimeve me grupet e interesit.

Edhe unë, si pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, bashkë me profesorët e Ekonomikut, të cilët i përfaqësoni në Shoqatën e Ekspertëve Kontabël, i kam dëgjuar me shumë vëmendje propozimet e të gjithë ekspertëve kontabël. Nëse duam të flasim për drejtësinë e taksimit, ky ligj ka vendosur një taksim të drejtë dhe të ndershëm, sepse një avokat i punësuar në një studio nuk mund të paguajë kurrësi më shumë tatim mbi të ardhurat sesa një avokat i cili ka një biznes. Duhet të ndajmë qartë

çfarë do të thotë tatim mbi të ardhurat nga puna dhe çfarë do të thotë biznes. Të flasësh në emër të shumicës ndërkohë që i konsideron pakicë 97 mijë biznese të vogla, për të cilat tatimi është zero, do të thotë të jesh e gabuar. Ndaj, ne jemi komplet kundër këtij propozimi.

Po ashtu, dua të përmend edhe një element tjetër. Përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat për të gjithë ata që kanë pagë mbi 50 mijë lekë prek 110 mijë të punësuar, duke përfshirë edhe lehtësitë fiskale që do të kenë të gjithë të punësuarit me pagë 50 mijë deri në 60 mijë lekë.

Nuk flasim për pakicat, por vijojmë me politikën tonë sociale, që e kemi pasur që kur kemi ardhur në pushtet në vitin 2013, për të mbështetur ata që fitojnë më pak, për të mbështetur dhe përjashtuar nga taksat shumicën, jo pakicën. Është vendosur një rregull shumë i drejtë për sa kohë të gjithë ata që kanë përfutuar nga hapësirat ligjore për të kaluar në person fizik, kanë bërë një evazion fiskal.

Nëse flasim për tatim të ndershëm dhe të drejtë, duhet të luftojmë evazionin dhe të jemi shumë korrektë kur i përdorim termat.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** - Faleminderit!

Hedhim në votim amendamentin e zonjës Tabaku.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 15 vota pro, 68 kundër, asnjë abstenim.

Amendamenti nuk miratohet.

Vazhdojmë me votimin me kartonë.

Neni 69. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 70. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 71. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 72. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi me elektronikë.

Hapet votimi në tërësi.

Mbyllet votimi.

Janë 70 vota pro, 12 kundër, asnjë abstenim.

Projektligji miratohet.

Vazhdojmë me votimin e projektvendimeve.

Bazuar në projektvendimin "Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021 "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e

komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”, deputeti Shpëtim Idrizi caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit është një me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 79 vota pro, asnjë kundër, 1 abstenim.

Projektvendimi miratohet.

Bazuar po në projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr.70/2021 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”, deputeti Shpëtim Idrizi caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Ekonominë dhe Financat. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit është një votim me elektronikë.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 78 vota pro, 1 kundër, asnjë abstenim.

Projektvendimi miratohet.

Këtu mbyllet procesi i votimit.

Ju lutem, kolegë, do të vijojmë me diskutimet për çështje jashtë rendit të ditës!

Fjalën e ka zoti Isuf Çelaj.

Nuk dëshiron të flasë.

Kolegë, lëvizni pak më shpejt, se do të vijojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Zoti Leskaj, fjala për ju. Koha në dispozicion 5 minuta.

**Bujar Leskaj** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Unë do të flas për dy çështje të karakterit përkujtimor dhe historik.

E para, dua t’i bëj me dije Kuvendit se përpara një jave, ne, një grup dashamirësish, studiues të artit, politikanë, të rinj dhe të reja, përkujtuam 75- vjetorin e lindjes së poetit hero, Vilson Blloshmi. Poeti Vilson Blloshmi, lindur më 18 mars 1948, dhe poeti Genc Leka, lindur më 23 mars 1941, janë pushkatuar nga diktatura më 17 korrik 1977.

Fakti që unë marr nismën t’i përkujtoj në këtë sallë të Kuvendit të Shqipërisë, pavarësisht numrit të paktë të deputetëve, në radhë të parë është vlerësim, obligim dhe përlujtje përpara figurës së madhe artistike të këtyre dy poetëve; në radhë të dytë është përlujtje përpara qëndresës së

tyre, sepse këta heronj janë pushkatuar nga regjimi komunist, dhe së treti, ç’ka është më kryesorja, unë kam një kërkesë për ministren e Kulturës, që besoj se do t’i përcillet: “Shtëpia-muze e Vilson Blloshmit në Bërzeshtë të Librazhdit, e ndërtuar në fund të viteve 1800, ku ai ka pasur krijimet e tij, të shpallet monument kulture, të restaurohet dhe në këtë shtëpi të ndërtohet muzeu i poetëve Vilson Blloshmi dhe Genc Leka”.

Vëllai i tyre, heroi i gjallë Bedri Blloshmi, tashmë ka një dhomë muze ku ndodhen relike dhe dokumente të shumta në lidhje me përndjekjen dhe krimin makabër që regjimi komunist ushtroi ndaj këtyre dy poetëve, ndodhen vëllime të ndryshme të dosjeve të ndjekjes së tyre nga ish-Sigurimi, vëllime të korrespondencës letrare dhe poezive të tyre, si dhe botime të ndryshme që Bedri Blloshmi ka përgatitur në këto vite.

Mendoj se do të ishte në nderin e ministres së Kulturës dhe deputetëve të Elbasanit, specifikisht të Librazhdit, nëse do të ndërtojnë muzeun “Vilson Blloshmi dhe Genc Leka” në godinën e vjetër në Bërzeshtë, e cila ka nevojë për një rikonstruksion të plotë. Kjo shtëpi do të shërbejë edhe si një vend pelegrinazhi për qindramijëra të rinj, studiues, dashamirës të artit, e të tjerë.

Për veprën e tyre është bërë një punë e madhe nga profesori Sadik Bejko, i cili sot kremtoi 80-vjetorin e lindjes. Unë i uroj jetë të gjatë profesorit Bejko! Gjithashtu, janë bërë studime nga shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare, nga studiuesi Bardhosh Gaçe, vepra e veçantë “Memoriali në Librazhd” e skulptorit të shquar Sadik Spahia, dhe shumë e shumë të tjera.

Me kthimin e kësaj godine në shtëpi-muze ne realizojmë një nga objektivat madhore që shtrohen në rrugëtimin e Shqipërisë për në Europë, të cilat kanë të bëjnë me dekomunistizimin dhe me luftën për çrrënjosjen e krimeve të komunizmit dhe pasojave të tyre.

Diskutimin për këtë çështje do ta mbyll me vargjet simbol të Vilson Blloshmit:

“Nëse nuk munda brengës t’i bëj ballë,

zjarr përsëri kam në shpirt të ndezur.

Nëse më i vdekur jam se çdo i gjallë,

mirë pra, më i gjallë jam se çdo i vdekur”.

E dyta, nesër është data 31 mars. 31 marsi i vitit 1945 shënon një ngjarje të rëndë dhe tragjike në historinë e kombit shqiptar, pasi në këtë datë



trupat e ish-Jugosllavisë së Titos asgjësuan në Tivar të Malit të Zi një kolonë ushtarësh kosovarë të paarmatosur. Kjo ngjarje ka ndodhur 78 vjet më parë, kurse numri i ushtarëve të vrarë është rreth 1690 veta apo edhe më shumë.

Vrasja nga serbët e rinj, nga regjimi titist, në ato vite u kalua si një incident dhe gabim i tmerrshëm, por pastaj nuk u përmend më nga Titoja dhe ministri famëkeq Rankoviç, armiku i madh i shqiptarëve. Për fat të keq, nga viti '45 deri në vitin '90 pati një përrulje dhe servilosje tipike të Enver Hoxhës dhe regjimit të tij.

Kjo tragjedi dhe masakër e madhe ka një dëshmitar të gjallë nga Kosova. Në vitet 1966 dhe 1985 dëshmitari Azem Hajdini ka kërkuar nga autoritetet jugosllave zbardhjen e masakrës, kurse në vitin 2009 i është drejtuar Kuvendit të Kosovës dhe Kuvendit të Shqipërisë. Kuvendi i Shqipërisë ngriti një komision, që drejtohej nga deputeti i nderuar, Fatos Beja, por për fat të keq, për arsye të konjukturave politike nuk e konkludoi raportin e tij. Si një shtetar me përvojë dhe një deputet korrekt, ish-deputeti Fatos Beja e ka dokumentuar punën e komisionit përmes botimit "Krim Luftë në Tivar", raport për komisionin parlamentar.

**Sekretare e Sekretariatit për  
Procedurat, Votimin dhe Etikën  
Klotilda Bushka**

**Drejtoreshë e Shërbimit të Redaktorëve  
Suela Bala**

Gjithashtu, për masakrën e Tivarit kemi edhe një botim nga dëshmitari që përmenda më sipër, por edhe një botim nga profesor Uran Butka.

Në kuadër të thellimit të kujtesës historike, unë mendoj që ne si Kuvend i Shqipërisë duhet ta riaktivizojmë materialin e komisioni hetimor, i përgatitur nga ish-deputeti Fatos Beja dhe deputetë të tjerë të Kuvendit të Shqipërisë, për të mbajtur qëndrimin tonë si parlament. Hetimet parlamentare sot në botë nxisin një reagim publik në mbrojtje të vlerave njerëzore në çdo kontekst historik. Kujtoj këtu përvojën e mirë të miqve dhe vëllezërve tanë polakë për sa i përket masakrës të vitit 1940, e ideuar dhe drejtuar nga Stalini dhe Beria, në pyllin e Katinit, ku u pushkatuan 22 mijë ushtarakë polakë.

Kjo ishte kërkesa ime për ju dhe drejtuesit e tjerë të Kuvendit.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** - Faleminderit!

Këtu mbyllet seanca.

Seanca e radhës do t'ju njoftohet.

Natën e mirë!

*(Sanca u mbyll në orën 18:00)*

**Kryetarja e Kuvendit**

**Lindita Nikolla**